



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
NËNTOR 2021

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i dytë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2021

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 1, datë 23.07.2021
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake
Kryetari i Bordit
Gjeneral Brigade **Dr. Albert Mullai**

Anëtarët e Bordit
Gjeneralmajor **Prof Asoc. Dr. Bajram Begaj**
Kolonel **Dr. Ahmet Leka**
Kolonel **Msc. Fatmir Neziraj**
Kolonel (R) **Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi**
Prof. Asoc. Dr. Teki Kurti
Dr. Etleva Smaçi
Kolonel **Msc. David Rroku**
Msc. Blerina Vorpsi

Përgatiti për botim
Grupi i Redaktimit & Publikimit
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)
Copyright © 2021 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.
Copyright © 2021 by the Military Scientific Research Institute of the Academy of Albanian Forces.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: nëntor 2021

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË: Analiza, sinteza dhe vlerësime të sigurisë.....	7
Kërcënimet hibride, faktor përshpejtues i bashkëpunimit civilo-ushtarak në fushën akademike	
Dr. Shpëtim Cami	
Universiteti “Barleti”	11
Gjithëpërfshirja dhe integrimi i aftësive civilo-ushtarake - pjesë e strategjisë së sigurisë në kushtet e kërcënimeve hibride	
Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj	
IKSHU, AFA.....	17
Siguria kibernetike dhe kuadri ligjor shqiptar	
Dr. Elona Bano	
Universiteti “Barleti”	27
Infrastruktura kritike dhe siguria kombëtare	
Nënkolonel Msc. Bajazit Muceku	
IKSHU, AFA.....	37
Strategjia detare ruse	
Roland Tashi	
AISM.....	49
Lufta hibride, rast studimi Rusia	
Nënkolonel Dr. Fitim Karasani	
Major Msc. Enkelejda Tyrku	
FMS, AFA.....	57
Armët e Shkatërrimit në Masë - rrezik për paqen dhe sigurinë e popujve	
Nënkolonel Msc. Esat Neziri	
Nënkolonel Msc. Shpresim Shllaku	
FMS, AFA.....	69
Sfidat e “NATO 2030” - qasja doktrinare në të ardhmen	
Major Msc. Mirela Lahi	
IKSHU, AFA.....	79

RUBRIKA E DYTË: Punime nga konferenca për arsimin ushtarak.....	91
Kërkimi shkencor në fushën e sigurisë e të mbrojtjes	
Kolonel Dr. Ahmet Leka IKSHU, AFA Gjeneral Brigade (R) Dr. Bardhyl Hoxha.....	93
Arsimimi dhe kultura -ndikimi i tyre në sigurinë kombëtare	
Kolonel Msc. David Rroku, Kolonel Msc. Irela Nebiaj IKSHU, AFA.....	111
Doktrina si pjesë themelore dhe e pandashme e zhvillimit të kurrikulës arsimore ushtarake	
Kolonel Msc. Mehmet Metko, Nënkolonel (R) Alqi Nikolla IKSHU, AFA.....	127
Zhvillimi i kompetencave të reja profesionale në arsimin e lartë ushtarak shqiptar	
Dr. Etleva Smaçi FMS, AFA.....	147
Vizioni, domosdoshmëri për sukses	
Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi Dr. Valbona Zeka FMS, AFA.....	155
RUBRIKA E TRETË: Studime historike.....	171
Lufta e Dibrës - vendimtare për sovranitetin kombëtar shqiptar	
Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi Akademia e Sigurisë, Tiranë.....	173
Çetat kryengritëse shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore	
Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake.....	189
Përmbledhje në anglisht.....	202
Kujtesë për bashkëpunëtorët.....	219

RUBRIKA E PARË

Analiza, sinteza dhe vlerësime për sigurinë

Nevoja për bashkëpunim midis institucioneve akademike ushtarake dhe civile, përveç se në fusha të cilat përmirësojnë mësimdhënien dhe të nxëniet, diktohet edhe nga prania e kërcënimeve hibride ndaj sigurisë së individit, sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nisur nga nevoja për politika të reja në fushën e kurrikulave në arsimin ushtarak me qasje nga arsimi civil, *Dr. Shpëtim Cami* nga universiteti “Barleti” me shkrimin **“Kërcënimet hibride, faktor përshpejtues i bashkëpunimit civilo-ushtarak në fushën akademike”** synon të kontribuojë në këtë fushë, duke dhënë rekomandime për përfshirjen e disa elementëve të arsimit civil që synojnë njohjen e plotë të kërcënimeve hibride, pasi një “mbrojtje e zgjuar” kërkon edhe “forca të armatosura të zgjuara”.

Përfshirja e njohurive të arsimit civil, me objekt kërcënimet hibride, në arsimin ushtarak, do të kontribuonte në kualifikimin e burimeve njerëzore ushtarake për të përballuar çdo situatë pasigurie dhe rreziku, duke pasur parasysh që forcat e armatosura janë brezi i parë i sigurisë njerëzore dhe kombëtare.

Mjedisi i sigurisë sjell sfida befasuese, të cilat kërkojnë një kuptim dhe vlerësim më të zgjuar për të reaguar në përshtatje me situatën. Shkrimi **“Gjithëpërfshirja dhe integrimi i aftësive civilo-ushtarake - pjesë e strategjisë së sigurisë në kushtet e kërcënimeve hibride”** me autor *Mcs. Kanan Himaj*, ka si objekt studimi reflektimin në çështjet më të ndjeshme që lidhen me mënyrën e vlerësimit të veprimeve gjithëpërfshirëse në integrimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore dhe joshtetërore. Strategjia e luftës ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve hibride përcakton objektivat dhe instrumentet thelbësore për mbrojtjen e interesave kombëtare. Ajo bazohet në Strategjinë e Sigurisë dhe është

në përputhje me politikat e sigurisë e të mbrojtjes së RSH. Në këtë kuadër, ky shkrim thekson idenë se rishikimi koherent i SSK dhe SU, sot ka nevojë të vlerësojë politikën gjithëpërfshirëse për t'iu kundërvënë ndërhyrjeve hibride.

Në vitet e fundit, me zhvillimin e teknologjisë, njerëzimi jo vetëm ka arritur të përmirësojë ndjeshëm stilin e jetesës, por edhe është ekspozuar dukshëm ndaj formave të reja të krimit, i cili duket sikur tashmë përveçse krimit të rëndomtë të rrugës është transferuar në krim kibernetik. Krimi kibernetik, si forma e re e përdorimit të teknologjisë për cenimin e sigurisë shoqërore dhe asaj vetjake, duket që ka gjetur të përgatitur mbarë njerëzimin dhe e ka bërë atë më vulnerabel se kurrë. Me punimin e saj **“Siguria kibernetike dhe kuadri ligjor shqiptar”**, Dr. Elona Bano synon të evidentojë mangësitë ligjore dhe problematikat që institucionet dhe kapacitetet njerëzore të organeve ligjzbatuese hasin në depistimin, hetimin, zbulimin e më pas gjykimin e veprave penale që cenojnë sigurinë e individëve në hapësirën virtuale.

Nënkolonel *Bajazit Muceku* me shkrimin **“Infrastruktura kritike dhe siguria kombëtare”** na njuh me termin “infrastruktura kritike”, e cila është një aset ose sistem thelbësor për ruajtjen e funksioneve jetësore shoqërore. Dëmtimi i një infrastrukture kritike, shkatërrimi ose prishja e saj nga fatkeqësitë natyrore, terrorizmi, veprimtaria kriminale ose sjellja keqdashëse mund të ketë një ndikim të rëndësishëm negativ për sigurinë, ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve. Për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, në kuadrin e sistemit të mbrojtjes civile, Forcat e Armatosura, si struktura më kryesore, kryejnë detyra duke u angazhuar në operacione të parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive, duke mbështetur institucionet, autoritetet qendrore e vendore dhe popullsinë civile, si dhe zhvillojnë kapacitete ndërvepruese, të nevojshme për të bashkëpunuar me strukturat kolektive të sigurisë euroatlantike për përballimin e fatkeqësive.

Artikulli **“Strategjia detare ruse”** trajton një çështje delikate në politikën e sotme ndërkombëtare, në lidhje me marrëdhëniet midis Rusisë dhe Perëndimit dhe faktorët që kanë ndikuar në përqësimin e tyre.

Për përgatitjen e tij, është shfrytëzuar dhe përpunuar artikulli “Strategjia Detare Ruse”, botuar në mars 2021 nga “Difesa on Line”, portal i cili trajton çështje të gjeopolitikës. Artikulli është shkruar nga Renato Scafi, analist i çështjeve politike dhe ushtarake. Komentet dhe opinionet, shprehin vetëm mendimin dhe gjykimin autorit.

Por ajo çka kërkon të tregojë autori, z. *Roland Tashi*, është se, në thelb, nuk duhet të kemi frikë nga marina ruse por duhet të njohim mirë kundërshtarin tonë të mundshëm, ta analizojmë atë që Moska po përpiqet të arrijë me flotat e saj ajrore dhe detare, si të gjitha flotat në botë, të cilat janë një vektor i rëndësishëm i politikës së jashtme dhe elementë përcaktues në dokumentet e strategjive ushtarake.

Si koncept modern, lufta hibride është me ndikim të gjerë në gjithë globin dhe për këtë arsye ajo studiohet nga shumë autorë dhe ekspertë të fushës së sigurisë dhe strategjisë. Karakteristikë e saj është që ajo po kthehet gjithnjë e më vdekjeprurëse dhe në një nga

sfidat më të mëdha të sigurisë së shteteve/aleancave dhe stabilitetit ndërkombëtar. Në punimin e tyre **“Lufta hibride, rast studimi Rusia”** autorët *Dr. Fitim Karasani* dhe *Msc. Enkelejda Tyrku* janë fokusuar në metodat e luftës hibride, të cilat i gjejnë të materializuara në metodat e luftës ruse. Mendimi ushtarak rus e shikon luftën hibride si një përzierje midis fuqisë së butë dhe të fortë. Rusia kërkon të arrijë objektivat e saj strategjike me pak kosto; instrumentet diplomatike dhe informacioni i përshtaten më mirë strategjisë ruse që të ripozicionohet si fuqi globale.

Shkrimi **“Armët e Shkatërrimit në Masë - rrezik për paqen dhe sigurinë e popujve”** me autorë, *Msc. Esat Neziri* dhe *Msc. Shpresim Shllaku*, synon të japë një paraqitje reale të ndikimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë (ASHM) në sigurinë dhe paqen e popujve në kushtet e veprimit të fenomeneve të reja në realitetin e sotëm të zhvillimeve globale. Sistemi i sotëm botëror gjendet në hapësirën e mundësisë për të bashkuar përpjekjet e të gjitha shteteve në përballimin e pasojave që mund të shkaktojë përdorimi i Armëve të Shkatërrimit në Masë.

Përballë këtij realiteti, lufta e përbashkët e komunitetit ndërkombëtar kundër përhapjes së tyre duhet të rrisë më shumë përpjekjet për të luftuar këtë kërcënim të ri.

Msc. Mirela Lahi vjen në këtë edicion me një analizë rreth konceptit “NATO 2030”, i cili do të shërbejë si bazë orientuese për reflektim në konceptet doktrinare të FARSH. Si vend anëtar i NATO-s, Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura kanë përgjegjësinë e përfshirjes në planifikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e strategjisë dhe koncepteve doktrinare në përputhje me axhendën e iniciuar “NATO -2030”, duke iu nënshtruar një rishikimi total jo vetëm i dokumenteve kryesore që udhëheqin zhvillimin dhe përgatitjen e forcave. Një vend të veçantë duhet të zërë përfshirja e këtyre ndryshimeve në kurrikulat dhe programet mësimore në shkollat ushtarake dhe qendrat tona të kualifikimit të çdo niveli, me qëllim që përgatitja e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të jetë në pararojë të këtyre ndryshimeve.

KËRCËNIMET HIBRIDE, FAKTOR PËRSHPEJTUES I BASHKËPUNIMIT CIVILO-USHTARAK NË FUSHËN AKADEMIKE

Dr. Shpëtim Cami
Universiteti "Barleti"

Trajtesë e shkurtuar.

Kërcënimet hibride janë bërë jo vetëm objekt i studimeve të sigurisë por edhe i strategjive dhe planeve të veprimit të organizatave ndërkombëtare dhe shteteve për shkak të pranisë së tyre dhe natyrës së sofistikuar e komplekse.

Përkufizimi i tyre u përcaktua për herë të parë nga Qendra Europiane e Ekselencës për luftën kundër kërcënimeve hibride: "Termi "kërcënim hibrid" i referohet një veprimi të kryer nga aktorë shtetërorë ose joshtetërorë, qëllimi i të cilëve është të minojnë ose dëmtojnë një objektiv duke kombinuar mjete të hapura dhe të fshehta ushtarake dhe joushtarake".¹

Nëpërmjet veprimit të tyre, të cilat janë aktivitete publike dhe jopublike, ata synojnë një objektiv duke ndikuar në vendimmarrjen e tij në nivel lokal, rajonal, shtetëror ose ndërkombëtar.

Nisur nga diskutimi për politika të reja në fushën e kurrikulave në arsimin ushtarak me qasje nga arsimit civil, ky punim synon të kontribuojë në këtë fushë.

Bazuar në analizën e planit mësimor të programit bachelor "Studime në shkencë ushtarake", të cilën e konsideroj një gjetje shumë të mirë, në këtë punim do të jepen rekomandime për përfshirjen e disa elementëve të arsimit civil që synojnë njohjen e plotë të kërcënimeve hibride, pasi një "mbrojtje e zgjuar" kërkon edhe "forca të armatosura të zgjuara".

Fjalë kyçe: Kërcënimet hibride, Qendra Europiane e Ekselencës, shkencë ushtarake, plan mësimor.

¹ <https://www.hybridcoe.fi/hybrid-threats/>

1. Përse kërcënimet hibride janë faktorë përshpejtues të bashkëpunimit civilo-ushtarak në fushën akademike?

Nevoja për bashkëpunim midis institucioneve akademike ushtarake dhe civile, përveç se në fusha të cilat përmirësojnë mësimdhënien dhe të nxëniet, diktohet edhe nga prania e kërcënimeve hibride ndaj sigurisë së individit, sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto kërcënime ndryshojnë formë dhe përmbajtje në mënyrë të vazhdueshme duke përfituar nga globalizmi dhe zhvillimi teknologjik, nga varfëria dhe mungesa e njohurive në këtë fushë. Ato veprojnë në distancë duke përdorur burime njerëzore vendase.

Në këto kushte, përfshirja e njohurive të arsimit civil, objekt i kërcënimeve hibride, në arsimin ushtarak do të kontribuonte në kualifikimin e burimeve njerëzore ushtarake për të përballuar çdo situatë pasigurie dhe rreziku, duke pasur parasysh që forcat e armatosura janë brezi i parë i sigurisë njerëzore dhe kombëtare.

Fakti që prania e kërcënimeve hibride shtohet me shpejtësi, është një faktor përshpejtues i këtij bashkëpunimi.

2. Çfarë janë kërcënimet hibride?

Sipas Qendrës Europiane të Ekselencës për luftimin e kërcënimeve hibride: Kërcënimet Hibride janë një përzierje e kërcënimeve ndaj sigurisë së shteteve duke kombinuar kërcënimet tradicionale si: lufta, terrorizmi, krimi i organizuar etj., me veprime si influencimi i vendimmarrjes së shteteve apo aktorëve të tjerë politikë dhe jopolitikë, për të dobësuar demokracinë dhe qeverisjen, nëpërmjet: krijimit dhe financimit të partive politike, krijimit dhe financimit të organizatave joqeveritare, financimit dhe ndikimit në partitë politike dhe organizatat joqeveritare ekzistuese dhe dezinformimit të opinionit publik.¹

Këto veprime zbehin kufijtë mes luftës dhe paqes dhe shteti gjendet gjithmonë në gjendje alarmi dhe pasigurie. Përkufizimi i kërcënimeve hibride është një koncept që ndryshon në varësi të shfaqjes dhe veprimit të tyre, ndaj vigjilenca dhe studimi rast pas rasti janë në qendër të vëmendjes së institucioneve të sigurisë dhe studiuesve të kësaj fushe.

3. A janë të pranishme kërcënimet hibride në Shqipëri ?

Në këndvështrimin tim, Po. Studime nga autorë të ndryshëm si dhe ish-drejtues të partive politike shkruajnë dhe deklarojnë çdo ditë se ka deformim të demokracisë së brendshme

¹ <https://www.hybridcoe.fi/hybrid-threats/>

në partitë politike si dhe financim në shumicë nga donatorë privatë. Me këtë përfundim del dhe studimi “Demokracia e brendshme në partitë politike shqiptare” i autorëve Afrim Krasniqi dhe Ardian Hackaj, publikim i Fondacionit “Friedrich Ebert”, të cilët ndër të tjera evidentojnë se partitë politike në masën 50% financohen nga donatorë privatë². Metodologjia e këtij studimi përcaktohej nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, një organizatë joqeveritare.

Në çdo prag zgjedhesh shohim krijim partish të reja që lindin vetëm në procese zgjedhore dhe më tej zhduken pas zgjedhjeve. Ligji për Partitë Politike që nga viti 2000 ka ndryshuar herë pas here, si: ligji nr. 9452, datë 02.02.2006; ligji nr. 10 374, datë 10.02.2011, ligji nr. 17/2014; ligji nr. 90/2017, datë 22.05.2017; ligji nr. 135/2020, datë 16.11.2020. Këto ndryshime të shpeshta janë pasuar me ndryshime edhe në kodin zgjedhor.

Deri tani kontrolli i financimit të tyre nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucioni ligjor i kontrollit financiar të partive politike, nuk ka prodhuar frenim dhe ndonjë konkluzion mbi energjitë e shpenzuara në këtë fushë nga shqiptarët, të cilat në përfundim kanë prodhuar paqëndrueshmëri politike dhe ulje të imazhit të qeverisë dhe të institucioneve të shtetit shqiptar. Krijimi i një klime paqëndrueshmërie politike, në mos produkt i një kërcënimi të pastër hybrid është një mjedis ideal ku mund të depërtojnë dhe të veprojnë lehtësisht kërcënimet hibride.

Elemente të tjera, si: nivel i ulët i ndëshkueshmërisë, zvarritje e reformave, mospranimi i zgjedhjeve, nxitje e emigracionit dhe imigrimit të pakontrolluar, shoqëri civile apatike dhe e fokusuar në kërkim financimesh, si dhe krijim i OJQ-ve nga individë jo profesionistë dhe pa integritet publik të njohur, nuk janë objekt i këtij studimi, por na shërbejnë si referenca për t’i reflektuar ato tek arsimi ushtarak.

4. Çfarë mund të bëjnë institucionet akademike në prani të kërcënimeve hibride?

4.1. Një përvojë nga Universiteti “Barleti”

Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit në Universitetin “Barleti” ofron tre programe nga të cilët një bachelor në shkencë politike dhe dy programe master: Master Profesional në Administrim Publik me kohë zgjatje 1-vjeçare dhe Master Shkencor në Studime Europiane me kohëzgjatje 2-vjeçare.

Bazuar në mundësinë që lejojnë aktet ligjore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kemi ndryshuar në masën 20% temat mësimore në master, duke thelluar njohuritë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të sigurisë si dhe ndryshuar programin bachelor, nga shkencë politike klasike, në shkencë politike me dy profile, administrim publik dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Ky është një hap i parë në një universitet civil për t’iu përshtatur jo vetëm tregut por edhe mjedisit të ri të sigurisë.³

² Krasniqi, Afrim; Hackaj Ardian, “Demokracia e brendshme në partitë politike shqiptare”, Fondacioni Friedrich Ebert, Tiranë 2014, faqe 116.

³ <https://www.umb.edu.al/>

4.2. *Plani mësimor bachelor “Studime në shkenca ushtarake” dhe mundësia për ndryshim⁴*

Në funksion të kërcënimeve hibride, tema e konferencës së zhvilluar më 30 shtator për politika të reja në fushën e kurrikulave në arsimin ushtarak me qasje nga arsimi civil, është një mundësi për të shqyrtuar planin mësimor të studimeve në shkenca ushtarake, me synimin për të përfshirë elemente të arsimit civil.

Së pari, nisur nga fakti se për studentët e vitit të tretë është planifikuar punim diplome, mendoj se përfshirja në plan e lëndës “Metoda të kërkimit shkencor” është një nevojë dhe domosdoshmëri që ata të marrin njohuri të përgjithshme mbi metodat sasiore dhe cilësore të kërkimit shkencor për ta realizuar punimin. Kjo lëndë ka nevojë të vendoset në semestrin e parë të vitit të tretë. Përfshirja e kësaj lënde mund të realizohet duke hequr në vitin e tretë, semestri i parë, lëndën “Histori e luftërave moderne” dhe në vend të saj të vendoset “Metoda të kërkimit shkencor”. Lënda “Histori e luftërave moderne” mund të bashkohet me lëndën “Histori e fushatave ushtarake” që zhvillohet në vitin e dytë.

Së dyti, nisur nga fakti që një nga veprimet e kërcënimeve hibride janë krijimi i partive politike dhe organizatave joqeveritare apo financimi i atyre ekzistuese, do të sugjeroja që të përfshihej një lëndë, syllabusi i së cilës të përmbante elemente të ligjit mbi partitë politike dhe financimin e tyre, elemente të Kodit zgjedhor dhe elemente të ligjit mbi krijimin dhe kontrollin financiar të organizatave joqeveritare. Në këtë mënyrë, një student që diplomohet në Shkenca Ushtarake merr njohuri edhe nga arsimi civil dhe e ndihmojnë atë për të kuptuar më mirë kërcënimet hibride dhe rrezikun e tyre. Kjo lëndë mendoj të titullohet “Njohuri mbi partitë politike dhe organizatat joqeveritare” dhe të vendoset në vitin e tretë, në vend të lëndës “Menaxhimi i burimeve të mbrojtjes”, e cila mund të bashkohet me një lëndë tjetër ose në vend të lëndës “Përgatitje zjarri”, duke arsyetuar se në vitin e parë dhe të dytë ka marrë mjaftueshëm njohuri në këtë fushë.

Një alternativë tjetër për përfshirjen e arsimit civil në arsimin ushtarak do të ishte edhe përfshirja e njohurive për administratën publike e cila do të mundësohej duke bashkuar lëndët “Etika Ushtarake” dhe “Kultura e organizatës” që zhvillohen në vitin e dytë. Lënda e re mund të titullohej “Njohuri mbi administratën publike” në syllabusin e së cilës do të përfshiheshin ligji për nëpunësin civil, ligji për administratën shtetërore, ligji për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, elemente të së drejtës administrative që trajton katër kontrollet mbi administratën publike si: kontrolli administrativ, gjyqësor, kushtetues dhe politik.

Në këtë mënyrë diploma “Studime në shkenca ushtarake” formon një student me njohuri në fushën ushtarake por edhe në fushën civile me të cilat ai do të përballet gjatë ushtrimit të detyrës së tij në të ardhmen apo do të thellojë njohuritë në studimet master apo doktorale si dhe në kurset e larta për sigurinë.

Së treti, nisur nga fakti që një nga llojet e kërcënimeve hibride është edhe dezinformacioni mendoj se lënda “Komunikimi dhe media” e planifikuar në semestrin e dytë të vitit të tretë

⁴ https://tradoc.mil.al/images/kds2020/bachelor/PLANI_MESIMOR_2020-2023.pdf

është e mjaftueshme për t'i pajisur studentët me njohuri në këtë fushë duke përfshirë në syllabus edhe tema mbi dezinformacionin si një rrezik për sigurinë.⁵

5. Përfundime

Kërcënimet hibride diktojnë ndryshime programore në shkencat ushtarake por jo vetëm, pasi ka nevojë të ketë ndryshime edhe brenda një syllabusi, duke respektuar udhëzimet e Ministrisë së Arsimit në masën 20%. Këto ndryshime do të shërbejnë për pajisjen e studentit me njohuri të fushës civile, por që i shërbejnë për njohjen e objektit të sulmit të kërcënimeve hibride, duke aplikuar metoda shkencore.

Kërcënimet hibride diktojnë bashkëpunime jo vetëm në nivel konferencash shkencore me institucionet arsimore civile, por edhe me programe të përbashkëta dhe krijimin e qendrave studimore me ekspertë të fushës.

6. Rekomandime

1. Ndryshimi në masën 20 % të planit mësimor të programit bachelor “Studime në Shkencat ushtarake”.
2. Shtimi i dy lëndëve të reja me objekt sulmi i kërcënimeve hibride, siç janë “Njohuri mbi partitë politike dhe organizatat joqeveritare” si dhe “Njohuri mbi Administratën Publike”.
3. Shtimi i një lënde “Metodat e Kërkimit Shkencor” krahas shkrimit akademik si lëndë, e cila i ndihmon studentët për kërkime shkencore.
4. Rritja dhe fuqizimi i Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak për mundësimin e angazhimit të eksperteve të jashtëm civilë si dhe organizimi i konferencave shkencore jo vetëm kombëtare, por edhe rajonale dhe ndërkombëtare.
5. Përditësimi çdo vit i literaturës së lëndëve me karakter civil në fushën e kërcënimeve hibride për shkak të natyrës së tyre të ndryshueshme.

Bibliografia:

- <https://www.hybridcoe.fi/hybrid-threats/>
- <https://www.tradoc.mil.al/>
- <https://tradoc.mil.al/rreth-kds/akademia-e-fa/476-asgsdhfhfg>
- <https://www.umb.edu.al/>
- <http://arsimi.gov.al/universiteti/>
- <http://arsimi.gov.al/urdhera-dhe-udhezime-3/>
- https://tradoc.mil.al/images/kds2020/bachelor/PLANI_MESIMOR_2020-2023.pdf

⁵ https://tradoc.mil.al/images/kds2020/bachelor/PLANI_MESIMOR_2020-2023.pdf

GJITHËPËRFSHIRJA DHE INTEGRIMI I AFTËSIVE CIVILO-USHTARAKE, PJESE E STRATEGJISË SË SIGURISË NË KUSHTET E KËRCËNIMEVE HIBRIDE

Nënkolonel (R) Mcs. Kanan Himaj
IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Mjedisi i sigurisë sjell sfida befasuese, të cilat kërkojnë një kuptim dhe vlerësim më të zgjuar për të reaguar në përshtatje me situatën. Shkrimi ka si objekt studimi reflektimin në çështjet më të ndjeshme që lidhen me mënyrën e vlerësimit të veprimeve gjithëpërfshirëse në integrimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore dhe joshtetërore. Rëndësi merr dhe trajtimi i tyre, pasi ato ndihmojnë në rishikimin e dokumenteve madhore të sigurisë së vendit në vendosjen në fokus koherencën e problematikës që na nevojitet për vendin.

Në këtë kuadër, me vlerë janë trajtimi i problematikës për nxitjet e qasjeve gjithëpërfshirëse ndaj aftësive dhe efektet të të gjithë instrumenteve të fuqisë, ushtarake dhe civile, qeveritare dhe joqeveritare, kombëtare dhe ndërkombëtare, në përballimin e pasojave të kërcënimeve hibride.

Strategjia e luftës ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve hibride do të përcaktojë objektivat dhe instrumentet thelbësore për mbrojtjen e interesave jetësore të Republikës së Shqipërisë. Ajo bazohet në Strategjinë e Sigurisë dhe është në përputhje me politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes së RSH. Ky shkrim thekson idenë se rishikimi koherent i SSK dhe SU, sot ka nevojë të vlerësojë politikën gjithëpërfshirëse për t'iu kundërvënë ndërhyrjeve hibride.

Fjalët kyçe: kërcënime hibride, qasje gjithëpërfshirëse, instrumente të energjisë, aftësitë civilo-ushtarake, lufta hibride, rishikim i strategjive, planifikim i mbrojtjes dhe sigurisë.

Hyrje

Ndërhyrja hibride përfshin veprime të fshehta dhe të hapura nga shteti, si dhe aktorë joshtetërorë (autorë të ndërhyrjeve hibride), të cilët synojnë elemente të prekshme të shteteve dhe shoqërive demokratike. Qëllimi i tyre është të dëmtojnë punën e institucioneve demokratike, proceset e sundimit të ligjit dhe sigurinë e brendshme të vendit. Nisur sa më lart, ata përdorin mjete politike, diplomatike, informative, ushtarake, ekonomike, financiare dhe të inteligjencës etj. Në konfliktet hibride, aktorët kanë elemente që, sipas rastit, ndikojnë në vendimet politike, diplomatike, sociale, ushtarake, ekonomike, informative, etj. Në shumicën e rasteve, natyra e tyre është e paqartë përfshinë shumë veprimtari edhe në zona të tjera.

Mjedisi operacional, i cili është kompleks dhe i paparashikueshëm për shkak të përfshirjes së aktorëve civilë, popullsisë civile, të faktorëve kulturorë dhe psikologjikë, kërkon rritjen e shkallës së integritimit civilo-ushtarak dhe rishikimin e metodave dhe mjeteve të punës drejt menaxhimit të konfliktit, nevojë e ambientit të sotëm të shoqërisë shqiptare.

Gjithashtu, si rezultat i shumëzimit dhe diversifikimit të situatave në të cilat strukturat ushtarake thirren të ndërhyjnë dhe të amplifikimit të nevojave operacionale të diktura nga mjedis operacional hibrid, lind nevoja për krijimin e strukturave (të integruara) të forcave të përshtatshme për llojet e reja të rreziqeve dhe kërcënimeve.

1. Pse qasje gjithëpërfshirëse dhe e integruar për sigurinë?

Në ndërhyrjet hibride mund të përfshihen aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë. Ndërhyrjet hibride janë gjithëpërfshirëse dhe mund të kundërshtohen vetëm përmes një qasjeje të gjithë shoqërisë. Ajo duhet të përfshijë jo vetëm shërbime të sigurisë dhe autoritete qeveritare, por edhe elementë të rëndësishëm të sektorëve tregtarë, mediatikë, arsimorë dhe jofitimprurës. Ata synojnë elementët kryesorë të funksionimit të shtetit dhe shoqërisë dhe përdorin një kombinim fleksibël të mjeteve diplomatike, informuese, ushtarake, ekonomike, financiare, të inteligjencës dhe ligjore.

Ndërhyrja hibride kërkon të mjegullojë kufijtë midis paqes, krizës dhe konfliktit. Ajo qëllimisht përpiket të jetë e fshehtë, e paqartë dhe e vështirë. Ndërhyrjet hibride përdorin dobësitë tashmë ekzistuese dhe ndarjet e brendshme brenda shoqërisë, duke synuar shtyrjen ose paralizimin e procesit të vendimmarrjes politike (përfshirë vendimmarrjen në mbrojtje dhe siguri) ose dobësimin e besimit të qytetarëve në sistemin kushtetues apo

institucionet demokratike. Për më tepër, përpiqet të prishë proceset ekonomike, të fitojë ndikim në sektorët kryesorë ekonomikë dhe ndërmarrjet strategjike, të manipulojë ose të marrë kontrollin e mjedisit të informacionit dhe të dobësojë ose të ndikojë në funksionimin e strukturës kritike. Për të arritur këtë, autorët e hibridit përdorin shumë mjete, përfshirë aktivitete me qëllim të dobësimit të kundërshtarit në hapësirën kibernetike.

Për më shumë, infrastruktura kritike përfshin industrinë e energjisë, menaxhimin e ujit, industrinë ushqimore dhe bujqësinë, sistemin shëndetësor, transportin, sistemet e komunikimit dhe informacionit, tregun financiar dhe valutën, shërbimet e urgjencës dhe qeverinë.

Shumë mjete dhe metoda specifike të angazhimit hibrid tashmë janë përdorur në të kaluarën. Sidoqoftë, shtrirja, kompleksiteti, sofistikimi teknik dhe niveli i organizimit të tyre është rritur. Kjo u mundësua nga zhvillimi dhe përdorimi i teknologjive të reja të tilla si: rrjetet sociale dhe aplikacione të tjera në internet, të cilat krijojnë dobësi të reja që duhen adresuar dhe zvogëluar sidomos në kushtet e vendit tonë.

Spektri i gjerë i veprimeve dhe konflikteve hibride kërkon entitetet/institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, përgjigjet kompetente dhe të koordinuara, si dhe aftësitë ushtarake dhe civile për të kryer veprime koherente dhe efektive në misione veçanërisht komplekse - duke kufizuar efektet e kërcënimeve hibride.

Në fushën e luftës kundër ndërhyrjeve hibride, strategjia përcakton objektivat strategjike:

- Shoqëria elastike, infrastruktura kritike elastike.
- Qasja sistematike dhe mbështetëse e Republikës Shqipërisë.
- Aftësia e reagimit adekuat dhe në kohë.

Karakteristikë e qasjes klasike gjithëpërfshirëse (të themi kështu) është se ajo fillon nga një studim paraprak ose një kuptim paraprak i një misioni, i një organizate në tërësi dhe më pas kalon në studimin e rolit të luajtur nga secila palë/entitet në organizimin dhe dinamikën e gjithë mekanizmit - një qasje e orientuar drejt qëllimit (Standardizimi i NATO-s, 2018, I-2; Kombet e Bashkuara, 2013, 3).

Sipas mendimit tonë, nuk është e mjaftueshme të analizohet roli i palëve (në situatën tonë instrumentet e fuqisë civile dhe ushtarake, kombëtare dhe ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare) dhe atë që mund të bëjnë për të arritur qëllimin përfundimtar; ne kemi nevojë për të pasur integrim koherent të veprimeve të të gjitha instrumenteve të pushtetit, gjithëpërfshirëse dhe qasje e integruar – dinamike dhe komplekse.

Për më tepër, duke integruar veprimet e instrumenteve të ndryshme civile dhe ushtarake nga të gjitha mjediset e shfaqjes së konflikteve hibride, bazuar në parime, mekanizma, norma, etj., mund të arrihen efekte të cilat do ta bënë misionin më shumë efektiv, do të zvogëlonte kostot dhe kohën e nevojshme për të arritur qëllimin përfundimtar.

Gjithashtu, në lidhje me aksionin e integritit gjithëpërfshirës të të gjitha instrumenteve ushtarake dhe fuqinë civile, është e dobishme të kemi një përcaktim më të qartë të saj,

duke përcaktuar konceptet/nocionet me të cilën e operon. Kështu, "gjithëpërfshirës"¹ do të thotë diçka "që përfshin shumë (të gjerë), që ka një përmbajtje të pasur dhe" të integroresh "nënkupton" të përfshish (vetveten), të integrosh (vetveten), të (inkorporosh) (vetveten), për të harmonizuar (veten) në një tërësi.

Në këtë kontekst, një aspekt i rëndësishëm dhe i nevojshëm është integrimi, harmonizimi i plotë i përbashkët në operacionet ushtarake, veprimet (nga të gjitha mjediset: toka, ajri, deti, kibernetika, hapësira), përbërësit/institucionet qeveritare civile dhe ushtarake, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe efektet e veprimeve të organizatave joqeveritare dhe/ose grupeve të tjera të presionit.

Rrjedhimisht, rezultati do të çonte në një qasje gjithëpërfshirëse e të integruar, e cila përfshin operacione dhe aktivitete të harmonizuara me efekte koherente, të kryera në mënyrë efikase në bazë të angazhimeve reciproke, besimit reciprok dhe qëllimeve të përbashkëta. Kjo qasje kombinohet në mënyrë unitare me të gjithë elementët e sistemit civil dhe ushtarak në të gjitha fushat e shfaqjes së konfrontimit hibrid.

Ky integrim gjithëpërfshirës duhet kuptuar si një organizëm i gjallë. Le ta krahasojmë me pjesët e një organizmi (hunda, mushkëritë, zemra, etj.) që janë shumë të ndryshme, por së bashku kontribuojnë ndjeshëm, në një mënyrë të integruar, për të mbështetur jetën e organizmit (qëllimi jetik), përbërës të një fushate për të luftuar kërcënimet hibride (civile dhe ushtarake, qeveritare dhe joqeveritare, kombëtare dhe ndërkombëtare) përmes një integrimi të gjithanshëm dhe për të ndjekur qëllimin e përbashkët dhe jetik. Këto mjete, forcat dhe aftësitë nuk janë vetëm elementë përbërës të thjeshtë, por ato duhet të jenë "organe" me një rol të përcaktuar mirë në një "entitet të gjallë dhe të shëndetshëm". Ka elementë të ndryshëm, por secili kontribuon me diçka specifike dhe jetësore (forca, efekte, burime, etj.).

Një qasje gjithëpërfshirëse dhe e integruar duhet të jetë një mënyrë për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme, jo vetëm për ato të prekura nga konfliktet (hibride), por edhe për qeverinë, strukturat brenda bashkësisë ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare të cilat mund të japin një kontribut thelbësor në promovimin e vlerave dhe interesave të përbashkëta.

2. Kërcënimet asimetrike / hibride në nivelin e NATO -s

NATO është duke u përqendruar në adresimin e kërcënimeve të përgjithshme hibride dhe në dokumentet e saj po përdor këtë formulë dhe jo kërcënimet asimetrike në veçanti. Me hibrid, Aleanca i referohet propagandës, mashtrimit, sabotimit, dezinformimit, sulmeve kibernetike, presionit ekonomik, vendosjes së grupeve të armatosura të parregullta dhe taktikave të tjera joushtarake, të përdorura nga kundërshtarët për të destabilizuar sigurinë në zonat me interes dhe përhapjen e pasigurisë brenda popullatave.

¹ Integrimi – Wikipedia: https://en.wikipedia.org/wiki/Çfarë_është_integrimi? Integrimi, në kuptimin më të përgjithshëm, mund të jetë çdo bashkim i gjërave: integrimi i dy ose më shumë ekonomive, kulturave, feve (zakonisht i quajtur sinkretizëm), etj. Integrimi, në matematikë, një koncept i llogaritjes, është akti të gjetjes së integraleve.

Strategjia e Aleancës në luftimin e veprimeve hibride ose klasike parashikon se detyrimi kryesor i përket shteteve anëtare (MS), ndërsa NATO është e gatshme të ofrojë mbështetje sipas Dispozitës së nenit 5 (NATO 2019). Në këtë drejtim, në vitin 2018, shtetet anëtare të NATO-s vendosën të krijojnë ekipe mbështetëse ndaj luftës hibride, të ngarkuara me ofrimin e ekspertizës për MS. Për më tepër, që nga riorganizimi i strukturave të Inteligjencës në NATO, së fundmi janë krijuar Joint Intelligence and Security Division, si një strukturë hibride e analizës përgjegjëse për paralajmërimet të nevojshme.

Duke marrë parasysh karakterin global të kërcënimeve hibride, NATO është gjithashtu për konsolidimin e partneriteteve të saj me shtetet e treta dhe organizatat me mendim të njëjtë. Partneriteti solid i BE-së në luftimin e kërcënimeve hibride demonstron nga përrurimi (tetor 2017) i Qendrës Evropiane të Ekselencës për Kundërvënien ndaj Kërcënimeve Hibride me seli në Helsinki nga Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg dhe Përfaqësuesja e tanishme e Lartë e Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe Zëvendës-presidente e Komisionit Evropian në Komisionin Juncker, Federica Mogherini (NATO 2017). Qendra funksionon si një strukturë bashkimi, duke mbështetur shtetet anëtare në përmirësimin e aftësive të tyre për të luftuar kërcënimet hibride.

Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat në BE, të cilat janë instrumenti kryesor për të parandaluar ndërhyrjet hibride, do të vijojë të marrë pjesë aktive në aktivitetet dhe iniciativat e NATO-s dhe BE-së për t'iu kundërvënë ndërhyrjeve hibride. Nevoja është që ajo të kërkojë të përdorë aftësitë kundër-hibride të NATO-s dhe si dhe të kontribuojë në ato aftësi të prekshme.

Solidariteti dhe mbështetja e ndërsjellë e Aleatëve të NATO-s përfaqëson një instrument efektiv për parandalimin e ndërhyrjeve hibride si dhe për t'iu përgjigjur manifestimeve të saj specifike. Prandaj ne duhet të mbështesim në mënyrë aktive unitetin dhe solidaritetin e aleatëve të NATO-s duke përfshirë identifikimin e mundshëm kolektiv të aktivitetëve hibride.

Vendi ynë do të mbështesë gjithashtu zhvillimin e mëtejshëm midis NATO-s dhe BE-së, i cili është thelbësor për të mbuluar të gjithë spektrin e instrumenteve të përdorura hibride. Në këtë kuptim, ne do të kontribuojmë në aktivitetet e nismave të tjera ndërkombëtare, përfshirë Qendrën Evropiane të Ekselencës për luftën kundër Kërcënimeve Hibride në Helsinki, Finlandë.

3. Aspekte të integritit, sfida për përfshirjen në menaxhimin hibrid të konflikteve

Duke pasur parasysh faktin se operacionet e ardhshme do të fokusohen në aplikimin e integruar të të gjithëve instrumentet e fuqisë, si ushtarake ashtu dhe joushtarake, në mënyrë që të krijohen efektet e planifikuara jo vetëm të forcës. Forcat dhe aftësitë duhet të jenë në gjendje të trajtojnë një metodë të qartë politike, ushtarake, civile, ekonomike dhe veprim i koordinuar e i bashkërenduar shkencërisht midis qeverisë dhe organizatave joqeveritare, pasi ne kemi nevojë për një perspektivë të integruar që rregullon konceptin e ndërtimit,

trajnimin dhe pjesëmarrjes të aftësive të synuara në gamën e plotë të operacioneve, përfshirë në kontekstin hibrid.

Strategjitë dhe metodat e përdorura në integrimin gjithëpërfshirës mund të jenë të shumëfishta dhe të ndryshme, por sfida e vërtetë për njësitë e përfshira në menaxhimin hibrid të konflikteve është llogaritja e duhur me efekte të përzierjes së qasjeve që përdoren gjatë gjithë konfrontimit (strategjisë), duke vlerësuar kohën e zbatimit të mjeteve, aftësive, metodave, pajisjeve (të kohës) të përshtatshme, por edhe masën në të cilën ato aplikohen (intensiteti).

Kështu, duke pasur parasysh kompleksitetin e qasjes, sipas mendimit tonë, është e nevojshme një strategji (dokument integruar), i ndërtuar mbi baza shkencore, i aftë të gjenerojë zbatimin e sistemeve të reja, procedurave dhe standardeve që rrjedhin nga koncepti dinamik i afërimit me veprimet.

Strategjia e integruar kontributeve dhe aftësive duhet të adresojë të gjitha strukturat përfshirë në procesin e sigurisë në kontekstin e kërcënimeve hibride. Në këtë kuptim, Strategjia Gjithëpërfshirëse e Integritit të Aftësive do të ketë këto attribute:

- krijimi i parimeve që rregullojnë statusin dhe rolin e secilit instrument të pushtetit;
- përcaktimi i situatave dhe kushteve në të cilat do të përdoren këto mjete;
- theksimi i strukturave organizative të integruara, të nevojshme për menaxhimin e aftësive dhe koordinimi i efekteve në interes të qëllimit;
- drejtimi i zhvillimit të një plani të integruar të aftësive në të gjitha rastet e planifikuara;
- rregullimi në një konceptim unitar i procesit të krijimit të aftësive, statusi i grupeve të forcave, planifikimi i veprimeve, vazhdimësia e pjesëmarrjes të instrumenteve (aftësitë), komanda dhe kontrolli;
- drejtimi i përgatitjes/trajnimin të aftësive (trajnim i integruar) i synuar për të marrë pjesë në veprimet e integruara para se të shfaqet ndonjë kërcënim hibrid.

Strategjia gjithëpërfshirëse e integritit të aftësive ofron mundësinë për të zhvilluar dokumente të tjera përcjellëse që forcojnë besimin midis institucioneve, promovojnë komunikimin e mësimave të nxjerra, inkurajojnë zhvillimin e procedurave të përbashkëta dhe krijojnë kuadrin për trajnim dhe ushtrime të integruara. E gjithë kjo do të lehtësojë planifikimin më të mirë të fushatave/operacioneve dhe zbatimin e tyre në një nivel më të lartë.

4. Njohja e mjedisit operacional – domosdoshmëri për gjithëpërfshirjen

Duke pasur parasysh ekzistencën e kërcënimeve, agresioneve dhe operacioneve hibride, lind pyetja: ku kryhen ato? Për këtë, karakterizohet mjedisi në të cilin shfaqet një gamë e gjerë përbërësish: aktorë, hapësira fizike (toka, ajri, deti, kozmike) e veprimeve, intelijenca, teknologjia, mjedisi kulturor, faktorët e rrezikut, kërcënimet, etj., kombinimi apo kryqëzimi i të cilëve çon në një kontekst të paqëndrueshëm, të pasigurt, kompleks dhe të paqartë (paqëndrueshmëria, pasiguria, kompleksiteti dhe paqartësia) – në një mjedis operacional hibrid.

Mjedisi hibrid operacional është korniza për shfaqjen e kërcënimeve hibride, që përfshijnë konfigurimin kompleks e të kombinuar të një mori aktorësh, që do të thotë veprimet dhe efektet që konvergojnë në mënyrë të bashkërenduar dhe shpesh në mënyrë të fshehtë, për të përmbushur interesa dhe qëllime të caktuara.

Në pjesën themelore të SSK, e cila do të jetë gjithëpërfshirëse e integritetit të aftësive, duhet të zgjidhet identifikimi i burimeve të pasigurisë përmes një kuptimi të plotë të funksionimit të mjedisit hibrid.

Pasiguria është rezultat i bashkëveprimit të një game të gjerë faktorësh, prandaj është e rëndësishme të përdoret një qasje gjithëpërfshirëse dhe e integruar ndaj kontekstit dhe mjedisit operacional, bazuar në një analizë shumëpalëshe.

Analiza duhet të fokusohet në drejtime të tilla si:

- aktorët e përfshirë (të cilëve iu është referuar), popullata civile me kulturën e saj, grupet shoqërore etnike ose të marginalizuara, feja, burimet natyrore, kufijtë e imponuar, çështje politike dhe ekonomike, sociale, etj.;
- baza, shkaqet, rrethanat e konfliktit dhe implikimet e tyre në qasjen e zgjidhjes;
- historia e konfliktit, pozicioni gjeo-strategjik, mjedisi fizik, klima, gjeografia, infrastruktura, etj.

Nëse popullsia civile është “qendra e gravitetit” e konflikteve hibride rreth të cilave rrotullohen të gjithë aktorët, forcat, aftësitë, veprimet dhe efektet, procesi i përgatitjes së inteligjencës nuk është më i mjaftueshëm. Ne kemi nevojë për një kuptim më të saktë të mjedisit operacional, duke përfshirë aspektet e komuniteteve lokale, për njohuri të thelluar të asaj që nënkuptojnë njerëzit, strukturat e tyre sociale dhe kulturore, si ata mendojnë, veprojnë dhe/ose reagojnë ndaj ndikimeve të caktuara të brendshme dhe të jashtme. Pra, në këtë mjedis operacional hibrid, mbështetja dhe mbrojtja e popullsisë civile është në fakt misioni i forcave qeveritare të integruara.

Një analizë e kujdesshme e konsideratave civile është thelbësore për suksesin afatgjatë. Për një analizë më të plotë të kontekstit të veprimit brenda konfrontimeve hibride, karakteristikat e popullatës civile, "terreni njerëzor" dhe kultura në zonën operationale duhet të merren parasysh. Kjo lidhet me përcaktimin e mjedisit civil në të cilin vepron: analiza e mjedisit civil operacional (terreni njerëzor), zhvillimi i modelit të mjedisit civil operacional dhe përcaktimi i veprimeve civile në zonë.

Rrjedhimisht, mund të thuhet se duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e terrenit njerëzor dhe duke përdorur metodologji/mjete të tilla, arrihet dhe mbahet një marrëdhënie e ngushtë me përbërësin civil (popullsia dhe aktorët civilë në mjedisin operacional), duke lehtësuar bashkëpunimin dhe harmonizuar aktivitetet, shkëmbimin e informacionit, planifikimin dhe menaxhimin e integruar të fushatave/misioneve për të kundërshtuar efektet e konflikteve hibride.

Mënyrat për të lehtësuar fërkimin midis instrumenteve ushtarake dhe joushtarake, strukturat

ushtarake dhe aktorët civilë i kanë perceptuar tradicionalisht rolet e tyre si krejtësisht të ndara dhe të ndryshme. Për shembull, organizatat joqeveritare (OJQ-të) ngurrojnë të veprojnë përkrah forcave ushtarake, edhe nëse vijnë nga i njëjti vend ose nga vendi që merr ndihmë. Në ndonjë rast, të vetëdijshëm për nevojën për të ruajtur neutralitetin dhe mbrojtjen, ata shpesh ndjehen të kërcënuar nga lidhja me ushtrinë. Nga ana tjetër, udhëheqësit ushtarake prireshin t'i shikonin organizatat civile, veçanërisht OJQ -të, si të padisiplinuara dhe operacionet e tyre jokoherente, joefikase. Me kalimin e kohës, pas përvojës së fituar në teatrot e fundit të operacioneve, të dyja palët filluan të ndryshonin qëndrim dhe mendim.

Personeli civil shpesh kërkon mbrojtje, mbështetje logjistike, mjekësore ose evakuim nga ushtria. OJQ-të kanë fituar respektin e strukturave ushtarake dhe qeveritare për nisma; shpejtësia në mobilizimin e burimeve, zgjuarsia dhe instrumenti ushtarak e ka imponuar veten përmes vizionit, planifikimit të veprimit të gjykuar, kapacitetit të veçantë logjistik, etj. Megjithatë, shumë mangësi në koordinimin e veprimeve të këtyre elementeve ende vazhdojnë. Prandaj, strategjia gjithëpërfshirëse e integritetit të aftësive duhet të fokusohet në veprime ndër-institucionale, të cilat, nëpërmjet analizës së aftësive tërësore, të gjithanshme planifikimi dhe zbatimi i integruar, do të çojnë në neutralizimin, kufizimin ose eliminimin e efekteve të veprimeve shumë-dimensionale të grupeve kundërshtarë.

Për më tepër, në procesin e propozimit të mënyrave, zgjidhjeve, ideve për promovimin dhe bërjen e integritetit gjithëpërfshirës më efikas, u identifikuan aspektet e mëposhtme thelbësore:

- Fushat ku ka dallime në qasjen ndaj pjesëmarrësve në veprime të integruara (përcaktuese statusi përfundimtar, përcaktimi i objektivave fillestarë, planifikimi dhe vendimi, zhvillimi i planeve, konceptuale elementet, parimet e veprimit, komunikimi, bashkëpunimi i inteligjencës, bashkëpunimi standard procedura në situata të ndryshme).
- Një sërë idesh, tezash dhe normash - parimesh themelore (p.sh. njohja e kulturës konteksti, përparësia e pjesëmarrjes së kontributeve, përpjekjet e përbashkëta, integrimi i komandës, njohuritë reciproke, përqendrimi i përpjekjeve në mbështetje të civilëve, përshtatshmëria, përcaktimi i rregullt i veprimeve, komunikimi dhe informacioni i ndërsjellë, etj.), të cilat duhet të përfaqësojnë standarde, pikë referimi të rëndësishme në realizimin konceptual të integritetit gjithëpërfshirës.
- Rrjedhimisht, për të integruar në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha veprimet dhe aftësitë e kërkuara nga konteksti hibrid, lidërshipi duhet të ketë një perspektivë të plotë të fushatës/misionit, në mënyrë që të identifikohen mekanizmat me anë të të cilëve marrëdhëniet midis forcave në dispozicion, ushtarake dhe civile, kombëtare dhe ndërkombëtare mund të përmirësohen.

Gjithashtu, nëse është e mundur, duhet të krijojë perspektivë për vlerësimin e të gjithë aktorëve (të pavarur, të panjohur, etj.) që veprojnë në rajon dhe veprimet e tyre, synimi është të përqendrohen dhe sinkronizohen përpjekjet për efekt maksimal.

Në vend të përfundimeve

Në kontekstin e rishikimit të dokumenteve të planifikimit strategjik të vendit, duhet të punojmë në njohjen dhe analizën e treguesve të ndërhyrjeve hibride duke mundësuar një përgjigje efektive dhe në kohë. Në përgjigje të ndërhyrjeve hibride, ne do të përdorim sistemin strategjik të komunikimit për pozicionet e koordinimit gjithëpërfshirës. Një komunikim i tillë do të synojë audiencat vendase, si dhe ato ndërkombëtare, përfshirë autorët e ndërhyrjeve hibride.

Vendi ynë do të vlerësojë dhe zhvillojë mundësi për përfshirjen publike të ndërhyrjeve hibride. Pra, synimi do të jetë të gatishmëria për t'iu përgjigjur aktiviteteve hibride armiqësore me masa konkrete (përfshirë sanksionet), duke përfshirë instrumentet nga organizatat ndërkombëtare ku vendi ynë është anëtar.

Strategjitë për sigurinë dhe mbrojtjen do të kenë kuptim pas ato të pasohen nga plane veprimi që përcaktojnë detyra dhe hapa specifike.

Forcat ushtarake nuk kanë qenë për një kohë të gjatë fuqia që mban monopolin, sigurinë, por ato janë/veprojnë si një nga mjetet e tjera në dispozicion të politikës. Në të ardhmen, luftërat, misionet e luftës hibride ose menaxhimit të krizave do të jenë shumë më komplekse dhe shumëdimensionale, prandaj qasja e integruar konsiderohet të jetë e suksesshme.

Pavarësisht nga tipologjia e aktorëve të përfshirë në dinamikat e krizave, strukturat ushtarake, organizatat qeveritare, joqeveritare ose agjencitë e medias, të gjitha ato kanë objektiva të veçanta në zonat e konfliktit/teatrot e operacioneve. Këto objektiva do të çojnë në politika dhe veprime të ndryshme, të cilat shpesh kundërshtojnë njëra -tjetrën.

Megjithatë, nuk është e mjaftueshme të analizohet roli i palëve (instrumentet e fuqisë civile dhe ushtarake, kombëtare dhe ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare) dhe çfarë ata mund të arrijnë për qëllimin përfundimtar, por është e nevojshme integrimi i efekteve të veprimeve të të gjitha instrumenteve të pushtetit, integrim i qasje në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Integrimi gjithëpërfshirës është një proces përmes të cilit aftësitë e një task force të përbashkët, së bashku me ato të organizatave dhe agjencive të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, kombinohen dhe arrijnë efekte koherente.

Pasoja është një qasje gjithëpërfshirëse dhe e integruar, e cila përfshin operacione të përbashkëta që komandohet dhe vendoset përmes mirëkuptimit reciprok, besimit dhe qëllimit të përbashkët – objektiv themelor i çdo force. Kjo qasje kombinon në mënyrë unitare të gjithë elementët e sistemit civil dhe ushtarak, brenda dhe ndërqeveritare/ndërshtetërore, si dhe tipologjinë e qasjes, efektit dhe rrjetit.

Kultura e integritetit luan rolin e një ideologjie që synon të eliminojë konceptualin dhe barrierat e veprimit midis vektorëve të dy fushave. Instrumentet civile dhe ushtarake mund të zhvillohen dhe të krijojnë aftësi koherente kur kultura e koordinimit krijon një

lëvizshmëri të task forcës. Një strategji e tillë është e nevojshme në nivelin e ekzekutimit, por veçanërisht në nivelin e konceptimit.

Çadra e sigurisë e Shqipërisë, e përbërë nga anëtarësimi në NATO, si dhe në partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara, po ofron një gamë të gjerë mjetesh, duke filluar nga ushtria, ekonomia, politika, etj., për t'iu kundërvënë kërcënimeve konvencionale dhe jokonvencionale. Sidoqoftë, përpjekja kombëtare është vendimtare dhe duhet të ngrihet në realitetin e sfidave rajonale dhe globale.

Ne e vlerësojmë se planifikimi duke marrë në konsideratë kërcënimet hibride, reagimi ndaj tyre, si një aspekt më pak i debatuar në literaturën dhe doktrinën ushtarake, duhet të vlerësohet nga mjedisi akademik ushtarak dhe të zbatohet me përgjegjësi nga institucionet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit tonë.

Prandaj, qasja gjithëpërfshirëse dhe e integruar (shumëpalëshe) dhe çështja e instrumenteve të energjisë në luftën hibride ose menaxhimin e krizave, vazhdojnë të zbulojnë një numër të konsiderueshëm sfidash, të cilat analistët, teoricienët dhe vendimmarrësit/politikëbërësit duhet të marrin parasysh konceptualitetin aktual të rishikimit të dokumenteve të strategjisë së sigurisë dhe të mbrojtjes në Shqipëri.

Bibliografia

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH-2014, kreu I, II, III.
- Strategjia Ushtarake, botimi i vitit 2015, kreu II “Mjedisi Strategjik i Sigurisë”.
- Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike të MM (2021-2023).
- Direktiva e Mbrojtjes 2021.
- Përfundime dhe Relacioni i Konferencës Shkencore “Sfidat e planifikimit të mbrojtjes dhe përputhshmëria me procesin e planifikimit të NATO- s (NDPP)”.
- Udhëzimet e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm FA për arsimimin dhe stërvitjen, 2019.
- Doktrina e Përbashkët e FA, edicioni II, 2017.
- AJP-1 (D) Doktrina e Përbashkët e Aleancës, 2017; Seksioni 2 - Sistemi i Përgjigjes së Krizave të NATO-s 3-3 dhe Procesi i menaxhimit të krizave të NATO-s 3-5.
- Marine Corps Civil-Military Operations School. 2019. Circular 3.2. - Civil Preparation of the Battlespace. Virginia: U.S. Marine Corps. Ministry of Defense. 2007.
- NATO Standardization Office. 2018. AJP-3.19 Allied Joint Doctrine for Civil-Military Cooperation. NATO HQ, Brussels, Belgium. Raftiu, Aurelian. 2016 “Countering Hybrid Threats by Integrating Civilian-Military Capabilities”.
- https://unsdg.un.org/sites/default/files/UN-Policy-on-Integrated-Assessment-andPlanning_FINAL_9-April-2013.pdf, accessed on February 20, 2021.
- US Joint Chiefs of Staff. 2014. J.P.2-01.3 Joint Intelligence Preparation of the Operational Environment. Washington, DC: Pentagon. <https://dexonline.ro/definitie/a%20integra>, accessed on February 20, 2021. <https://dexonline.ro/definitie/cuprinz%C4%83tor>, accessed on February 20, 2021

SIGURIA KIBERNETIKE DHE KUADRI LIGJOR SHQIPTAR

Dr. Elona Bano
Universiteti “Barleti”

Trajtesa e shkurtuar.

Në vitet e fundit, me zhvillimin e teknologjisë, njerëzimi jo vetëm ka arritur të përmirësojë ndjeshëm stilin e jetesës, por edhe është ekspozuar dukshëm ndaj formave të reja të krimit, i cili duket sikur tashmë përveçse krimit të rëndomtë të rrugës është transferuar në krim kibernetik. Krimi kibernetik, si forma e re e përdorimit të teknologjisë për cenimin e sigurisë shoqërore dhe asaj vetjake, duket që ka gjetur të papërgatitur mbarë njerëzimin dhe e ka bërë atë më vulnerabël se kurrë.

Në këtë radhë idesh, mungesa e kuadrit ligjor në fushën e krimit kibernetik, me një Strategji Kombëtare të Sigurisë Kibernetike të miratuar vetëm në dhjetor të vitit 2020 dhe me akte normative të pjesshme në këtë fushë, ekspozon dhe më shumë qytetarët ndaj pasigurisë duke bërë të vështirë apo edhe të pamundur reagimin e autoriteteve shtetërore për shkak të mungesës së instrumenteve ligjore.

Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë mangësitë ligjore dhe problematikat që institucionet dhe kapacitetet njerëzore të organeve ligj-zbatuese hasin në depistimin, hetimin, zbulimin e më pas gjykimin e veprave penale që cenojnë sigurinë e individëve në hapësirën virtuale.

Fjalë kyçe: strategji, krim kibernetik, hapësirë virtuale, kuadër ligjor

Hyrje

Siguria kibernetike është arti i mbrojtjes së rrjeteve, pajisjeve, të dhënave nga akseset e paautorizuar kriminal. Siguria kibernetike përfshin dhe ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit, si dhe të aksesit dhe vlefshmërisë së informacionit. Në pamje të parë duket sikur ka lidhje dhe mbështetet te kompjuterët dhe komunikimi në internet (smartphone, tableta, email), mjete të tjera argëtimi, si: lojërat video-interaktive, mediat sociale, aplikacionet e ndryshme, transporti me mjetet dhe sistemet e navigimit, blerjet online me përdorimin e kartave të kreditit, mjekësia me pajisjet mjekësore dhe telemedicinën etj.¹

Normalisht që mjetet elektronike dhe teknologjia na ka lehtësuar komunikimin dhe jetën e përditshme, por a ia vlen çmimi që duhet të paguajë secili prej nesh? A jemi të gatshëm, të ndërgjegjshëm dhe të sigurtë që shumë prej të dhënave tona personale dhe sensitive të jenë të aksesueshme nga sisteme të ndryshme elektronike dhe në të njëjtën kohë të jemi lehtësisht të gjetshëm e të kontrollueshëm?

Dukshëm zhvillimet teknologjike kanë vënë në dyshime jo vetëm individët, por edhe shtetet të cilat tanimë janë më të sulmuar dhe vulnerabël me një armik të padukshëm, i cili mund të jetë kilometra larg por që mund të shkatërrojë sisteme të tëra elektrike, bankare e mund të ndërhyjë deri në sistemet më të sofistikuar të mbrojtjes së një shteti.

Nëse do t'i referohemi Evropës, vetë Bashkimi Evropian ndihet më i kërcënuar në vlerat kryesore, si: liria, demokracia dhe dinjiteti, barazia dhe solidariteti. Sulmi kibernetik më 2007 ndaj Estonisë, shtet i BE-së, bëri që Evropa dhe NATO të ndryshonin drejtimin e tyre duke vendosur një vijë të drejtë mes qëndrueshmërisë në hapësirën kibernetike dhe mbrojtjen kolektive. Sulmet kibernetike në vitet e fundit konsiderohen në doktrinën ushtarake njëloj të rrezikshme dhe me pasoja, ashtu si dhe “aktet e agresionit” ndaj një shteti, duke i mundur këtij të fundit kundërpërgjigjen dhe përdorimin e armëve apo taktikave mbrojtëse jo në proporcion me armët e përdorura, në këtë rast teknologjinë e informacionit, por me armë në proporcion me dëmin e shkaktuar, që mund të jenë sanksione të njohura nga e drejta ndërkombëtare publike si: embargot, tërheqja e përfaqësive diplomatike e deri në tërheqjen e trupit diplomatik nga shteti sulmues.

¹ Agjencia e sigurisë dhe infrastrukturës kibernetike të SHBA-ve; burimi elektronik: <https://us-cert.cisa.gov/ncas/tips/ST04-001>

1. Cilat janë sfidat kryesore kur flasim për sigurinë kibernetike të një shteti?

Sfida e parë për vendin tonë por edhe më gjerë është edukimi dhe ndërgjegjësimi i pakët i qytetarëve në këtë fushë. Studimet tregojnë se kryesisht qytetarët evropianë mbi 50 vjeç kanë vështirësi akses në internet, përdorimi të teknologjive bazike të informacionit e për pasojë informacion të vakët për sa i përket efekteve dhe pasojave që përdorimi i tyre mund të sjellë në sigurinë personale apo shtetërore.

Nëse do t'i referohemi statistikave zyrtare sipas INSTAT për 2020² do të vëmë re se moshë 16-24-vjeçare përdor mbi 94,8% internetin, ndërsa ata të moshës 65-74 vjeç e përdorin vetëm 30,3% internetin në mënyrë sistematike. Nëse do t'i referohemi përdorimit të internetit në baza ditore, do të vëmë re se përqindjen më të lartë e kanë grup-moshat 25-34 vjeç, pasuar nga ata të grup-moshës 16-24 vjeç. Ndërsa grup-moshat mbi 55 vjeç e përdorin vetëm në masën 11,3%.

Sfida e dytë lidhet me investimet e pakta që shtete të ndryshme evropiane e sidomos ato ballkanike kanë kryer vitet e fundit për sa i përket teknologjisë së informacionit dhe ruajtjes e sigurisë së rrjeteve të informacionit. Konkretisht, nëse do t'i referohemi vendeve të rajonit dhe Shqipërisë për investimet në teknologjinë e informacionit në tërësi, sipas raportit për 2021 të Global Innovation Index 2021 do të vëmë re se Shqipëria është e 26-ta në grupin e saj, duke u renditur 4 vende më poshtë se Bosnje-Hercegovina dhe shumë vende më poshtë se Serbia apo Mali i Zi, të cilat janë të renditura afër vendeve të para të listës së grupit, duke pasur një performancë shumë më të mirë se pritshmëritë për nivelin e grupit. Gjithsesi, Shqipëria renditet në vendet brenda pritshmërive për sa i përket të ardhurave vjetore³.

Sfida e tretë, që kufizon pikërisht rolin proaktiv që organet ligjzbatuese dhe mbrojtëse të shtetit duhet të luajnë, konsiston në faktin që infrastruktura informacionale i përket kryesisht privatëve dhe biznesit dhe shumë më pak shtetit. Janë pikërisht bankat, kompanitë e telekomunikacionit që kanë rrjetet informatike më të zhvilluara dhe i japin një kujdes të veçantë krimeve kibernetike, duke investuar shuma të konsiderueshme parash për mbrojtjen dhe sigurinë e sistemeve IT. Shpeshherë këto sipërmarrje private nën petkun e “sekretit tregtar” apo atë të “ruajtjes së të dhënave personale të klientëve të tyre” refuzojnë dhe të bashkëpunojnë me autoritetet ligjzbatuese duke e vështirësuar hetimin dhe zbulimin e veprave të ndryshme penale, të cilat cenojnë sigurinë në hapësirën kibernetike.

Një sfidë e katërt lidhet me aksesin e pakufizuar në teknologjinë e lartë e cila na ekspozon si shoqëri drejt rreziqeve të pakonceptueshme për ne dhe autoritetet ligjzbatuese e për pasojë të pashmangshme. Më konkretisht, shembuj të realitetit të sotëm në botë por që kanë filluar të bëhen pjesërisht pjesë dhe e realitetit shqiptar janë:

- Smart cities (qytete të zgjuara)

Rritja e qasjes dhe miniautorizimi i komponentëve kompjuterikë ka çuar në përsheptimin

² http://www.instat.gov.al/media/8267/ict-2020_shqip_.pdf

³ Global Innovation Index 2021, 14 Edition, file:///C:/Users/e.bano/Downloads/gii-full-report-2021.pdf

e instalimit të rrjeteve të Smart City dhe infrastrukturës së tij. Shembuj të këtyre rrjeteve të ndërlidhura janë ASEAN Smart Cities Network⁴, modeli indian i Smart Cities Mission⁵, i cili promovon një infrastrukturë të qenësishme, të qëndrueshme, një mjedis të pastër, i cili ofron një jetë të denjë për qytetarët nëpërmjet “zgjidhjeve të zgjuara”. 100 qytete në mbarë Indinë prej 2015 janë përzgjedhur për t’u zhvilluar si Smart Cities përmes një kompeticioni me dy faza. Vihet re se integrimi dhe inovacioni janë një nga parimet kryesore të kësaj iniciative. Derisa zhvillimi i qyteteve të zgjuara është një qëllim kryesor për shumë ekonomi, ai gjithashtu zgjeron sulmet e mundshme, sipërfaqet e disponueshme për kriminelët në internet që synojnë pajisjet inteligjente të cenueshme.

- Smart homes (shtëpitë e zgjuara)

Qytetet e zgjuara nuk janë shembulli i vetëm i disponueshmërisë masive të pajisjeve të Internetit të Gjërave (IoT).

Aksesi në rritje i pajisjeve të shtëpisë inteligjente për konsumatorët zgjeron numrin e pajisjeve të cenueshme. Shumë përdorues të këtyre pajisjeve nuk arrijnë të ndryshojnë fjalëkalimet e paracaktuara, të cilat më pas përditësohen rregullisht dhe softueri i tyre i bën ato objektiva të lehtë për sulm. Sende të zakonshme shtëpiake, siç janë bravat e dyerve dhe frigoriferët janë bërë pajisje të afta që lidhen me internetin, duke ofruar një sërë opsionesh të reja në shënjestrimin e kriminelëve kibernetikë.

Në vitin 2019, Kaspersky vuri në dukje se në gjashtë muajt e parë të vitit u zbuluan mbi 100 milionë sulme ndaj pajisjeve të tilla elektroshtëpiake. Ky numër është një rritje dramatike nga 12 të një viti më parë. Në vitin 2020, pikat e kontaktit Kaspersky zbuluan 426 milionë sulme ndaj pajisjeve IoT që vijnë nga 742,000 adresa IP unike, vetëm në gjashtë muajt e parë të vitit. Kjo është një rritje prej katër herë më shumë në numrin e sulmeve dhe 2.5 herë numri i IP-ve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Pra, vihet re një ekspozim i tejskajshëm para këtyre sulmeve si dhe një vulnerabilitet, i cili vendos në rrezik çdo ditë jetën e njerëzve dhe komuniteteve në mbarë botën.

2. Kuadri ligjor kushtuar sigurisë kibernetike

Ligjet kryesore që lidhen me sigurinë dhe krimin kibernetik janë:

- ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”;
- ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- ligji nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar;

⁴ Association of Southeast Asian Nations- A community of opportunities for all: <https://asean.org/what-we-do/>

⁵ Indian Smart Cities Mission: <https://smartcities.gov.in/about-the-mission>

- ligji nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar;
- ligji nr. 107, datë 15.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar.

3. Kodi Penal Shqiptar

Kodi Penal Shqiptar parashikon një sërë veprash penale të cilat parashikojnë cenimin e sigurisë nëpërmjet përdorimit të hapësirës kibernetike⁶ apo mjeteve elektronike siç do t'i vëmë re që përdoret si terminologji juridike. Ligji nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, në nenin 3, pika 3 e përkufizon hapësirën kibernetike si :“Hapësirë kibernetike” është mjedisi digjital i aftë të krijojë e të shkëmbejë informacionin e krijuar nga sistemet, shërbimet e shoqërisë së informacionit, si dhe rrjetet e komunikimit elektronik. Ndërsa në të njëjtën logjikë dhe pse më i hershëm, Kodi Penal në nenin 137/a parashikon veprën penale të vjedhjes së rrjetit të komunikimeve elektronike, duke nënkuptuar përvetësimin e tyre në mënyrë të padrejtë⁷.

Neni 232 i Kodit Penal e sheh hapësirën kibernetike si një mjet i cili mund të përdoret për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, siç është ajo e stërvitjes së personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste. Pikërisht sipas këtij neni, përgatitja, stërvitja dhe dhënia në çdo formë e udhëzimeve edhe në mënyrë anonime ose në rrugë elektronike, pra nëpërmjet hapësirës kibernetike, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike apo bërthamore ose të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, si dhe të teknikave e të metodave të tjera për kryerjen e veprave me qëllime terroriste dhe pjesëmarrja në veprimtari të tilla, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, përbëjnë një vepër me rrezikshmëri tepër të lartë shtetërore.

Por Kodi Penal i bazuar dhe në një sërë direktivash dhe rregulloresh evropiane nuk kufizohet me kaq, ai parashikon dhe një vepër penale siç është ajo e “stërvitjes për prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të armëve e lëndëve të tjera të rrezikshme”, parashikuar nga neni 282/b e Kodit Penal ku hapësira kibernetike mund të përdoret për të dhënë udhëzime rreth përgatitjes, stërvitjes së individëve të ndryshëm, me qëllim prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, të armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike, bërthamore apo të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë.

Me qëllim ofrimin e një pasqyre më të gjerë këtij punimi, vlen të përmendet dhe klasifikimi i veprave penale në hapësirën kibernetike sipas INTERPOLIT, i cili është përditësuar jo më

⁶ Ligji Nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”

⁷ Neni 137/a Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike (Shtuar me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 34) Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike dënohet me burgim deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

vonë se marsi i vitit 2021. Më konkretisht kemi këto ndarje ⁸:

- Titulli 1: Veprat kundër konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave kompjuterike dhe sistemet; aksesit i paligjshëm, përgjimi i paligjshëm, ndërhyrja në të dhëna, ndërhyrja në sistem dhe keqpërdorimi i pajisjeve.
- Titulli 2: Veprat penale të lidhura me kompjuterin - falsifikimet e lidhura me kompjuterin, mashtrimet e lidhura me kompjuterin.
- Titulli 3: Veprat penale të lidhura me përmbajtjen - pornografia e fëmijëve.
- Titulli 4: Veprat penale që lidhen me shkeljen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to.
- Titulli 5: Përgjegjësia shtesë dhe sanksionet - përpjekje dhe ndihmë ose mbështetje, përgjegjësia korporative.

3.1. A është i njëjtë krimi kibernetik me shkeljen e sigurisë kibernetike?

Krimi kibernetik në përgjithësi kuptohet si akti kriminal ku kompjuterët dhe rrjetet janë shënjestër kryesore, përdoren si mjete për të kryer veprën penale ose janë vendndodhja e krimit apo vendi ku dallohet dëmi kryesor.

Edhe pse nuk ka përkufizim të pranuar universalisht, mund të bëhet dallim midis dy llojeve kryesore të krimit kibernetik:

• **Krimi i mundësuar nga kibernetika**, duke iu referuar formave ‘tradicionale’ të krimit, tani të transferuara në sferën kibernetike, siç janë veprat penale të fokusuara në financa, aktet që pengojnë sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve madje edhe terrorizmi. Akte të tjera kriminale të përhapura ndjeshëm në sferën kibernetike përfshijnë tregtinë e paligjshme të drogës, armëve dhe të dhënave dhe informacionit sensitiv, trafikimin e njerëzve dhe porositjet e vrasjeve apo rracheve në bazë të një kontrate në Darknet. Që nga emri “Darknet” kuptojmë rrjetin e errët ku përdoruesit veprojnë zakonisht në anonimitet, ndërrojnë shpesh IP e kompjuterëve të tyre duke fshehur gjurmët e mundshme të depistimit të tyre në hapësirë, përdorin mesazhe të koduara dhe bitcoini apo valuta të tjera të krijuara për të blerë apo shitur sende e shërbime të ndaluara nga qarkullimi civil apo të jashtëligjshme.

• **Krimi i avancuar kibernetik** (i njohur edhe si krimi i teknologjisë së lartë), duke iu referuar sulmeve të sofistikuara ndaj pajisjeve kompjuterike dhe softuerëve të ndryshëm. Në këtë rast hapësira kibernetike kthehet në vendndodhjen e zhvillimit të një veprë penale. Vendi ku organizata të ndryshme mund të ofrojnë shërbimet e tyre organizatave terroriste, me qëllim kryerjen e akteve kriminale të sponsorizuara nga shtetet në hapësirën kibernetike vetëm për qëllime fitimi financiar.

Është e rëndësishme të mos ngatërrohet krimi kibernetik me sigurinë kibernetike. Të dyja kërcënimet e lidhura me kibernetikën dallojnë për nga motivi, dashja, mjetet e përdorura,

⁸ Interpol, “Strategjia Kombëtare e Krimit Kibernetik” – Udhëzues, fq. 9

file:///C:/Users/e.bano/Downloads/National%20Cybercrime%20Strategy%20Guidebook.pdf,

shënjestra, shtrirja, pasojat, si dhe aktorët e përfshirë në parandalim dhe zbutje. Në praktikë, krimi kibernetik është i shumëllojshëm nga spam-i dhe email-et phishing, dallaveret dhe mashtrimet në internet, si dhe përfaqësimi i rremë, deri te përmbajtja e ndaluar fyese dhe e kundërligjshme, vjedhja e identitetit dhe materiali online i abuzimit seksual të fëmijëve. Motivi kryesor prapa akteve kriminale kibernetike, si në rastin e krimit ‘tradicional’, përgjithësisht konsiderohet se është fitimi financiar. Kriminelët kibernetikë janë në thelb hackera dashakeqë⁹.

Terma si: domain dashakeq; ransomware; malware për mbledhje të dhënash; Botnets; Cryptojacking; Darknet; kriminaliteti informatik si shërbim, janë vetëm disa nga termat që para 10 vitesh as që ekzistonin ndërsa tani janë pjesë e gjuhës së përbashkët, pasi shkelësit e ligjit i përdorin së bashku me teknologjitë e reja për të kryer sulme kibernetike kundër qeverive, bizneseve dhe personave fizikë. Këto lloj veprash penale nuk njohin kufij fizikë, virtualë, përkundrazi shkaktajnë dëme të rënda dhe paraqesin rreziqe reale për viktimat e tyre në gjithë botën.

Karakteristikat kryesore të krimit kibernetik janë: kryhet pa lënë gjurmë; i jep shumë siguri autorit duke qenë se kryhet në distancë; nuk njeh kufij shtetërorë apo juridiksione shtetërore; përdor teknologjinë më të fundit duke qenë pararojë në krahasim me teknologjinë e përdorur nga organet ligjzbatuese; përdorin dhe krijojnë çdo herë forma bashkëpunimi dhe ndërveprimi mes autorëve pavarësisht se në cilin cep të globit mund të jenë¹⁰.

4. Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”

Ligji për sigurinë kibernetike në Shqipëri është relativisht i ri, i miratuar në fillim të vitit 2017 dhe ka transpozuar pjesërisht Direktivën (BE) 2016/1148 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 6 korrik 2016 “Mbi masat për një nivel të përbashkët të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në Bashkimin Europian”. Numri CELEX: 32016L1148, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 194, datë 19.7.2016, faqe 1-30. Në fakt, vihet re në analizë krahasimore me ligje të shteteve të tjera anëtare të BE-së p.sh., Rumania, që ligji ynë është shumë i ngjashëm me të tyrin i cili në fakt është teksti i njëjtë me direktivën e sipërcituar. Konkretisht, ligji 362/2018 i Rumanisë për sigurinë e një niveli të ngritur sigurie të përbashkët të rrjeteve dhe sistemeve informatike¹¹ ka ndryshime thelbësore, të cilat në kuadër të përafrimit ligjor shqiptar me *acquis communautaire*, do duhet të përafrohen dhe në legjislacionin tonë, më konkretisht në:

a. kreun II, neni 6, pika 2 referuar subjekteve përgjegjëse në fushën e sigurisë kibernetike, ligji shqiptar parashikon se: “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, miraton listën e infrastrukturave kritike të informacionit dhe të infrastrukturave të

⁹ Hyrje në Qeverisjen e Sigurisë Kibernetike- Mjet Pune për deputetë të parlamentit; Publikuar nga Geneva CENTRE FOR SECURITY SECTOR GOVERNANCE. <https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/CyberPolicyToolALBANIAN.pdf>

¹⁰ <https://www.interpol.int/en/Crimes/Cybercrime>

¹¹ <https://cert.ro/pagini/informatii-generale-despre-nis>

rëndësishme të informacionit, e cila përditësohet të paktën një herë në dy vjet.” Një parashikim i tillë jo vetëm tregon që nuk është në frymën e direktivës por është dhe një normë e cila qartazi tregon të centralizojë pushtetin dhe kontrollin shtetëror në këtë fushë duke përfshirë apo sipas disa interesave të momentit lista të ndryshme infrastrukturash. Aktualisht, vetëm pas 3 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji më 13/10/2020 me urdhër nr. 73, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ka miratuar “Metodologjinë për identifikimin dhe klasifikimin e infrastrukturave kritike dhe infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”.

b. legjislacioni i sipërcituar rumun, por dhe vetë direktiva e BE-së e quajtur Direktiva NIS 2016/1148 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 6 korrikut 2016, në lidhje me masat për një nivel të rritur të përbashkët të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve informatike në Bashkim, këtë të ashtuquajtur metodologji e parashikon si Aneks me titull – Sektori i aktivitetit dhe llojet e operatorëve.¹²

5. Ligjet e tjera

Sipas renditjes së mësipërme, do të vëmë re se ligjet e tjera si: “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe “Për informacionin e klasifikuar”, kanë objekte të ndryshme duke bërë dallimin që në objektin e tyre dhe evidentuar target-grupin të cilit i drejtohen si dhe marrëdhëniet publike apo private që përdorin komunikimin publik.

Konkretisht, ligji për komunikimet elektronike që në nenin 1 të tij parashikon se: “Qëllimi i këtij ligji është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë”, duke kaluar më poshtë në nenin 2 dhe paraqitur kufizimet e tij siç janë shërbimet nëpërmjet komunikimeve elektronike apo transmetimet radiotelevizive.

Me rëndësi për këtë punim janë parashikimet e ligjit nr. 8457 dt. 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave për klasifikimin, përdorimin, ruajtjen dhe deklasifikimin e informacionit për sigurinë kombëtare, i cili, me këtë ligj, do të konsiderohet sekret shtetëror. Shteti është zotëruesi i vetëm i sekreteve shtetërore, duke e rregulluar këtë të drejtë me të drejtën e publikut për t’u njohur me veprimtarinë e tij”.¹³

6. Përfundime

Sot krimi kibernetik është një problematikë jo vetëm për vendin tonë, por edhe për organizma si vetë INTERPOLI, i cili duke filluar që prej vitit 2013, mori një kah tjetër në analizimin e kësaj situate dhe hetimin e tij, duke u bazuar në partneritetet mes autoriteteve publike,

¹² Departamenti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike të Rumanisë: <https://cert.ro/pagini/informatii-generale-despre-nis>

¹³ Ligji nr. 8457, neni 1, dt. 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.

private dhe akademike me ekspertizë në hetimin e krimit informatik. Në vendin tonë është Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike ajo që parashikon si objektiv politik 2 këtë lloj qasje, duke parashikuar si prioritarë ndërtimin e një mjedisi të sigurt kibernetik, duke edukuar dhe ndërgjegjësuar shoqërinë në ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë së informacionit dhe si objektiv specifik rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë së informacionit nëpërmjet rishikimit të kurrikulave arsimore.

Kuadri ligjor dhe institucional për një fenomen kaq sensitiv është jo i përafëruar plotësisht me Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Evropian duke krijuar kështu vakume ligjore si dhe problematika interpretimi.

Kuadri ligjor shqiptar kushtuar sigurisë kibernetike ka filluar të përgatitet që prej vitit 1999 me miratimin e ligjit “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, e në vijim, por pa ndjekur një koherencë dhe plotësim logjik të njëri-tjetrit.

Institucionet të cilat zbatojnë dhe funksionojnë me këtë korpus ligjor janë nën vartësinë e ministrive të ndryshme të linjës dhe/ ose të pavarura, duke krijuar kështu mungesa koordinimi dhe bashkëpunimi në monitorimin e më pas marrjen e masave shtrënguese nga subjektet shtetërore ose private që operojnë në hapësirën kibernetike.

Strategjia Kombëtare për sigurinë kibernetike e miratuar në fund të vitit 2020 nga Këshilli i Ministrave e parashikon shprehimisht si objektiv specifik nr. 1 “Përmirësimin e kuadrit ligjor që normon dhe rregullon fushën e sigurisë kibernetike në vend, si dhe harmonizimi i tij me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian referuar korpusit ligjor si dhe ngritjen dhe funksionimin e CSIRT-eve në të gjithë sektorët e industrisë në nivel kombëtar referuar kuadrit institucional”. Për këtë qëllim duhet të mbahen parasysh dhe parashikimet më të fundit të Strategjisë Kombëtare për Krimin Kibernetik të Interpol miratuar në 2021¹⁴.

Bibliografia:

Baza ligjore:

- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”.
- Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9880, datë 25.2.2008. “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 107, datë 15.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar.

¹⁴ file:///C:/Users/e.bano/Downloads/National%20Cybercrime%20Strategy%20Guidebook.pdf

Institucione dhe adresat elektronike zyrtare:

- Agjencia e sigurisë dhe infrastrukturës kibernetike të SHBA-ve [https://us-cert.cisa.gov/ncas/tips/ST04-001\](https://us-cert.cisa.gov/ncas/tips/ST04-001)
- INSTAT http://www.instat.gov.al/media/8267/ict-2020_shqip__.pdf
- Global Innovation Index 2021, 14 Edition, file:///C:/Users/e.bano/Downloads/gii-full-report-2021.pdf
- INTERPOL <https://www.interpol.int/en/Crimes/Cybercrime>
- Departamenti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike të Rumanisë: <https://cert.ro/pagini/informatii-generale-despre-nis>

INFRASTRUKTURA KRITIKE DHE SIGURIA KOMBËTARE

Nënkolonel Msc. Bajazit Muceku
IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Infrastruktura kritike është një aset ose sistem, i cili është thelbësor për ruajtjen e funksioneve jetësore shoqërore. Dëmtimi i një infrastrukture kritike, shkatërrimi ose prishja e saj nga fatkeqësitë natyrore, terrorizmi, veprimtaria kriminale ose sjellja keqdashëse mund të ketë një ndikim të rëndësishëm negativ për sigurinë, ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve. Ndërprerja ose mbyllja e plotë e shërbimeve të ofruara nga infrastruktura kritike, qoftë ato të lidhura me shpërndarjen e ujit, rrjetin elektrik, sektorin e energjisë apo fusha të tjera, mund të kenë efekte katastrofike në nivel lokal, kombëtar madje edhe ndërkombëtar. Sot, kërcënimet kibernetike po rriten në numër, lloj dhe sofistikim. Raporte të ndryshme theksojnë këtë pikë jetike, duke sjellë në fokus rreziqet e shumta kibernetike që mund të lindin nga përdoruesit e sistemeve të bazuara në teknologji. Në dritën e teknikave të shumta dhe vektorëve kërcënues në dispozicion të hakerëve që synojnë kryerjen e një sulmi, subjektet përgjegjëse për infrastrukturën kritike dhe zinxhirët e tyre të furnizimit duhet të kenë protokoll adekuat të sigurisë për t'u mbrojtur kundër sulmeve kibernetike e infiltrimit dhe të jenë në gjendje të tregojnë elasticitet pas një sulmi të vërtetë.

Mbrojtja e infrastrukturës kritike është sistemi proaktiv i aktiviteteve të përdorura për të mbrojtur njerëzit e domosdoshëm, asetet fizike dhe sistemet kibernetike nga të cilat ne varemi. Mbrojtja e aseteve më kritike të vendit nuk është detyrë e lehtë. Ajo kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm midis agjencive kryesore dhe strukturave të të gjitha niveleve, si dhe zbatimin e vazhdueshëm të teknologjive dhe proceseve të përmirësuara të mbrojtjes së infrastrukturës kritike.

Fjalë kyçe: Infrastruktura kritike, ndërvarësi, aset, sistem, mbrojtja e infrastrukturës kritike, elasticitet

1. Përcaktimi i infrastrukturës kritike të vendit

Termi “infrastrukturë kritike” ka ndryshuar kuptim me kalimin e kohës dhe për këtë arsye ndonjëherë është i paqartë. Para datës 11 shtator 2001, ky term i referohej kryesisht ndërtimeve publike (ndërtesa që i përkisnin publikut dhe përdororeshin prej tij), si për shembull, rrugët, autostradat, urat, kanalizimet e ujërave, aeroportet, portet detare dhe ndërtesat publike.¹ Shqetësimi kryesor asokohe ishte se sa mirë shfrytëzoheshin këto shërbime për publikun. Kjo gjë nisi të ndryshojë në fillim të viteve '90, pasi në SHBA ndodhën ngjarje të tilla si vendosja e bombave në Qendrën Botërore të Tregtisë (1993) dhe në ndërtesën e qytetit të Oklahomas (1995). Në këto vite, kërcënimi nga terrorizmi po shpërndahej edhe në SHBA dhe rrjedhimisht, përkufizimi i infrastrukturës kritike u zgjerua. Sot, termi “infrastrukturë kritike” është koncept i përgjithshëm që i referohet rrjeteve dhe sistemeve të krijuara nga njeriu që i sjellin të mira dhe shërbime publikut. Me fjalët të tjera, janë ndërtesat dhe strukturat, si fizike ashtu edhe organizative, që mundësojnë shërbime thelbësore anëtarëve të një komuniteti dhe përkujdesen për mbarrëvajtjen e tij. Gjithashtu, përfshihen objekte të tilla si: ndërtesa, rrugë dhe sisteme transporti, sistemi i telekomunikacionit, sistemi i ujit, sistemi i energjisë elektrike, shërbimet e emergjencave, institucionet bankare dhe financiare. Përveç strukturave dhe asetëve fizike, ajo përfshin edhe sistemet virtuale (kibernetike) dhe njerëzit. Përgjithësisht, infrastruktura kritike përfshin të gjitha sistemet që janë të pazëvendësueshme e të nevojshme për mirëfunksionimin e qeverisë në të gjitha nivelet. Ajo është një aset jashtëzakonisht i nevojshëm dhe i rëndësishëm për një komunitet ose një vend, i cili nëse prishet, dëmtohet apo shkatërrohet, në një mënyrë të tillë që pengon funksionimin e tij, mund të ketë një ndikim të pandreqshëm në sigurinë, ekonominë, shëndetin dhe mirëqenien e vendit, të qytetarëve dhe bizneseve.

Ligji Publik 107-56/2001 në SHBA përcakton infrastrukturën kritike si “sisteme dhe asete, fizike ose virtuale, kaq vitale për Shtetet e Bashkuara sa paaftësia ose shkatërrimi i tyre kanë një efekt të dobësuar mbi sigurinë, ekonominë kombëtare, shëndetin publik ose ndonjë kombinim të këtyre çështjeve”.² Plani Kombëtar i Mbrojtjes së Infrastrukturës Kritike të SHBA e organizon infrastrukturën kritike në 16 sektorë dhe përcakton një departament federal ose agjenci si agjenci specifike e sektorit koordinator-sektorial për

¹ Kelley A. Pesch-Cronin, Nancy E. Marion, Critical infrastructure protection, risk management, and resilience, 2017, f.4.

² Brian T. Bennett, Understanding, Assessing, and Responding to Terrorism, 2018, p.40.

secilin sektor: sektori kimik; objektet tregtare; komunikacionet; prodhimi kritik; digat; shërbimet e emergjencës; teknologjia e informacionit; reaktorët bërthamorë, materialet dhe mbeturinat; ushqimi dhe bujqësia; baza industriale e mbrojtjes; energjia; shëndetësia dhe shëndeti publik; shërbimet financiare; sistemet e ujit dhe të ujërave të zeza; objektet qeveritare; sistemet e transportit.

Përcaktimi i infrastrukturës kritike sipas BE: Infrastruktura kritike është një aset ose sistem i cili është thelbësor për ruajtjen e funksioneve jetësore shoqërore. Dëmtimi i një infrastrukture kritike, shkatërrimi ose prishja e saj nga fatkeqësitë natyrore, terrorizmi, veprimtaria kriminale ose sjellja keqdashëse mund të ketë një ndikim të rëndësishëm negativ për sigurinë e BE-së dhe mirëqenien e qytetarëve të saj³. Përcaktimi i infrastrukturës kritike sipas NATO-s: Infrastruktura kritike janë ato asete, shërbime dhe sisteme informacioni të cilat janë kaq jetësore për kombet, që paaftësia ose shkatërrimi i tyre do të kishte një ndikim negativ në sigurinë kombëtare, ekonominë, shëndetin publik dhe funksionimin efektiv të qeverisë⁴.

Infrastruktura kritike sipas ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”: Infrastruktura kritike janë strukturat fizike, rrjetet dhe pasuritë e tjera, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin ekonomik dhe social të shoqërisë ose komunitetit. Sipas këtij ligji, infrastruktura kritike në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga: sistemet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë; prodhimi, rafinimi, trajtimi, magazinimi dhe shpërndarja e gazit nëpërmjet tubacioneve; nafta dhe prodhimi i produkteve të saj, magazinimi dhe shpërndarja nëpërmjet tubacioneve; telekomunikacioni (rrjetet, sistemet); furnizimi me ujë; bujqësia, prodhimi dhe shpërndarja e ushqimit; shëndeti publik; sistemet e transportit (rrjeti hekurudhor, aeroportet, portet, transporti i brendshëm); shërbimet financiare (bankare, kleringu); dhe shërbimet e sigurisë dhe të mbrojtjes. Infrastrukturat kritike janë të vendosura kudo. Ato janë të pranishme në të gjitha aspektet e rutinës sonë të përditshme dhe janë ngulitur në komunitetet tona. Është e lehtë për t'i përcaktuar ato si një koleksion i aseteve të pranishme brenda një juridiksioni. Një juridiksion është një palë përgjegjëse që ka autoritet dhe kontroll mbi aktivitetet brenda një zone të caktuar gjeografike⁵. Një juridiksion mund të jetë sektori privat ose sektori publik. Një juridiksion i sektorit privat është në pronësi private dhe operohet nga një individ ose një person juridik si një korporatë dhe ka kontrollin e drejtpërdrejtë të asetit. Një juridiksion i sektorit publik është ai në të cilin pasuritë janë pronë e qytetarëve dhe kontrollohen e operohen nga një agjenci shtetërore, njësi ekonomike, ose punonjës. Në vendin tonë një pjesë e konsiderueshme e sektorëve të infrastrukturës kritike është në pronësi të sektorit privat si: sektori i naftës, i gazit, sektori i telekomunikacioneve, sektori i bujqësisë, shërbimet financiare, një pjesë e shërbimit shëndetësor, etj. Është e mundur që një aset të klasifikohet si infrastrukturë kritike si për sektorin privat, ashtu edhe

³ Cristina Alcaraz, Sherali Zeadally, Critical Infrastructure Protection, Requirements and Challenges for the 21st Century, 2015, p.2.

⁴ Khan Jahier, Critical infrastructure protection within NATO.

⁵ Brian T.Bennett, Understanding, Assessing, and Responding to Terrorism, 2018, p.43.

për sektorin publik. Një shembull do të ishte një qendër private mjekësore e specializuar që operohet nga një subjekt privat dhe i synuar për të siguruar një fitim, por që siguron një shërbim kritik mbi të cilin publiku varet⁶.

2. Ndërvarësitë dhe efekti “kaskadë” i infrastrukturës kritike

Shumë nga asetet e infrastrukturës kritike janë të lidhura me njëra-tjetrën në një farë mënyre. Ky integrim i infrastrukturës do të thotë që nëse një aset është dëmtuar dhe i paaftë për t'i shërbyer njerëzve, asetet e tjera të lidhura me të, mund të jenë gjithashtu në gjendje jofunksionale. Kjo gjë është referuar si efekti “kaskadë”. Natyra e ndërlidhur e infrastrukturës kritike mund të sjellë edhe më shumë dëm në një komunitet në qoftë se asetet do të ishin të pavarura. Në disa raste, ndërvarësitë mund të jetë globale pasi shumë nga asetet kombëtare të vendeve janë të lidhura me ato rreth botës. Studiues të ndryshëm kanë identifikuar dhe analizuar konkretisht katër lloje të ndërvarësive të infrastrukturës kritike: fizike, gjeografike, kibernetike dhe logjike.⁷ Një shembull i qartë i ndërvarësisë mund të shihet me asetet kibernetike, të cilat janë të lidhura me të gjitha infrastrukturat e tjera si në vend ashtu edhe në vende të tjera. Kompjuterët janë bërë një pjesë thelbësore e shoqërisë sonë dhe çdo sektor tjetër mbështetet, të paktën pjesërisht, në teknologjinë e informacionit. Një sulm në internet mund të ndikojë në rrjetin e energjisë, ujit, shërbimeve financiare dhe kujdesit shëndetësor, duke shkaktuar shumë dëme në një periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë. Kjo gjithashtu do të ndikonte në transportin dhe rrjetet financiare, duke ndikuar kështu në ekonominë e vendit. Sistemet kompjuterike kontrollojnë pajisjet në industritë e naftës, gazit dhe mineraleve të tjera. Kompanitë mbështeten në teknologjinë e informacionit për një komunikim të lehtë, menaxhimin e personelit, hulumtimin dhe tregtinë në internet. Rrjeti kompjuterik është aq thelbësor sa që në dokumentet kryesore të kësaj fushe, të fuqive botërore, siguria kibernetike është identifikuar si një nga sfidat më serioze me të cilat përballlet siguria kombëtare dhe ekonomia e tyre. Ato asete, që janë të ndërlidhura me të tjera asete dhe rrjete, mund të jenë një objektiv tërheqës për keqbërësit për shkak të dëmit të madh që mund të shkatojnë. Nga ana tjetër, asetet e ndërlidhura mund të jenë një dobi për komunitetet. Në rast se një sektor nuk është në gjendje të ofrojë një shërbim, një tjetër aset mund të jetë në gjendje të ndërhyjë në mënyrë që të ketë një shqetësim minimal dhe mund të sigurohet niveli i dëshiruar i shërbimit. Pra, në mënyrë të qartë, natyra e ndërlidhur e infrastrukturës kritike ka të dyja komponentët, pozitiv dhe negativ. Një efekt “kaskadë” është një zinxhir ngjarjesh për shkak të një veprimi që ndikon në një sistem që ndodhja e një ngjarje, të shkatojnë një ngjarje tjetër. Ndërvarësitë midis sektorëve të infrastrukturës nxisin këto efekte. Është e mundshme që një sulm i suksesshëm në një sektor të veçantë të infrastrukturës kritike do të ketë një efekt të kundërt “kaskadë” në sektorë të tjerë. Ndikimi dhe pasojat e një sulmi të suksesshëm mund të zmadhohen me efektin “kaskadë”.⁸ Një shembull i efektit “kaskadë” do të ishte një sukses i sulmit terrorist që shkatërron një digë

⁶ Brian T. Bennett, *Understanding, Assessing, and Responding to Terrorism*, 2018, f.44.

⁷ Po aty, f.51.

⁸ Po aty, f.53.

dhe rezultati është përmbytja masive në komunitetin lokal duke shkaktuar viktima dhe shkatërrim të pronës.

3. Mbrojtja e infrastrukturës kritike, detyrat e Forcave të Armatosura

Mbrojtja e infrastrukturës kritike është nevoja për të mbrojtur infrastrukturën vitale të një vendi, të tilla si: ushqimi, bujqësia ose transporti. Çdo qeveri në çdo vend ka përgjegjësinë për të mbrojtur këto infrastruktura kritike kundër fatkeqësive natyrore, veprimtarive terroriste dhe kërcënimeve kibernetike. Nga kompanitë energjetike tek ato të transportit, është e rëndësishme që siguria në të gjithë sektorët e infrastrukturës kritike është e standardit më të lartë dhe se gatishmëria, reagimi dhe rimëkëmbja nga pasojat e katastrofave janë përparësitë kryesore. Komponentët e zakonshëm të infrastrukturës kritike që kanë nevojë për konsideratë të sigurisë përfshijnë sistemet e kontrollit industrial (ICS), teknologjinë e operimit (OT) dhe sistemet e kontrollit kompjuterik mbikëqyrës (SCADA). Bota po ndryshon dhe sistemet digjitale dhe fizike po konvergojnë. Sistemet që dikur qëndronin vetëm duke menaxhuar operacionet kritike të infrastrukturës, sot janë lidhja me internetin dhe ndarja e të dhënave të ndjeshme. Kjo strukturë e re sjell me vete probleme të reja të sigurisë. Asetet e infrastrukturës kritike duhet të përdorin një kornizë të fuqishme që mund të parashikojë dhe zbutë katastrofën në të gjithë mjedisin e infrastrukturës së tyre. Mbrojtja e infrastrukturës kritike ndihmon organizatat/asetet të përgatiten dhe të përgjigjen në incidentet serioze që përfshijnë mjedise infrastrukturore kritike dhe për t'u mbrojtur kundër një numri gjithnjë në rritje të kërcënimeve.⁹ Qasja e vendit në rrjetin e energjisë elektrike, sistemet e transportit, ujit të pijshëm dhe shumë shërbime të tjera të infrastrukturës kritike është gjithnjë në rrezik nga sulmet kibernetike. Këto kërcënime mund të kenë pasoja shkatërruese dhe mund të kërcënojnë ekonominë dhe komunitete të tëra. Suksesi i iniciativave të mbrojtjes së infrastrukturës kritike mbështetet në partneritete të fuqishme dhe kuptimplotë që ndërtohen mes strukturave shtetërore dhe subjekteve private.¹⁰ Suksesi gjithashtu mbështetet në zgjidhjet që përdoren për të menaxhuar dhe zbatuar këto iniciativa. Gjithashtu është e rëndësishme të njihen rreziqet që mund të kërcënojnë integritetin e sistemeve të infrastrukturës kritike. Kur mendojmë për sigurinë e sistemit ose të rrjetit, pothuajse gjithmonë mendojmë menjëherë për kërcënime hakeri ose terroriste, por ka edhe kërcënime të tjera që duhet të merren parasysh, si dështimi i pajisjeve, gabimi njerëzor dhe shkaqet natyrore. Mbrojtja e aseteve më kritike të vendit nuk është detyrë e lehtë. Ajo kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm midis agjencive kryesore dhe strukturave të të gjitha niveleve si dhe aplikimin e vazhdueshëm të teknologjive dhe proceseve të përmirësuara të mbrojtjes së infrastrukturës kritike.

Mbrojtja e infrastrukturës kritike është sistemi proaktiv i aktiviteteve të përdorura për të mbrojtur njerëzit e domosdoshëm, asetet fizike dhe sistemet kibernetike nga të cilat ne

⁹ Kelley A. Pesch-Cronin, Nancy E. Marion, Critical infrastructure protection, risk management, and resilience, 2017, f.9.

¹⁰ Po aty, f.10.

varemi. Qëllimi i mbrojtjes së infrastrukturës kritike është të pengojë ose zbutë sulmet ndaj infrastrukturës kritike. Mbrojtja e infrastrukturës kritike përfshin zbatimin e një procesi analitik, të integruar plotësisht në të gjitha planet dhe operacionet. Për të mbrojtur infrastrukturën kritike dhe informacionin e saj, si dhe për të ruajtur shërbimet nëse ndodh një ngjarje, është thelbësore që strukturat shtetërore dhe autoritetet vendore lokale, si dhe pronarët privatë të infrastrukturës kritike, të zhvillojnë plane jo vetëm për të mbrojtur asetet e tyre nga një dëmtim i mundshëm, por edhe plane veprimi për t'iu përgjigjur një sulmi apo ndonjë dëmtimi tjetër. Këto plane duhet të rishikohen rregullisht dhe të përditësohen pasi kërcënimet e mundshme vazhdojnë të ndryshojnë. Termi "mbrojtje e infrastrukturës kritike" i referohet atyre veprimeve që synojnë mbrojtjen e infrastrukturës kritike kundër sulmeve fizike ose rreziqeve.¹¹ Këto veprime mund të drejtohen gjithashtu për të parandaluar sulmet (ose lehtësimin e efekteve të sulmeve) që janë bërë qoftë nga njeriu apo nga natyra. Përderisa mbrojtja e infrastrukturës kritike përfshin disa masa parandaluese, zakonisht i referohet veprimeve që janë më reaguese në këtë fushë. Në ditët e sotme, mbrojtja e infrastrukturës kritike fokusohet mbi një qasje të të gjitha rreziqeve. Mbrojtja e infrastrukturës kritike nuk mund të realizohet në mënyrë efektive thjesht nga qeveria dhe sektorët publikë. Në vend të kësaj, ata duhet të punojnë së bashku me pronarët dhe operatorët e sektorit privat. Në rast se ndodh një sulm apo fatkeqësi tjetër, një komunitet/aset duhet të marrë hapa për t'u kthyer në normalitet, ose në kushtet që kanë ekzistuar para ngjarjes dhe ndërprerjes së mëvonshme të shërbimeve. Ky proces quhet rimëkëmbje dhe është pjesë e ciklit të menaxhimit të emergjencës të të gjitha rreziqeve të mundshme. Rimëkëmbja është në fakt, aftësia për tu përshtatur dhe përballuar pasojat që ndodhin pas një emergjence ose ngjarjeje. Është aftësia për të rimarrë veten shpejt, pas një fatkeqësie, e cila mund të jetë natyrore, teknologjike ose e shkaktuar nga njeriu.¹² Në shumicën e rasteve, agjencitë dhe shërbimet për komunitetin janë në gjendje të kthehen në aftësi funksionale të plota, në një kohë të arsyeshme pas një ngjarjeje. Megjithatë, në shumë raste, shpenzimet e rindërtimit janë shumë të larta dhe është e vështirë për t'u kthyer në standardet para ngjarjes. Një koncept i ngjashëm është elasticiteti, i cili i referohet aftësisë së një komuniteti/aseti për të rezistuar, për t'u shëruar, ose për t'u përshtatur me një ndryshim në kushte.

Elasticiteti në një sistem të infrastrukturës kritike mund të shihet si një cilësi që zvogëlon cenueshmërinë, minimizon pasojat e kërcënimeve, përshpejton reagimin dhe rimëkëmbjen dhe lehtëson përshtatje në një ngjarje shqetësuese.¹³ Elasticiteti është bërë më i vështirë sepse, në shumë raste, kur një infrastrukturë preket (ndikohet), të tjera mund të ndikohen së bashku. Elasticiteti i një aseti përbëhet nga qëndrueshmëria, përshtatshmëria dhe rigjenerimi. Qëndrueshmëria referohet për forcën e natyrshme në një strukturë ose sistem, ose aftësinë e saj për t'i bërë ballë dëmtimit të jashtëm pa humbje të funksionalitetit. Përshtatshmëria

¹¹ Kelley A. Pesch-Cronin, Nancy E. Marion, Critical infrastructure protection, risk management, and resilience, 2017, f.12.

¹² Po aty, f.14.

¹³ Po aty, f.15.

është kapaciteti për të mobilizuar burimet dhe shërbimet e nevojshme në raste urgjente dhe rigjenerimi është aftësia për t'u kthyer në një gjendje normale. Disa prej studiuesve kanë përmendur një faktor të katërt që duhet të përfshihet në këtë ekuacion, i cili është shpejtësia me të cilën shqetësimet mund të kapërcehen dhe siguria, shërbimet, dhe stabiliteti financiar të rimëkëmbet.

Mbrojtja e infrastrukturës kritike në vendin tonë është pjesë e sistemit të mbrojtjes civile. Ligji 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” përcakton detyrat e strukturave qendrore dhe vendore të Mbrojtjes Civile. Institucionet publike, strukturat qendrore dhe vendore apo subjektet private që kanë në administrim apo pronësi infrastrukturë kritike sigurojnë funksionimin normal të saj në kushte normale dhe në rastet e fatkeqësive, hartojnë dhe përditësojnë dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, si edhe planin për emergjencat civile, të cilat i dërgojnë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime planifikimi dhe analizimi. Strukturat operacionale të mbrojtjes civile që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera janë: Forcat e Armatosura; policia e shtetit; shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit; shërbimi i urgjencës mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor; shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile.¹⁴ Për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, në kuadrin e sistemit të mbrojtjes civile, Forcat e Armatosura, si struktura më kryesore dhe e mirëpajisur, kryejnë detyra të tilla si: a) angazhimi në operacione të parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive, nëse kapacitetet e tjera në dispozicion janë të pamjaftueshme për të përballuar situatën e krijuar nga fatkeqësia, duke mbështetur institucionet, autoritetet qendrore e vendore dhe popullsinë civile; b) zhvillojnë kapacitete ndërvepruese, të nevojshme për të bashkëpunuar me strukturat kolektive të sigurisë euroatlantike për përballimin e fatkeqësive. Struktura të posaçme të kërkim-shpëtimit të Forcave të Armatosura angazhohen në kryerjen e operacioneve për përballimin e fatkeqësive. Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kapacitetet e Forcave të Armatosura angazhohen në zbatim të detyrave të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile. Kur njësitë e Forcave të Armatosura marrin pjesë në operacione, ato drejtohen nga komandantët e tyre sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit.¹⁵

Gjatë viteve të fundit, vendi ynë është përballur me fatkeqësi natyrore si: përmbytje masive, zjarre të fuqishme, të cilat rrezikuan seriozisht sektorë të rëndësishëm të infrastrukturës kritike si: sektorin e bujqësisë, sistemet e transportit, sistemet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë dhe sektorin e furnizimit me ujë. Forcat e Armatosura kanë qenë të angazhuara maksimalisht në përballimin e këtyre fatkeqësive natyrore dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike të vendit, duke treguar një përkushtim dhe profesionalizëm të lartë e duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm. Pavarësisht arritjeve në këtë drejtim, nga strukturat e Forcave të Armatosura sidomos nga strukturat e posaçme të kërkim-shpëtimit, të cilat angazhohen në kryerjen e operacioneve për përballimin e fatkeqësive kërkohet më shumë bashkërendim e komunikim me strukturat e tjera të mbrojtjes civile dhe operatorët

¹⁴ Ligji 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

¹⁵ Ligji 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

publik e privat të infrastrukturës kritike për menaxhimin e rreziqeve natyrore, teknologjike apo të shkaktuara nga njeriu si dhe modernizim të teknikës dhe pajisjeve në përdorim të tyre.

4. Sfidat e mbrojtjes të infrastrukturës kritike

Mbrojtja e asetëve më kritike të vendit nuk është detyrë e lehtë. Ajo kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm midis agjencive kryesore dhe strukturave të të gjitha niveleve si dhe aplikimin e vazhdueshëm të teknologjive dhe proceseve të përmirësuara të mbrojtjes së infrastrukturës kritike. Mbrojtja e infrastrukturës kritike, rreziku dhe qëndrueshmëria janë dinamike dhe komponentë gjithnjë në ndryshim të arritjes së sigurisë kombëtare. Sfidat e sotme përfshijnë një infrastrukturë të vjetruar, efektet e ndryshimeve klimatike, ndërvarësitë në mes sektorëve dhe partneriteti publik-privat.¹⁶ Adresimi i këtyre sfidave dhe shqetësimeve të të gjithë aktorëve kryesorë të infrastrukturës kritike është një hap thelbësor drejt zhvillimit të planeve strategjike të sigurisë kombëtare dhe garantojnë një vend të sigurtë. Le t'i shohim më gjerësisht këto sfida.

Një infrastrukturë e vjetruar. Një çështje serioze me të cilën ballafaqohet e ardhmja e mbrojtjes së infrastrukturës kritike në vendin tonë është ruajtja e dobët dhe mirëmbajtja e sistemeve tona të infrastrukturës. Urat e vjetra dhe të përkeqësuar, sistemet e transportit dhe rrjeti i energjisë elektrike paraqesin rreziqe të rëndësishme për ekonominë dhe aftësinë tonë për t'u rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore ose nga njeriu, efektet e ndryshimeve klimatike dhe veprimtaria keqbërëse. Një shqetësim i veçantë janë sistemet e energjisë dhe sektori i transportit. Më shumë se 50% e urave në vendin tonë kanë probleme me sigurinë. Një raport i hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në mars 2019 tregon se shtatë prej tyre janë në gjendje emergjente, për të cilat do të nisë riparimi. Shqipëria është një vend ku rreth 70% e urave kanë kaluar moshën 50 deri në 70 vjet që do të thotë kanë hyrë në fazën e tyre të riskut. Shembulli i urës “Morandi” në Genova të Italisë është një kampanë alarmi. Deri tani mirëmbajtja e urave ka qenë një mirëmbajtje rutinë që do të thotë pastrim, riparim i parmakëve, ndonjë mbushje nga erozioni që është krijuar në këmbët e urave, por asnjëherë ndërhyrje në nivel strukturor, që do të thotë ndërhyrje në elementët konstruktiv të urës, përjashto rastet kur ka qenë shumë evident rreziku i shembjes. Dy janë faktorët që kanë sjellë dëmtime të urave në vend: amortizimi në kohë dhe faktori i dytë ka qenë mungesa e mirëmbajtjes sipas standardeve të përcaktuara.¹⁷

Rreziqet ndaj ndryshimeve klimatike. Ngjarjet ekstreme të njëpasnjëshme të motit, në vitet e fundit, shkaktuan dëme të mëdha në rajone të ndryshme të vendit, sidomos në pjesën më të begatë, atë të ultësirës perëndimore të tij. Këto ngjarje të motit dhe klimës, përfshinin përmbytjet masive, zjarret e fuqishme, rrëshqitje dherash, etj. Sipas raportit të Bankës Botërore rreziku nga përmbytjet në vend do të dyfishohet në të ardhmen si rezultat

¹⁶ Kelley A. Pesch-Cronin, Nancy E. Marion, Critical infrastructure protection, risk management, and resilience, 2017, f.278.

¹⁷ Shqiptarja.com, Raporti për sigurinë e urave, mars 2019.

i ndryshimeve klimatike por edhe si rezultat i urbanizmit. Ndërkohë që problem për dy vitet e ardhshme mbetet rreziku nga thatësira. Përmbytjet e ndodhura si pasojë e reshjeve intensive në Shqipëri gjatë periudhës 1990 -2017 kanë shkaktuar një dëm prej 24.7 milion dollarë. Të dhënat janë publikuar nga Banka Botërore në raportin e fundit për Ballkanin dhe përtej dëmit ekonomik nga përmbytjet janë prekur rreth 1 milion njerëz, midis të cilëve janë shënuar 52 viktima. Megjithatë situata pritet të përkeqësohet dhe parashikohet që deri në vitin 2050 rreziku nga përmbytjet parashikohet të dyfishohet e ndikuar nga ndryshimet klimatike por edhe urbanizimi pa plan. Ngjarjet ekstreme të motit që lidhen me ndryshimet klimatike mund të ndikojnë gjithashtu në sistemet e ndërlidhura të infrastrukturës kritike. Sektori i energjisë është veçanërisht i cenuseshëm. Adresimi i çështjes së mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe theksimi i ndryshimeve klimatike është një çështje në zhvillim. Përpjekjet po përqendrohen në programe dhe nisma në nivel global dhe rajonal.

Ndërvarësia ndërmjet sektorëve. Infrastrukturat kritike nuk funksionojnë vetëm. Ato bashkëpunojnë me sektorë të tjerë dhe i ndihmojnë të funksionojnë duke siguruar burime dhe shërbime thelbësore. Ndërsa secili ka funksione unike, ato gjithashtu varen dhe ndërvaren nga infrastruktura të tjera kritike. Vartësia mund të jetë e lidhur si një marrëdhënie midis dy infrastrukturave në një drejtim të vetëm ose një infrastrukturë në shtetin e një tjetri.¹⁸ Për shembull, mbështetja në energjinë elektrike dhe karburantet nga një mori industrish do të thotë që të gjitha sektorët e infrastrukturës kritike varen nga sektori i energjisë. Ndërvarësia është dydrejtimëshe dhe shumëdrejtimëshe, me dy ose më shumë infrastruktura që lidhen me njëra-tjetrën. Sektori i furnizimit me ujë është një shembull i mirë i një infrastrukturë kritike e cila përmban ndërvarësi të shumta me sektorë të tjerë kritikë. Një ndërprerje në shërbimin e ujit, paraqitur nga një rrezik natyror, terrorizëm apo aksident, kërcënon sektorë të tjerë si shërbimet emergjente, kujdesin shëndetësor dhe transportin. Për më tepër, ndërvarësitë janë thelbi i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Shqyrtimi i varësive dhe ndërvarësive të infrastrukturave kritike është jetike për vlerësimin e rrezikut dhe elasticitetit. Një shembull nga fatkeqësitë natyrore të viteve të fundit në vendin tonë, ku përmbytjet e mëdha sollën ndërprerje dhe dëmtime në sistemin e transportit, kjo solli vështirësi dhe probleme për sektorin e shëndetit publik, ku për shpëtimin e jetës së banorëve të kërcënuar nga përmbytja u përdorën helikopterët e Forcave të Armatosura. Kompleksiteti i këtyre ndërvarësive kërkon përdorimin e modelimit dhe aftësive simuluese. Modelimi dhe analiza e ndërvarësive ndërmjet infrastrukturave kritike mund të përdoret për të kuptuar sistemet e infrastrukturës dhe për të mbështetur vlerësimet e rrezikut dhe kërcënimit, ushtrimet e trajnimit dhe matjen e performancës. Sfidat janë të ngjashme me çdo fushë të modelimit: aksesimi i të dhënave, zhvillimi dhe miratimi i modelit.¹⁹ Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile duhet të jetë përgjegjëse për zhvillimin e këtyre aftësive modeluese për infrastrukturën e vendit tonë. Analistët

¹⁸ Kelley A. Pesch-Cronin, Nancy E. Marion, Critical infrastructure protection, risk management, and resilience, 2017, f.280.

¹⁹ Po aty, f.281.

dhe ekspertët duhet të studiojnë hollësitë e të gjitha infrastrukturave kritike, nga niveli i aktiveve në nivel sistemesh; ndërveprimet midis sektorëve, dhe se si sektorë të ndryshëm i përgjigjen katastrofave natyrore, sulmeve kibernetike apo sulmeve terroriste.

Partneriteti i sektorit publik-privat. Ekziston një tension i ngushtë ndërmjet pikëpamjeve të sektorit publik dhe atij privat kur bëhet fjalë për mbrojtjen e infrastrukturës kritike.²⁰ Me një pjesë të konsiderueshme të infrastrukturës kritike të vendit tonë nën kontrollin e sektorit privat, bashkëpunimi i sektorit privat është thelbësor. Duhet të ketë një partneritet të ngushtë të sektorit publik-privat për të reduktuar dobësitë e sigurisë. Secili sektor ka burime që mund të jenë efektive në ndihmën për të parandaluar një rrezik nga një fatkeqësi, në një aset kritik. Për të qenë efektiv, duhet të ekzistojë një proces i fuqishëm dhe i mirëfilltë i komunikimit. Sektorët duhet të ndajnë informacionin e inteligjencës që mund të jetë me vlerë. Partneriteti ndërsektorial gjithashtu mund të ndihmojë në lehtësimin e çështjeve të burimeve të pamjaftueshme. Shpesh, sektori privat ka resurse që mund të plotësojnë nevojat e sektorit publik, dhe anasjelltas. Edhe një herë, duhet të ketë planifikim dhe koordinim të kujdesshëm për të zhvilluar plotësisht këtë marrëdhënie. Partneriteti mund të formalizohet nëpërmjet ekzekutimit të një marrëveshjeje të ndihmës reciproke ndërmjet dy sektorëve. Për të siguruar që partneriteti është veçanërisht efektiv, të dy sektorët duhet të punojnë së bashku për të koordinuar planet e reagimit emergjent, udhëzimet operacionale dhe trajnimet.²¹ Kulmi i këtyre përpjekjeve duhet të jetë një stërvitje e përbashkët, ku të gjitha sistemet e ndryshme testohen dhe vlerësohen, me mundësi për përmirësim të identifikuar. Blerjet e pajisjeve duhet të koordinohen në mënyrë që mjetet dhe pajisjet personale mbrojtëse të jenë të këmbyeshme dhe nuk ka mospërputhje mes dy sektorëve. Për shembull, nëse sektori privat po blen pajisjet për fikjen e zjarrit, duhet të sigurohet që ato janë në përputhje me ato të njësisë lokale të zjarrfikësve. Ky partneritet, bashkëpunimi i ndihmës së ndërsjellë do të rezultojë në një efekt sinergjik, ku shuma e dy sektorëve që punojnë së bashku është më e madhe se shuma e aftësive të tyre individuale nëse ata kanë punuar veçmas. Rritja e efektivitetit të partneritetit publik-privat mund të jetë një sfidë dhe do të ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme nga të dy palët për të përmirësuar këto bashkëpunime.

5. Përfundime dhe rekomandime

1. Infrastrukturat kritike janë ato asete, shërbime dhe sisteme informacioni, të cilat janë kaq jetësore për vendin, sa paaftësia ose shkatërrimi i tyre do të kishte një ndikim negativ në sigurinë kombëtare, në ekonominë, shëndetin publik dhe funksionimin efektiv të qeverisë.

2. Infrastruktura kritike është e kërcënuar nga rreziqe natyrore, teknologjike dhe të shkaktuara nga njeriu që përfshijnë aktet e terrorizmit, sulme biologjike dhe kimike, sulme kibernetike, etj.

²⁰ Kelley A. Pesch-Cronin, Nancy E. Marion, Critical infrastructure protection, risk management, and resilience, 2017, f.282

²¹ Po aty.

3. Mbrojtja e infrastrukturës kritike është sistemi proaktiv i aktiviteteve të përdorura për të mbrojtur njerëzit e domosdoshëm, asetet fizike dhe sistemet kibernetike nga të cilat ne varem, ajo është thelbësore për shëndetin publik dhe sigurinë e banorëve, fuqinë ekonomike, mënyrën e jetesës dhe sigurinë kombëtare.

4. Mbrojtja e infrastrukturës kritike në vendin tonë është pjesë e sistemit të mbrojtjes civile. Institucionet publike, strukturat qendrore dhe vendore, subjektet private që kanë në administrim apo pronësi infrastrukturë kritike sigurojnë funksionimin normal të saj në kushte normale dhe në rastet e fatkeqësive; hartojnë dhe përditësojnë dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, si edhe planin për emergjencat civile.

5. Për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, në kuadrin e sistemit të mbrojtjes civile, Forcat e Armatosura, si struktura më kryesore, kryejnë detyra duke u angazhuar në operacione të parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive, duke mbështetur institucionet, autoritetet qendrore e vendore dhe popullsinë civile si dhe zhvillojnë kapacitete ndërvepruese, të nevojshme për të bashkëpunuar me strukturat kolektive të sigurisë euroatlantike për përballimin e fatkeqësive.

6. Mbrojtja e infrastrukturës kritike kërkon hartimin e një ligji të veçantë për infrastrukturën kritike në vendin tonë. Në hartimin e këtij dokumenti duhet të marrin pjesë institucionet qendrore shtetërore, dikasteret përkatëse sipas sektorëve të infrastrukturës kritike, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, etj. Qëllimi i këtij ligji është për të ruajtur dhe mbrojtur infrastrukturën kritike kombëtare, parandaluar incidentet dhe minimizuar dëmin potencial për infrastrukturën kritike, humbjet ekonomike dhe sociale, siguruar stabilitetin qeverisës dhe rritur qëndrueshmërinë.

Bibliografia

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare, 2014.
- Strategjia Ushtarake, 2015.
- Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, 2019.
- Ligji 45/2019“ Për Mbrojtjen Civile”.
- Kelley A. Pesch-Cronin, Nancy E. Marion, Critical infrastructure protection, risk management and resilience, Ohio, USA, 2017.
- Brian T. Bennett, Understanding, Assessing, and Responding to Terrorism, USA, 2018.
- Cristina Alcaraz, Sherali Zeadally, Critical Infrastructure Protection, Requirements and Challenges for the 21st Century, 2015.
- Khan Jahier, Critical infrastructure protection within NATO.
- David Rehak, Resilience of Critical Infrastructure Elements and Its Main Factors, 2017.

STRATEGJIA DETARE RUSE¹

Roland Tashi
AISM

Trajtesë e shkurtuar.

Krizat e viteve të fundit kanë evidentuar të gjithë faktorët që kanë ndikuar në përkeqësimin e marrëdhënieve midis Rusisë dhe Perëndimit. Mosbesimi i Moskës ndaj Perëndimit është kuptuar si një kërcënim që përfshin jo vetëm sferën ushtarake, por edhe atë kulturore. Faktor tjetër mbetet mosbesimi evropian ndaj Putinit, i cili vepron për t'i kthyer Rusinë ndikimin e humbur me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik në një përpjekje për të rindërtuar një marrëdhënie të barabartë me fuqinë amerikane. Këto marrëdhënie rizgjojnë rivalitetin gjysmë të fjetur të Luftës së Ftohtë, të cilat nuk ndikojnë në qetësimin e klimës politike.

Rusia e ditëve të sotme është dukshëm më pak e fuqishme se Bashkimi Sovjetik i dikurshëm, megjithatë forcat e saj të armatosura kanë potenciale të mjaftueshme ushtarake për t'u konsideruar të rrezikshme për sigurinë e rajonit dhe më gjerë. Rajoni i Mesdheut dhe Detit të Zi paraqet më shumë interes për Moskën, vitet e fundit është shtuar ndjeshëm prezenca e forcave detare, kjo për arsye të politikës dhe strategjisë së re detare ruse, por edhe të reduktimit të prezencës, forcës detare amerikane në këtë rajon, e cila ka shtuar vëmendjen në rajonin e Indo-Paqësorit.

¹ Për përgatitjen e këtij shkrimi, është shfrytëzuar dhe përpunuar artikulli “Strategjia Detare Ruse”, botuar në mars 2021 nga “Difesa on Line”, portal i cili trajton çështje të gjeopolitikës. Artikulli është shkruar nga Renato Scafi, analist i çështjeve politike dhe ushtarake. Komentet dhe opinionet, shprehin vetëm mendimin dhe gjykimin autorit.

1. Strategjia detare ruse

Rusia është një vend që paraqet interes të veçantë për kontinentin e vjetër, një vend që mbetet gjithmonë i vëmendshëm ndaj ngjarjeve në Lindjen e Mesme, me interesa historike në zonën euro-mesdhetare, aq më tepër pas përvetësimit të Krimesë, e konsideruar si një trampolinë për zgjerimin drejt Mesdheut, Detit të Kuq dhe Gjirit Persik. Këtij fakti i duhet shtuar edhe mundësia që ka Rusia për dalje në Paqësor dhe territorin aziatik. Pozicioni gjeografik dhe ambicia për ekspansion, kombinuar me burimet e saj të konsiderueshme në fushën e energjisë, atë bërthamore dhe raketore, i shton Rusisë “pretendimet” që me këmbëngulje të arrijë qëllimin e kthimit në madhësinë e fuqisë globale.

Për të arritur këtë qëllim, pas krizës shumë të rëndë që kaloi në vitet 90-të dhe vitet e para të këtij shekulli, Moska në dekadën e fundit ka filluar një fazë të rëndësishme të modernizimit dhe riorganizimit, duke filluar në korrik të vitit 2016 me rivlerësimin e strategjisë detare.

Në raportin e Qendrës për Sigurinë Ndërkombëtare Detare të Uashingtonit përcaktohet roli i marinës ruse në strategjinë e sigurisë së Moskës deri në vitin 2030, duke prezantuar objektivat e rritjes së forcave detare, zonat gjeografike të interesit dhe kërcënimet me të cilat do duhet të përballet, duke identifikuar si kundërshtar kryesor NATO-n dhe forcat detare të saj. Në këtë vizion strategjik, Rusia beson se brenda një periudhe afatshkurtër marina e saj nuk do të jetë në gjendje të ketë të njëjtat aftësi luftarake si kundërshtarët, duke njohur në veçanti përparësinë teknologjike të Shteteve të Bashkuara dhe duke pranuar se planet ruse nuk parashikojnë ndërtimin e një flote me të njëjtin nivel cilësor dhe sasior.

Marina ruse synon të përmbushë katër misione kryesore:

- Mbrojtja e brigjeve ruse dhe kufijve të saj detare.
- Sulmi me rreze të gjatë veprimi duke përdorur armët bërthamore dhe konvencionale.
- Projektimi i fuqisë nëpërmjet flotës nënujore.
- Fuqia bërthamore parandaluese nëpërmjet nëndetëseve me raketa balistike.

Pjesa e dokumentit që tërheq më shumë vëmendjen është identifikimi i zonave me interes strategjik të flotës ruse, të cilat janë:

- Oqeani Arktik dhe Deti i Ohotsk, Rusia Lindore, konsideruar si fortesat strategjike nga të cilat mbikëqyret Oqeani Atlantik dhe Paqësor.

- Deti i Zi.
- Deti Mesdhe.



Forca detare ruse, ashtu si në periudhën e Luftës së Ftohtë, kërkon të mbajë një qëndrim me fuqi parandaluese kundër fuqive të tjera detare. Kjo është gati e njëjta qasje e mbajtur që nga viti 1975, kur flota sovjetike, në thelb tërësisht ruse, konsistonte në përqendrimin e nëndetëseve bërthamore me raketa balistike në dy zona; pranë vendit, për të rritur nivelin e sigurisë dhe larg tij për të vepruar si hakmarrje bërthamore kundër objektivave të SHBA. Sipas asaj që evidentohet në dokumentin e strategjisë detare ruse, duket se Moska nuk e ka braktisur teorinë e bastionit, fortesave natyrore mbrojtëse edhe pas shpërbërjes së “perandorisë” sovjetike, duke e konsideruar atë si një nga prioritetet kryesore në masat parandaluese ndaj kërcënimeve bërthamore që mund t’i vijnë nga Uashingtoni apo fuqi të tjera ushtarake që tentojnë të kërcënojnë territorin e Rusisë.

Për oqeanin Atlantik, bastioni, fortesa mbrojtëse natyrore, është nën ujërat e ftohtë të Arktikut, zonë e cila është një “strehë e sigurtë” natyrore e shtrirë për 14 milionë km katrorë, një e gjashta e Atlantikut, me një thellësi prej rreth 4,000 m, ndërkohë që ngushtica e Beringut, kalimi i vetëm nëpërmjet Paqësorit, ka një thellësi maksimale prej 55 m. Kjo zonë mbetet një vend i privilegjuar bazimi për anije të destinuara për parandalimin bërthamor, ndërkohë që shtrati, fundi i detit, ofron një strehë ideale, pasi akulli i mbron nëndetëset nga mbikëqyrja satelitore.

Për oqeanin Paqësor, rolin e bastionit, fortesës mbrojtëse, e luajnë ujërat e detit Okhotsk, rajoni detar ndërmjet gadishullit Kamçatka, ishujve Kurili, ishullit japonez Hokkaido dhe ishullit Sakhalin.

² Harta, e cila tregon vendbazimin e flotave detare si dhe zonat gjeografike që paraqesin interes, është përgatitur duke iu referuar të dhënave dhe informacionit që trajton artikulli.

Michael Kofman, studiues, analist për çështje të Rusisë dhe ish-Bashkimit Sovjetik, Drejtor i Programit Kërkimor në Programin e Studimeve të Rusisë në CNA, anëtar në Institutin Kennan, Qendra Ndërkombëtare Woodrow Wilson në Uashington, DC, në një shkrim të janarit 2020, thekson se: "... Marina ruse nuk është krijuar për të konkurruar me marinën amerikane, por përkundrazi, për ta kundërshtuar atë, duke mbështetur strategjinë euro -aziatike të fuqisë tokësore të shekullit të 21-të ...".

2. Fuqia ushtarake detare dhe ajrore

Në Rusinë e sotme, pavarësisht se është dukshëm më pak e fuqishme krahasuar me Bashkimin Sovjetik të periudhës së Luftës së Ftohtë, forcat e armatosura kanë përsëri potenciale të mjaftueshme për të shkaktuar dëme të konsiderueshme në rast të një konflikti ushtarak të mundshëm. Në këtë kontekst strategjik, marina luan një rol të rëndësishëm, ajo nuk duhet të nënvlerësohet pavarësisht reduktimit të mjeteve luftarake lundruese dhe armatimit. Në rast se i referohemi vetëm nëndetëseve, kujtojmë se në vitin 1989 blloku sovjetik kishte në armatim 62 nëndetëse të pajisura me raketa balistike, ndërsa sot ka vetëm dhjetë.

Nga investimet ushtarake të filluara nga Moska prej vitit 2010, duhen përmendur raketat balistike ndërkontinentale R-30 "Bulava", të cilat instalohen në nëndetëset e gjeneratës IV të klasës "Borei". Tetë njësitë e planifikuara të kësaj klase do të mbajnë secila gjashtëmbëdhjetë raketa. Një kërcënim tjetër mbetet hyrja në armatim, planifikuar për vitin 2023, e raketës hipersonike kundër anijeve "Tsirkon" e cila do të shërbejë edhe për mbrojtjen e bastioneve. Raketat, të cilat instalohen në anijet e sipërfaqes por edhe në nëndetëse, mund të godasin objekte në det dhe në tokë në një distancë deri 1 000 km, me një shpejtësi shumë të madhe lëvizje. Duhet kuptuar se mbrojtja e bastioneve, fortesave natyrore, sigurohet jo vetëm nga flota nënujore dhe raketat hipersonike, por edhe nga sisteme të tjera mbrojtëse.

Flota e Veriut, komanda e së cilës është e vendosur në Severomorsk, gadishulli Kola, është e shumtë në numër por me nivel operacional të reduktuar pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik si shkak i kushteve të vështira meteorologjike, të cilat kërkojnë mirëmbajtje të vazhdueshme të arsenalit ushtarak shoqëruar me kosto të larta ekonomike. Si pasojë e financimeve të konsiderueshme të dekadës së fundit, niveli operacional po përmirësohet gradualisht, krahas rritjes së efikasitetit të anijeve.

Flota e Paqësorit, komanda e së cilës është e vendosur në Vladivostok, aktualisht ka rreth 60 anije të klasave të ndryshme si dhe një komponent të sulmit amfib. Për t'iu përgjigjur konkurrencës që po zhvillohet në atë rajon, Moska ka filluar një program rinovimi i cili synon që në periudhë të shkurtër kohore, flotës t'i shtohen rreth 20 anije me teknologji të avancuar.

Për luftën kundër nëndetëseve, aviacioni i marinës ruse ka tre tipe për patrullim, me performancë të vjetruar, të cilat janë përmirësuar e modernizuar në drejtim të teknologjisë.

Modeli i parë, "Ilyushin-38", sot Il-38N, me autonomi të kufizuar për përdorim operacional

larg bregdetit rus.

Modeli i dytë, "Tupolev-142MK / MZ", patrullues me rreze të gjatë veprimi që daton prej viteve 1970, derivat i bombarduesit strategjik "Tu-95", i disponueshëm në rreth tridhjetë ekzemplarë, të ndarë midis Flotës së Veriut dhe Paqësorit.

Modeli i tretë, hidroplani "Beriev-12N Čajka", i cili daton në vitet 1960. Fillimisht u tërhoq nga shërbimi dhe më pas u rivendos në armatimin e flotës së Detit të Zi, pas aneksimit të Ukrainës në vitin 2014.

Aktualisht, janë duke u studiuar projekte më moderne të avionëve patrullues, por, siç bëhet e ditur nga gazeta "Izvestiya", në janar 2020, njoftim i pa konfirmuar nga marina ruse, modeli i ri "Tu-204P" nuk do të jetë në armatim para vitit 2030. Sipas asaj që raportohet në faqen mediatike redsamovar.com, avioni do të paraqesë zgjidhje interesante në lidhje me pajisjet elektronike interceptuese si dhe do të ketë në armatim katër raketa kundër anijeve "Zvezda Kh-35U".

Deri në vitin 2030 Rusia do të pajiset me nëndetëse ultramoderne, por ato do të jenë të mbrojtura nga aviacioni detar mjaft i vjetruar, pavarësisht planifikimeve për modernizimin e flotës ajrore.

James Lacey, specialist i studimeve strategjike në Kolegjin e Luftës së Trupave Detare në Quantico, Virginia, në janar 2020 komenton se: "Megjithatë, kjo nuk do të ndikojë në strategjinë e bastioneve, fortesat natyrore të Rusisë veriore do të jenë ende objektiva strategjike për të siguruar ndikimin e Moskës në Arktikun e pasur me burime. Më në jug, Moska duket se dëshiron ta bëjë Detin e Zi një liqen rus dhe Krimenë një bastion ushtarak me qëllim dominimin e zonave kufitare ujore."

3. Deti i Zi dhe Mesdheu

Rajoni detar i Mesdheut dhe Detit të Zi, për arsye gjeografike paraqet më shumë interes. Vitet e fundit, prania e marinës ruse në këtë hapësirë ujore është rritur ndjeshëm, ndoshta si rrjedhojë e qëndrimit, politikës së re detare të Moskës, si dhe reduktimit të prezencës detare amerikane, e cila ka shtuar vëmendjen në teatrin e Indo - Paqësorit për arsye të kërcënimeve që vijnë nga Kina dhe Koreja e Veriut. Rusia ka shfrytëzuar rastin për t'u kthyer në Mesdhe, pasi krizat siriane dhe libiane kanë shtuar arsyet për zgjerim dhe kanë rritur mundësinë që ajo të luajë një rol të rëndësishëm në këtë rajon. Shtimi i prezencës së forcave detare ruse në ujërat e Sirisë duhet parë në këtë këndvështrim: Kremlini kërkon t'i dërgojë një sinjal të qartë faktorit ndërkombëtar se ai është një aktor i rëndësishëm në zgjidhjen e çështjeve kryesore planetare.

Në thelb, rinovimi i pranisë ruse në Siri përfaqëson mjetet me të cilat ajo po zbaton strategjinë e saj detare në ish "Mare Nostrum", një strategji detare që duhet të konsiderohet si elementi kualifikues i një vizioni më të gjërë.

Vazhdimi i këtij vizioni për Mesdheun është marrëveshja e nënshkruar midis Moskës dhe Damaskut në janar 2017, për përdorimin e bazës detare të Tartusit dhe bazës ajrore

Khmeimimm, të dyja në perëndim të Sirisë, për një periudhë 49-vjeçare, me mundësi përsëritjeje në vazhdim edhe për 25 vite të tjera.

Porti i Tartusit është një pikë mbështetëse për anijet e Moskës që nga viti 1971. Në këtë bazë mund të ankorohen deri në 20 njësi detare të cilat marrin këtu shërbimet e nevojshme teknike dhe logjistike. Përgjatë bregdetit sirian janë instaluar: raketa kundërajrore S-300, sistemet e raketave "Pantsir" me rreze të shkurtër dhe të mesme, raketa supersonike kundër anijeve "Yakhont", raketa taktike hipersonike me rreze të shkurtër veprimi "Iskander", sisteme elektronike të zbulimit, mbikëqyrjes dhe luftës elektronike.

Baza ajrore në Khmeimimm është përdorur për bazimin e avionëve luftarakë dhe helikopterëve me detyrën e krijimit të një ombrelle mbrojtëse për operacionet detare ruse, të cilat mund të mbështeten gjatë operacioneve edhe nga vendbazime dytësore përgjatë brigjeve jugore të pellgut siç janë: Aleksandria në Egjipt, Algjeria, porti Kyrenaica në Libi, i cili vlerësohet si pedan për depërtimin rus në Mesdheun qendror.

Për momentin, konsistenca e përgjithshme ruse në ujërat e Mesdheut nuk kërkon porte të tjera të mëdha të llojit të Tartusit, por, duke vlerësuar ndikimin në rritje që rusët po marrin në zonën libiane dhe rëndësinë që Moska i jep mbajtjes së këtij pozicioni me synim depërtimin në kontinentin Afrikan, nuk përjashtohet mundësia që pasi të konsolidohet prania në brigjet e Sudanit, të kthehet përsëri vëmendja ndaj porteve dhe bazave libiane në Tobruk, Derna, Sirte dhe al-Ğufra, të cilat mund të marrin të njëjtën rëndësi si Tartusi në të ardhmen.

4. Përfundime

Pas Luftës së Dytë Botërore, në arenën ndërkombëtare janë shfaqur dy palë, dy interpretime të kundërta lidhur me marrëdhëniet e Perëndimit me Bashkimin Sovjetik të atëhershëm. Njëra palë shikonte te BRSS një entitet të dominuar nga Rusia, profetin e revolucionit botëror me të cilin çdo dialog do të ishte i pamundur. Pala tjetër, ata që tentonin të ulnin peshën e ideologjisë dhe ta konsideronin BRSS një fuqi të madhe tradicionale, ishte më shumë e interesuar të përfitonte nga rendi ndërkombëtar se sa ta rrëzonte atë.

Tani që paragjykimi ideologjik duhet konsideruar i larguar, shtrohet pyetja: si duhet vepruar, si duhet të vendosen marrëdhëniet me një Rusi që me vendosmëri gjithnjë e më të madhe ndjek qëllimin për të rimarrë një rol të spikatur brenda skenarit ndërkombëtar.

Në themel të qëndrimit aktual rus, ka ende gjurmë, trauma të dhimbshme si pasojë e rënies së Bashkimit Sovjetik, një Perandori e ndërtuar me sakrificë të mëdha gjatë shekujve. Putini, sapo erdhi në pushtet, deklaroi se donte t'i rikthente vendit "madhësinë" e dikurshme duke kuptuar edhe rrezikun se në nivelin gjeopolitik, Rusia mund të reduktohej në një fuqi mesatare aziatike e shtrënguar midis Kinës, një fuqi në zhvillim që e kishte tejkaluar Rusinë në nivelin ekonomik, demografik, ushtarak dhe Evropës që kishte rifituar unitetin e saj deri në kufijtë lindorë të Polonisë dhe Finlandës, e cila inkuadroi në NATO shumë vende të ish-Traktatit të Varshavës.

Në këtë panoramë dhe ambicie gjeopolitike, nëse tërheqja e SHBA përveç se nga Mesdheu

do të vazhdojë edhe nga territori evropian, mund të përballemi me një gabim strategjik me përmasa të mëdha. Pas krizës në Gjeorgji, korrik 2009, një grup politikanësh nga Evropa Qendrore dhe Lindore, përfshirë Lech Wałęsa dhe Václav Havel si dhe ish-presidentët e Lituanisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Letonisë deklarorin se: "... rajoni ynë është një nga ata për të cilët amerikanët duket se kanë ndaluar të shqetësohen, duke e konsideruar të stabilizuar përfundimisht. Ky përfundim është i parakohshëm. Shpresat tona se marrëdhëniet me Rusinë mund të përmirësohen dhe se Kremli do ta pranonte sovranitetin dhe pavarësinë tonë nuk janë përmbushur. Përkundrazi, Rusia është kthyer në një fuqi ekspansioniste me një program të shekullit të 19-të, por me mjete dhe metoda të shekullit të 20-të. Vetëm një politikë më vendimtare dhe parimore mund ta nxisë Moskën të ndjekë një politikë bashkëpunimi ...".

Ndërkohë, Evropa nuk duket se ka një strategji afatgjatë, është kufizuar në kritikën ndaj Kremlinit për veprimet ruse në Ukrainë dhe stigmatizimin e dështimit për të hetuar vrasjet e gazetarëve dhe kundërshtarëve, ndërsa deklaror se marrëdhëniet me Rusinë është dhe mbetet vendimtare për Evropën.

Në këtë synim, ajo "favorizohet" nga mungesa e një politike të qëndrueshme evropiane si dhe nga qëndrimet e administratave të fundit amerikane duke e lejuar Kremlinin të zgjerojë ndikimin e saj në të gjithë rajonin. Prania e anijeve të vogla detare të sipërfaqes, të pajisura me raketa të afta për të goditur në një distancë të madhe dhe me efektshmëri të lartë operacionale, krijojnë mundësinë që rusët të "kontrollojnë" me kujdes zonën, të konsolidojnë aleancat e tyre në rajon si dhe të hedhin themelet për depërtimin strategjik në kontinentin afrikan të pasur me burime.

Operacionet e avion-mbajtëses "Admiral Kuznetsov", nga e cila u nisën misione të shumta ajrore për të goditur objektivat në territorin sirian, treguan aftësinë ruse për të projektuar fuqinë ushtarake si dhe dëshirën e Moskës për t'u kthyer në një subjekt gjeopolitik me ndikim vendimtar në zonën e Mesdheut dhe jo vetëm. Kjo është arsyeja pse qasja operacionale ndaj krizave të tanishme dhe të ardhshme nuk mund të injorojë studimin dhe kuptimin e strategjisë ushtarake bashkëkohore ruse. Në thelb, nuk duhet të kemi frikë nga marina ruse por duhet të njohim mirë kundërshtarin tonë të mundshëm, ta analizojmë atë që Moska po përpiqet të arrijë me flotat e saj ajrore dhe detare si të gjitha flotat në botë të cilat janë një vektor i rëndësishëm i politikës së jashtme dhe elementë përcaktues në dokumentet e strategjive ushtarake.

LUFTA HIBRIDE, RAST STUDIMI RUSIA

Nënkolonel Dr. Fitim Karasani
Major Msc. Enkelejda Tyrku
FMS, AFA

“Luftërat e të ardhmes mund të kenë forca konvencionale, forca speciale, luftë guerile, terrorist, kriminelë, që të gjithë këto aktorë dhe metoda luftime të miksuara me një terren dhe ambient kompleks me një densitet të lartë të prezencës së popullsisë civile”¹

General Mark A. Milley
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i 39-të i SHBA

Trajtesë e shkurtuar.

Tendenca e përshkrimit të dukurive apo ngjarjeve është ndeshur gjithnjë me nevojën për të futur në brendësi të saj koncepte të reja, sidomos kur impakti i tyre është domethënës. Terma dhe koncepte të tilla, për më tepër kur ato kanë qenë të fushës ushtarake, kanë qenë temë e debatit të vazhdueshëm akademik. Ndërthurja akademike me kuptimin apo mbulimin “diplomatik/politik” të konceptit, formimi intelektual i individit apo situatat e caktuara të mjedisit të sigurisë, janë elemente që ndikojnë drejtpërsëdrejti në këndvështrimin përkatës.

Në shekuj është shkruar se çfarë kuptojmë me mësymje apo mbrojtje, me marshim apo ndjekje, me rrethim apo kundër mësymje, etj. Krahës kësaj, e parë në kontekst më të përgjithshëm, është folur se çfarë kuptojmë me luftë, me luftë totale apo e të limituar, luftë

¹ Cooper.H, “The War of the Future? Picture Big Armies and Many Fronts,” The New York Times, June 10, 2016, sec. U.S., accessed November 1, 2021, <https://www.nytimes.com/2016/06/11/us/the-war-of-the-future-picture-big-armies-and-many-fronts.html>.

konvencionale apo asimetrike, luftë atomike apo terroriste, etj. Ajo që konstatohet është që gjithnjë e më shumë linjat ndarëse të luftës po bëhen më të paqarta ose e thënë ndryshe ndeshemi me “luftë hibride”.

Në kushtet e luftërave bashkëkohore, sfida më e madhe është të kuptohet sesi në një botë të industrializuar me teknologji të lartë, taktikat e luftës miksohen dhe përshtaten. Metodatat e luftës ekonomike, politike, diplomatike të kombinuara, të gërrshetuara me metodatat e tjera të luftës, si cyber, informacioni, mjetet psikologjike, janë tashmë karakteristikat e reja të luftës. Në këtë shkrim ne do të fokusohemi në metodatat e luftës hibride, që i gjejmë të materializuara në metodatat e luftës ruse.

Fjalë kyçe: koncept, luftë hibride, Rusi, cyber, informacioni.

Hyrje

Realiteti i sotëm është i mbushur me fjalë apo koncepte të cilat janë kthyer në slogane Rditore. Ato përmenden duke filluar nga panelet e konferencave shkencore në botimet e shtypit të përditshëm, nga auditorët e arsimit në deklaratat e takimeve në nivele të ndryshme të organizatave/aleancave, etj.

Si për shumë koncepte të tjera, kemi një larmi përkufizimesh edhe mbi konceptin “luftë hibride”. Tendencia për një kuptim akademik të termit “Luftë Hibride” ndeshet me vështirësinë e kuptimit të saj që në nisje. Në bazë të saj, ajo ka fjalën “luftë”, term i cili për kuptimin e tij kemi histori mijëra vjeçare tendence definimi, duke filluar që nga Sun Tzu, Diderot, Ciceroni, Machiavelli, deri të kohëve moderne, si Keegan, Bull, etj. Edhe pse në përcaktimin e luftës nuk kemi një dakordësi të plotë, historianët dhe mendimtarët ushtarakë vendosin një emërues të përbashkët që, natyra e luftës nuk ndryshon, por karakteristikat e luftës gjithmonë përshtaten.

Në kryeveprën e tij “Mbi luftën”, Clausewitz shkruan: *“lufta është më shumë se një kameleon që lehtësisht i përshtat karakteristikat sipas situatës”*¹. Në të njëjtën linjë Gray sjell argumentin e tij mbi ndryshimet në natyrën e luftës moderne: *“Natyra e luftës në shekullin XXI është e njëjtë siç ishte në shekullin XX dhe shekullit XIX apo në shekullin V para Krishtit, natyra e luftës është e përhershme”*². Meqenëse lufta në shekullin e XXI ka ndryshuar në forma që kombinojnë format e luftës si forcat e rregullta me forcat e parregullta në të njëjtën fushëbetejë, analistë të mbrojtjes kanë sjellë si domosdoshmëri sjelljen e një koncepti të ri, “luftën hibride”³.

Historia botërore është ballafaquar me luftëra botërore, në rajone të caktuara apo në mes dy shteteve. Kemi ndeshur luftë totale apo të limituar, luftë koloniale apo guerile, luftë atomike apo terroriste, etj. Ajo që konstatohet është që gjithnjë e më shumë linjat ndarëse të luftës po bëhen më të paqarta. Fuqitë e mëdha kanë përdorur luftën hibride, me metodat mikse dhe karakteristikat të veçanta që nga kohët më të hershme. Metoda hibride kanë përdorur shtete të ndryshme në luftërat e limituara që nga 1945 deri në ditët e sotme. Vietkongët gjatë luftës së Vietnamit, në Yom Kippur u përdorën taktika të luftës hibride, për të vazhduar me konfliktet e vendeve të tjera të Lindjes së Mesme dhe gjithashtu në luftën në Afganistan dhe

¹ Smith, R., *The Utility of Force: The art of war in the modern world*, London 2005, fq. 203.

² Colin S. G., *“Another Bloody Century: Future Warfare”* (Orion Publishing Group, 2012).

³ Mansoor . P. *“Hybrid Warfare in History”* Cambridge University Press, Jule 2012, fq.1.

në Irak. Lufta hibride lulëzoi me sukses gjatë shekullit XX dhe fillim të shekullit XXI dhe po fiton terren për t'u kthyer në një nga luftërat e të ardhmes.

1. Qasjet aktuale mbi konceptin e luftës hibride

Termi “hibrid” vjen nga latinishtja, i përdorur në Perandorinë Romake për të përshkruar një fëmijë të lindur nga prindër me statuse sociale të ndryshme. Më vonë, ai evoluoi për të përshkruar dukuritë, entitetet apo veprimet e natyrës së kombinuar, që nuk janë “të përziera” mekanikisht, por që janë organikisht të integruara, kohezive dhe të koordinuara.

Parë në këndvështrime të ndryshme nga autorë të shumtë, me termin “luftë hibride” i referohen taktikave të çrregullta, në disa autorë të tjerë e paraqesin si një seri taktikash konvencionale dhe të çrregullta. Walker në argumentin e tij shpjegon që *“luftë hibride është ajo që qëndron dhe kryqëzohet midis luftës konvencionale dhe asaj speciale”*⁴. Më vonë në punimin e tij, Nemeth arrin në përfundimin se *“fuqia e luftës hibride qëndron tek përdorimi i taktikave guerile, që përbëjnë një pengesë shumë të vështirë për t'u përballur edhe nga forca që kanë teknologji dhe armatim superior dhe shumë të avancuar”*⁵.

Newson zgjeron konceptin e tij duke alternuar krahas elementeve të tjerë edhe manipulimin politik të saj. Ai përcakton luftën hibride si *“kombinim i metodave konvencionale/ të rregullta, luftës së çrregullt dhe asimetrike, përfshirë edhe manipulimin politik dhe ideologjik në konflikte, mund të përfshijë kombinimin e operacioneve të forcave speciale dhe forcave të rregullta ushtarake, agjentëve të inteligjencës, provokatorëve politikë, përfaqësuesve të medias, sulmi ekonomik, sulmet cyber, grupet proxy, grupet paramilitare, terroristë dhe elementët kriminal”*⁶.

Hoffman⁷, një ndër teoricienët kryesorë të luftës hibride, reflekton mendimet e tij mbi atë si një fenomen dhe analizon ndryshimin e karakterit të luftës në botën bashkëkohore. Ai e përcakton luftën hibride si: *“kërcënim që inkorporon në një rreze të gjerë të formave të luftës duke përfshirë kapacitete të forcave të rregullta, taktikat dhe formacionet e çrregullta, aktet terroriste përfshirë dhunën dhe detyrimin, çrregullime dhe krijimin e situatave kaotike kriminale, akte që zhvillohen nga të dyja palët në konflikt dhe nga një gamë e gjerë aktorësh joshitetorë”*⁸.

Edhe shkolla ruse ka konceptin e saj mbi luftën hibride, i cili fillimisht është sjellë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Rus, Gjenerali Gerasimov. Ai na sjell një këndvështrim nga pikëpamja ruse mbi luftën hibride, që quhet “Lufta e gjeneratës së re”⁹. Audiencia e vendeve

⁴ Robert.W, “SPEC FI : The United States Marine Corps and Special Operations” (Monterey, California. Naval Postgraduate School, 1998), <http://hdl.handle.net/10945/8989>.

⁵ Naval Postgraduate School, n.d.), <http://hdl.handle.net/10945/5865>

⁶ Newson.R, “Why the US Needs a Strategy To Counter ‘Hybrid Warfare,’” accessed October 29, 2021, <https://www.defenseone.com/ideas/2014/10/why-us-needs-strategy-counter-hybrid-warfare/97259/>.

⁷ Frank Hoffman është anëtar i Institutit për Studime Strategjike në Washington.

⁸ Hoffman.F, “Conflict in the 21st Century.”: Potomac Institute for Policy Studies, Virginia, December 2007,72

⁹ “The Value of Science in Prediction” <https://www.ies.be/files/Gerasimov%20HW%20ENG.pdf>

perëndimore u njoh me këtë koncept, në një artikull të publikuar në shkurt të vitit 2013. Ky artikull publikoi konceptet e formuluar nga mësimet e nxjerra nga konfliktet ushtarake të liderëve ushtarakë rusë dhe vizionin e tyre për luftërat e të ardhmes.

Ne kemi trajtuar në mënyrë të integruar përdorimin e elementeve të fuqisë kombëtare të një vendi për arritjen e objektivave të caktuara. Sipas një skenari të përgatitur, rëndësia e elementit ushtarak, ekonomik apo diçka tjetër për arritjen e këtij objektivi, i përshtatet situatës konkrete. Lufta e gjeneratës së re “*përdor metodat ekonomike, politike, diplomatike të kombinuara me metodat e tjera të luftës, si cyber, informacioni, mjetet psikologjike, sesa në hapjen e një konflikti të hapur të armatosur*”¹⁰. Gerasimovi thekson “rëndësinë e përdorimit të kamufluar të forcave paramilitare, kryengritëse dhe operacioneve të forcave speciale (SOF)”¹¹, rregullat e luftës kanë evoluar dhe shpjegon se mënyrat joushtarake mund të sigurojnë objektiva politikë dhe strategjikë me rezultate më të larta se armët të fuqishme.

Modeli Gerasimov ka një vlerë përshkruese, po ashtu edhe një vlerë parashikuese: se ushtria ruse duhet të studiojë elementet dhe efektet e saj, si dhe zbatimin e tyre kundër kundërshtarëve të Rosisë. Edhe pse Gerasimov ka shkruar fillimisht për këtë gjeneratë, mendimi i tij u ndikua nga shkrimet më të fundit të teoricienëve ushtarakë rusë, si dhe nga strategët ushtarakë sovjetikë të viteve 1920-30, si Svechin, Isserson dhe të tjerë. Që të gjithë ata e vunë theksin te rëndësia e luftës politike dhe luftës së informacionit, si dhe në vendosjen e shpejtë dhe të fshehtë të trupave në terren, ashtu si edhe te mungesa e deklaratave zyrtare të luftës në epokën moderne.

Adamsky, profesor në shkollën e përgatitjes së liderëve, strategjisë dhe diplomacisë në Izrael nënvizon se “*lufta e gjeneratës së re është përzierje e fuqisë së fortë dhe fuqisë së butë dhe aplikimit të mjeteve ushtarake, diplomatike dhe ekonomike*”¹². Gjithashtu, fokusohet “në ndryshimin në fushëbetejën konvencionale dhe veçanërisht në impaktin e rritjes së përdorimit të armëve me precizion të lartë”¹³.

Një përkufizim tjetër për luftën hibride vjen nga teoricienët kinezë, ata e quajnë “luftë e pakufizuar” “unrestricted warfare”¹⁴. Kjo teori e argumenton këtë metodë lufte si të përshtatshme për vende si Kina, me qëllim që të përballojnë një kundërshtar me teknologji superiore ushtarake, si SHBA. Lufta e pakufizuar përdor edhe mjetet ushtarake dhe ato joushtarake dhe ka shumë ngjashmëri me luftën hibride. Ekspertët kinezë të luftës së

¹⁰ Mark.G, “The ‘Gerasimov Doctrine’ and Russian Non-Linear War,” In Moscow’s Shadows, July 6, 2014: <https://inmoscowsshadows.wordpress.com/2014/07/06/the-gerasimov-doctrine-and-russian-non-linear-war/>

¹¹ Chekinov, Bogdanov, “The Nature and Content of a New-Generation War,” <https://www.usni.org/sites/default/files/inline-files/Chekinov-Bogdanov%20Military%20Thought%202013.pdf> .20

¹² Adamsky. D, “Cross-Domain Coercion: The Current Russian Art of Strategy,” Proliferation Papers No.54 (November 2015): 21–23, aksesuar Tetor 22, 2021, <https://www.ifri.org/en/publications/etudes-de-lifri/proliferation-papers/cross-domain-coercion-current-russian-art-strategy>.

¹³ Chekinov, Bogdanov, “The Nature and Content of a New-Generation War,” <https://www.usni.org/sites/default/files/inline-files/Chekinov-Bogdanov%20Military%20Thought%202013.pdf> .13.

¹⁴ Liang and Xiangsui, “Unrestricted Warfare,” PLA Literature and Arts Publishing House, Beijing (1999).

pakufizuar, Liang and Xiangsui, argumentojnë se rregulli i parë i luftës së pakufizuar është që nuk ka rregulla, asgjë nuk është e ndaluar.

Metodat e luftës së pakufizuar përfshijnë: “hakerim i kompjuterëve, subversion i sistemit bankar, i tregjeve ndërkombëtare, manipulimi monetar (luftë financiare), terrorizëm, keqinformim mediatik dhe luftë urbane”¹⁵. Autorët Liang dhe Xiangsui shpjegojnë se si zhvillimet në teknologjinë e informacionit kanë ndryshuar metodat e luftës dhe konceptin se cilat mund të quhen armë në kohët moderne, si për shembull, një armë shumë e fortë mund të jenë edhe viruset kompjuterike, që mund të përdoren në mënyrë shumë efektive gjatë një operacioni luftarak.

Pas studimit në tërësi të këtyre përkufizimeve, duke studiuar edhe atë se çfarë kuptohet nga NATO, për kërcënimet hibride, të cilat “*kombinojnë mjetet ushtarake dhe joushtarake, sekrete dhe të hapura, duke përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, vendosjen në terren të grupeve të armatosura paramilitare dhe përdorimin e forcave të rregullta ushtarake. Metodat hibride përdoren për të mjegulluar kufijtë midis luftës dhe paqes, dhe në përpjekjen për të mbjellë dyshime në mendjet e popullatave të synuara*”¹⁶, mund të themi që lufta hibride përbën disa shkallë ndërhyrjeje në kohën e sotme dhe i ngjan deri në një farë shkalle përgatitjeve për luftë në luftërat e kaluara, përgatitje e cila kishte në vetvete agjitacionin, propagandën dhe ndërhyrjen pasi krijoheshin kushtet. Ajo përbëhet nga sulmet kibernetike; propaganda për të nxitur panikun dhe pasigurinë dhe protestat; futja e forcave speciale pa shenja përkatëse për të provokuar violencë në shkallë të kufizuar e vetëm në ato zona që kërkohen.

2. Karakteristikat e luftës hibride, rast studimi Rusia

Që të kuptojmë hapësirën se ku vepron lufta dhe aktorët hibridë, duhet të eksplorojmë elementët që përmendëm më sipër. Lufta hibride është në fakt një zonë “gri” midis luftës së vërtetë dhe jo luftës. Analistët ushtarakë e përshkruajnë zonën gri si një hapësirë konceptuale midis paqes dhe luftës ose midis diplomacisë dhe luftës. “Zona gri” është fushëbeteja ku lufta hibride zhvillohet. Raine e shikon këtë zonë si fushëbeteja me shumë lojtarë, kapacitete dhe axhenda. Pjesë e këtij domeini është “edhe krimi i organizuar, hakërruesit e kompjuterëve, terroristët dhe aktivistët politikë”¹⁷. Në zonën gri zhvillohen aktivitete të dyshimta që e kalojnë kufijtë e përplasjeve normale. Këto aktivitete janë nën nivelin e konflikteve të drejtpërdrejta por “përsëri përbëjnë një kërcënim dhe minojnë dhe thyejnë rregullat apo normat dhe ligjet ndërkombëtare”¹⁸. Profesor Hoffman thotë se në konflikte të tilla, kundërshtarët përdorin një set instrumentesh të fuqisë kombëtare në një luftë të mjegullt, për të fituar objektiva specifike strategjike por pa e kaluar kufirin e konfliktit të hapur.

¹⁵ Liang and Xiangsui, “Unrestricted Warfare,” PLA Literature and Arts Publishing House, Beijing (1999).

¹⁶ https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_183004.htm

¹⁷ Raine, J., “War or Peace? Understanding the Grey Zone,” <https://www.iiss.org/blogs/analysis/2019/04/ing-the-grey-zone>.

¹⁸ Lyle, M et al., Gaining Competitive Advantage in the Gray Zone: Response Options for Coercive Aggression Below the Threshold of Major War. https://www.rand.org/pubs/research_reports/RR2942.html.

Anthony Cordesman, ish-drejtor i inteligjencës në Pentagon, e përforcon argumentin që taktikat e luftës janë të vjetra si edhe vetë historia e njerëzimit. Në kushtet e luftërave bashkëkohore sfida më e madhe është të *“kuptohet sesi në një botë të industrializuar me teknologji të lartë, taktikat e luftës miksohen dhe përshtaten”*¹⁹. Metodatat e luftës hibride, i gjejmë të materializuara në metodatat e luftës ruse dhe mënyrën se si ata i kanë kombinuar taktikat e ndryshme. Në mënyrën ruse të luftës, “forcat konvencionale mund të përdoren si mburojë për të mbrojtur forcat e çrregullta”²⁰. Më parë, gjatë zhvillimit të operacionit, forcat e çrregullta luftarake ishin dytësor në krahasim me forcat e rregullta. Në luftën në Gjeorgji në vitin 2008, Rusia “kombinoi forcat e rregullta, me milicinë jugore të Ossetisë dhe Abkazisë, me forcat speciale që operonin fshehurazi”²¹.

Mënyra se si operojnë forcat konvencionale me forcat e çrregullta në fushëbetejën bashkëkohore i dallojnë luftërat hibride nga metodatat e mëparshme të luftimit. Në vitin 2006 në konfliktin midis Hezbollahut dhe Izraelit, forcat e Hezbollah i tronditën forcat izraelite me metodatat e tyre të sofistikuara dhe kombinimin e forcave guerile me taktikat e rregullta ushtarake. Teoricienët ushtarakë shpjegojnë se ky variant i luftës së përdorur nga Hezbollah është edhe shembulli më i pastër i një force të re hibride. Vietnami është gjithashtu një rast tjetër sinergjie e krijuar nga luftërat hibride, si *“vendosja përballë e taktikave të çrregullta hibride të Vietkongëve me forcat konvencionale të ushtrisë vietnameze të Veriut”*²².

Me qëllimin kryesor që të fitojnë influencë, të provokojnë destabilizim të brendshëm duke shmangur konflikt të hapur ushtarak, “Taktikat jo të dhunshme subversive/përmbysëse”²³ janë pjesë e luftës hibride. Varieteti dhe kompleksiteti i aktorëve që janë të përfshirë tregojnë intensitetin e aksioneve dhe taktikave jo të dhunshme subversive. Një rast i taktikave subversive është edhe përdorimi i koordinuar i organizatave joqeveritare për të inkurajuar tensione dhe për të rritur dyshimet brenda popullsisë. Një shembull i qartë i këtyre taktikave shërbejnë taktikat ruse në Ukrainë. Rusia përdori gjuhën dhe edukimin si një instrument politik, duke përfshirë këtu djegien e shkollave dhe të librave, publikimin dhe shpërndarjen falas të gazetave, vendosja e emrave rus të rrugëve, fshatrave, qendrave kulturore dhe vendosja e flamujve rus.

Rusia përdor luftën hibride nëpërmjet taktikave jo të dhunshme subversive, si promovimi historik, kulturor dhe lidhjet shpirtërore midis Rusisë dhe rajoneve të ndryshme. Një nga aleatët e Rusisë është kisha ortodokse dhe oligarkët rusë. Ata përdorën fenë si instrument politik duke promovuar kishën ortodokse ruse dhe duke modifikuar memorien kolektive

¹⁹ Jones.S, “Ukraine: Russia’s New Art of War” <https://www.ft.com/content/ea5e82fa-2e0c-11e4-b760-00144feabdc0>

²⁰ Radin A, “Hybrid Warfare in the Baltics: Threats and Potential Responses” (RAND Corporation, 2017), 5, accessed October 26, 2021, http://www.rand.org/pubs/research_reports/RR1577.html.

²¹ Wither.J., “Making Sense of Hybrid Warfare,” Connections; The Quarterly Journal 15, no. 2 (2016): 73–87.

²² Hoffman. F, “Hybrid Warfare and Challenges,” ndupress.ndu.edu, no. 52 (2009): 36.

²³ Radin A, “Hybrid Warfare in the Baltics: Threats and Potential Responses” (RAND Corporation, 2017), 5, aksesuar tetor 26, 2021, http://www.rand.org/pubs/research_reports/RR1577.html.

(historinë). Feja ortodokse ka qenë gjithmonë një mjet delikat që është shfrytëzuar për të mbajtur lidhjet e afërta tradicionale midis shtetasve sllavë kudo janë ato. Cilësia e dobët e medias dhe e ndikuar nga manipulimi politik “e ndihmon propagandën ruse që të shpërndajë propagandën e saj në arenën rajonale dhe ndërkombëtare”²⁴. Nëpërmjet lidhjeve tradicionale dhe krijimit të imazhit ku ruhen tradita të njëjta dhe lidhje familjare midis popujve sllavë, këto mesazhe propagandohen në media dhe gazetarë që janë nën ndikimin rus.

Dominimi i Informacionit shërben si një mjet i ri dhe shumë i rëndësishëm në komunikimin strategjik. Informacioni mund të ndikojë në përcimin e mesazheve politike dhe të sigurojë rezultate vendimtare për të kontrolluar gjithë spektrin e informacionit në të gjitha dimensionet e fushëbetejës. Operacionet informative në luftën hibride “janë një kapacitet kritik për të arritur rezultate vendimtare gjatë konfliktit”²⁵. Lufta e informacionit dhe ajo psikologjike së bashku me avancimin e teknologjisë do të dominojnë luftërat bashkëkohore. Sipas studiuesit Berzins, këndvështrimi rus i luftës moderne qëndron në idenë që fushëbeteja më e madhe është në mendjen e njerëzve. Qëllimi kryesor është që të reduktohet nevoja për të dislokuar forca të forta ushtarake. Ndikimi dhe manipulimi të arrijë në mënyrë të tillë që *“ushtria e një vendi të targetuar dhe popullata civile, arrijnë të mbështesin sulmuesin deri në kundërshtimin dhe dëmtimin e qeverisë së vendit”*²⁶.

Informacioni ka qenë një mjet kryesor në luftën bashkëkohore, duke krijuar një version të realitetit që i përshtatet qëllimeve politike dhe ushtarake në të gjitha nivelet e luftës. Rusia synon që audienca ndërkombëtare, qytetarët rusë dhe sidomos vendet e ish-Bashkimit Sovjetik të dyshojnë dhe të jenë mosbesues ndaj çdo informacioni të transmetuar nga perëndimi. Rusia gjatë dekadës së fundit i ka dhënë rëndësi të madhe dhe e shikon informacionin si një domen kritik të luftës bashkëkohore. Profesor Wither për krizën në Ukrainë të vitit 2014 shpjegon që: *“operacionet e informacionit u përdorën nga Rusia për të dezinformuar dhe intimiduar anëtarët e NATO-s Objektivi kryesor ishte të shmangte ndonjë reagim dhe konflikt ushtarak”*²⁷. Si objektivi madhor, lufta e informacionit i shërben Rusisë si mjet kritik për të arritur objektivin final strategjik që të bëhet një lojtare dominante në arenën ndërkombëtare.

Lufta cyber luan një rol të madh në luftën hibride kur kombinohet dhe koordinohet shumë mirë me luftën elektronike dhe atë të informacionit. Lufta cyber “është pjesë përbërëse me rol të madh në operacionet e informacionit dhe në luftën hibride”²⁸. Rusia rekruton

²⁴ Bechev D, “Understanding Russia’s influence in the Western Balkans,” Strategic Analysis September 2018, the European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats, 3

²⁵ United States Defense Intelligence Agency: <http://www.dia.mil>, “Russia Military Power: Building a Military to Support Great Power Aspirations”, accessed November 2, 2021, <https://www.hsdl.org/?abstract&did=>.

²⁶ Berzins. J “Russia’s’ New Generation Warfare in Ukraine: Implications for Latvian Defense Policy,” n.d., 5, accessed October 25, 2021, <https://sldinfo.com/wp-content/uploads/2014/05/New-Generation-Warfare.pdf>.

²⁷ James K., “Making Sense of Hybrid Warfare,” Connections: The Quarterly Journal 15, no. 2 (2016): 73–87.

²⁸ Keir. G, “Handbook of Russian Information Warfare,” NATO Defense College 9, no. (November 2016): 4.

një numër të madh agjentësh cyber, që të mund të kenë akses dhe të godasin sistemet e informacionit që shërbejnë për të mbledhur informacion të vlefshëm. Në rastin e Rusisë, informacioni dhe lufta cyber përdoret për të ndërhyrë në zgjedhje elektorale dhe për të influencuar tek aktorët ndërkombëtarë politikë me poste kyçe. Në luftën në Gjeorgji, të gjitha operacionet ushtarake përfunduan vetëm pas pesë ditësh. Sistemi kompjuterik ka qenë target i viruseve kompjuterike që i shërbeu si një mjet që i dha akses rusëve në sekretet e brendshme të Kievit. Këto mjete hibride treguan se ishin shumë të vlefshme për të arritur objektivin pa përfshirë ndonjë element të fuqisë kombëtare.

Operacionet e dhunshme të kamufluara janë gjithashtu karakteristike të taktikave të luftës hibride. Rusia ka përdorur ushtarët proxy, forca speciale pa identitet, agjentë të inteligjencës të infiltruar me qëllim që të krijohet konfuzion dhe për të arritur suksese strategjike. Forcat Proxy janë grupe të armatosura që nuk janë pjesë e forcave të rregullta luftarake, por që luftojnë për vendin që e sponsorizon. Grupet proxy në mënyrë indirekte bashkëveprojnë me shtetin sponsorizues dhe e zhvillojnë luftën në bazë të mbështetjes që i jepen. Ata mund të intimidojnë popullsinë civile dhe të lehtësojnë zhvillimin e një game të gjerë aktiviteteve të fshehura hibride. Aksionet e fshehura e të dhunshme shërbejnë për të nxitur dhe mbështetur lëvizjet separatiste. Rusia preferon të sigurojë armatim dhe asistencë sesa prezencë trupash të rregullta ushtarake.

Rusët përdorin grupet paramilitare, të cilët motivohen nën kauzën e deviacionit të tyre ndaj kishës ortodokse ruse dhe nacionalizmit ekstrem. Analistët informojnë që Rusia ka mbështetur dhe furnizuar grupime të ndryshme rebele separatiste në Ukrainën Lindore me armatim të rëndë si tanke, artileri dhe sisteme të sofistikuara kundërajrore. Rusia nuk lançoi një pushtim tradicional ndaj Krimesë në Ukrainë, por aktivizoi dhe shfrytëzoi demonstrimet pro-ruse, infiltroi grupet milice pa shenja të dallueshme që të pushtonin ndërtesat qeveritare, ndezi dhe mbikëqyri referendumin lokal që ta legjitimonte aneksimin e Krimesë në opinionin ndërkombëtar.

Lufta hibride nuk ka të njëjtin efektivitet në të gjitha rajonet, sepse çdo rajon ka specifikat e veta. Në Ukrainë, Rusia e ka pasur të vështirë që të përdorë metodat hibride në disa rajone. Në aneksimin e Krimesë, Rusia nuk kishte nevojë të dislokonte trupa ushtarake të mëdha sepse përdori grupimet që ndodheshin në vend. Prezenca e shumë ish-ushtarakëve të dalë në rezervë, arsimuar në akademitë ushtarake të BS dhe që kishin shërbyer në periudhën e BS, ishin një aset shumë me vlerë për Rusinë. Në pjesën më të madhe të qyteteve të Krimesë ata shërbyen edhe për të rritur mbështetjen ndaj bashkimit me Rusinë. Ndërsa në Ukrainën Lindore ishte më e vështirë për Rusinë që të mobilizonte popullsinë lokale. Vlen për t'u theksuar që lufta hibride nuk ka të njëjtin efektivitet edhe vetë brenda rajonit të ish-BS.

Forcat Speciale (SOF) luajnë një rol të rëndësishëm në luftën hibride. Forcat speciale ruse "Spetsnaz" janë forca të çrregullta që operojnë në mënyrë të fshehtë, ata gjenden në të gjitha forcat e armatosura, në shërbimin e inteligjencës dhe shërbimin e sigurisë. Këto trupa speciale, të njohura si beretat jeshile, operuan gjatë marrjes së institucioneve me rëndësi në

Krime dhe u zhdukën kur grupet milice dhe trupat lokale erdhën për të marrë në kontroll situatën. Konflikti në Ukrainë tregoi se Rusia i rekruton forcat “spetsnaz” nga popullsia lokale në vendet që janë të targetuara nga Rusia, “nga minoritetet, nga disidentët politikë dhe grupime kriminele”²⁹. Spetsnaz kanë evoluar që nga angazhimi i tyre në Gjeorgji në vitin 2008. Shpesh forcat speciale janë përdorur edhe për menaxhimin e krizave dhe si ndërlidhës midis grupeve opozitare brenda një shteti që është vënë në shënjestrën e strategjisë ruse.

Për të përmbushur objektivat e saj, qeveria ruse shpërndan dyshime, konfuzion dhe mohon pjesëmarrjen në konflikt, demoralizon dhe intimidon kundërshtarin. Kështu ndodhi në Krime, ku Rusia zhvilloi stërvitje në shkallë të gjerë me forcat e rregullta në kufirin me Ukrainën. Në të njëjtën kohë hodhi sulmet cyber në sistemet e qeverisë dhe zhvilloi një ofensivë diplomatike dhe mediatike për të minuar legjitimitetin e qeverisë të Ukrainës. Qëllimi i kësaj forme lufte ishte që të aplikonte presion psikologjik dhe të shkaktonte krizë të brendshme dhe të kolapsonte shtetin e targetuar. Prandaj lufta hibride siguron objektivat politikë pa përfshirë luftime në shkallë të gjerë.

Agjentët e inteligjencës janë një komponent kritik i luftës hibride. Agjencitë e inteligjencës janë “përgjegjëse për një seri aktivitete të fshehta në rreze të gjerë që janë pjesë vitale e objektivave politikës ruse”³⁰. Format e fshehta të pushtetit që Rusia po përdor nuk janë vetëm ushtarake. Rusia po përdor paratë për të blerë anëtarë në parlament, po blen kompani dhe individë, bankierë që marrin punë në Moskë dhe e gjejnë veten të përfshirë, të kompromentuar dhe të shantazhuar kur kthehen në perëndim. Moska përdor korrupsionin për të shantazhuar. Shumë qeveri të ndryshme në botë, nuk iu pëlqen që ndihma vjen e shoqëruar me një faturë me detyrime të tipit të tillë shantazhues. Rusia paguan dhe bashkëpunon me rrjete të krimit të organizuar duke e përdorur botën e krimit si mjet për të arritur objektivat e saj. Sipas Donnelly, “Moska është më mirë me spiunazhin jo vetëm tek kamuflimi tradicional por edhe tek analiza e burimeve të hapura në atë nivel që Perëndimi ka harruar se si zhvillohet.”³¹

Rusia po e përdor luftën hibride për të siguruar edhe influencë politike në Evropë. Studiuesit dhe analistët e çështjeve të sigurisë hedhin dyshime të forta që Rusia po arrin të ndërhyjë në çështjet e brendshme të vendeve të Evropës Perëndimore. Në vitin 2015, në zgjedhjet elektorale në Gjermani, Merkel-it iu desh të përballej me një fushatë të vështirë elektorale, sepse ajo u tregua “e vendosur për të vepruar me sanksionet e Evropës kundër Rusisë për arsye të çështjes së Krimesë në Ukrainë”³². Chivis guxon edhe më shumë në studimin e tij

²⁹ Horn.B, “On Hybrid Warfare”The CANSOFCOM Professional Development Centre, 2016, f. 23.

³⁰ Robinson. L, Modern Political Warfare: Current Practices and Possible Responses (Santa Monica, Calif: RAND Corporation, 2018), f. 76

³¹ Jones. S “Ukraine: Russia’s new art of war”, Financial Times, <https://www.ft.com/content/ea5e82fa-2e0c-11e4-b760-00144feabdc0>.

³² Christopher, C “Understanding Russian “Hybrid Warfare” and what can be done about it” RAND Corporation, March 22, 2017, 7.

duke parë edhe mundësinë e një ndërhyrje të mundshme edhe vendimin e Britanisë për të dalë nga BE. Strategjia e politikës ruse synonte të minonte partitë pro SHBA dhe pro BE në Gjermani, Francë dhe Itali duke ndërhyrë në disa zgjedhje elektorale 2017. Lufta hibride e paraqitur në këto forma, “synon të fusë dyshime tek opinionet e njerëzve në lidhje me integritetin e institucioneve demokratike dhe besimin tek demokracia liberale në vetvete”³³.

Strategjia ruse për t’u kthyer në një fuqi globale i kushton vëmendje influencës ekonomike dhe intensifikimit të marrëdhënieve tregtare në sektorët strategjikë. Rusia përdor si ndikimin e drejtpërdrejtë ekonomik dhe atë indirekt me qëllim që të ndikojë politikat evropiane. Moska e përdor energjinë si një mjet të politikës së jashtme, kur në dimrat e ashpër të viteve 2006-2009, Rusia arriti të menaxhonte që të vinte nën presion Ukrainën dhe “ta detyronte të bënin një marrëveshje sipas interesit të saj për të vendosur çmimin e gazit”³⁴, apo edhe në rastin e krizës energjetike evropiane të shtatorit 2021.

Parë në perspektivën ruse, mjetet jo ushtarake mund të arrijnë shumë objektiva strategjikë duke përdorur instrumentet e fuqisë kombëtare të kombinuara me cyber, informacion, domenin psikologjik mund të sigurojnë suksese pa pasur nevojën e një konflikti të hapur. Lufta e gjeneratës së re i jep rëndësi aksioneve të fshehta, përdorimit të gupeve paramilitare, rebelëve dhe forcave speciale. Mendimi ushtarak rus e shikon luftën hibride si një përzierje midis fuqisë së butë dhe të fortë. Rusia do që t’i arrijë objektivat e saj strategjikë me pak kosto, instrumentet diplomatike dhe informacioni i përshtaten më mirë strategjisë ruse që të ripozicionohet si fuqi globale.

3. Përfundime

Si koncept modern, lufta hibride është me ndikim të gjerë në gjithë globin dhe për këtë arsye, studiohet nga shumë autorë dhe ekspertë të fushës së sigurisë dhe strategjisë. Karakteristikë e saj është që ajo po kthehet gjithnjë e më vdekjeprurëse, pa kufij midis luftës konvencionale dhe taktikave të luftës së çrregullt, midis përdorimit të taktikave jo të dhunshme subversive dhe aksioneve të kamufluara të dhunshme. Ajo po kthehet në një nga sfidat më të mëdha të sigurisë së shteteve/aleancave dhe stabilitetit ndërkombëtar.

Dekada e fundit ka vërtetuar që letaliteti i luftës hibride dhe paparashikueshmëria e metodave të saj mikse e bëjnë atë shumë komplekse dhe shumë të vështirë për t’u parandaluar. Gray argumenton se, “diçka që ne mund ta parashikojmë është që do të jetë një luftë gjithnjë e më e mjegullt”³⁵. Kërcënimet e luftës hibride janë rritur në masë vitet e fundit sa që ato tashmë janë jo vetëm rrezik por edhe kërcënim. Problemi është që në shumicën e rasteve, kërcënimet hibride nuk detektohen lehtë. Për më tepër edhe kur ato zbulohen, shpeshherë është tepër vonë për të reaguar pasi pasojat e tyre kanë ndodhur dhe janë në disa raste të pariparueshme.

³³ Kudors. A, “Hybrid War-A New Security Challenge for Europe”, Latvia Defense Institute, 7

³⁴ Christopher.C “Understanding Russian “Hybrid Warfare” and what can be done about it”, 6

³⁵ Gray. C, “Another Bloody Century: Future Warfare”, Orion Publishing Group, 2012.

Përballja me një kërcënim të tillë, si për organizatën apo shtetin, bart në vetvete një dilemë sigurie permanente: nuk duhet doemos të gjendesh në luftë të hapur, për të pasur kërcënime të tilla, pasi lufta hibride mund të zhvillohet edhe në kushte të paqes, me anë të masave të ndryshme ekonomike, propagandistike, shantazheve, ndërhyrjes në elementet demokratik, etj. Në metodat e luftës hibride kemi një ndryshim themelor në mënyrën e përdorimit të forcave të armatosura, forcat konvencionale, të cilat ishin baza e përdorimit të forcës apo e kërcënimit mbi përdorimin e saj, tashmë mund të përdoren si mburojë për të mbrojtur forcat e çrregullta.

Bibliografia

- Andrew Radin “Hybrid Warfare in the Baltics: Threats and Potential Responses” (RAND Corporation, 2017).
- Colin S Gray, Another Bloody Century: Future Warfare (Orion Publishing Group, 2012).
- Dimitrav Bechev, “Understanding Russia's influence in the Western Balkans” Strategic Analysis September 2018.
- Frank G Hoffman “Hybrid Warfare and Challenges” Small Wars Journal, issue 52, 2009.
- Janis Berzins “Russia’s’ New Generation Warfare in Ukraine: Implications for Latvian Defense Policy” 2015.
- Linda Robinson, Modern Political Warfare: Current Practices and Possible Responses (Santa Monica, Calif: RAND Corporation, 2018)
- Peter R Mansoor . “Hybrid Warfare in History” Cambridge University Press, Jule 2012.
- Qiao Liang and Wang Xiangsui, “Unrestricted Warfare,” PLA Literature and Arts Publishing House, Beijing, February 1999.
- Robert A. Newson, “Why the US Needs a Strategy To Counter ‘Hybrid Warfare,’” 2014.

ARMËT E SHKATËRRIMIT NË MASË – RREZIK PËR PAQEN DHE SIGURINË E POPUJVE

Nënkolonel Msc. Esat Neziri,
Nënkolonel Msc. Shpresim Shllaku
FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Ky material synon të japë një paraqitje reale të ndikimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë (ASHM) në sigurinë dhe paqen e popujve në kushtet e veprimit të fenomeneve të reja në realitetin e sotëm të zhvillimeve globale. Sistemi i sotëm botëror gjendet në hapësirën e mundësisë për të bashkuar përpjekjet e të gjitha shteteve në përballimin e pasojave që mund të shkaktojë përdorimi i Armëve të Shkatërrimit në Masë.

Strategjitë e miratuara nga organizatat me ndikim në sistemin e sotëm ndërkombëtar kanë lehtësuar marrjen e masave për përballimin e situatave që asnjë shtet i vetëm nuk do të mundet që t'i zgjidhë. Gjithashtu, në kushtet e sotme të zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit janë krijuar mundësi dhe aftësi të reja që organizata, grupe dhe individë të caktuar, të lidhur me aktivitete kriminale, të përdorin për arritjen e synimeve, qëllimeve dhe objektivave të tyre Armët e Shkatërrimit në Masë.

Në këto prirje të zhvillimeve të rendit të sotëm është e vështirë të rekomandohen zgjidhje me efekte të menjëhershme ndikuese në sigurinë dhe paqen e popujve, por do të ishte e palejueshme që të mos rekomandohej orientimi i veprimtarive që çon në marrjen e masave për të vështirësuar dhe pamundësuar përdorimin e Armëve të Shkatërrimit në Masë (ASHM) nga ata që mendojnë t'i përdorin nëse do t'i gjejnë. Krijimi dhe forcimi i bindjes tek elitat

politike në nivel kombëtar, rajonal, global dhe tek opinionin i gjerë publik për eliminimin e ASHM, nëpërmjet prezantimit të mundësive dhe aftësive që ekzistojnë sot në botë për përdorimin e tyre, është bërë domosdoshmëri.

Fjalë kyçe: Armët e Shkatërrimit në Masë (ASHM), mjedisi i sigurisë, strategji, vlerësim, rreziqet dhe kërcënimet, sfidë, interesa, koherencë, bashkëpunim, posedim.

1. Retrospektivë

Armët e Shkatërrimit në Masë (ASHM) janë armët më shkatërrimtare që njihen historia njerëzore. Efekti dëmtues i tyre bazohet në armën e kimisë, biologjisë dhe nukleare. Historia e zhvillimit të ASHM është e lidhur me historinë e zhvillimit njerëzor. Në betejat të ndryshme të zhvilluara ndërmjet mbretërive për zaptime terriroresh ose shtrirje të influencës që para erës sonë, gjenden gjurmë të përdorimit të elementeve me ndikim të madh në fatet e luftimeve. Substanca dhe mikrobet e prodhuara në format më të thjeshta për pamundësinë e njohurive të kohës dhe të përdorura ndaj kundërshtarëve, në luftërat e zhvilluara në Greqinë e lashtë, tregojnë për efektet dërmuese të tyre në jetën e gjallë.

Lufta e Parë Botërore tregoi efektet shkatërruese që kanë këto armë, me përdorimin e tyre në vitin 1915 në Ipër të Francës ku gjetën vdekjen 5000 njerëz. Edhe në Luftën e Dytë Botërore u panë shkatërrimet e paimagjinueshme dhe vështirësia për t'u mbrojtur ndaj tyre, me përdorimin kundër Japonisë të armës bërthamore nga SHBA në gusht të vitit 1945, ndikime që shfaqin efektet e saj edhe sot pas 76 vitesh. Në të gjitha rastet e përdorimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë, pas Luftës së Dytë Botërore e deri në ditët e sotme, është vënë re vështirësia e përbaltjes së shtetit, duke kërkuar bashkëpunim ndërkombëtar.

Në ditët e sotme të ballafaqimit të shteteve me zhvillime, fenomene, aktivitete, probleme të ndryshme e bëjnë edhe më të pamundur përbaltjen e tyre me pasojat e përdorimit të mundshëm të ASHM¹ dhe bëhet domosdoshmëri bashkëpunimi rajonal, ndërkombëtar dhe global në marrjen e masave për përballimin e pasojave të shkaktuara. Pakënaqësitë e shkaktuara nga pasojat e dukurive të sotme në grupe të ndryshme shoqërore, në organizata shtetërore ose joshtetërore, në shtete dhe rajone të ndryshme, kanë rritur mundësitë për të kërcënuar me përdorimin e Armëve të Shkatërrimit në Masë, për realizimin e interesave të tyre. Rrezikun dhe kërcënimin më të madh, duke parë efektet e tyre shkatërruese, e përbëjnë grupet dhe elementë të caktuar terroristë të përhapur në të gjithë globin. Përballja me rrezikun dhe kërcënimin e përdorimit të ASHM kërkon marrjen dhe forcimin e masave të ruajtjes dhe sigurisë nga të gjitha shtetet poseduese të tyre.

Krijimi i bindjes tek elitat politike për eliminimin e Armëve të Shkatërrimit në Masë, nëpërmjet prezantimit të mundësive dhe aftësive që ekzistojnë sot në botë për përdorimin e tyre, është bërë domosdoshmëri. Përgatitja e publikut nëpërmjet informimit të vazhdueshëm për pasojat që sjell përdorimi i mundshëm i tyre, si dhe mundësitë që ekzistojnë për një gjë

¹ Kisinger Henri "Armët e Shkatërrimit në Masë dhe politika e jashtme".

të tillë duhet të jetë vazhdimësi e punës së institucioneve ligjore të specializuara për ta bërë një gjë të tillë.

2. Përdorimi i ASHM - rrezik për paqen dhe sigurinë e popujve

Një nga sfidat më të mëdha dhe kërcënimet më të rrezikshme në botë është terrorizmi ndërkombëtar. Tani që bota ka hyrë në shekullin e 21-të terrorizmi vazhdon të mbetet një kërcënim serioz ndaj interesave kombëtarë dhe ndërkombëtarë të sigurisë.

Ngjarjet tragjike të 11 shtatorit kanë demonstruar në mënyrë të qartë që terrorizmi ndërkombëtar nuk do të lërë mjete e metoda pa përdorur për realizimin e objektivave të tij antinjerëzore. Janë shumë shembuj që tregojnë se me dhjetëra vende kanë përjetuar goditje sporadike, por të egra nga terrorizmi. Shtetet e ndryshme dhe komuniteti ndërkombëtar e gjejnë vetveten në një situatë në të cilën terroristët dhe grupet e organizuara terroriste kanë provuar kapacitetet e tyre për të kërcënuar paqen dhe sigurinë kudo në botë. Një nga mjetet që terroristët përdorin për të arritur qëllimet e tyre janë kërcënimet dhe përdorimi i armëve të shkatërrimit në masë. Kërcënimet dhe përdorimi i ASHM nga ana e terroristëve mbetet real dhe i vazhdueshëm për arsye nga më të ndryshme.

Paralajmërimi dhe lajmërimi në kohë i popullsisë, mbrojtja e drejtpërdrejtë e jetës së njerëzve, përgatitja e institucioneve për marrjen e masave për eliminimin e pasojave që shkaktohen nga goditja me ASHM, informimi me të gjitha llojet e mjetet e mundshme i publikut për rreziqet dhe pasojat që vijnë nga përdorimi i këtyre armëve dhe mundësitë e mënyrat e veprimit për t'u përballur me shkatërrimet që ndodhin nga veprimi i tyre, janë çështje që trajtohen në dokumentet strategjike të NATO-s, që lidhen me përdorimin e mundshëm të ASHM në situata komplekse të caktuara.

Pasojat njerëzore, frika dhe pasojat psikologjike të përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë janë shumë të mëdha. Incidentet terroriste në të ardhmen mund të jenë më shkatërruese në viktima njerëzore si dhe më shkatërrimtare të pasurisë sesa në të kaluarën. Përdorimi i Armëve të Shkatërrimit në Masë (biologjike, kimike ose bërthamore) si instrumente të terrorizmit mund të shkaktojë dëme të përmasave jashtëzakonisht të mëdha në njerëz e pasuri dhe do të jenë një rrezik i madh për sigurinë rajonale dhe globale.

Në fjalimin e tij në Uashington mbi ndalimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë më 12 shkurt të vitit 2004, ish-presidenti amerikan George W. Bush² thekson se "Këto armë të tmerrshme janë duke u bërë të lehta për t'u siguruar, ndërtuar, fshehur dhe transportuar. Agjentët biologjikë apo armët e thjeshta bërthamore të ambalazuara në shishe të thjeshta, do të përdoren nga grupe të vogla fanatike ose shtete të paqëndrueshme për të rritur fuqinë e tyre për të kërcënuar shtetet ose kërcënuar paqen në botë". Përhapja e armëve të dëmtimit në masë është në distancë rrezik i madh për paqen dhe sigurinë e popujve. Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rregullat e kontrollit të ekspertëve dhe sistemet mbrojtëse kanë zvogëluar përhapjen e armëve të dëmtimit në masë. Përkrahja e teknologjisë së raketave

² Bush W George Në fjalimin e tij në Uashington mbi ndalimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë më 12 shkurt të vitit 2004.

krijon një aktualitet shtesë dhe të ri që ekspozon Evropën në një rrezik më të madh. Më e keqja është mendimi që grupet terroriste zotërojnë armë të dëmtimit në masë, dëmtimi në këtë rast do të ishte i madh, potenciali i tyre deri tani do të ishte i mundur vetëm për shtetet dhe ushtritë. Përparimet në fushën e njohurive biologjike dhe veprimet me armët biologjike në vitet e ardhshme mund të forcohen. Goditjet me lëndët kimike dhe materiale radiologjike janë në çdo rast një rrezik në rritje.

Terrorizmi që përdor armët e shkatërrimit në masë është një çështje veçanërisht e vështirë për hartuesit e politikës për shkak të pamundësisë thujse absolute për t'u përgatitur në mënyrë të gjithanshme për t'u përgjigjur ndaj sulmeve me armë të dëmtimit në masë. Terroristët mund të përdorin armët e shkatërrimit në masë kundër objektivave të ndryshëm ndaj të cilëve ata mendojnë se realizimi i qëllimeve të tyre politike, shoqërore, ekonomike është më i lehtë për t'u arritur.

Por cilat mund të jenë këto objektiva?³ - Objektet që janë simbole historike, ndërtesat qeveritare, gjykatat. Disa shembuj që tregojnë qartë për efektin e madh psikologjik që shkaktojnë këto armë, janë sulmet terroriste ndaj SHBA në vjeshtën e vitit 2000 në të cilat u përdorën sporet vdekjeprurëse të antraksit të mbyllura në letër, pluhuri radioaktiv dërguar me postë në shumë zyra qeveritare në Tokio, Japoni, burime radioaktive me nivel të ulët dërguar me postë në shumë zyra në Uashington DC.

Ndërtesat publike dhe zonat e mbipopulluara si stadiumet, qendrat e mëdha tregtare, mund të jenë gjithashtu objekte të sulmeve terroriste. Sulmet ndaj këtyre objekteve kanë treguar qartë që sasi të vogla të këtyre armëve kimike shkaktojnë dëme mjaft të mëdha. Kështu mund të përmendim sulmin me zarin në metronë e Tokios në Japoni. Vetëm nga përdorimi i një sasive të vogël të agjentëve kimikë pati dhjetëra viktima dhe 5510 njerëz që u trajtuan në 278 spitale japoneze.

Sistemi i infrastrukturës, rrugët e komunikimit, rezervat ujore janë të gjitha objekte të mundshme për t'u goditur me armë të dëmtimit në masë. Qytetet e ndryshme mund të jenë objekte të sulmeve me armë të shkatërrimit në masë. Megjithëse mundësia e terrorizmit bërthamor mbetet më e vogël në krahasim me terrorizmin biologjik e kimik, pasojat e shkatërrimit mund të jenë të pallogaritshme. Kështu, nëse një bombë me fuqi një kiloton (një e dhjeta e fuqisë së bombës që u hodh në Hiroshima) vidhet ose ndërtohet nga një grup me burime dhe aftësi të mjaftueshme dhe shpërthen mbi ndonjë qytet të madh, ajo do të shkaktohte me mijëra viktima si dhe dëme materiale të pallogaritshme. Gjithashtu, pasojat e rrezatimit nga efekti radioaktiv do të vazhdojnë për vite të tëra dhe do të ketë ndikime negative në brezat e ardhshëm.

3. Mundësia e përdorimit të ASHM - gjithnjë e më evidente

Terroristët kanë deklaruar në mënyrë të përsëritur si qëllimin, po ashtu dhe aftësitë e tyre për përdorimin e ASHM-ve. Zhvillimet ndërkombëtare në fushën e sigurisë do të kenë ndikim më të madh në jetën e qytetarëve të të gjitha vendeve. Vlerësimet janë qetë ndërkombëtar të

³ Kisinger Henri "Armët e Shkatërrimit në Masë dhe politika e jashtme".

bëhet më global në shtrirje dhe më vdekjeprurës në rezultate.

Përhapja e armëve të dëmtimit në masë ka të ngjarë të bëhet kërcënimi kryesor. Kjo lidhet me shumë faktorë, si: mungesa e stabilitetit për shkak të liderëve fanatikë të shteteve “që nuk mund të bëhen shtet”, konfliktet dhe krizat rajonale, përpjekjet për të “privatizuar” armatimin e sofistikuar konvencional, shpërdorimi i teknologjive, ndërprerja e burimeve jetësore, stoqet e mëdha të armëve shkatërrimit në masë që posedohen sot në botë, mosratifikimi dhe mospërbushja e detyrimeve ndaj Konventës së Ndalimit të Përdorimit të Armëve të Dëmtimit në Masë etj.

Përhapja e ASHM është një nga sfidat më të mëdha të sigurisë që po ndeshet sot komuniteti ndërkombëtar. Shqetësimi më i madh sot është mundësia shumë reale që këto armë mund të bien në duart e grupeve terroriste. Nuk ka dyshim për dëshirën e madhe të grupeve terroriste të tilla si al-Qaeda, që të kenë këto armë ose të i prodhojnë ato. Osama bin Laden dhe terroristët kanë deklaruar në mënyrë të hapur që do t'i përdorin këto armë në rastin më të parë të posedimit të tyre.

Tani e dimë nga laboratorët dhe dokumentet e kapura në Afganistan që ai ishte duke marrë në konsideratë zhvillimin e Armëve të Shkatërrimit në Masë. Pyetja është se sa të vështirë e kanë grupet terroriste mundësinë për të pasur këto armë, materialet dhe njohuritë për prodhimin e tyre?

Realiteti i sotëm tregon qartë se materialet, teknologjia dhe ekspertiza për prodhimin e këtyre armëve janë më të mundshme sot se ndonjëherë më parë. Lëvizja e lirë e materialeve që inkurajojnë zhvillimin e ekonomisë krijojnë padashur mundësinë që përhapësit e ASHM-ve të kenë mundësi për përhapjen e tyre. Ata mund të përdorin rrugët dhe mjetet e transportimit të mallrave. Gjithashtu ekziston dhe mundësia e pakapshme e zhvillimit dhe përhapjes të ASHM përmes studimeve të avancuara me qëllim zhvillimin e tyre. Një faktor tjetër shqetësues sot është mundësia përherë dhe më e madhe e gjetjes së teknologjive të përgatitjes së armëve kimike, si për shembull me anë të internetit.

Gjithashtu, industria kimike përdor shumë materiale, substanca kimike të ndryshme, të cilat mund të kërkohen dhe mund të blihen nga ana e terroristëve, pasi ata kanë mundësi financiare të mëdha për blerje, për prodhimin e armëve të ndryshme kimike, biologjike, si dhe përdorimin e tyre⁴. Zhvillimi i programeve bërthamore është një faktor tjetër që krijon mundësinë e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë. Testi bërthamor i kryer nga Koreja e Veriut më 9 tetor 2006 përbën një nga dështimet e Traktatit të Mospërhapjes së Armëve Bërthamore.

Shumë e rëndësishme është që objektivat e vendosur në Traktatin e Mospërhapjes së Armëve Bërthamore në vitin 1968 janë duke rritur stres. Shumë armë bërthamore vazhdojnë të ekzistojnë në pesë vende që kanë armë të tilla (Kina, Franca, Rusia, Britania e Madhe dhe SHBA) dhe vendet që nuk janë pjesë e këtij traktati si: India, Pakistani dhe Izraeli, kanë demonstruar kapacitetet e tyre të armëve bërthamore. Çështja është se këto vende ndodhen

⁴ Ban Jonathan “Diplomacia e vaksinës”.

në rajone ku krizat dhe konfliktet janë të pranishme dhe si rrjedhim, mundësia e përhapjes së këtyre armëve bërthamore është e pranishme dhe e mundshme. Ekzistenca e stoqeve bërthamore janë pakësuar, por përsëri ekzistojnë sot në botë rreth 30000 armë bërthamore. Një shqetësim i madh janë dhe stoqet me municione kimike që arrijnë një vlerë prej 8.6 milion ton, të cilat janë të deklaruara në Organizatën e Ndalimit të Armëve Kimike.⁵

Kushtet e ruajtjes dhe të sigurisë së këtyre stoqeve dhe municioneve kimike janë një mundësi e mirë nga ana e grupeve terroriste për sigurimin dhe përdorimin e tyre për realizimin e qëllimeve politike, shoqërore dhe ekonomike, të cilat do të kërkojnë angazhim të madh të strukturave të përgatitura dhe kapaciteteve intelektuale për sigurimin e mjeteve mbrojtëse dhe trajnimin për përdorimin e tyre, me qëllim që të reduktohen pasojat nëse këto armë do të përdoren.

4. Ligjet ndërkombëtare që nuk lejojnë përdorimin e tyre

1. Konventat e Hagës të viteve 1899 dhe 1907 për ndalimin e përdorimit të armëve kimike janë nga iniciativat ndërkombëtare për evitimin e përdorimit të armëve kimike.
2. Protokolli i Gjenevës (Protokolli për Ndalimin e Përdorimit në Luftë i gazrave helmuese apo i llojeve të tjera, si dhe të metodave bakteriologjike të luftës), nënshkruar në Gjenevë, më 17 korrik 1925.
3. Marrëveshja e Mospërhapjes së Armëve Nukleare, në Nju Jork, më 01.07.1968.
4. Konventa e Armëve Biologjike dhe Helmuese bërë në Londër, më 10.04.1975.
5. Konventa mbi ndalimin e zhvillimit, prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të Armëve Kimike dhe shkatërrimin e tyre, bërë në Gjenevë, më 03.09.1992.
6. Konventa e Armëve Kimike, bërë në Paris, më 13.01.1993.
7. Traktati mbi Ndalimin e testeve bërthamore, bërë në Nju Jork, më 10.09.1996.

5. Masat kundër përhapjes së ASHM

Si pasojë e ngjarjeve të 11 shtatorit, kërcënimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë ka fituar një dimension të ri: kërkesa e grupeve terroriste për të pasur dhe përdorur këto armë. Përhapja e armëve kimike, biologjike, bërthamore dhe mundësia e përdorimit të tyre nga shtete ose grupe terroriste ndërkombëtare kërcënojnë sigurinë e të gjitha shteteve. Përballë këtij realiteti, lufta e përbashkët e komunitetit ndërkombëtar kundër përhapjes së tyre duhet të rrisë më shumë përpjekjet për të luftuar këtë kërcënim të ri.

Të gjitha shtetet duhet të jenë vigjilente që të sigurojnë që ata nuk asistojnë ose mbështesin shpërndarjen e materialeve, të cilat mund të shërbejnë për përhapjen e ASHM-ve ose për zhvillimin e programeve të raketave me mbushje bërthamore. Doganat, forcimi i ligjit, veprimet e strukturave të zbulimit, shkëmbimi i informacionit janë në mënyrë të veçantë të rëndësishme në zbulimin dhe kundërpërgjigjen ndaj përhapjes së tyre.

⁵ En Margaret “Raport i OKB-s viti 2020”.

Disa nga hapat që duhen marrë janë:

1. Modernizimi i sistemit të sigurisë kolektive të Kartës së Kombeve të Bashkuara në termat e diplomacisë parandaluese dhe veprimeve detyruese.
2. Krijimi i një mjedisi në të cilin përdorimi i forcës, parashikuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, është i kufizuar në rrethanat e vetëmbrojtjes ose të masave detyruese të autorizuara nga Këshilli i Sigurimit.
3. Përpjekja e të gjitha shteteve për eliminimin e ASHM-ve.
4. Pjesëmarrja e të gjitha shteteve në procesin e çarmatimit të armëve bërthamore.
5. Demonstrimi dhe ndërtimi i mirëbesimit përmes procesit të përpjekjeve të përbashkëta për një botë të lirë nga ASHM.
6. Ndryshimi i doktrinave, politikave dhe institucioneve që mbështesin një botë të lirë nga ASHM.
7. Marrja e hapave konkretë për minimizimin e përvetësimit ose përdorimit të ASHM dhe përgatitja e doktrinave alternative për sigurinë.
8. Zhvillimi i një regjimi gjithëpërfshirës që të sigurojë që ASHM dhe komponentët e tyre nuk do të bien në dorë të terroristëve.

6. Përfundime

Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe mundësia e përdorimit të tyre nga grupet terroriste ndërkombëtare vërtet sot përbëjnë një rrezik të madh për sigurinë rajonale dhe globale⁶. Janë një sërë arsyesh të veçanta se përse terroristët mund të kërcënojnë ose përdorin këto armë:

Së pari, përdorimi i Armëve të Shkatërrimit në Masë (biologjike, kimike ose bërthamore), si instrumente të terrorizmit, mund të shkaktojë dëme të përmasave jashtëzakonisht të mëdha të paparashikuara në njerëz e pasuri.

Së dyti, mundësia e gjetjes dhe fabrikimit të lehtë nga ana e terroristëve.

Së treti, ekzistenca e një rrjeti ndërkombëtar që mbështet grupet dhe shtetet, çka e lehtëson shumë ndërmarrjen e veprimeve terroriste.

Lufta kundër këtij kërcënimi kërkon kundërpërgjigje të mirëkoordinuar dhe të integruar nga të gjitha shtetet dhe autoritetet ndërkombëtare, agjencitë ndërkombëtare siç janë: Kombet e Bashkuara, Organizata e Ndalimit të Armëve Kimike, Qendra e Kombeve të Bashkuara për ndalimin e krimeve dhe kontrollin e drogës. Gjithashtu, marrëveshjet e ndryshme rajonale janë elemente të rëndësishme në kontrollin dhe luftën ndaj përhapjes së armëve të shkatërrimit në armë.

⁶ Prof. Dr. Gjeneral (R) Ruzhdi Gjatoja, "Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare", V.I-rë.

Bibliografia:

- Henri Kissinger “Armët e Shkatërrimit në Masë dhe politika e jashtme”.
- George W Bush, në fjalimin e tij në Uashington për ndalimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, më 12 shkurt të vitit 2004.
- Jonathan Ban “Diplomacia e vaksinës”.
- Margaret En “Raport i OKB-s viti 2020”.
- Prof. Dr. Gjen. (R) Ruzhdi Gjatoja “Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare”, V. I-rë.

SFIDAT E “NATO 2030” QASJA DOKTRINARE NË TË ARDHMEN

Major Msc. Mirela Lahi
IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Dy dekadat e para të shekullit që kemi nisur kanë sjellë me vete një sërë ngjarjesh të veçanta e të rëndësishme, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në mjedisin e sigurisë. Shumëllojshmëria e spektrit të veprimit të tyre dhe befasia me të cilën kanë ndodhur këto ngjarje krijuan situata të paparashikueshme e të paprogramuara jo vetëm nga analistët dhe strategët ushtarakë, por dhe nga politikëbërësit dhe strukturat qeveritare, të cilat në disa raste vunë në situata të vështira shtete me ekonomi të zhvilluar dhe forca të armatosura me një teknologji të avancuar.

Lindja dhe aktivizimi me përmasa të jashtëzakonshme të grupeve terroriste, gjunjëzimi i shteteve dhe paralizimi ekonomik para një virusi, zhvillimi dhe përdorimi me përmasa shkatërruese të sulmeve kibernetike ndaj institucioneve të rëndësishme dhe jetësore për ekonominë dhe shëndetin e popullsisë, katastrofat e jashtëzakonshme dhe dëmet e mëdha të shkaktuara nga një mot i paqëndrueshëm si shkak i ngrohjes globale, si dhe situata e fundit në Afganistan ka nxjerrë në pah nevojën e përmirësimit të koncepteve mbi sigurinë, marrëdhëniet civilo-ushtarake, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së krizave pavarësisht natyrës së tyre, analizën e ngjarjeve të ndodhura, si dhe të mësimave të nxjerra prej tyre.

Forcat e Armatosura kanë qenë të përfshira direkt apo indirekt në përballimin ose zgjidhjen e këtyre krizave pavarësisht natyrës së tyre. Kjo e bën edhe më të domosdoshme nevojën për përshtatje të vazhdueshme të procedurave, manualeve, rregulloreve dhe materialeve doktrinare, duke i lidhur ngushtë ato me përgatitjen e strukturave dhe forcave, në përputhje me mësimet e nxjerra dhe ndryshimet që kërkojnë.

Si vend anëtar i NATO-s, Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura kanë përgjegjësinë e përfshirjes në planifikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e strategjisë dhe koncepteve doktrinare në përputhje me axhendën e iniciuar “NATO -2030”, duke iu nënshtruar një rishikimi total jo vetëm i dokumenteve kryesore që udhëheqin zhvillimin dhe përgatitjen e forcave, por një vend të veçantë duhet të zërë përfshirja e këtyre ndryshimeve në kurrikulat dhe programet mësimore në shkollat ushtarake dhe qendrat tona të kualifikimit të çdo niveli, me qëllim që përgatitja e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të jetë në pararojë të këtyre ndryshimeve.

Fjalë kyçe: Koncept, doktrinë, mjedis strategjik, siguri, arsimim ushtarak, program mësimor, AFA, NATO.

1. Axhenda “NATO 2030” dhe kërkesat për reflektim në konceptet doktrinare për të ardhmen

Në samitin e mbajtur më 14 qershor 2021, NATO shpalli axhendën e saj të zhvillimit “NATO-2030”. Në fjalën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, duke folur mbi konceptin e ri të zhvillimit, theksoi se: “NATO po vazhdon të përshtatet për të na mbajtur të sigurtë në këtë dekadë dhe më gjerë. Nisma e NATO-s 2030 ka të bëjë me sigurimin që Aleanca jonë të jetë gati sot për t'u përballur me sfidat e së nesërme.”¹

Samiti i Brukselit theksoi se nevoja për një ndryshim të konceptit të ri të NATO-s për të ardhmen ka ardhur pasi NATO përballlet sot me mjedisin më kompleks të sigurisë që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Sjellja e Rusisë mbetet e afirmuar dhe destabilizuese dhe terrorizmi vazhdon të përfaqësojë një sfidë globale të sigurisë dhe një kërcënim për stabilitetin. Në të njëjtën kohë, rritja e Kinës po zhvendos ekuilibrin global të pushtetit, me pasoja për sigurinë, vlerat dhe mënyrën e jetesës së Aleancës.

Pasiguria globale në rritje, kërcënimet më të sofistikuara në fushën kibernetike, risitë në inteligjencën artificiale, sistemet autonome të armëve, të dhënat e mëdha dhe bioteknologjia, format e reja e të paparashikuara luftarake të grupeve terroriste po ndryshojnë rregullat në luftë. Por jo vetëm këto, fushatat e dezinformimit, ndryshimet me pasoja shkatërruese të motit për shkak të ngrohjes globale, flukset e migrimit në shkallë të gjerë, prania me pasoja shkatërruese për ekonominë dhe jetën e qytetarëve e sëmundjeve të paparashikueshme si rasti i Covid-19 kanë shtuar spektrin e kërcënimeve dhe rreziqeve, të cilat duhet të jenë pjesë e analizës së vlerësimit dhe vendimmarrjes në përdorimin e forcave dhe mjeteve. Ato kanë tashmë një ndikim thelbësor jo vetëm mbi strategjinë dhe doktrinat e Aleancës, por dhe për çdo anëtar veçmas të saj pjesë e të cilës është edhe vendi dhe Forcat tona të Armatosura.

Samiti theksoi gjithashtu se: “Asnjë vend apo kontinent nuk mund t'i përballojë vetëm këto sfida. Në një botë më të paparashikueshme dhe më konkurruese, uniteti dhe solidariteti transatlantik janë jetike për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e aleatëve të NATO-s. Kjo është arsyeja se pse nisma e NATO-s 2030 për të vazhduar përshtatjen e Aleancës është në zemër të Samitit.”²

¹ Stoltenberg, NATO SAMIT, 14. 6. 2021

² Po aty.

Në thelb të filozofisë së saj, axhenda “NATO 2030” kërkon futjen e masave shtesë për të siguruar që NATO të mbetet më e fortë ushtarakisht, të bëhet edhe më e fortë politikisht dhe miraton një qasje më globale ndaj sigurisë. Kjo tregon se nevoja për një strategji dhe koncepte të reja doktrinare janë bërë evidente.

Misioni në Afganistan për NATO-n nxiti kohezionin politik, efektshmërinë organizative dhe ndërveprueshmërinë ushtarake. Në fushën e zbatimit praktik të koncepteve doktrinare, përfshirja e NATO-s në kuadër të një misioni ndërkombëtar demonstroi dhe nxiti zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve të saj mbështetëse në terren, ofroi trajnim dhe përvojë për ushtritë kombëtare pjesëmarrëse, nxiti ndërveprueshmërinë e tyre dhe shpuri në zhvillimin e disa funksioneve të NATO-s dhe standardeve të përbashkëta. Mësimet e nxjerra gjatë misionit dhe veçanërisht problematika që u shfaq në mbyllje me situatën emergjente në Afganistan kanë shtuar më tepër përgjegjësinë dhe interesin për strukturat politiko-ushtarake në NATO, që rishikimi i strategjisë dhe doktrineve të saj të bëhet pjesë e strategjisë dhe doktrineve në kuadër të axhendës “NATO 2030”.

Mësimet e nxjerra nga pjesëmarrja e forcave tona të armatosura në këtë mision përbën një përvojë të shkëlqyer, e cila duhet t’i shërbejë punës sonë të ardhme në përmirësimin e koncepteve se si duhet ta përgatisim, trajnojmë dhe menaxhojmë trupat për një pjesëmarrje në një angazhim në të ardhmen dhe se si duhet që këto mësimet të bëhen pjesë e diskutimeve dhe përmirësimeve në manualët, rregulloret dhe konceptet tona doktrinare në frymën e axhendës së re “NATO 2030”. Direktiva e Mbrojtjes 2021 përkon me këto zhvillime të reja e cila thekson se “... vazhdimi i punës për konsolidimin e këtij sistemi, zgjerimi i mëtejshëm i ratifikimit dhe përdorimit të standardeve në FA, si dhe harmonizimi me parimet doktrinare të NATO-s”³ është një nga objektivat kryesorë të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura.

Ajo që tërheq vëmendjen në nismën për axhendën “NATO 2030” është metoda gjithëpërfshirëse në përpilimin e saj. Gjatë vitit të kaluar, një grup ekspertësh të pavarur si edhe zëra nga shoqëria civile, rinia dhe sektori privat dhanë kontribute për të ndihmuar në formësimin e axhendës “NATO-2030”. Mbi këtë bazë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s paraqiti propozime konkrete që udhëheqësit e NATO-s t’i miratojnë në Samit. Këto propozime synojnë të përforcojnë unitetin e NATO-s, të zgjerojnë qëndrimin e Aleancës ndaj sigurisë dhe të mbrojnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla.

Metoda e gjithëpërfshirjes praktikuar nga NATO në përpilimin e nismës “NATO 2030” është një model dhe hap për t’u ndjekur edhe nga ne gjatë procedurave tona të rishikimit të dokumenteve kryesore doktrinare. Kjo tregon pjekurinë që NATO transmeton tek anëtarët e saj se problemet e sigurisë e të mbrojtjes nuk mund të jenë kurrë vetëm pronë e ushtarakëve, apo përgjegjësi e një sektori të caktuar dhe përgjegjësi që merret me çështje të sigurisë. Sot sfida e sigurisë nuk lidhet vetëm me një konflikt të armatosur pasi pasojat mbi sigurinë kanë treguar se kanë qenë të lidhura edhe me klimën, migrimin e popullsisë,

³ Direktiva e Mbrojtjes.

epidemitë etj., ku përballimi dhe zgjidhja e pasojave të tyre ka qenë gjithëpërfshirës me kontributet e strukturave shtetërore, strukturave ushtarake, shoqërisë civile, organizatave joqeveritare, individëve, organizatave ndërkombëtare, etj.

Bazuar mbi këtë analizë të re të sigurisë, axhenda “NATO 2030” synon të thellojë konsultimin politik brenda aleancës, të forcojë aftësitë penguese dhe mbrojtëse dhe të rritë elasticitetin në përgjigje të çdo krize, e cila do të shkojë paralel me investimet dhe zhvillimet në fushën e teknologjisë, trajnimin, masat për të luftuar ndryshimin e klimës dhe formulimin e Konceptit të ardhshëm Strategjik të Aleancës.

Axhenda “NATO 2030” kërkon të angazhojë aleatët të përmbushin udhëzimet nga NATO për vendosjen, qëndrueshmërinë dhe masat e rëna dakord, me qëllim që forcat e tyre të armatosura mund të operojnë së bashku efektivisht, duke përfshirë zbatimin e standardeve dhe doktrinëve të NATO-s. Kjo rrit me tepër përgjegjësinë tonë për të ndjekur me kujdes dhe implementuar në ndryshimet tona në dokumentet strategjike dhe doktrinare çdo rekomandim, propozim dhe ndryshim që vjen apo bëhet në kohë në strukturat dhe dokumentet doktrinare të saj. Kjo është përgjegjësi jo vetëm e Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak dhe sektorëve që merren me analizën dhe rekomandimet për ndryshime në manuale, rregullore dhe doktrina, por edhe e çdo komande, force dhe shkollave tona ushtarake ku janë përqendruar një resurs i mirë pedagogësh dhe specialistësh të aftë për të bërë rekomandimet e nevojshme për ndryshime. Institucionet arsimore veçanërisht duhet të jenë në pararojë të këtyre ndryshimeve duke i dhënë hapësirë transmetimit të informacioneve diskutimeve të gjera dhe debateve mbi nevojën e këtyre ndryshimeve.

Nevoja për një strategji të re në axhendën “NATO 2030” nuk do të ndryshojë aspak dy konceptet ushtarake që do të vazhdojnë të jenë në fokusin e lidërshit dhe zhvillimeve të reja për të ardhmen e NATO-s, “Koncepti për Pengimin dhe Mbrojtjen e Zonës Euroatlantike”, e cila përqendrohet në angazhimet dhe aftësitë për të penguar dhe mbrojtur sot, si dhe “Koncepti Capstone i Luftës i NATO-s”, i cili ofron një vizion për të udhëhequr zhvillimin e luftës afatgjatë të Aleancës për të mbetur ushtarakisht i fortë, sot dhe në të ardhmen. Axhenda “NATO 2030” ka hedhur idenë e një strategjie të re të saj për të ardhmen, e cila padyshim do të jetë udhërrëfyese për përgatitjen e koncepteve doktrinare, të cilat do të kenë ndikimin e tyre edhe mbi doktrinat ekzistuese në përdorim nga NATO dhe anëtarët e saj. Kjo na shton përgjegjësinë që rishikimi i materialeve tona doktrinare të shkojë paralel me kohën dhe në përputhje me konceptet e reja doktrinare që NATO do të përgatisë dhe përdore në të ardhmen.

Forcat tona të Armatosura kanë fituar tashmë një përvojë të mirë me pjesëmarrje në misione brenda dhe jashtë vendit, të cilat duhet të materializohen në një dokument të unifikuar si “Mësime të Nxjerra” që mund dhe duhet të shërbejnë gjatë rishikimit të materialeve tona doktrinare. Institucionet tona arsimore në FA duhet të tregojnë jo vetëm kujdes por dhe një përgjegjësi të veçantë në përthithjen e përfundimeve të “Mësimeve të Nxjerra”, pasi ato japin një panoramë realiste të asaj çfarë dhe si ka ndodhur, por dhe nxit mendimin dhe analizën se çfarë dhe si duhet ndryshuar në manuale, rregullore dhe doktrinat ushtarake.

Tani që NATO ka filluar një proces aktiv për rishikimin e strategjisë dhe materialeve të saj doktrinare, nën dritën e axhendës “NATO 2030” e bën edhe më imperative që ky proces të jetë po kaq aktiv edhe në institucionet tona arsimore në FA për të kontribuar në ndryshimet që kërkohen.

Pandemia COVID-19 demonstroi faktin se përgjigja e menjëhershme si një nga konceptet themelore të strategjisë mbrojtëse të NATO-s ishte funksionale. Epidemia COVID-19 nënvizon rëndësinë e elasticitetit, duke përfshirë aftësinë për të trajtuar viktimat në masë dhe sigurimin e vazhdimësisë së zinxhirëve të furnizimit civil. Forcat e armatosura aleate luajtën një rol jetik në mbështetjen e përgjigjeve civile kombëtare brenda Aleancës, duke ruajtur njëkohësisht gatishmërinë e tyre për t’iu përgjigjur çdo emergjence. Ato mbështesin përpjekjet civile me logjistikën dhe planifikimin, spitalet në terren dhe anijet spitalore, transportin për pacientët, riadhesimin e shtetasve jashtë vendit, dezinfektimin e zonave publike dhe në kalimet kufitare etj., një spektër i gjerë detyrash dhe përgjegjësish të marrë si përgjegjësi dhe të pa kryera më parë. Ky angazhim i gjerë përgjegjësish e bën edhe me të domosdoshëm rishikimin e manualeve, rregulloreve dhe koncepteve tona doktrinare në fokusin se si do të përgatisim stafin drejtues dhe shtabet dhe se si do të përgatisim dhe përdorim forcat në këto lloj situatash kaq të shumta dhe të veçanta për nga lloji. Strukturat tona arsimore, qendrat stërvitore dhe shtabet duhet të rishikojnë dhe përshtatin kurrikulat dhe programet mësimore, si dhe trajnimin e trupave në këtë frymë dhe koncepte të reja që kërkojnë ndryshim.

Axhenda “NATO 2030” nxjerr në pah se mësimet e nxjerra nga përvojat e aleatëve me pandeminë janë të rëndësishme për Aleancën që të vazhdojë të trajtojë veprimtaritë hibride si dhe sfidat e ardhshme që synojnë shoqëritë civile të aleatëve. Kjo është një përgjegjësi e drejtpërdrejtë edhe për forcat tona të armatosura për të përfshirë në diskutimet për rishikimin e koncepteve tona doktrinare këto përfundime të rëndësishme të aleancës.

Situata pandemike forcoi bindjen se prania dhe kontributi i Forcave të Armatosura në përbalimin e një situatë emergjente brenda një vendi ishte jo vetëm jetike, por dhe një përgjegjësi e së ardhmes së saj për t’u përgatitur për situata të tilla të ngjashme që lidhen me emergjencat civile dhe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pronës, jetës dhe shëndetit të njerëzve. Kjo rrit më tej përgjegjësinë që rishikimi dhe përpilimi i materialeve udhëzuese, përgatitore dhe drejtuese të Forcave të Armatosura për situata të tilla të jenë pjesë e axhendës sonë të ardhshme jo vetëm për misionet brenda vendit, por edhe në kuadër të misionëve të përbashkëta në përgjigje të marrëveshjeve që Shqipëria ka me vendet partnere. Situata e tërmetit në vitin 2019, angazhimi i përvitshëm për shuarjen e zjarreve ku së bashku me forcat tona të armatosura kontribuuan shumë nga vendet partnere me forca dhe mjete, e bëjnë edhe më të domosdoshme përgatitjen dhe vënien në përdorim të manualeve, rregulloreve dhe standardeve të përbashkëta në përgjigje të këtyre situatave. Axhenda “NATO 2030” e forcon edhe më tepër këtë përgjegjësi kur thekson se: “Kapaciteti i NATO-s për të penguar dhe mbrojtur bazohet nga një përzierje e përshtatshme e kapaciteteve luftarake të saj, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën dhe mbështetjen nga një sërë burimesh civile e ushtarake për

të mbështetur këto aftësi dhe qëndrim më gjerë” dhe se “NATO ruan gjithashtu lirinë e veprimit dhe fleksibilitetin për t’iu përgjigjur spektrit të plotë të sfidave me një metodë të përshtatshme dhe të përshtatur.”⁴

2. Doktrina si një nga shtyllat kryesore e arsimimit në shkollat tona ushtarake

Strategjia Ushtarake ka përcaktuar qartë se: “Roli parësor i Doktrinë Ushtarake është sigurimi i udhëzimeve për veprime të unifikuara të Forcave të Armatosura. Për këtë arsye, ajo është e lidhur ngushtësisht me Strategjinë Ushtarake. Në terma të përgjithshëm, Doktrina Ushtarake vendos lidhjet mes “qëllimit final” (çfarë duhet realizuar) dhe mënyrës së realizimit (kapaciteteve), duke dhënë rrugët për forcat e bashkuara se si të realizojnë strategjinë ushtarake dhe objektivat operative, në mbështetje të qëllimeve kombëtare dhe në kuadër të Aleancës. Si dokumenti kryesor në hierarkinë e materialeve doktrinare, Doktrina e Përbashkët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë synon zbatimin e koncepteve të Strategjisë Ushtarake në veprimtarinë e FA-ve, gjatë përgatitjes dhe zhvillimit të operacioneve.”⁵

Reformimi dhe modernizimi i FA, veçanërisht i trupës së oficerëve, kërkon zhvillimin dhe konsolidimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor ushtarak, i cili duhet të zhvillohet për t’iu përgjigjur realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë, ndryshimeve që ndodhin në fushën e zbatimit të koncepteve dhe përdorimit të forcave, si dhe nevojave që vijnë për përmirësimin e koncepteve, manualeve, rregulloreve dhe doktrinare. Fillimi i nismës nga aleanca për një strategji të re zhvillimi nëpërmjet nismës “NATO 2030”, “është një udhëzues dhe mundësi për të filluar edhe në Forcat tona të Armatosura një aksion përmirësues dhe përshtatës në frymën e kësaj axhende të NATO-s, por dhe të rishikimit dhe përgatitjes së strategjisë dhe materialeve tona doktrinare në përshtatje me frymën kombëtare, me sfidat dhe përgjegjësisë që FA kanë në përmbushje të detyrimeve kushtetuese.

Për këtë arsye, studimi i mësimave të nxjerra, eksperimentimi dhe zhvillimi i koncepteve të reja doktrinare ka qenë dhe mbetet një përparësi veçanërisht e Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak dhe e sistemit tonë arsimor ushtarak, të cilët nëpërmjet publikimeve i bëjnë ato pjesë të literaturës për studim dhe përdorim në Forcat e Armatosura. “Taktikat, teknikat dhe procedurat që mbështetësin zhvillimin doktrinar, publikohen në formën e manualeve dhe rregulloreve, të cilat së bashku përcaktojnë edhe bazën e hartimit të materialeve mësimore dhe stërvitore. Publikimet mësimore dhe stërvitore përshkruajnë taktikat, teknikat dhe procedurat e përdorura nga Forcat e Armatosura (komponentët përbërës) për t’u stërvitur në bazë të parimeve themelore doktrinare.”⁶

Doktrinat, manualët apo rregulloret janë udhëzues unifikues dhe sigurojnë një kornizë të përbashkët referimi në të gjithë ushtrinë. Nëpërmjet tyre synohet zhvillimi, shpërndarja

⁴ Stoltenberg, NATO SAMIT, 14. 6. 2021.

⁵ Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, botim i vitit 2015.

⁶ Rregullore e Procedurave të Publikimeve Doktrinare, botuar në vitin 2021.

dhe rivlerësimi në mënyrë periodike i teknikave, taktikave dhe procedurave për luftim dhe mbështetjen e shërbimeve të luftimit në të gjithë FARSH. Direktiva e Mbrojtjes 2021 përcakton qartë se "... vazhdimi i punës për konsolidimin e këtij sistemi, zgjerimi i mëtejshëm i ratifikimit dhe përdorimit të standardeve në FA, si dhe harmonizimi me parimet doktrinare të NATO-s"⁷ është një nga objektivat kryesorë të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura.

Doktrina i siguron ushtrisë një paketë parimesh se si forcat ushtarake kryejnë operacione dhe siguron një leksik të përbashkët për përdorim nga planifikuesit ushtarakë dhe drejtuesit e çdo niveli. Doktrina ndihmon standardizimin e operacioneve dhe lehtësimin e gatishmërisë duke vendosur mënyra të përbashkëta të përmbushjes së detyrave ushtarake. Ajo lidh teorinë, historinë, eksperimentimin dhe praktikën.

Megjithëse është pranuar se doktrina është një paketë procedurash standarde në aplikimin e pajisjeve, armëve dhe forcave, vetë ajo nuk pranon autoritetin e saj si rregulla te pandryshueshme, përkundrazi objektivi i saj është nxitja e iniciativës dhe të menduarit krijues. Është përgjegjësia e drejtuesve në sistemin tonë të arsimit ushtarak dhe trupës mësimdhënëse që në procesin e përgatitjes së programeve mësimore dhe të mësimdhënies të krijojnë hapësirat e nevojshme që studentët të gjejnë mundësinë dhe të angazhohen duke i dhënë hapësirë diskutimit të hapur dhe vendimmarrjes larg shablloneve dhe kornizave strikte të rregullave të shkruara.

Para zhvillimit të botimeve të veçanta doktrinare, shumë kombe e shprehën filozofinë e tyre ushtarake nëpërmjet rregullave, por historia ushtarake na ka treguar se gjithnjë ka pasur krijimtari, të cilat pavarësisht rregullave dhe procedurave të miratuara doktrinare të mësuara ne shkolla, vendimet e komandantëve dhe shtabeve kanë qenë në përputhje me situatën, vendin dhe forcat ku është zhvilluar një betejë apo operacion. "Doktrina është një udhëzues për këdo që dëshiron për të mësuar për luftën nga librat Doktrina ka për qëllim të edukojë mendjet e komandantëve të ardhshëm jo t'i shoqërojnë në fushat e betejës", thekson Clausewitz, një ndër teoricienët më në zë ushtarak, në librin e tij "Mbi Luftën".⁸

Sot, koncepti mbi doktrinën ushtarake ka përkufizime të sakta dhe të qarta në raport me strategjinë. Doktrina nuk është strategji. Përcaktimi i strategjisë së NATO-s është "Paraqitje e mënyrës se si duhet zhvilluar dhe zbatuar fuqia ushtarake për të arritur objektivat kombëtarë apo ato të një grupi vendesh".

Doktrina nga ana tjetër kërkon të sigurojë një kuadër të përbashkët konceptual për një shërbim ushtarak: mbi vetë-shërbimin ("Kush jemi ne?"); cili është misioni i tij ("Çfarë bëjmë?"); si do të kryhet misioni ("Si ta bëjmë këtë?") dhe si është kryer misioni në histori ("Si e bëmë këtë në të kaluarën?"). Kjo tregon se doktrina ka karakter praktik dhe analitik mbi veten, misionin e marrë, mënyrën që duhet ndjekur për zbatim dhe mësimet e nxjerra nga e kaluara. Shkollat ushtarake si institucionet bazë të arsimit dhe kualifikimit të

⁷ Direktiva e Mbrojtjes.

⁸ Clausewitz, "Mbi Luftën".

trupës së oficerëve kanë përgjegjësinë kryesore jo vetëm në transmetimin dhe përvetësimin e materialeve doktrinare nga pjesëmarrësit në kurset që zhvillohen, por dhe në krijimin e hapësirave për rritjen e fantazisë dhe debatit, si dhe mësimet të nxjerra nga veprimtaritë luftarake të zhvilluara me parë.

Doktrina pasqyron jo vetëm gjykimet e ushtarakëve profesionistë, por në një masë më të vogël por të rëndësishme edhe për udhëheqësit civilë, rreth asaj që është dhe nuk është ushtarakisht e mundur dhe e nevojshme. Parë në këtë këndvështrim gjithëpërfshirës ku marrëdhëniet civilo-ushtarake janë bërë tepër të nevojshme në zgjidhjen e problemeve para, gjatë dhe pas luftës, studimi dhe përvetësimi i kërkesave doktrinare në shkollat tona ushtarake është jo vetëm një detyrë, por dhe domosdoshmëri jetike në përgatitjen e një trupe autoritare planifikuesish dhe drejtuesish ushtarake jo vetëm në planin e interesave për nevojat e kontingjenteve për forcat tona të armatosura, por dhe të përgatitjes së tyre në kuadër të njohjes së koncepteve doktrinare të aleancës dhe aftësive ndërvepruese në kuadër të pjesëmarrjes në shtabe ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, përgjegjësia e shkollave ushtarake në ndërtimin dhe përmirësimin e kurrikulave dhe programeve mësimore është e drejtpërdrejtë. Pjesëmarrja e trupave tona në disa lloj operacionesh në kuadër të NATO-s, BE-së, OKB-së ka vërtetuar këtë domosdoshmëri dhe tashmë përfshirja në kurrikulat dhe programet mësimore të shkollave tona ushtarake të koncepteve doktrinare që lidhen me këto lloje operacionesh nuk ka më diskutim, ato janë dhe duhen bërë të domosdoshme në formimin e përgjithshëm të një trupe oficerësh që duhet për të tashmen dhe të ardhmen e Forcave tona të Armatosura.

E vërteta për këtë duhet të na bindë pasi në hierarkinë e literaturës së çdo ushtrie moderne, doktrina ushtarake renditet në top-listën e materialeve dhe literaturës që shërben për ngritjen teorike dhe thellimin e aftësive planifikuese dhe drejtuese për trupën e oficerëve në të gjitha nivelet.

Teorikisht, strategjia e madhe e një kombi përcakton termat e referencës për strategjinë e tij ushtarake, e cila nga ana e vet dikton karakterin e doktrinae të tij ushtarake. Kjo lidhje organike midis strategjisë së sigurisë kombëtare, strategjisë ushtarake dhe doktrinae pavarësisht fushës që ajo mbulon është e rëndësishme, pasi “konceptet doktrinare përshkruajnë bazat e parimeve themelore që udhëheqin Forcat e Armatosura ose komponentët e saj për arritjen e objektivave kombëtarë, së bashku me taktikat, teknikat, procedurat dhe metodologjinë e zbatimit të këtyre parimeve doktrinare.”⁹ Kjo e bën të domosdoshme që doktrina ushtarake të jetë boshti i përhershëm i studimit dhe aftësimit të oficerëve në çdo nivel kursi dhe arsimimi në shkollat tona ushtarake dhe si e tillë, ajo duhet të zërë një pjesë të rëndësishme në kurrikulat dhe programet mësimore të tyre. Kjo përgjegjësi është e pasqyruar qartë në Doktrinën e Përbashkët të FARSH, ku thuhet “Reflektimi i koncepteve dhe publikimeve doktrinare në programet mësimore të AFA, nga ku mund të gjykohej, se çfarë shkon dhe çfarë nuk shkon mirë. Në këtë këndvështrim,

⁹ Rregullore e Procedurave të Publikimeve Doktrinare, botim i vitit 2021.

raporti i doktrinës me Mësimet e Nxjerra siguron që doktrina të jetë e përshtatshme, aktuale dhe gjithëpërfshirëse”.¹⁰

Tashmë jemi dëshmitarë të një realiteti tjetër në fushën e studimit dhe analizës mbi doktrinën ushtarake që përdoret. Historia e luftërave dhe angazhimeve ushtarake jo vetëm të fuqive të mëdha, por dhe angazhimit të një organizate ushtarake të madhe si NATO, ka treguar se ka ndryshuar ndjeshëm mendimi mbizotërues që për zgjidhjen e një konflikti, forcat e armatosura dhe trupat e tyre të oficerëve të përgatiten duke u mbështetur vetëm në një doktrinë ushtarake të karakterit klasik.

Lufta asimetrike apo e ashtuquajtur hibride e cila ka mbizotëruar në konfliktet e dekadave të fundit, përdorimi para luftës dhe gjatë saj i një teknologjie tepër të përparuar të përfaqësuar nga sulmet elektronike nëpërmjet hakerëve në shkatërrimin e instrumenteve ushtarake, por dhe civile, ka nxjerrë nevojën e lindjes dhe përdorimit të doktrinave të reja të cilat duhet t’i përgjigjen formave të reja të luftimit. Është kjo arsyeja që shkollat tona ushtarake, qendrat e studimit dhe analizës përfaqësuar me rekomandimet e tyre të quajtura “lesson learned” të jenë në pararojë dhe të bëjnë pjesë integrale të botimeve të reja dhe në fushën e mësimdhënies ndryshimet e reja që ndodhin në doktrinat ushtarake duke i bërë pjesë ato edhe në praktikën e përgatitjes së shtabeve dhe stërvitjes së forcave pavarësisht llojit të tyre.

Për sa folëm më sipër, lind natyrshëm pyetja nëse duhen ndryshuar dhe përmirësuar doktrinat ushtarake që kemi dhe a duhet përmirësimi i tyre të shkojë paralel me krijimin e doktrinave të reja apo përmirësimin në përshtatje me format e reja të luftës që tashmë janë bërë një e vërtetë e pranueshme? Përgjigja është absolutisht Po, pasi:

Forcat e Armatosura duhet të lëvizin me kohën. Doktrinat ushtarake duhet t’i përgjigjen ndryshimeve të zhvillimeve teknologjike dhe krijimit të armëve të reja, duhet t’i përshtaten formave të reja të luftimit që konfliktet nxjerrin në pah, pasi mjedisi ku zhvillohen operacionet është gjithnjë më e pasigurt, kompleks dhe i shpërndarë.

Lufta asimetrike po bëhet tashmë një komponent tepër sfidues i një fushate, beteje apo luftimi të veçantë, kjo ka bërë që jo vetëm ushtarakët që drejojnë operacionet, por dhe udhëheqja civile kurrë nuk ka qenë kaq sfiduese. Afganistani tashmë tregoi shumë në këtë drejtim.

Është kjo arsyeja që tregon se edhe doktrinat ushtarake nuk janë dhënë njëherë e përgjithmonë, ato duhet të përmbushin këtë sfidë në luftë dhe në paqe, me nevojën tonë të përhershme për t’i përshtatur ato sa të jetë e mundur me sfidën që kërkohet.

Në këtë drejtim, ndryshimi dhe përmirësimi i doktrinave është dhe duhet të jetë jo vetëm një kërkesë e një sektori të veçantë, i cili merret dhe studion nevojat e përmirësimit të doktrinave, por ajo duhet të jetë përgjegjësia kryesore e çdo komande e shtabi, të cilat në fushën e studimit dhe kërkimeve “lesson learned” duhet të kontribuojnë në këto ndryshime që kërkohen. Shkollat ushtarake në bashkëpunim me sektorët që merren me studimin dhe

¹⁰ Doktrina e Përbashkët e Forcave të Armatosura (DP-01, edicioni i dytë), viti 2017, faqe 1-6.

përmirësimin e doktrineve ushtarake kanë rol prioritar në këto ndryshime dhe përmirësime. Ato kanë kapacitete studimi dhe kërkimi, të cilët mund dhe duhet të udhëheqin ndryshimet dhe përmirësimet që kërkohen.

Kurset dhe studimet në shkollat ushtarake kanë për mision dhe detyrë jo vetëm të njohin dhe përgatisin një trupë drejtuesish për të ardhmen të cilët duhet të kenë njohuri të thella doktrinare mbi mënyrën e planifikimit dhe përdorimit të forcave në një operacion, por duhet të jenë pararoja e transmetimit të studentët e çdo ndryshimi që ndodh në përdorimin e teknologjisë, armëve të reja dhe të çdo ndryshimi që shfaqet në përdorimin e forcave në luftë dhe që lidhet me doktrinat ushtarake.

Doktrina siguron themelin, gjuhën profesionale që ne të gjithë duhet të përdorim për të përmbushur misionin tonë. “Doktrina i siguron një organizmi ushtarak filozofi të përbashkët, gjuhë të përbashkët, qëllim të përbashkët dhe bashkim përpjekjesh”¹¹. Sa më e madhe të jetë cilësia e përvetësimit dhe zbatimit në praktikë të këtyre shtyllave kryesore të kërkesave doktrinare, aq më të mëdha janë mundësitë për bashkëpunim të frytshëm, mirëkuptim të ndërsjellë dhe në fund të fundit, për sukses.

Bibliografia

- Komunikata e Samitit të NATO-s në Bruksel, viti 2021.
- Meeting of NATO Ministers of Foreign Affairs and Defence - 1 June 2021.
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH, miratuar në vitin 2014.
- Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, botim i vitit 2015.
- Ligji nr. 121/2015, datë 12.11.2015 “Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2025”.
- VKM nr. 269, datë 03.04.2013 “Për miratimin e Dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes”.
- Doktrina e Përbashkët e Forcave të Armatosura të RSh (DP-01, botimi i dytë), 2017.
- AJP-01 “Allied Joint Doctrine”, February 2017.
- Doctrine for the Armed Forces of the United States, July 2017.
- Clausewitz, On War, Book 8, Chapter VIII/B “War is an Instrument of Policy”, 2018.

¹¹ General George H. Decker, US Army Chief of Staff, 1960-1962, Doctrine for the Armed Forces of the United States, 12 July 2017.

RUBRIKA E DYTË

PUNIME NGA KONFERENCA PËR ARSIMIN USHTARAK

Në kuadër të globalizmit dhe zhvillimeve të vullshme gjeopolitike dhe teknologjike, me synim përgatitjen sa më cilësore të profesionistëve të së ardhmes, forcimin e cilësisë akademike, përdorimin e teknologjive të reja, në funksion të mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, Akademia e Forcave të Armatosura dhe Universiteti “Barleti” organizuan konferencën shkencore me temë “Bashkërendimi civil-ushtarak në fushën akademike, sfidë e shekullit të 21-të”.

Konferenca trajtoi çështje të reformës kurrikulare, sfidat e epokës digjitale, kërkimin shkencor dhe inovacionin, si dhe çështje të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë për dhënie të diplomave të përbashkëta.

Një prezantim dinjitoz në këtë konferencë bëri Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU) me trajtimin me kompetencë shkencore të kumtesave që lidhen me trajtimin “kërkimi shkencor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes”, “doktrina si pjesë themelore e kurrikulës arsimore ushtarake”, “arsimi dhe kultura si investimi më i mirë në siguri dhe mbrojtje” dhe “zhvillimi i profesionit ushtarak dhe sfidat bashkëkohore”.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUSHËN E SIGURISË E TË MBROJTJES

Gjeneral Brigade (R) Dr. Bardhyl Hoxha
Koordinator i Sigurisë së ARB Security Group TAP
Kolonel Dr. Ahmet Leka
IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Kërkimi shkencor është një mjet shumë i rëndësishëm për të lundruar me sukses në botën tonë komplekse, pa të cilin do të detyrohemi të mbështetemi vetëm tek intuïta, disa referenca të kufizuara dhe te verbëria e fatit. Ndërsa shumë prej nesh ndjehen të sigurtë në kapacitetet për të kuptuar dhe bashkëvepruar me botën rreth nesh, historia është e mbushur me shembuj se sa keq mund të ndjehemi kur nuk njohim nevojën e gjetjeve dhe provave për mbështetjen e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore, gjatë hulumtimeve në çdo lloj fushe, veçanërisht në atë të sigurisë dhe mbrojtjes.

Fusha e sigurisë dhe e mbrojtjes është shumë e gjerë dhe specifike, ku veçanërisht siguria shfaqet shumëdimensionale, duke përfshirë sigurinë ushtarake, ekonomike, njerëzore, shëndetësore, energjetike, mjedisore, ushqimore, kufitare dhe kibernetike. Mjedisi i sigurisë vazhdon të jetë i paparashikueshëm dhe rreziqet e kërcënimit e sotme vazhdojnë të evoluojnë gjithnjë e më shumë drejt natyrës asimetrike, hibride dhe kibernetike. Dhjetë vitet e ardhshme do të jenë shumë ndryshe nga dekadat e mëparshme, ku fuqitë e mëdha konkurruese kanë në rendin e ditës zgjerimin e fuqisë dhe ndikimin e tyre edhe në Ballkanin Perëndimor, përfshirë vendin tonë. Ndërkohë, krahas rreziqeve dhe kërcënimeve të njohura, po shfaqen edhe rreziqe të reja nga pandemitë dhe ndryshimi i klimës. Ky kompleksitet dhe kjo paparashikueshmëri e mjedisit të sigurisë shtrojnë nevojën e kërkimit shkencor, me synim identifikimin, analizën, vlerësimin dhe përcaktimin e qasjeve për përballimin e tyre.

Në ditët e sotme, më shumë se kurrë më parë, është në qarkullim një sasi shumë e madhe informacioni dhe me një kërkim të thjeshtë në internet për çdo temë të dhënë kërkimore, mund të rezultojë një numër i konsiderueshëm studimesh kontradiktore. Prandaj, për të pasur parashikime të besueshme, duhet të zbatohen metoda shkencore dhe logjike. Kërkuesit shkencorë mund të përdorin disa metoda shkencore për parashikimin e së ardhmes, ku aplikimi i metodës më të përshtatshme do të varet nga shumë faktorë, siç janë: fusha specifike e interesit, këndvështrimi dhe synimi i parashikimit, periudha kohore, të dhënat e disponueshme, njohuritë dhe përvoja, etj. Meqë nuk ekziston asnjë metodë shkencore universale për parashikimet në fushën e sigurisë, në këtë artikull do të trajtojmë kryesisht metodat cilësore dhe sasiore të parashikimit, si dhe do të argumentojmë se qasja më e mirë është kombinimi i disa metodave shkencore, me qëllim mbështetjen më të mirë të kërkimeve shkencore dhe kuptimin si duhet të kompleksitetit të sigurisë në shekullin e 21-të.

Pasiguritë e së ardhmes kërkojnë që të përshtatemi, çka duhet të aplikohet edhe në Akademinë tonë. Arsimi universitar ushtarak, veçanërisht programet master dhe doktoratë, nuk mund të konceptohen pa kërkime shkencore aktive. Po ashtu, duhet të inkurajohet futja e disiplinave të reja shkencore dhe rritja e kapaciteteve kërkimore për të përgatitur shkencëtarë të rinj. Ne duhet të bëjmë përpjekje të rëndësishme për të ndryshuar qasjen në sistemin e sigurisë e të mbrojtjes, duke rritur më shumë interesin për kërkime shkencore në institucionet tona, me qëllim krijimin e kushteve për brezin modern, të njohurive moderne. Ndërkohë, një qasje gjithëpërfshirëse do të mundësonte krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme midis kërkuesve dhe analistëve, institucioneve dhe organizmave të ndryshëm të sigurisë në vendin tonë, përfshirë botën akademike, me qëllim bashkimin e përpjekjeve në adresimin e spektrit të gjerë të rreziqeve të sotme dhe hartimin e strategjive efektive për përballimin e tyre në të ardhmen.

Fjalët kyçe: kërkim shkencor, mjedisi i sigurisë, shkencë ushtarake, strategji, metodologji, akademi, Ballkan Perëndimor

Hyrje

Mjedisi i sigurisë përballet me një sërë kërcënimesh, të cilat papritur mund të kthehen në rreziqe reale ndaj sigurisë së brendshme dhe të jashtme të vendit tonë. Ato mund të shfaqen në forma të ndryshme, por me gjasa më të mëdha mund të jenë një kombinim i formave konvencionale dhe jokonvencionale. “Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë”, duke evidentuar nevojën e studimit të këtyre dukurive, nënvizon: “Identifikimi, njohja dhe vlerësimi i këtyre kërcënimeve dhe marrja e masave për përballimin e tyre do të ndikojë pozitivisht në menaxhimin e situatës së sigurisë në vendin tonë”¹.

Qëllimi i kërkimit shkencor në fushën e sigurisë e të mbrojtjes është përcaktimi i parashikimeve në formën e vizioneve dhe skenarëve të zhvillimeve të mundshme të së ardhmes, si dhe sfidave për përballimin e tyre. Në këtë kontekst, kërkuesit shkencorë duhet të ndërtojnë bazën e provave kërkimore dhe të parashikojnë e argumentojnë kurset e mundshme të veprimit që mund të ndodhin në mjedisin e sigurisë. Ata duhet të adresojnë fillimisht pyetjen “Çfarë nëse...?” (“What if ...Scenarios”), që është bazë për hartimin e skenarëve dhe më tej, të kërkojnë përgjigjet e pyetjes tjetër “Çfarë duhet bërë nëse mund të ndodhë...?” (“What must be done if it could happen”).

Fusha e sigurisë dhe e mbrojtjes është shumë e gjerë dhe shumëdimensionale, ku përfshihen siguria ushtarake, ekonomike, njerëzore, shëndetësore, energjetike, mjedisore, ushqimore, kufitare dhe kibernetike, të cilat janë ndikuar në mënyrë të përhershme nga paparashikueshmëria e mjedisit të sigurisë dhe evoluimi gjithnjë e më shumë i rreziqeve e kërcënimeve të ditëve të sotme.

Objektivi i kërkimit shkencor është rritja e njohurive dhe kuptueshmërisë së realitetit të mjedisit të sigurisë dhe dukurive ushtarake, i cili fillon me parashtrimin e një apo disa pyetjeve kërkimore mbi çështjen që na shqetëson apo dukurinë që na intereson. Meqë nuk ekziston asnjë metodë shkencore universale për kërkimin shkencor në fushën ushtarake, më poshtë do të shtjellojmë metodologjinë e kërkimit shkencor dhe do të argumentojmë se qasja më e mirë është kombinimi i disa metodave shkencore, me qëllim mbështetjen më të mirë të kërkimeve shkencore dhe kuptimin si duhet i kompleksitetit të sigurisë në shekullin e 21-të.

¹ VKM nr. 628, datë 25.09.2019 “Për miratimin e dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”, faqe 4.

Pasiguritë e së ardhmes kërkojnë që të përshtatemi, çka duhet të aplikohet edhe në sistemin e arsimit universitar ushtarak, veçanërisht në programet master dhe doktoratë, të cilat nuk mund të konceptohen pa kërkime dhe punë aktive shkencore. Po ashtu, duhet të inkurajohet futja e disiplinave të reja shkencore dhe rritja e kapaciteteve kërkimore për të përgatitur shkencëtarë të rinj.

Në këtë artikull do të evidentojmë edhe nevojën për përpjekje të rëndësishme për të ndryshuar qasjen në sistemin e sigurisë e të mbrojtjes, duke rritur më shumë interesin për kërkime shkencore në institucionet tona, me qëllim krijimin e kushteve për brezin modern, të njohurive moderne.

1. Shkenca Ushtarake dhe Kërkimi Shkencor

Në historinë ushtarake, termi “Shkencë Ushtarake” është përdorur gjatë periudhës së Revolucionit Industrial si një term i përgjithshëm për t’iu referuar të gjitha çështjeve të teorisë ushtarake dhe aplikimit të teknologjisë si një disiplinë e vetme, përfshirë atë të dislokimit dhe angazhimit të trupave në kohë paqeje ose lufte.

Shkenca Ushtarake, në përgjithësi, përshkruan teoritë, konceptet dhe metodat për angazhimin e forcave të armatosura dhe rrënjët historike të saj janë pasqyruar më së miri në librin “Për Luftën”², ku autori Carl Von Clausewitz bëri zbulimin se “... lufta është një instrument i veprimit politik, jo vetëm i veprimit të dhunshëm”. Por pavarësisht këtij zbulimi të Clausewitz, termi “Shkencë Ushtarake” nuk ka ende një përcaktim të qartë si një disiplinë akademike, duke u paraqitur si një mozaik kurrikulash ku përfshihen historia, çështjet e jashtme, studimet e sigurisë, udhëheqja, menaxhimi i operacioneve, sistemet inxhinierike, si dhe elemente të tjera të shkencave ekzakte dhe shoqërore. Madje dhe “... fjalori i Departamentit të Mbrojtjes nuk ka një përkufizim për shkencën ushtarake”³. Ky kategorizim i paqartë i shkencës ushtarake është disi reflektues i statusit të zvogëluar të këtij termi, që nga përdorimi i tij në shekullin e 19-të kur Shkenca Ushtarake u kapitalizua dhe pati një vendosje të mirë përkrah fizikës, filozofisë dhe disiplinave të tjera akademike.

Gjithsesi, nga studimi i shumë fjalorëve dhe autorëve të ndryshëm, në lidhje me përkufizimin që i bëjnë shkencës ushtarake, do të pranojmë ose do t’i referohemi njërit prej tyre: “Shkenca ushtarake merret me studimin e historisë ushtarake, institucioneve ushtarake, praktikave dhe teknologjive. Ajo gjithashtu përfshin shkencat politike, çështjet ndërkombëtare dhe vlerësimin psikologjik”⁴. Po ashtu, një përkufizim tjetër interesant është dhe “Shkenca ushtarake studion teoritë, taktikat dhe strategjitë ushtarake të përdorura në luftë, mbrojtje dhe diplomaci”⁵.

² Carl Von Clausewitz: “On War”, Edited and Translated by Michael Howard and Peter Paret, Princeton University Press Princeton, New Jersey, shih: <https://press.princeton.edu/books/paperback/9780691018546/on-war>, hyrë më 07.09.2021.

³ https://ndupress.ndu.edu/Portals/68/Documents/jfq/jfq-75/jfq-75_84-90_Voelz.pdf, hyrë më 06.09.2021.

⁴ <https://thebestschools.org/degrees/military-science-degree>, hyrë më 06.09.2021

⁵ Po aty.

Pra, në mënyrë të përmbledhur, Shkenca Ushtarake ka si objekt studimi proceset, institucionet dhe sjelljen ushtarake, së bashku me teorinë e luftës dhe zbatimin e forcës së organizuar shtrënguese. Në mënyrë specifike, shkenca ushtarake përqendrohet kryesisht në teorinë, metodën dhe praktikën e krijimit të kapaciteteve ushtarake që të jenë në përputhje me kërkesat e politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare.

Shkenca ushtarake është një fushë ndërdisiplinore, që studion teorinë, taktikat dhe strategjitë ushtarake që përdoren në luftë, mbrojtje dhe diplomaci, përfshirë risitë, aplikimet dhe ndikimin në to të teknologjive moderne ushtarake. Ajo shërben për të identifikuar elementet strategjike, politike, ekonomike, psikologjike, sociale, operacionale, teknologjike dhe taktike, të nevojshme për të siguruar përparësinë relative të forcës ushtarake, si dhe për të rritur gjasat dhe rezultatet e favorshme të fitores në kohë paqe ose gjatë një lufte. Shkencëtarët ushtarakë përfshijnë teoricienë, studiues, shkencëtarë eksperimentalë, shkencëtarë të aplikuar, projektues, inxhinierë, specialistë testimi dhe personel tjetër ushtarak.

Studimet ushtarake/mbrojtëse njihen me emra të ndryshëm⁶ si: studime të mbrojtjes, shkenca ushtarake, studime të luftës, studime të sigurisë kombëtare, studime strategjike etj., ku në fakt secila prej tyre ka specifikat e veta. Për shembull, qasja në studimin e sigurisë kombëtare është ndërdisiplinore dhe si e tillë, përfshin aspekte si: gjeopolitika dhe gjeografia ushtarake, shkenca dhe teknologjia, ekonomia e mbrojtjes, menaxhimi i konflikteve dhe zgjidhja e konflikteve, etj. Studimet ushtarake në tërësi i ekspozojnë kërkuesit shkencorë në një analizë të thelluar të ngjarjeve dhe çështjeve bashkëkohore në këtë botë shumëpolare, shumëdimensionale dhe të paparashikueshme.

Kërkimi shkencor, në një formë më gjithëpërfshirëse, përkufizohet si “...një proces i qëllimshëm, sistematik dhe shkencor i mbledhjes, analizimit, klasifikimit, organizimit, paraqitjes dhe interpretimit të të dhënave për zgjidhjen e problemit, për parashikimin apo zbulimin e së vërtetës, ose për zgjerimin apo verifikimin e njohurive ekzistuese, të gjitha këto për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës njerëzore”⁷. Pra, në kuptimin e përgjithshëm, kërkimi shkencor përcaktohet si ...studim sistematik i të panjohurës specifike ekzistuese në raport me të njohurën, me qëllim gjetjen e zgjidhjes së saj. Ndërsa në kuptimin më specifik, studiues dhe autorë të ndryshëm kanë formuluar disa përkufizime të kërkimit shkencor, si më poshtë⁸:

Sipas Fjalorit Longman të Anglishtes bashkëkohore (1997), kërkimi shkencor është hulumtimi për një studim serioz të një lënde që synon të zbulojë fakte të reja ose të testojë ide.

⁶<https://www.careerindia.com/courses/unique-courses/what-is-military-defence-studies-scope-career-opportunities-011840.html?story=3> , hyrë më 06.09.2021

⁷ https://www.google.com/search?q=Research+is+uncomplicatedly+defined+as+the+systematic+search+of+the+specific+unknown+existing+between+the+known+to+find+out+its+solution.&rlz=1C1EJFC_enAL941AL941&oq=Research++is+uncomplicatedly+defined+as+the+systematic+search+of+the+specific+unknown+existing+between+the+known+to+find+out+its+solution.&aqs=chrome..69i57j2980j0j7&sourceid=chrome&ie=UTF-8 , hyrë më 07.09.2021

⁸ Po aty: <http://learningtz.blogspot.com/2017/03/meaning-of-research-according-to.html> , hyrë më 02.09.2021

Sipas Fjalorit Webster, kërkimi shkencor është një hetim ose ekzaminim studimor, veçanërisht hetim ose eksperimentim që synon zbulimin dhe interpretimin e fakteve, rishikimin e teorive ose ligjit të pranuar në dritën e fakteve të reja ose zbatimin praktik të teorive ose ligjit të tillë të ri ose të rishikuar.

Sipas Waltz dhe Bansell (1981), kërkimi shkencor është një proces sistematik, formal, rigoroz dhe i saktë hulumtimi, i përdorur për të marrë zgjidhje për problemet ose për të zbuluar dhe interpretuar fakte dhe marrëdhënie të reja.

Sipas Kothari (2006), kërkimi shkencor është ndjekja e besimit me ndihmën e studimit, vëzhgimit, krahasimit dhe eksperimentit, si dhe kërkimi i njohurive përmes metodës objektive dhe sistematike të gjetjes së zgjidhjeve për një problem.

Sipas Payton (1979), kërkimi shkencor është procesi i kërkimit, përmes hulumtimit, të një pyetjeje specifike në një mënyrë të organizuar, objektive dhe të besueshme.

Sipas Kerlinger (1873), kërkimi shkencor është një hetim sistematik i kontrolluar, empirik dhe kritik i propozimeve hipotetike, në lidhje me marrëdhëniet e supozuara midis fenomeneve natyrore.

Kërkimi shkencor është një mjet kritik për të lundruar me sukses në botën tonë komplekse. Pa kërkimin shkencor, do të jemi të detyruar të mbështetemi vetëm tek intuita, autoriteti dhe opinionet e njerëzve të tjerë dhe te fati i verbër. Ndërsa shumë prej nesh ndihen të sigurt në aftësitë tona për të kuptuar dhe bashkëvepruar me botën përreth nesh, historia është e mbushur me shembuj se sa shumë të gabuar mund të jemi, kur nuk arrijmë të njohim nevojën për prova dhe dëshmi në mbështetjen e pretendimeve që mund të kemi. Në periudha të ndryshme të historisë, ne do të ishim të sigurt se dielli rrotullohej rreth një toke të sheshtë dhe kontinentet e tokës nuk lëviznin. Ndërkohë që shkencëtarët apo kërkuesit shkencorë, përmes kërkimit sistematik shkencor, bënë që ne të heqim dorë nga intuita apo paragjykimet tona të paramenduara dhe të fitojmë një kuptim objektiv për vete dhe botën që na rrethon.

2. Metodologjia e Kërkimit Shkencor

Metodat e kërkimit në shkencat shoqërore, pjesë e të cilave është dhe shkenca ushtarake, janë instrumente të domosdoshme, që mundësojnë arritjet e rezultateve dhe njohurive të reja dhe/ose korrigjimin e atyre ekzistuese. Shkenca ushtarake, siç do ta zhvillojmë më poshtë, përdor ose kombinon një sërë metodash, të cilat janë të njëjta ose të ngjashme me ato që përdoren në shkencat shoqërore, të huazuara nga shkencat e përpikta.

Metodologjia është përshkrimi apo konturimi i një kërkimi shkencor, i cili ka për qëllim të përcaktojë llojin (përshkrues, ndërveprues, eksperimental, shqyrtues apo analitik), pyetjet kërkimore, hipotezën, variablat e pavarura dhe të varura, projektin eksperimental, si dhe metodat e mbledhjes të të dhënave dhe një plan analize statistikore. Ky dokument përbën bazën për të kërkuar përgjigje për pyetjet e kërkimit shkencor, të cilat bazohen në një teori, që i sfidon përmes hipotezës, ku kjo e fundit duhet t'i nënshtrohet vlerësimit përmes

testimit, për të arritur të përfundimet e dëshiruara. Procesi i kërkimit shkencor përbëhet nga disa faza që janë të ndërlidhura, si: formulimi i teorisë, operacionalizimi, përzgjedhja e teknikave kërkimore, analiza dhe interpretimi i të dhënave.

Studiuesit/shkencëtarët ushtarakë përdorin kryesisht dy metoda shkencore gjatë punës kërkimore: metodën cilësore dhe metodën sasiore, nëpërmjet të cilave ata mund të gjejnë çdo detaj të mundshëm për përcaktimin e metodologjisë më të përshtatshme për interesat e tyre të veçanta shkencore ose audiencën e përcaktuar apo e synuar; përfshirë edhe mënyrën se si zbatohet kjo metodologji.

Metodat cilësore bazohen në njohuritë, përvojën dhe opinionin e ekspertëve. Këto metoda quhen gjithashtu subjektive, reflektuese ose intuitive. Ato përdoren në situata ku nuk ka të dhëna të mjaftueshme nga e kaluara. Avantazhi i tyre është përdorimi i një sasive relativisht të madhe të informacionit të ekspertëve. Anasjelltas, disavantazhet janë vlerësimi josistematik i informacionit të marrë dhe gjithashtu paragjykimi i ekspertëve. Këto metoda janë më të përshtatshme për prognoza afatgjatë.

Ndërsa **metodat sasiore** (të referuara edhe si metoda objektive, metoda statistikore) bazohen në aplikimin e analizës statistikore të të dhënave historike. Këto metoda përdorin modele dhe ekuacione matematikore për përcaktimin e horizonteve kohore në të ardhmen. Këto metoda supozojnë se tendencat e identifikuara dhe treguesit e tyre të matshëm do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Avantazhi kryesor i aplikimit të metodave sasiore është një verifikim objektiv dhe i saktë i parashikimeve. Këto metoda janë të përshtatshme për prognoza afatshkurtra dhe afatmesme.

Metodat cilësore ose sasiore, si në rastet kur përdoren veç e veç, ashtu edhe të kombinuara, kanë avantazhe dhe disavantazhe, mbi bazën e të cilave studiuesit duhet të vendosin se cilën prej tyre duhet të ndjekin, për t'iu përgjigjur sa më mirë pyetjeve të parashtruara shkencore. Gjithsesi, në shumicën e literaturës që trajton dhe ofron qasje teorike ndaj metodologjive të kërkimit, pak prej tyre tregojnë përvojat reale dhe aq më pak trajtojnë dhe diskutojnë çështje që janë me interes të veçantë në kontekstin e shkencës ushtarake.

Zbatimi i metodës më të përshtatshme varet nga shumë faktorë, të tillë si: fusha e studimit, lloji, diapazoni dhe objektivi i prognozës, periudha kohe, të dhënat në dispozicion, njohuritë dhe përvoja, etj. Gjatë përpunimit të një prognoze, zakonisht aplikohet kombinimi i disa metodave të përdorura për këtë prognozë, ku në rastin e shkencës ushtarake janë metodat cilësore dhe sasiore.

Një aspekt i rëndësishëm i propozimit të metodës është efikasiteti, besueshmëria, shpejtësia dhe vërtetësia e metodës së parashikimit të situatës së sigurisë. Një metodë prognostike universale për krijimin e parashikimeve të sigurisë aktualisht nuk ekziston.

Fazat themelore të një prognoze apo parashikimi përfshijnë: identifikimin dhe përcaktimin e problemit të prognozës apo parashikimit; përgatitjen e procesit të zhvillimit të parashikimeve; marrjen e informacionit; renditjen e informacionit; analizën e informacionit; zgjedhjen e metodave të përshtatshme për krijimin e parashikimeve; zbatimin e metodave të zgjedhura;

përpunimin, stilizimin dhe verifikimin e parashikimeve.

Përzgjedhja e metodologjisë bazohet te natyra e objektit të kërkimit shkencor dhe, nisur nga përvoja jonë kërkimore, metoda cilësore është metoda më e përshtatshme e kërkimit në shkencën ushtarake. Nëpërmjet kësaj metode synohet mbledhja e materialeve dhe e të dhënave sa më cilësore e më të përditësuara, duke shfrytëzuar dokumentet arkivore, monografite, studimet në fushën e sigurisë e të mbrojtjes; revistat shkencore; punimet e ndryshme të paraqitura si disertacione me tematikë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes; artikujt shkencorë; periodikët; mësimet e nxjerra; raportet e institucioneve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare ...dhe të qeverive të vendeve të fushës së interesit; materiale të marra nga interneti; përvoja personale etj., “... ku faktet e mbledhura, në të cilat bazohet realizimi i analizës në Punimin Shkencor, duhet të jenë nga burime alternative”⁹.

Metoda cilësore trajtohet edhe në një nga botimet e rralla në botë që trajton Metodologjinë e Kërkimit Shkencor në shkencën apo studimet ushtarake, të quajtur: “Metodat Cilësore në Studimet Ushtarake: Eksperiencë Kërkimesh dhe Sfidash”¹⁰, shkruar nga Helena Carreiras dhe Celso Castro. Ky libër analizon dhe promovon metodën e **Kërkimit Cilësor** në studimet ushtarake, si një metodë të suksesshme.

Libri është me interes për kërkuesit në fushën e studimeve ushtarake, metodave të kërkimit, sociologjisë, antropologjisë, studimeve të luftës dhe konfliktit, si dhe studimeve të sigurisë në përgjithësi; ku në fokus të punës shkencore është metoda cilësore e kërkimit. Qëllimi i tij është jo vetëm të paraqesë rezultatet e projekteve specifike kërkimore të kryera nga autorë të vendeve të ndryshme, por më tepër të trajtojë veçoritë e kryerjes së kërkimit shkencor në institucionet ushtarake dhe të reflektojë përvojat empirike kërkimore të këtyre autorëve. Në kontekstin më të gjerë, libri analizon një sërë metodash dhe teknikash cilësore si për shembull: vëzhgimi, intervistimi dhe grupet e interesit, ku autorët iu përkasin disiplinave të ndryshme si: antropologjia, historia, sociologjia, shkencat politike, psikologjia sociale, në vende të tilla si: Gjermania, Franca, Britania, Argjentina, Brazili dhe Afrika e Jugut. Për më tepër, në këtë libër janë shtjelluar një sërë temash, duke përfshirë vëzhgimin e objektit të kërkimit, qëndrimin e kërkuesit shkencor, ndërveprimin e tij me ata që marrin pjesë në hulumtim gjatë intervistimit, vëzhgimit apo bisedave me fokus grupet e interesit, çështje të lidhura me gjininë, statusin “i brendshëm” apo “i huaj” i kërkuesit, procesin e marrjes së të dhënave dhe analizën e tyre, si dhe konceptin dhe praktikën e reflektimit, si një mënyrë për të përmirësuar cilësinë e procesit dhe produktit të kërkimit dhe publikimin e rezultateve të këtij kërkimi.

Refleksionet dhe qëndrimet ndaj këtij libri evidentojnë edhe pyetjen shumë interesante dhe të rëndësishme mbi përshtatshmërinë e metodave cilësore për shkencën apo studimet ushtarake, duke pasur parasysh vështirësinë jo vetëm për të marrë leje për të hyrë në një

⁹ Dr. Hoxha, Bardhyl, Disertacion: “Siguria Bashkëpunuese nëpërmjet Nismave Rajonale në Ballkanin Perëndimor”, nëntor 2018, fq. 33.

¹⁰ Qualitative Methods in Military Studies: “Research Experiences and Challenges”, ISBN 9781138797482, Published on May 2014 by Routledge, page 208.

repart ushtarak, por edhe për të fituar besimin e ushtarakëve (për shkak të kufizimeve të ndryshme, në varësi të statusit të brendshëm/ të jashtëm të studiuesit, gradës së tij/ saj, etj.,) gjatë hulumtimit në terren. Autorët diskutojnë gjithashtu faktorët që mund të ndikojnë në vlefshmërinë e të dhënave të marra, duke përdorur një qasje cilësore, format e ndryshme të intervistave që mund të zhvillohen dhe çështjen nëse pjesëmarrësit marrin pjesë në studim mbi baza vullnetare ose nën urdhra. Tema e trekëndëzimit të metodave, në mënyrë që të kuptohen më mirë të dhënat dhe të vlerësohen gjetjet ose një situatë nga perspektiva të ndryshme, është analizuar së bashku me rëndësinë e kontrollit të tërthortë të deklaratave dhe përshkrimeve të mbledhura. Argumentimi i autorëve mbi çështjet e besueshmërisë dhe vlefshmërisë së metodës cilësore është eksploruar më tej duke përdorur paradigma të nxjerra nga përvoja e dy dekadave të kryerjes së kërkimit brenda Forcave të Armatosura Sllovene.

Metoda sasiore dhe ajo e kombinuar mund të përdoren në faza të ndryshme për të përmbushur një kërkesë apo specifike të caktuar të kërkimit shkencor, si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore që nuk mund të trajtohen nga një perspektivë thjesht cilësore.

3. Fushat kryesore të Kërkimit Shkencor

Çështjet thelbësore të kërkimit shkencor në shkencën ushtarake janë shkaqet e luftës apo konfliktit, bazat shoqërore dhe kulturore, doktrina ushtarake: strategjia, logjistika, udhëheqja, teknologjia, taktikat e përdorura dhe si kanë ndryshuar ato me kalimin e kohës.

“Kur shikojmë dhe vlerësojmë se shkenca duhet t'i përgjigjet pyetjeve rreth botës që na rrethon, ne shpesh presim që ato përgjigje të jenë të sakta, çka nuk ndodh gjithmonë, pasi *paqartësia* është një pjesë normale e shkencës dhe objekt kryesor i studimit të saj..., e cila mund të duket shumë zhgënjyese, kur duam të dimë një përgjigje përfundimtare rreth një çështjeje të caktuar...”¹¹.

Sidoqoftë, fakti që shkenca nuk di gjithçka për një çështje të caktuar, nuk do të thotë se ajo nuk di asgjë. Çdo pjesëz e kërkimit shkencor përbën një pjesë të vogël të një enigme më të gjerë të njohurive mbi një fushë konkrete studimore. Vlera kryesore që mbështet shkencën është ideja për të qenë të hapur ndaj mundësisë së njohurive ose informacioneve të reja. Kjo do të thotë që shkencëtarët shpesh shprehin një shkallë të vogël pasigurie, edhe në rastet kur shumica dërrmuese e provave tregojnë një përfundim. E thënë me fjalë të tjera, shkencëtarët janë të përqendruar në mënyrë aktive në atë që ne nuk e dimë, ndërkohë që shumica e njerëzve, që duan të përdorin dëshmi shkencore, janë më të interesuar më shumë për atë që ne dimë. “...Fatkeqësisht, disa njerëz, veçanërisht ata me interesa të caktuar, përdorin pasigurinë shkencore për t'i përshkruar ose prezantuar çështjet më të kontestuara, se sa ato janë në realitet”¹².

Le ta ilustrojmë atë çka evidentuam më sipër me një shembull të marrë nga një informacion

¹¹ <https://www.understandinghealthresearch.org/useful-information/scientific-uncertainty-25>, hyrë më 08.09.2021

¹² Po aty.

në burimin elektronik në lidhje me Afganistanin, ku Darren Kimball, Forbes, më 2 shtator 2021 nënvizon: “Në kushtet e paqartësisë dhe të pasigurisë për të ardhmen e Afganistanit, dhjetëra mijëra njerëz vrapuan për të ikur nga vendi në avionë të furishëm të drejtuar nga SHBA, që përfundoi përpara tërheqjes përfundimtare të trupave amerikane në fillim të kësaj jave”¹³.

Pra, shkencëtarët nuk veprojnë me 100 për qind siguri, pasi gjetjet e tyre bazohen në probabilitetet dhe provat e reja mund të zhvlerësojnë parashikimet, madje të modifikojnë kuptimet e mirëpranuara më parë. “Në shumë aspekte paqartësia është kritike për shkencën, sepse nxit shkencëtarët të angazhohen në hetime dhe kërkime të mëtejshme”¹⁴.

Ky artikull synon të marrë parasysh kuptimin dhe marrëdhënien midis paqartësisë apo pasigurisë dhe rrezikut në kontekstin e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, të cilat shprehen te kompleksiteti dhe paparashikueshmëria e mjedisit të sigurisë euroatlantik, rajonal dhe të brendshëm.

Ajo çka evidentohet te dokumentet aktuale kryesore të Sigurisë Kombëtare të Mbrojtjes dhe Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, sfidat e sigurisë, rreziqet dhe kërcënimet vazhdojnë të evoluojnë dhe përfshijnë gjithnjë e më shumë ato të natyrës asimetrike, hibride, kibernetike dhe pandemike. Shqetësimet kryesore të deklaruara në këto dokumente: çështjet ekonomike dhe politike; krimi i organizuar; terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi; migrimi ilegal; lufta hibride; pandemitë, mbrojtja kibernetike; dhe fatkeqësitë natyrore etj., kërkojnë qasje rajonale në bashkëpunim të ngushtë me SHBA, NATO-n dhe BE-në. Qëllimi është të kemi një vend demokratik të sigurtë dhe të begatë, me marrëdhënie të mira dhe konstruktive me vendet e rajonit e më gjerë, si një tregues i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajonin tonë.

Nisur nga fakti që Shqipëria është një shtet i vogël, Shkenca jonë Ushtarake / Kërkimi Shkencor duhet të fokusohet te studimi dhe përcaktimi i saktë i rreziqeve dhe kërcënimeve të jashtme e të brendshme, me të cilat po përballemi tani dhe në perspektivë, te studimi i interesave kombëtarë dhe zhvillimi i një politike të jashtme realiste dhe pragmatike për arritjen e këtyre interesave. Siguria kombëtare është një parakusht dhe domosdoshmëri për zhvillimin tonë ekonomik, kulturor dhe social, ku sfidat kryesore lidhen me sigurinë, rritjen e mirëqenies, zhvillimin e reformave të institucionalizuara evropiane, forcimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, pavarësinë e medias, luftën kundër korrupsionit, luftën kundër trafikimit ilegal, etj. Po ashtu, pavarësisht përparimit të arritur vitet e fundit, rajoni ynë vazhdon të përballlet me sfida që i kanë rrënjët te faktorët historikë dhe brishtësia e demokracisë së vendeve të rajonit. Arsyet e krizave të shumta që kanë karakterizuar këtë pjesë të Evropës shpjegohen edhe nga fakti i ndarjeve etnike, përzierja e kulturave të ndryshme dhe bashkësive fetare, prapambetja në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe demokratik.

¹³ <https://www.merriam-webster.com/dictionary/uncertainty> , hyrë më 08.09.2021

¹⁴ <https://www.merriam-webster.com/dictionary/uncertainty> , hyrë më 08.09.2021

Paqartësia dhe pasiguria evidentojnë nevojën e identifikimit, analizimit dhe vlerësimit të kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave të kohës dhe përcaktimit të masave dhe kapaciteteve të duhura operationale për zbutjen apo përballimin e tyre, që janë detyra dhe fusha të mirëfillta të kërkimit shkencor në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, duke pasur parasysh bashkëpunimin me vendet e rajonit, veçanërisht me Kosovën, si dhe me aktorët kryesorë ndërkombëtarë: NATO, SHBA dhe BE. Mbi bazën e parashikimeve në formën e vizioneve dhe skenarëve të mundshëm të së ardhmes, si dhe sfidave për përballimin e tyre, kërkuesit shkencorë duhet të ndërtojnë bazën e provave kërkimore dhe parashikojnë e argumentojnë kurset e mundshme të veprimit, që mund të ndodhin në mjedisin tonë të sigurisë. Ata duhet të adresojnë fillimisht pyetjen "Çfarë nëse...?" ("What if ...Scenarios"), që është bazë për hartimin e skenarëve dhe më tej, të kërkojnë përgjigjet e pyetjes tjetër "Çfarë duhet bërë nëse mund të ndodhë...?" ("What must be done if it could happen").

Pasiguritë e së ardhmes kërkojnë që të përshtatemi. Siç u theksua edhe në Samitin e fundit të NATO-s¹⁵, Aleanca do të përballlet me kërcënime të shumanshme, konkurrencë sistematike nga fuqitë autoritare, si dhe sfida në rritje të sigurisë ndaj vendeve tona dhe qytetarëve tanë nga të gjitha drejtimet strategjike. Veprimet agresive të Rusisë përbëjnë një kërcënim për sigurinë euroatlantike; terrorizmi në të gjitha format dhe manifestimet e tij mbetet një kërcënim i vazhdueshëm për të gjithë vendet e NATO-s. Aktorët shtetërorë dhe joshetërorë po sfidojnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla dhe kërkojnë të minojnë demokracinë në të gjithë botën. Paqëndrueshmëria përtej kufijve të NATO-s po kontribuon gjithashtu në migrimin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Ndikimi në rritje i Kinës dhe politikat ndërkombëtare mund të paraqesin sfida që duhet të adresohen bashkërisht si Aleanca.

Po ashtu, më 1 maj 2021, gjatë një fjalimi në Komandën e Paqësorit të SHBA-ve me bazë në Havai, Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, zoti Austin u shpreh: "Mënyra se si ne luftojmë luftën tjetër të madhe, do të duket shumë ndryshe nga mënyra se si ne luftuam në luftën e fundit"¹⁶.

Dhjetë vitet e ardhshme do të jenë ndryshe nga periudha e Luftës së Ftohtë apo dekadave që pasuan këtë luftë. Do të jetë një botë e fuqive të mëdha konkurruese, në të cilën shtetet autoritare, me axhenda revizioniste të politikës së jashtme, do të kenë pretendime apo kërkojnë të zgjerojnë fuqinë dhe ndikimin e tyre, përfshirë edhe rajonin dhe vendin tonë, ku në mënyrë sistematike siguria dhe ekonomia do të jenë nën presion. Kërcënimet e njohura si terrorizëm, në të gjitha format dhe manifestimet e tij do të vazhdojnë krahas kërcënimeve të reja nga pandemitë dhe ndryshimet klimatike.

Sfidat e mësipërme duhet të jenë objekt i vazhdueshëm i punës kërkimore shkencore, e cila duhet të shoqërohet me përpjekje të vazhdueshme për të ndryshuar qasjen në sistemin e sigurisë e të mbrojtjes, në kontekstin e ndryshimeve të natyrës së rreziqeve.

¹⁵ Brussels Summit Communiqué, issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Brussels 14 June 2021.

¹⁶ <https://www.reuters.com/world/us/next-major-war-will-be-very-different-us-defense-secretary-2021-04-30/>

4. Edukimi universitar Ushtarak dhe Kërkimi Shkencor

Arsimit shqiptar i kërkohet sot përmirësimi i efikasitetit të të nxënit: studentët nuk kanë nevojë për vëllime të mëdha njohurish, por për marrjen e dijeve cilësore dhe për kompetenca që t'i zbatojnë gjerësisht. Ky objektivi - i ngjashëm me atë të fushave të tjera të shoqërisë dhe ekonomisë - nis të sendërtohet, kur arsimit nis dhe tejkalon paradoksin më të çuditshëm, sa i takon rolin e tij në zhvillimin e shoqërisë:

Ndërsa sistemi arsimor për nga misioni konsiderohet sfera më e rëndësishme për rigjenerimin e dijeve në shkallë shoqërore, vetë ky sistem përdor shumë pak dijet e reja ose zbulimet shkencore për përmirësimin e veprimtarive të veta. Ka një mijë arsye për të pohuar se arsimit ynë nuk i përket sektorëve që gjenerojnë dije intensive. Konceptuar si një nga investimet afatgjata më dobiprurëse, arsimit i nxit vendet të zgjerojnë sfondin e studimit shkencor të mësimdhënies dhe të nxënit dhe të rritin kapacitetet hulumtuese. E nëse kjo ka prodhuar zhvillime spektakolare, Shqipëria, me sa duket, është ende në fazën e formulimit të problemit.

Sistemi ynë i arsimit publik është sektori me numrin më të madh të profesionistëve me diploma të arsimit të lartë. Megjithatë, ai mbështetet në një masë shumë të vogël mbi të dhënat shkencore për trajnimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Kërkesa për ta vendosur zhvillimin e arsimit në një kontekst socio-ekonomik më të gjerë korrespondon jo vetëm me nevojat tona, por dhe me përvojat e mira në ato vende që shpenzojnë gati 4 për qind të PBB për kërkimin & zhvillimin (Research & Development - R&D).

Kështu, dy rajone të gjera ekonomike, Shtetet e Bashkuara dhe Azia Juglindore, me të cilat Bashkimi Evropian përpiqet të mbajë ritmin, shpenzojnë vazhdimisht mbi 3 për qind të PBB-së për kërkimin dhe zhvillimin. Treguesi është shumë më i lartë në ata sektorë që gjenerojnë intensivisht dije dhe teknologji. Kthimi i arsimit në një sektor të tillë vjen nga zgjerimi i përshpejtuar i kapaciteteve, përmirësimi i infrastrukturës kërkimore dhe kualifikimi i studiuesve.

Sa i takon Shqipërisë, megjithëse ka një tendencë të vogël rritjeje, shpenzimet tona direkte për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor kufizohen në 0.4-0.6% të PBB.¹⁷ Ndërsa në Akademinë e Forcave të Armatosura një përqindje e jo e kënaqshme është alokuar për Kërkimin Shkencor.

Analiza e marrëdhënieve mes dijes, fushave përkatëse të interesit dhe arsimimit jep prova të shumta që tregojnë se rritja e kërkimeve shkencore në arsim, vlerësohet si një nga investimet më fitimprurëse. Duke parë proceset e zhvillimit gjatë dekadave të fundit, shohim lidhjen ndërmjet përparimit të shpejtë, me vëmendjen që i kushtohet Kërkimit Shkencor dhe njësimit të Kërkimit Shkencor në arsim, me Kërkimin Shkencor në sektorë e tjerë të interesit. Gjithsesi ajo që vihet re sot në Shqipëri, është mungesa si e fondeve, ashtu dhe e kërkuesve të mirëfilltë shkencorë. Kjo vihet re në interesin për zhvillimin e

¹⁷ <https://www.monitor.al/pse-eshte-nevojshem-kerkimi-shkencor-ne-universitetet-shqiptare>, hyrë më 14.09.2021

temave shkencore, të cilat në mjaft raste, vlerësohen më tepër si një mjet për të siguruar një vend pune në Institucionet e Arsimit të Lartë dhe për një pagë më të mirë, se sa një nevojë për t'i shërbyer një sektori të caktuar, përfshirë Sigurinë dhe Mbrojtjen, duke iu referuar Akademisë tonë të Forcave të Armatosura.

Ndërkohë nuk akordohen fonde, mungojnë ekipet kërkimore të specializuara në studimet arsimore dhe ka pak ekspertë të kualifikuar. Mungon kujdesi për nevojat financiare të hulumtimit dhe vëmendja kryesore përqendrohet vetëm te ngarkesa mësimore.

Siç kemi argumentuar më lart, **metoda cilësore** është metoda më e mirë e Kërkimit Shkencor në Shkencën Ushtarake, e cila nuk kërkon shumë investime, por kërkon më tepër ekspertizë. Nisur nga ky këndvështrim, kemi një numër të kufizuar punonjësish shkencorë me grada shkencore, që krahas formimit intelektual dhe pasionit për kërkim shkencor, kanë edhe ekspertizën e duhur. Ky fakt pasqyrohet edhe te disa punime shkencore, madje edhe te punimet për doktoratë, në kuadrin e cikleve të studimeve apo programeve akademike të Akademisë së Forcave të Armatosura, të cilat nuk plotësojnë si dhe sa duhet kërkesat e metodologjive për kërkime shkencore, çka konstatohet nga mënyra si mbledhen, analizohen, interpretohen të dhënat dhe formulohen rekomandimet.

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) gjatë veprimtarisë së saj ka hedhur hapa cilësorë, duke u shndërruar jo vetëm në një qendër mësimdhënëse cilësore por njëherësh edhe studimore shkencore të evidentimit, studimit dhe përpunimit të mendimit ushtarak. Forcimi i lidhjeve dhe bashkëpunimi me institucionet shkencore të vendit dhe të huaja ka mundësuar përmirësimin e kurrikulave duke e harmonizuar tematikën e programeve mësimore edhe me disa akademi homologe perëndimore. Në vijimësi është reformuar në strukturë, emërtim e në programet e procesit mësimor, në përputhje me misionin e saj nga periudha në periudhë. Për realizimin e misionit ajo bashkërendon punën e saj me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me institucionet e larta arsimore publike dhe jopublike.

AFA vlerësohet si një nga qendrat më të rëndësishme kombëtare të përpunimit të ideve dhe të politikave në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Në vitin 1998, Akademia u pranua anëtare me të drejta të plota në Konsorciumin e Akademive të Mbrojtjes dhe të instituteve të studimit e sigurimit të vendeve anëtare të NATO-s. Ajo ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit, si: Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Universitetin e Tiranës, Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, Universitetin e Durrësit, Universitetin e Vlorës, Universitetin Evropian të Tiranës, etj.

Në kuadrin ndërkombëtar, AFA realizon programin e studimeve të sigurisë dhe mbrojtjes me Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM) me pjesëmarrje të ushtarakëve dhe civilëve nga vendi ynë dhe vendet e rajonit e më gjerë. KLSM realizohet njëkohësisht me ndihmesën dhe asistencën e partnerëve tanë ndërkombëtarë si: Instituti për Studimet në Fushën e Mbrojtjes (CASD), Romë, Itali, Qendra "George Marshall Center", Instituti i Studimeve Globale Romë, Itali si dhe institucionet ndërkombëtare të vendosura në vendin tonë. Këto institucione krijuan kushtet e nevojshme për shndërrimin e këtij kursi në kolegji rajonal.

Nga viti 2012, Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen është akredituar nga Komanda e Aleancës për Transformim në Norfolk SHBA dhe statusi aktual i kursit është “NATO LISTED”.

Me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, në tetor 2012, AFA zhvilloi Konferencën Ndërkombëtare Shkencore “100 years Albanian State - 100 years Albanian Armed Forces” me pjesëmarrjen e studiuesve dhe lektorëve nga Italia (Army Historical Office - Italy), Turqia (Military History and Strategy Research Center - Turkey), Gjermania (Military History Research Institute of Bundeswehr - Germany), Austria (Academy for Peace and Security in Europe – Austria) Shqipëria, (Institute of History Tirana- Albania, Academy of Armed Forces), Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Universiteti i Strugës Maqedoni, punime të cilat janë botuar në librin me të njëjtin titull “100 years Albanian State - 100 years Albanian Armed Forces”.

Akademia e Forcave të Armatosura me pjesëmarrësit e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes ka zhvilluar konferenca të ndryshme me pjesëmarrjen e lektorëve të ndryshëm ndërkombëtarë e vendas, siç është ajo e zhvilluar më datë 31 tetor 2016, në bashkëpunim me Institutin për Studime Globale në Romë, Itali me temë “Kërcënimet terroriste në rajonin e Ballkanit” në të cilën kanë lektuar profesorë vendas dhe të huaj nga: SHBA, Gjermania, Italia, etj.

Vendimi i KM, nr. 156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm Publik i Arsimit të Lartë në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë Kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit të saj¹⁸”, pika 3, përcakton se Akademia e Forcave të Armatosura zhvillon veprimtari mësimore e shkencore në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare. Ajo ka si mision arsimimin, kualifikimin dhe kërkimin shkencor në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil, për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, si dhe të institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare. Po ashtu, pika 8, e VKM-së së mësipërme përcakton kryerjen e studimeve të karakterit teoriko-shkencor në fushat e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, që t’i paraprijë zhvillimeve në mjedisin strategjik të mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare. Pra, kjo VKM i jep Akademisë së Forcave të Armatosura status të veçantë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, me vartësi nga ministri përgjegjës për mbrojtjen dhe ministri përgjegjës për arsimin.

Krijimi dhe ruajtja e standardeve në Akademinë e Forcave të Armatosura nuk është një punë e lehtë. Rritja e cilësisë së arsimit mbetet një sfidë e përditshme dhe pjesë e një debati të vazhdueshëm. Është një sfidë që fillon, por nuk mbaron me skanimin e Institucionit tonë të vetëm të Arsimit të Lartë Ushtarak. Është koha të flasim më mirë për shkencën, kërkimin shkencor, produktin shkencor dhe nevojën jetike të tyre, për zhvillimin e mendimit ushtarak në mbështetje të veprimtarisë së Forcave të Armatosura.

Rruga e reformimit rrënjësor të Arsimit të Lartë Ushtarak lidhet dhe me krijimin e konsolidimit të Institutit Kërkimor Shkencor, e cila është strukturë e rëndësishme që inicion

¹⁸ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-156-dt.-19.2.2020-AFA.pdf>, hyrë më 14.09.2021

dhe zhvillon kërkimin shkencor dhe metodën e vlerësimit të botimeve shkencore, për të matur vlerat dhe meritat akademike të punonjësve shkencorë.

Procesi i Bolonjës, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria, i cili çon në përputhshmëri dhe krahasueshmëri më të madhe të sistemeve në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, sigurohet përmes reformave të sistemeve dhe politikave kombëtare të arsimit të lartë, të bazuara në vlerat evropiane të autonomisë institucionale dhe lirisë akademike. Një nga temat kryesore në kërkimin e përbashkët është **siguria e shoqërisë**, ku vizioni i përbashkët është zhvillimi i programeve dhe platformave kombëtare të teknologjisë për të siguruar realizimin e plotë të potencialit shkencor kombëtar në fushën e sigurisë. Meqenëse njohuritë e sigurisë janë shumë të specializuara, është e nevojshme të krijohen lidhje të shumta, kryesisht horizontale, midis njerëzve, institucioneve dhe organizmave me qëllim grupimin, ruajtjen, përhapjen dhe zbatimin e tyre në praktikë. Këto lidhje duhet të mbulojnë jo vetëm sferën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, por edhe të gjitha sferat tjera - biznesin, komunitetin akademik, qeverinë dhe shoqërinë në tërësi.

Aktualisht jemi në një epokë të re të kërkimeve shkencore në fushën e sigurisë e të mbrojtjes. Gjatë dekadave të fundit është vënë re një përparim i jashtëzakonshëm nga komuniteti i kërkimit të shkencave kompjuterike duke nxitur rritjen në fushat e robotikës, të mësuarit dhe arsyetimit, të kuptuarit të gjuhës, inteligjencës kolektive dhe teknologjive të tjera të ngjashme. Këto përparime kanë filluar të gjejnë rrugën e tyre në produkte të reja dhe po ripërcaktojnë ndërfaqjen njeri-makinë.

Ndërsa dekada e fundit ka demonstruar se kërcënimet ndaj sigurisë kanë ndryshuar shumë në aspektin e shkaqeve dhe mënyrës së shfaqjes së tyre. Në këtë sens, ato paraqesin interes dhe kërkojnë përgjigje edhe nga shkencat shoqërore, shoqëria civile dhe një komunitet shumë i gjerë politikë-bërësish dhe veçanërisht shkenca ushtarake. Në të kaluarën, shmangia e luftës ishte objektivi parësor, ku gjithsesi edhe ajo “Lufta pëson evolucion të vijueshëm. Armët e reja, japin edhe forma të reja luftimi. Të parashikosh këtë evolucion teknologjik para se ai të ndodhë, të gjykosësh mirë mbi ndikimin e këtyre armëve të reja në betejë, të përdorësh ato para të tjerëve është thelbësore dhe kusht për sukses.”¹⁹

Por me përfundimin e Luftës së Ftohtë, mbrojtja ushtarake, si qendër e axhendës së sigurisë ndërkombëtare, ka ndryshuar. Pra, kemi një zhvendosje të rëndësishme nga qasjet tradicionale të sigurisë, në një axhendë të re që flet për anën më të butë të sigurisë, në aspektin e sigurisë njerëzore, sigurisë ekonomike dhe sigurisë mjedisore, çka përbën edhe një axhendë të rëndësishme politike dhe kërkimore në të ardhmen e afërt.

Ndryshimet në mjedisin ndërkombëtar të sigurisë dhe skena ndërkombëtare në tërësi parashikojnë skenarë shumë shqetësues për të ardhmen, me re të zeza të pasigurisë dhe konkurrencës gjeostrategjike, që mund të shfaqen në shumë fronte. Pandemia aktuale e koronavirusit ka shkaktuar tronditje të status quo-së aktuale. Kjo mund të jetë sfida më e madhe, veçanërisht në fushat e politikave të rëndësishme, të tilla si: siguria dhe mbrojtja.

¹⁹ Ferdinand Miksche, *Attack: A Study in Blitzkrieg Tactics* (New York: Random House, 1972), fq. 7.

Pandemia tashmë po ndikon indirekt edhe në procesin e integritetit të mbrojtjes, duke testuar parimet e solidaritetit evropian dhe kapacitetin për menaxhimin kolektiv të krizave.

Këto shqetësime duhet të nxisin dhe inkurajojnë përpjekjet institucionale për të zhvilluar dhe krijuar kapacitete e aftësi më koherente dhe ndërvepruese ushtarake, duke i bërë në të njëjtën kohë edhe objekt të punës kërkimore shkencore për zgjidhje më optimale dhe fitimprurëse.

Ne duhet të investojmë shumë në kërkimin shkencor dhe ekspertiza e shkencës ushtarake do të jetë thelbësore për çdo aspekt që lidhet me sigurinë dhe mbrojtjen. Është e nevojshme të monitorojmë, drejtojmë dhe inkurajojmë studiuesit dhe analistët e rinj për të kontribuar në fushën e studimeve ushtarake, për të mbështetur sigurinë kombëtare. Investimi ynë në Kërkim dhe Zhvillim (R&D) është shumë i rëndësishëm dhe një pjesë integrale e strategjisë sonë të përgjithshme të sigurisë kombëtare. Ne duhet të vazhdojmë t'u japim ushtarakëve, ish-ushtarakëve dhe shkencëtarëve ushtarakë, me ekspertizë të lartë, punë domethënëse dhe përmbushëse të nevojave tona; dhe ata nuk do të na zhgënjëjnë.

Pasiguritë e së ardhmes kërkojnë që të përshtatemi. *“Fitorja buzëqesh tek ata që i paraprijnë ndryshimeve në karakterin e luftës, jo tek ata që rrinë në pritje të adoptohen pasi ndryshimet kanë ndodhur”*²⁰. Kjo filozofi përshtatjeje duhet të zërë vend institucionalisht edhe në Akademinë tonë të Forcave të Armatosura, ku veçanërisht programet master dhe doktoratë, nuk mund të konceptohen pa kërkime shkencore aktive. Duhet të inkurajohet futja e disiplinave të reja shkencore dhe rritja e kapaciteteve kërkimore për të përgatitur shkencëtarë të rinj. Duhet përpjekje më të mëdha për të ndryshuar qasjen në sistemin e sigurisë e të mbrojtjes, duke rritur më shumë interesin për kërkime shkencore në institucionet tona, me qëllim krijimin e shkencëtarëve të rinj, të njohurive moderne. Përpjekjet gjithëpërfshirëse do të krijojnë kushte për marrëdhënie më të qenësishme e të qëndrueshme, midis kërkuesve në fushën e sigurisë e të mbrojtjes dhe analistëve, institucioneve e organizmave të ndryshëm të sigurisë në vendin tonë, përfshirë edhe botën akademike, me qëllim adresimin e spektrit të gjerë të rreziqeve të sotme dhe hartimin e strategjive efektive për përballimin e tyre në të ardhmen.

Përfundime

Fusha e sigurisë dhe e mbrojtjes është shumë e gjerë dhe specifike, ku veçanërisht siguria shfaqet shumëdimensionale, ku përfshihen siguria ushtarake, ekonomike, njerëzore, shëndetësore, energjetike, mjedisore, ushqimore, kufitare dhe kibernetike. Mjedisi i sigurisë vazhdon të jetë i paparashikueshëm dhe rreziqet e kërcënimeve të sotme vazhdojnë të evoluojnë gjithnjë e më shumë drejt natyrës asimetrike, hibride dhe kibernetike.

Krahas rreziqeve dhe kërcënimeve të njohura, po shfaqen edhe rreziqe të reja nga pandemitë dhe ndryshimi i klimës. Ky kompleksitet dhe kjo paparashikueshmëri e mjedisit të sigurisë shtrajnë nevojën e kërkimit shkencor me synim identifikimin, analizën, vlerësimin dhe përcaktimin e qasjeve për përballimin e tyre.

²⁰ Giulio Douhet, Command of the Air [Washington, D.C.: 1983), a reprint by the Office of Air Force History of the 1942 translation published by Coward- McCann, New York. fq. 30

Në ditët e sotme, më shumë se kurrë më parë, është në qarkullim një sasi shumë e madhe informacioni dhe me një kërkim të thjeshtë në internet për çdo temë të dhënë kërkimore mund të rezultojë një numër i konsiderueshëm studimesh kontradiktore. Prandaj, për të pasur parashikime të besueshme, duhet të aplikohen metoda shkencore dhe racionale. Kërkuesit shkencorë përdorin disa metoda shkencore për parashikimin e së ardhmes, ku aplikimi i metodës më të përshtatshme do të varet nga shumë faktorë, siç janë fusha specifike e studimit, diapazoni dhe synimi i parashikimit, periudha kohore, të dhënat e disponueshme, njohuritë dhe përvoja, etj.

Kërkimi Shkencor duhet të aplikohet në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe veçanërisht në Institutin Kërkimor Shkencor Ushtarak. Arsimi universitar ushtarak, veçanërisht programet master dhe doktoratë, nuk mund të konceptohen pa kërkime shkencore aktive. Futja e disiplinave të reja shkencore dhe rritja e kapaciteteve kërkimore për të përgatitur shkencëtarë të rinj duhet të inkurajohen. Ne duhet të bëjmë përpjekje të rëndësishme për të ndryshuar situatën në sistemin e sigurisë duke rritur interesin për kërkime në institucionet tona, me qëllim krijimin e kushteve për brezin modern të njohurive moderne.

Një qasje gjithëpërfshirëse do të mundësonte krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme midis kërkuesve dhe analistëve, institucioneve dhe organizmave të ndryshëm të sigurisë në vendin tonë, përfshirë botën akademike, me qëllim bashkimin e përpjekjeve në adresimin e spektrit të gjerë të rreziqeve të sotme dhe hartimin e strategjive efektive për përballimin e tyre në të ardhmen.

Bibliografia

- VKM nr. 628, datë 25.09.2019 “Për miratimin e dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”.
- Carl Von Clausewitz: “On War”, Edited and Translated by Michael Howard and Peter Paret, Princeton University Press Princeton, New Jersey, shih: <https://press.princeton.edu/books/paperback/9780691018546/on-war>, hyrë më 07.09.2021.
- https://ndupress.ndu.edu/Portals/68/Documents/jfq/jfq-75/jfq-75_84-90_Voelz.pdf, hyrë më 06.09.2021
- <https://thebestschools.org/degrees/military-science-degree/>, hyrë më 06.09.2021
- <https://www.careerindia.com/courses/unique-co> <https://www.monitor.al/pse-eshte-nevojshem-kerkimi-shkencor-ne-universitetet-shqiptare>, hyrë më 14.09.2021
- <https://www.urses.gov.uk/what-is-military-defence-studies-scope-career-opportunities-011840.html?story=3>, hyrë më 06.09.2021
- https://www.google.com/search?q=Research+is+uncomplicatedly+defined+as+the+systematic+search+of+the+specific+unknown+existing+between+the+known+to+find+out+its+solution.&rlz=1C1EJFC_enAL941AL941&oq=Research++is+uncomplicatedly+defined+as

+the+systematic+search+of+the+specific+unknown+existing+between+the+known+to+find+out+its+solution.&aqs=chrome..69i57.2980j0j7&sourceid=chrome&ie=UTF-8, hyrë më 07.09.2021

- Dr. Hoxha, Bardhyl, Disertacion: “Siguria Bashkëpunuese nëpërmjet Nismave Rajonale në Ballkanin Perëndimor”, nëntor 2018.
- Qualitative Methods in Military Studies: “Research Experiences and Challenges”, ISBN 9781138797482, Published on May 2014 by Routledge.
- <https://www.understandinghealthresearch.org/useful-information/scientific-uncertainty-25>, hyrë më 08.09.2021
- <https://www.merriam-webster.com/dictionary/uncertainty>, hyrë më 08.09.2021
- Brussels Summit Communiqué, issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Brussels 14 June 2021.
- <https://www.reuters.com/world/us/next-major-war-will-be-very-different-us-defense-secretary-2021-04-30/>
- <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-156-dt.-19.2.2020-AFA.pdf>, hyrë më 14.09.2021
- Ferdinand Miksche, Attack: A Study in Blitzkrieg Tactics (New York: Random House, 1972).
- Giulio Douhet, Command of the Air [Washington, D.C.: 1983], a reprint by the Office of Air Force History of the 1942 translation published by Coward- McCann, New York.

ARSIMIMI DHE KULTURA NDIKIMI I TYRE NË SIGURINË KOMBËTARE

Kolonel Msc. David Rroku,
Kolonel Msc. Irela Nebiaj
IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Një aspekt i rëndësishëm por edhe i spikatur i çështjeve të sigurisë është arsimimi i ushtarakut dhe kultura e tij, si një fenomen i rrënjosur thellë në shoqëri. Ekziston një korrelacion pozitiv midis arsimit dhe sigurisë kombëtare. Marrëdhënia midis nivelit të kulturës, arsimimit me sigurinë në çdo shoqëri ka ndikim të madh për të parashikuar dhe përballuar sfidat e kohës.

Kultura përcaktohet në mënyra të ndryshme. Shpesh varet nga përvojat e një individi, epoka me të cilën lidhet, normat dhe vlerat shoqërore. Përkufizimet e ndryshme tregojnë se kultura është një koncept që varet nga konteksti apo këndvështrimi që ne e studiojmë. Kultura është diçka me të cilën mund të njihet identiteti i një personi, grupi, komuniteti, pakice, organizate apo kombi.

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), si institucion i lartë arsimor ushtarak, i vetmi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, ka kulturën e tij specifike. Kultura e institucionit të lartë arsimor ushtarak mund të përkufizohet si mënyra e jetesës dhe punës së tij, ndikimi i traditës dhe sjellja e atyre që ndjekin, e cila përfshin mësimdhënësit dhe të gjithë personelin e tij. Organizatat ushtarake, të cilat janë disa nga institucionet më të vjetra dhe më të spikatura, janë mjedise pune specifike me një kulturë të veçantë. Bashkimi me forcat e armatosura përfshin heqjen dorë nga një pjesë e jetës private të dikujt për t'u bërë oficer, nënoficer dhe ushtar. Kur një person hyn në një sistem arsimor ushtarak, ndodhin ndryshime

domethënëse të jetës, ku pranohen forma të ndryshme të aktiviteteve personale, shoqërore dhe profesionale. Ky punim analizon ndikimin e arsimimit në sigurinë kombëtare, sistemin arsimor në AFA, duke identifikuar karakteristikat dalluese të kulturës në një institucion të lartë arsimor ushtarak.

Fjalët kyçe: arsim, siguri kombëtare, kulturë, institucion i lartë arsimor ushtarak, kadet, student, hierarki, organizatë ushtarake, nënkulturë, programe studimi.

Hyrje

Qëllimi i arsimit në kohët moderne është më i gjerë në shtrirje se më parë. Arsimimi sot formon politikën, kulturën, familjen, ekonominë e të tjera. Meqenëse shoqëria është dinamike, ndryshon dhe rritet vazhdimisht, edhe arsimi ndjek shembullin e saj. Në fakt, ndryshimet shpesh bëhen përmes sistemit arsimor në vend. Arsimimi është një nga përbërësit më të rëndësishëm të sigurisë kombëtare të një vendi dhe bëhet më e rëndësishëm kur niveli i zhvillimit të tij është më i lartë. Ndikimi i arsimit në sigurinë e një vendi përcaktohet nga fakti se sa e zvogëlon apo e rrit nivelin e intelektualit të vullnetshëm, sa lejon brezi i ri zhvillimin e teknologjisë së lartë, deri në çfarë mase drejton të rinjtë drejt zgjidhjes së problemeve kryesore, me të cilat mund të përballësh.

Nëse shikojmë apo komunikojmë me ushtarakë, qartazi vëren se ata sillen sipas rregullave. Ushtarakët dinë të përdorin armët e tyre personale, dinë të drejtojnë, dinë si të mbrohen dhe si të maskojnë veten. Ata marrin urdhra nga eprorët e tyre dhe dinë të kryejnë detyrat që u janë caktuar e për më tepër, ata dinë si të raportojnë për realizimin e tyre. Shumica e këtyre kërkesave rrjedhin nga një kuptim i përgjithshëm i kulturës organizative dhe misionit, duke përfshirë standardet shoqërore dhe marrëdhëniet që lidhen me shërbimin në Forcat e Armatosura dhe bindjen ndaj urdhrave.

Çdo organizatë mbështetet dhe varet nga traditat dhe mjedisi i saj. Sa më e gjatë të jetë tradita, aq më e dukshme dhe e njohur është kultura dhe më lehtë përcaktohen vlerat që promovon. Shumë faktorë, si: historia, feja, identiteti etnik, gjuha dhe kombësia krijojnë një kulturë. Kultura zhvillohet në përgjigje të presioneve dhe ndikimeve të ndryshme; mësohet përmes shoqërizimit dhe nuk trashëgohet. Shkurtimisht, kjo promovon vlerat dhe siguron një pasqyrë përmes së cilës anëtarët e tij mund të shohin dhe kuptojnë botën.

Kultura në organizatat ushtarake ka një karakter specifik dhe ndryshon nga kulturat e tjera për sa i përket filozofisë, qasjes dhe kërkesave të saj. Për edukimin e anëtarëve të ardhshëm përmes kurrikulës, kërkesave, metodave, përmbajtjes dhe niveleve arsimore, institucioni i lartë arsimor ushtarak duhet të prodhojë ushtarakë të aftë, të përgatitur dhe të gatshëm për të përbushur detyrat e oficerëve të tyre urdhërues. Karakteri i institucionit të lartë arsimor ushtarak ndryshon nga institucionet e tjera arsimore, që ushqejnë zhvillimin e veprimeve të përbashkëta konstruktive, mendimin kritik, eliminimin ose pranimin e autoritetit të imponuar, pyetjet dhe të gjitha karakteristikat e tjera të veçanta që rrjedhin nga një filozofi me në qendër studentin. Sigurisht, nuk mund të thuhet se institucioni i lartë arsimor ushtarak

kërkon të shmangë zhvillimin e këtyre sjelljeve dhe mendimeve, por ai me siguri punon për t'i integruar ato me respekt e qartësi për strukturën dhe natyrën specifike të karakterit ushtarak.

Zhvillimi dhe pranimi i këtyre dallimeve është qëllimi i gjithë personelit të këtij institucioni të lartë arsimor ushtarak. Përveç pranimi të kërkesave eksplicite të punës së tyre, ata gjithashtu duhet që me shembullin e tyre dhe pedagogjinë e nënkuptuar, të promovojnë vlerat themelore të organizatës dhe kështu të kenë një efekt pozitiv në zhvillimin e kulturës unike të institucionit. Prandaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme njohja, studimi, hulumtimi dhe përmirësimi i kulturës dhe kurrikulës së tij.

1. Arsimimi dhe siguria kombëtare

Arsimimi është një nga përbërësit më të rëndësishëm të sigurisë kombëtare të një vendi dhe bëhet më i rëndësishëm kur niveli i zhvillimit të tij është më i lartë. Arsimimi, kur ofrohet dhe përdoret mirë, ka fuqinë e promovimit të sigurisë kombëtare. Kjo ndodh sepse siguria kombëtare mbulon fushën sociale-ekonomike, politike, ushtarake, kulturore, familjare, industriale, diplomatike, artistike etj., të një kombi. Kur dhe ku këto fusha, por jo vetëm, të një kombi janë të qëndrueshme, të gjalla dhe përparojnë, siguria kombëtare e kombit është e garantuar dhe anasjelltas. Për të promovuar strategjinë kombëtare nëpërmjet arsimimit, ne vlerësojmë atë që arsimimi konceptohet si dija dhe njohuritë që u jepen qytetarëve përmes sistemit arsimor. Në këtë kontekst, arsimimi mund të promovojë sigurinë e kombit. Disa nga mënyrat përmes të cilave arsimit mund të promovojë sigurinë kombëtare janë:

- **Arsimi prodhon qytetarë patriotë që do të ndihen të detyruar ndaj kombit.** Njerëzit me edukim të mirë bëjnë përpjekje për të projektuar dhe mbrojtur imazhin e mirë të vendit brenda dhe jashtë tij. "Mirë-arsimimi i brezave rrit kohezionin shoqëror, garanton ruajtjen dhe përçimin e vlerave kombëtare, si dhe rrit ndërveprimin mes vetes dhe botës së jashtme.¹" Në këtë mënyrë, ata në mënyrë direkte dhe indirekte sigurojnë stabilitetin, përparimin dhe mbrojtjen e kombit.

- **Arsimi prodhon burime njerëzore për vendin.** Qeveria me përpjekjet e saj për të kënaqur dëshirat e qytetarëve në drejtim të sigurimit të infrastrukturave sociale dhe ekonomike, krijon institucione. Këto institucione duhet të menaxhohen nga njerëz të arsimuar. Performanca e tyre dhe efektiviteti promovon sigurinë kombëtare dhe anasjelltas. Këto institucione përfshijnë jo vetëm ushtrinë, por edhe shumë institucione të tjera civile.

- **Arsimimi fuqizon ekonomikisht, politikisht dhe nga ana sociale një person ose një popull.** Një komb me njerëz të arsimuar mund të thuhet se është një komb i pasur. Arsimi i lartë ka transformuar natyrën e ekonomisë amerikane. Shtetet e Bashkuara janë kombi më i fuqishëm në botë sot, sepse ekonomia e tij është më e forta². Për më tepër, kur njerëzit janë të arsimuar, familjet janë më të mirat për të, sepse me të ardhura të rregullta, të besueshme

¹ Strategjia e Sigurisë Kombëtare, viti 2014, faqe 9.

² <http://forum.mit.edu/articles/higher-education-and-national-security/>

dhe të drejta, familjet nuk do të prishen me pasoja negative për sigurinë kombëtare.

- Arsimimi lejon prodhimin dhe angazhimin e profesionistëve në fusha të ndryshme: mjekësi; inxhinieri; punë sociale; gazetari; teknologji informacionit; inxhinieri, shkenca politike, ushtarake, etj. Këta profesionistë adresojnë nevojat e përditshme të shoqërisë dhe me ekspertizat që ofrojnë nëse nuk arrijnë t'i plotësojnë ato nevoja, atëherë rendi dhe stabiliteti shoqëror, kërcënimi ndaj sigurisë kombëtare do të ishte i pashmangshëm.

- Arsimimi, përmes sistemit të tij, ndihmon në përthithjen, trajnimin, fuqizimin dhe angazhimin e të rinjve, gjë që i mbron ata nga përtacia dhe rreziqet që lidhen me të. Nëse nuk arsimohen dhe do të jenë të paangazhuar, ata mund të përdoren për të nxitur telashe me implikime negative në sigurinë kombëtare.

- Arsimimi i mundëson njeriut të arsyetojë dhe të angazhohet në veprime racionale. Ai pasuron mendimin njerëzor dhe zgjeron horizontin e të menduarit të njeriut. Për më tepër, arsimimi i dhënë apo i marrë udhëzon veprimet njerëzore përmes arsytimit, i cili normalisht promovon rendin dhe stabilitetin, përfshirë këtu edhe sigurinë kombëtare.

Njeriu për të marrë një arsimim kalon në disa procese, në të cilat gjithsecili nuk i kushton vëmendje ndjesive të ngushta dhe fillestare. Prandaj, personat e arsimuar mirë i shmangen nepotizmit, etnisë, rajonizimit, fanatizmit fetar, etj. Kjo ndodh për shkak të kuptimit se ndërvarësia dhe ndërthurja janë fakte të jetës dhe ekzistencës njerëzore. Prandaj, arsimimi i duhur promovon tolerancën, paqen, unitetin dhe rendin, e për rrjedhojë promovojnë sigurinë kombëtare.

- Arsimimi lejon ekzistencën e një grupi intelektualësh që ndihmojnë dhe mendojnë fillimisht për konceptimin dhe zbatimin e politikave. Ata ndihmojnë në grumbullimin e të dhënave se si të promovohet dhe varet realisht siguria kombëtare. Këta intelektualë, përmes arsimimit të tyre, i ofrojnë kombit rrugët dhe mënyrat për të shmangur apo zgjidhur konfliktet dhe tensionet shoqërore. Të gjitha këto ndikojnë pozitivisht në sigurinë kombëtare.

Arsimimi i ofron një kombi një grup të madh njerëzish që mund të mobilizohen lehtësisht për veprimtari pozitive drejt përparimit njerëzor dhe të çmobilizohen në kohë tensionesh shoqërore. Kjo ndodh sepse një popullsi e arsimuar mund të kapet nga një numër mediash, duke krijuar tensione me implikime pozitive për sigurinë kombëtare.

2. Disa përkufizime për kulturën

Fjala "kulturë" është një term francez, i cili rrjedh nga latinishtja "colere" që do të thotë: përpunimi, kujdesi, ruajtja, edukimi), pra është një atribut njerëzor. Nocioni i Edward Burnett Tylor³ për kulturën përshkruhet më së miri në veprën e tij më të famshme me dy vëllime "Kultura Primitive": vëllimi i parë "Origjina e Kulturës" merret me etnografinë, duke përfshirë evolucionin shoqëror, gjuhësinë dhe mitin; vëllimi i dytë "Feja në Kulturën Primitive" merret kryesisht me interpretimin e tij të animizmit. Sipas një përkufizimi,

³ Edward Burnett Tylor (1832- 1917) është një themelues i antropologjisë moderne dhe një nga shkencëtarët e parë që përdori termin "kulturë" në kuptimin universal dhe njerëzor.

kultura përfshin zakonet, idetë, besimet e një shoqërie ose grupi shoqëror specifik. Tylor e përcakton kulturën si: “..... një tërësi komplekse që përfshin njohuri, besime, arte, moral, ligj, zakone dhe çdo aftësi dhe zakone të tjera të fituara nga një njeri si anëtar i shoqërisë.”⁴ Kultura përcaktohet në mënyra të ndryshme, në varësi të perspektivës së individit, epokës historike dhe natyrës së shoqërisë së dikujt. Përkufizime të ndryshme tregojnë se kultura është vështirë të shpjegohet, por sipas përkufizimit më të përgjithshëm, është ajo që njerëzit kanë bërë për veten dhe botën, diçka me të cilën ne jemi në gjendje të njohim identitetin e një personi, grupi, komuniteti, pakice, kombi apo populli; megjithatë, një kulturë mund të ekzistojë e pavarur nga kulturat e tjera. Për të kuptuar dhe nënkuptuar çdo kulturë, duhet të merren parasysh katër përbërës thelbësorë: sistemi politik, ekonomia, institucionet shoqërore (bankat, sistemi shkollor, niveli arsimor, forcat e sigurisë, sindikatat e punës, deri te klubet e futbollit) dhe kultura.

Hofstede⁵ e përkufizon kulturën në mënyrë sintetike, si: “..... programimi i përbashkët i mendjes, i cili i dallon anëtarët e një grupi apo kategori njerëzish nga një tjetër”.⁶ Kultura, në kuptimin e gjerë, gjithashtu nuk është e lehtë të përcaktohet, sepse ajo ndikohet nga parimet, besimet dhe vlerat që përcaktojnë perceptimin, qëndrimet, pritjet, komunikimin ndërveprues dhe format e sjelljes. Teoricieni letrar anglez, Terry Eagleton shprehet se kultura nënkupton një marrëdhënie dialektike midis artificiales dhe natyrale, pra gjithçka që bën individin në lidhje me botën dhe atë që bën bota në lidhje me individin. Njeriu jeton në natyrë dhe me natyrën dhe që në fillim përpiqet ta formësojë atë sipas nevojave të tij, domethënë të krijojë një formë të kulturës. Sipas Mai Moua⁷, një nga përkufizimet më të pranueshme dhe më të thjeshta të kulturës është: “...mbledhja ose grumbullimi i bindjeve, vlerave dhe supozimeve të përbashkëta të një grupi të caktuar njerëzish, të cilët mësojnë nga njëri-tjetri dhe u mësojnë të tjerëve se bindjet, vlerat e tyre, dhe qëndrimet janë të drejta.”⁸ Prandaj, kultura është përmbledhja e veprimtarisë njerëzore që mësohet dhe përcillet brez pas brezi dhe që zhvillohet me kalimin e kohës.

Secili prej nesh reflekton dhe shpreh kulturën e tij apo të saj. Kultura ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës të secilit dhe çdo njeri ndikon në zhvillimin e kulturës përmes punës së tij. Fatkeqësisht, jo vetëm mjedisi, por edhe qëndrimi personal i secilit mund të ketë një efekt negativ në shoqëri, nëse ai person nuk dëshiron të përshtatet me mjedisin ku jeton ose me kulturën dhe shoqërinë që e rrethon. Pastaj, shfaqen forma të padëshirueshme të sjelljes

⁴ Edward Burnett Tylor, *Primitive Culture*, Vol. 1 of 2: *Researches into the Development of Mythology, Philosophy, Religion, Art, and Custom* (Classic Reprint) Paperback – May 18, 2017, faqe 1.

⁵ Gerard Hendrik Hofstede ishte një psikolog social holandez, punonjës i IBM dhe Profesor Emeritus i Antropologjisë Organizative dhe Menaxhimit Ndërkombëtar në Universitetin Maastricht në Holandë, i njohur mirë për kërkimet e tij pionier në grupe dhe organizata ndërkulturore.

⁶ Geert Hofstede, “Identifying Organizational Subcultures: An Empirical Approach, 2002, faqe 2.

⁷ Mai Moua psikologe me grade “Doktor” dhe e specializuar në udhëheqjen dhe zhvillimin organizativ, trajnimin dhe kërkimin.

⁸ Mai Moua, *Culturally Intelligent Leadership*: Mai Moua, *Culturally Intelligent Leadership*: Released January 2011, Publisher(s): Business Expert Press, citim në faqe. 15

nga individët, të parë në intolerancën dhe qëndrimet fanatike ndaj atyre që nuk përshtaten në pikëpamjen e tyre personale për identitetin kulturor të një komuniteti. Shoqëria është një rrjet kompleks, në të cilin ekzistojnë grupe të ndryshme interesi me kulturat e tyre specifike dhe që promovojnë stilin e tyre të jetesës dhe etikën e punës në përputhje me filozofitë e tyre.

Organizata ushtarake është një grup kulturor, ku anëtarët e tij jetojnë në përputhje me vlerat e tyre. Struktura e veprimtarive të tyre të përditshme përputhet me jetën ushtarake. Ngritja e hershme, stërvitja fizike, ushqyerja në ambiente të përbashkëta, rreshtimi (formacionet), respektimi i rreptë i orarit, raportimi i rregullt etj., të gjitha zhvillojnë dhe forcojnë ndikimin e kulturës ushtarake në formimin e ushtarakëve dhe jetën e përditshme. Në ushtri, komandanti i grupit, skuadrës, togës, kompanisë etj., ka një ndikim të madh në zhvillimin kulturor. Kontributi i komandantit në krijimin e një klime pozitive reflekton sjelljen e tij personale, përmes së cilës ai demonstroi kompetencën dhe vlerat themelore të njësisë, bindjet dhe supozimet. Prandaj, nëse oficeri komandues nuk demonstroi vlerat e Forcave të Armatosura të RSH, anëtarët që i përkushtohen asaj kulture nuk do ta pranojnë komandantin si autoritet legjitim, sidomos kur veprimet e tij bien ndesh me vlerat kulturore, bindjet dhe ligjet që janë në fuqi.

3. Kultura në një organizatë ushtarake

Manuali i forcave të armatosura të Shteteve të Bashkuara e përshkruan kulturën si: "... një rrjet kuptimi të ndarë nga anëtarët e një shoqërie ose grupi të caktuar brenda shoqërisë; një sistem i besimeve, vlerave, zakoneve, sjelljeve dhe objekteve të përbashkëta që anëtarët e një shoqërie përdorin për të përballuar botën e tyre dhe me njëri -tjetrin; të mësuar, përmes një procesi të quajtur enculturation⁹ apo socializim; të ndarë nga anëtarët e shoqërisë; nuk ka "kulturë të njërës"; të modeluara, që do të thotë se njerëzit në një shoqëri jetojnë dhe mendojnë në mënyra të tilla duke formuar modele të caktuara, të përsëritura; të ndryshueshme, përmes ndërveprimeve shoqërore midis njerëzve dhe grupeve; arbitrare, që do të thotë se ushtarakët nuk duhet të bëjnë supozime në lidhje me atë që shoqëria e konsideron të mirë dhe të gabuar, të mirë dhe të keqe; përvetësimi në kuptimin që është e zakonshme, merret si e mirëqenë dhe perceptohet si "e natyrshme" nga njerëzit brenda shoqërisë."¹⁰ E thënë thjesht, akti i regjistrimit në forcat e armatosura nënkupton nënshkrimin e jetës private të një personi ndaj stilit të jetës ushtarake. Duhet kohë e nevojshme dhe përpjekje e madhe për t'u bërë një ushtar, nënoficer apo oficer.

Ushtria është një organizatë shumë e suksesshme që krijon ushtarakë të përshtatshëm për nevojat e shtetit dhe nevojat specifike. Që në fillim, individët bëhen pjesë e një kulture, në të cilën individualiteti është shtypur, kryerja e detyrave dhe misionëve ka më shumë përparësi ndaj problemeve, dëshirave personale dhe sakrificave për qëllime më të larta është pjesë e jetës së përditshme. Aspekti më i rëndësishëm për ruajtjen e vazhdimësisë në një kulturë

⁹ Përvetësimi gradual i karakteristikave dhe normave të një kulture grupi nga një person i një kulture tjetër.

¹⁰ ATP 3-24.3, Cultural and Situational Understanding 2015, Chapter 1, faqe 1-2.

(përfshirë ushtrinë) është tradita, ku tiparet e zgjedhura të sjelljes dhe veprimeve të mësuara kalohen nga brezat e mëparshëm. Kur një qytetar ndryshon ambientin nga shkolla civile dhe shkon në një mjedis tjetër p.sh., ushtarak, nuk ka një ndryshim të plotë të stilit të jetës, por specifik. Në varësi të mjedisit, perspektiva ushtarake ndryshon nga ajo civile në atë që anëtarësimi si pjesë e FA konsiderohet si një privilegj dhe nuk vihet në dyshim funksionimi i strukturës hierarkike. Personeli aktiv si pjesë e FA duhet të sillet në atë mënyrë që të mos kërcënojë besueshmërinë dhe besimin e publikut; ata duhet të kryejnë detyrat e tyre me ndërgjegje dhe përgjegjësi, duke kryer me përpikëri të gjitha detyrat që u janë caktuar, të zbatojnë legjislacionin, si dhe të respektojnë normat e tjera që përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre.

Organizatat ushtarake janë disa nga organizatat më të vjetra tradicionalisht e më të spikatura të shtetit. Ato kanë një mjedis pune specifike e, gjithashtu kanë procedura dhe kërkesa të sakta organizative dhe pune. Në dallim me civilët, personeli aktiv ushtarak dhe kadetët/studentët veshin uniforma ushtarake, ku theksojnë anëtarësimin e tyre në një kulturë të veçantë. Organizatat ushtarake kërkojnë shumë nga personeli i tyre: disponueshmëria 24-orëshe, ndërrime të veçanta të punës, një orar i rreptë i aktiviteteve të përditshme, raportim i detyrueshëm tek eprorët, respektim i pakushtëzuar i afateve, kërkesa të aftësisë fizike, sjellje me rregulla, ndalim të daljes në media pa leje, paraqitjet, zhvendosjet e shpeshta, ndalimi i organizimit të sindikatave, pjesëmarrje në parti politike, mitingje etj. Për kadetët/studentët, ushtarët, nënoficerët dhe oficerët, njohuritë dhe aftësitë ushtarake nuk janë të mjaftueshme; ato duhet të lidhen së bashku me vlera të tilla si: guximi, besnikëria, bindja, nënshtrimi ndaj njësisë dhe zotërimi i parimeve të larta morale.

Pjesëtarët e forcave të armatosura janë të vetëdijshëm se puna e tyre mund të jetë potencialisht e rrezikshme. Nëse është e nevojshme, ushtria, në mënyrë legjitime, mund të përdorë forcën për të realizuar detyrat që i janë dhënë. Masat e dhunshme janë të rrezikshme, prandaj kërkohet nënshtrimi i individit ndaj grupit. Kjo nënkupton gatishmërinë për të sakrifikuar veten për të tjerët dhe në raste ekstreme, për të dhënë jetën. Gjatë arsimit dhe trajnimit ushtarak, kadetët/studentët/ oficerët/ nënoficerët, ushtarët mësojnë dhe zotërojnë zakonet, sjelljen, vlerat dhe etikën ushtarake, duke përfshirë bindjen, ndjekjen e urdhrave dhe mënyrën e funksionimit brenda zinxhirit të komandimit ushtarak, i cili është vendimtar për suksesin e tyre. Psikologu holandez Hofstede thekson se "...ato vlera kanë anët pozitive dhe negative: të mira-të këqija, të pista-të pastra, të shëmtuara-të bukura, të panatyrshme-natyrore dhe se dallimet ndodhin ndërsa njerëzit mendojnë se si duhet të jetë bota në lidhje me atë që duan për veten e tyre.¹¹ Marrëdhënia ndaj asaj që ata duan për veten e tyre në organizatat ushtarake është dytësore, pasi e gjithë kultura e organizatës bazohet në respektimin e vlerave të përbashkëta dhe nënshtrimin e vetvetes ndaj nevojave të organizatës dhe atdheut.

Të gjitha organizatat janë të ndryshme, duke përfshirë edhe ushtrinë. Njerëzit janë unikë

¹¹ Geert Hofstede, Gert Jan Hofstede; Michael Minkov: Cultures and Organizations, Software of the Mind, Intercultural Cooperation and its Importance for Survival (Johanneshov: MTM, 2017).

për shkak të karakteristikave të tyre dalluese, por kultura organizative siguron unitet dhe identitet për çdo organizatë. Ashtu siç nuk ka në botë dy njerëz identikë, ashtu edhe është e pamundur të flitet për dy organizata identike. Sistemi bazë i menaxhimit të një organizate ushtarake në tërësi është komandimi dhe kontrolli (mbikëqyrja). Pjesëtarët e forcave të armatosura veshin uniforma ushtarake të njohura. Në uniformat e tyre pasqyrohen grada, mbiemri, specialiteti i tyre, forca që shërben dhe medaljet e tyre. Kultura ushtarake zakonisht thekson dhe forcon disiplinën, besnikërinë dhe solidaritetin, që do të thotë se mund të kërkohej angazhim shtesë nga secili individ në kryerjen e një detyre të caktuar. Kultura ushtarake përcillet brez pas brezi dhe zhvillohet si diçka që respektohet dhe gjeneron krenari te pjesëtarët e FA.

Kultura ushtarake ka veçori dalluese brenda kulturës së saj organizative. Perspektiva organizative dhe kulturore e shoqërisë është e vlefshme për fokusin e saj në format e njohurive dhe praktikave të vetë organizatës. Kjo përfshin ushtrinë, e cila ka zhvillimin dhe kuadrin e saj historik të metodave të saj të punës, rutinës, pritjeve dhe supozimeve themelore. ***Kultura organizative gjithashtu mbart në vetvete shenja të dukshme dhe të padukshme.*** Shenjat e dukshme përfshijnë simbolet sipas statusit (gradat), ceremonitë (rreshtimi, inspektimet), njoftimet, parullat apo citimet ("Dija është fuqi"), sjellja, gjuha dhe stili i veshjes, uniforma. Shenjat e padukshme përfshijnë vlera, besime, supozime, qëndrime dhe ndjenja të përbashkëta. Këto shenja të kulturës organizative formojnë një koncept shumëdimensional që supozon aspekte të ndryshme të stilit të jetesës e sjelljes, të cilat ndikojnë në lidhjet dhe ndikimin dypalësh të dimensioneve të ndryshme brenda organizatës.

Kultura ushtarake përfshin vlerat, zakonet, traditat dhe filozofitë e bazuara në një karakter të përbashkët të njohur. Kultura ushtarake formohet nga kultura kombëtare dhe faktorë të tillë si: pozicioni gjeopolitik dhe përvoja historike që ndikojnë në ushtrinë kombëtare. Nderi, integriteti, guximi dhe forca janë thelbësore për kulturën ushtarake dhe kanë një ndikim të madh në çdo aspekt të identitetit të saj kulturor. Kultura ushtarake është themeli mbi të cilin ndërtohen faktorë të tjerë, të cilët gjenerojnë rritje të përhershme. Ajo që i dallon organizatat nga njëra-tjetra janë tiparet e tyre të gjera dhe unike. Organizatat ushtarake drejtohen rreptësisht në bazë hierarkie, në përputhje me organizimin dhe kulturën e tyre të brendshme.

Kultura ushtarake është unike në vlerat e saj themelore, strukturën organizative dhe terminologjinë. Identiteti kulturor ushtarak i çdo individi rrit lidhjen midis anëtarëve dhe përputhet me rregullat, politikat dhe procedurat e organizatës. Që në fillim të edukimit apo arsimimit, personeli ushtarak pranon parimet mbi të cilat mbështetet organizata ushtarake dhe kultura e saj. Edukimi ushtarak është gjithashtu i përcaktuar qartë për secilin anëtar të organizatës, përfshirë mësimdhënësit dhe kadetët/studentët. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen qartë së bashku me qëndrimet e tyre ndaj autoritetit. Organizata ushtarake vepron sipas vendimeve, rregulloreve dhe urdhrave, me qëllim mbarëvajtjen e jetës dhe punës së saj.

4. Strukturat ushtarake dhe aspekte të arsimit në AFA

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave¹², Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe punën shkencore në Republikën e Shqipërisë dhe në përputhje me NATO-n për zbatimin e standardeve më të larta akademike në fushën e edukimit ushtarak. VKM-ja specifikon që AFA zhvillon veprimtari mësimore e shkencore në të tre ciklet e studimit në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, kryen arsimimin, kualifikimin, kërkimin shkencor dhe trajnimin në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil, për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, si dhe të institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare. Struktura organizative e AFA-së përbëhet nga njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësi të tjera. Njësitë kryesore janë Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) dhe Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU), ku njësitë bazë të tyre janë departamentet dhe qendrat. Njësitë e tjera përfshijnë struktura ndihmëse akademike me karakter administrativ, si dhe struktura ndihmëse administrative dhe trajnuese, të krijuara nga AFA në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e saj, si vend anëtar i NATO-s dhe institucion i AL. Në përbërje të AFA ka edhe struktura të tjera arsimore të përgatitjes, formimit, kualifikimit dhe trajnimit së ushtarëve dhe nënoficerëve, të cilat nuk janë subjekte të arsimit të lartë, por që janë në vartësi të AFA. Ato rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni në përputhje me Kushtetutën dhe strukturat e tjera arsimore në NATO.

Aktualisht, AFA, përveç programit të studimeve në shkenca ushtarake, bashkëpunon me universitete¹³ të tjera publike për zhvillimin e programeve të studimeve universitare në degët “navigim dhe komandim detar” dhe “teknologji informacioni në fushën e mbrojtjes”. AFA ka lidhje edhe me Qendrat Stërvitore të Komandave të Forcave/ Reparteve dhe atyre Mbështetëse të FARSH-së, të cilat janë subjekte të formimit, kualifikimit e trajnimit në specialitetin përkatës profesional ushtarak, në vartësi strukturore dhe organike të këtyre komandave. Ajo përgjigjet për standardet, vlerësimin dhe certifikimin e kurrikulave mësimore dhe programeve të stërvitjes, si dhe certifikimin e personelit që përfundon këto programe në Qendrave Stërvitore të Komandave të Forcave/ Reparteve dhe atyre Mbështetëse, me qëllim unifikimin e standardeve të cilësisë edhe në formimin dhe trajnimin profesional të të gjithë ushtarakëve të Forcave të Armatosura sipas kërkesave dhe politikave të NATO. Gjithashtu bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për regjistrimin, njohjen e programeve për zhvillimin profesional të ushtarakëve, si dhe certifikimin e personelit të trajnuar në këto qendra.

Aspekte të arsimit në AFA përfshijnë programet që aktualisht ofron ky institucion i lartë arsimor ushtarak për plotësimin e nevojave të Forcave tona të Armatosura. Tashmë këto

¹² VKM nr. 156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit të saj”.

¹³ Universiteti “Marin Barleti në Tiranë”, “Aleksandër Moisiu” në Durrës dhe “West Point”, SHBA.

programe janë: programi bachelor; pasuniversitar Kursi i Përgatitjes së Oficerit (KPO), programi i studimit të navigim dhe komandim detar; programi i studimit teknologji informacioni në fushën e mbrojtjes; si dhe programi “Master Profesional” në Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes, i cili ofrohet jo vetëm për formimin i një ushtaraku, por edhe të personelit civil, me qëllim mbajtjen e një mjedisi elektronik të sigurt e të besueshëm, në mbështetje për sigurinë në Forcat e Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Kultura, klima dhe marrëdhëniet në institucionin e lartë arsimor ushtarak ¹⁴

AFA, si institucion i lartë arsimor ushtarak, ka kulturën e tij të formuar nga kadetët/studentët e tij, personeli mësimdhënës, programet mësimore, llojet e metodave të mësimdhënies të përdorura, mjedisi, atmosfera dhe të gjitha aspektet e tjera që ndikojnë në sistemin e vlerave, besimeve dhe ndjenjave përkatëse. Aspektet e pranimit dhe mjedisi inkurajues e bëjnë institucionin e lartë arsimor ushtarak (AFA) një vend ku modifikohen dhe mbështeten sjelljet paraprake dhe ku futen forma krejtësisht të reja të sjelljes. Çdo individ në sistemin e lartë arsimor ushtarak nuk duhet të ketë ndjenjë refuzimi, izolimi ose inferioriteti. Me fjalë të tjera, organizatat ushtarake të AFA-së dhe klima e tyre kanë efekt më të madh tek kadetët/studentët/ oficerët/ nënoficerët/ ushtarët dhe gjithashtu mbi mësimdhënësit, që punojnë në këtë institucion. Roli i kulturës në AFA padyshim duhet vlerësuar, sidomos në krijimin e një bashkësie mësimdhënësish dhe programesh që ndihmojnë reciprokisht njëri-tjetrin përmes pjesëmarrjes, në mënyrë pro-aktive, bashkëpunuese dhe të përkushtuar. Kultura e secilës strukturë, pjesë përbërëse e AFA-së, mund të konsiderohet si mënyra e jetesës dhe punës, ndikimi i traditës në suksesin e saj dhe sjellje e kadetëve/ studentëve/ oficerëve/ ushtarëve/ nënoficerëve dhe mësimdhënësve. Kultura e institucionit të AFA-së, përveç kurrikulës, lëndëve, metodave të mësimdhënies, pajisjeve teknike, përfshin gjithashtu të gjithë pjesëmarrësit (personelin akademik (mësimdhënësit), personeli ndihmësakademik me karakter administrativ, personelin mbështetës, kadetët/ studentët/nënoficerët/ushtarët) me qëndrimet, mirëkuptimin, vlerat dhe besimet e tyre. AFA, si institucion i arsimit të lartë ushtarak pritet të ofrojë arsimim ushtarak përmes marrjes së njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe përgjegjësive të nevojshme për të përballuar sfidat e një bote modern e komplekse, duke bashkëpunuar dhe ndërthurur programet edhe me Akademinë Ushtarake të SHBA-së “West Point”¹⁵. Gjithashtu, AFA pritet të realizojë krijimin e kolegjit të lartë mbrojtjes¹⁶, me synim kryerjen e të gjithë programeve të kurseve të karrierës, duke përfshirë jo vetëm ushtarakët e FARSH, por edhe ushtarakë nga rajoni.

Kultura e institucionit të AFA-së ndikon në mënyrën e drejtimit të grupeve mësimore dhe në punën e vetë mësimdhënësve. Përshtypja e përgjithshme që lë AFA, qoftë ajo pozitive apo negative, ndikon në potencialin e saj kulturor. Kultura e AFA-së krijohet nga një

¹⁴ Institucioni i lartë arsimor ushtarak nënkupton Akademinë e Forcave të Armatosura dhe strukturat e saj: Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerit, Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarit, Qendra e Gjuhëve të Huaja.

¹⁵ Fjala e Kryeministrit mbajtur në akademinë ushtarake “West Point” në SHBA, datë 21.09.2021

¹⁶ Fjala e Ministrit të Mbrojtjes në Parlament, datë 16.09.2021

përzierje e bindjeve, zakoneve dhe qëndrimeve të të gjithë anëtarëve të saj dhe mjedisit ku ajo funksionon. Ndjenja e përkatësisë intensifikohet kur kadeti/ studenti/ oficeri/nënoficeri/ ushtari është jashtë këtij institucioni. Një individ identifikohet me AFA-në si organizatën e tij, gjë që i bën ata më të fortë, sepse ata nuk përfaqësojnë veten, por organizatën. Për shembull, në West Point (Akademia FA Amerikane) vlerat ushtarake¹⁷ përcaktohen qartë dhe nguliten nga të gjithë kadetët:

- a. Besnikëria, nënkupton atë që të gjithë kadetët duhet të kenë besim dhe besnikëri të vërtetë ndaj Kushtetutës së SHBA, Ushtrisë, njësisë dhe ushtarakëve të tjerë.
- b. Detyra, specifikon atë që të gjithë kadetët duhet të përmbushin detyrimet e tyre. Të bësh detyrën tënde do të thotë më shumë sesa të kryesh detyrat e caktuara. Detyrë do të thotë të jesh në gjendje të përmbushësh detyrat, si pjesë e një ekipi.
- c. Respekti nënkupton atë që gjithsecili duhet të trajtojë njerëzit ashtu siç duhet të trajtohen. Në Kodin e Ushtarakut, ata zotohen që "t'i trajtojmë të tjerët me dinjitet dhe respekt, ndërsa presin që edhe të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë".
- d. Shërbim vetëmohues nënkupton atë që gjithsecili vendos mirëqenien e kombit, të ushtrisë dhe të afërmeve të tyre para vetes. Shërbimi vetëmohues është më i madh se vetëm një person. Duke i shërbyer vendit të tyre ata po e bëjnë detyrën me besnikëri pa menduar për njohje ose fitim.
- e. Nderi nënkupton atë që secili duhet të jetojë në përputhje me vlerat e ushtrisë. Nderi është një çështje e kryerjes, veprimit dhe jetesës së vlerave të respektit, detyrës, besnikërisë, shërbimit vetëmohues, integritetit dhe guximit personal në gjithçka që bëni.
- f. Integriteti nënkupton atë cilësi, ku gjithsecili duhet të bëjnë atë që është e drejtë, ligjërish dhe moralisht. Integriteti është një cilësi që zhvillohet duke iu përmbajtur parimeve morale.
- g. Guximi Personal përbën atë cilësi ku gjithsecili mund të përballlet me frikën, rrezikun apo fatkeqësinë (fizike ose morale) dhe duhet të guxojë për ta mposhtur ato.¹⁸

Këto vlera ushtarake janë të përgjithshme dhe vlejné për të gjithë ushtarakët. Respekti ndaj tyre bën të mundur marrjen e misionit dhe të gjitha detyrave, në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin aktual. Në AFA, zhvillohet gjithashtu puna në grup dhe besimi i ndërsjellë. Rezultatet e mësimdhënies (organizimi i jetës dhe punës, hartimi i programeve, urdhrave, etj.) përfundojnë në një kohë të kufizuar, gjë që tregon punën ekipore e të koordinuar mirë. Kjo zhvillon besimin reciprok midis anëtarëve të ekipit. Në çfarëdo situatë qofshin paqe, krize apo lufte, individët kurrë nuk i marrin përsipër vetë detyrat e dhëna, por ato kryhen së bashku, si pjesë e një grupi, një skuadre, një toge, një kompanie, një batalioni ose një brigade.

¹⁷ Vlerat e ushtrisë: besnikëri, detyrë, respekt, shërbim vetëmohues, nder, integritet dhe guxim personal.

¹⁸ The United States Military Academy Strategic Plan, 2015-2021, USMA Strategic Initiatives (West Point, NY: United States Military Academy, 2015), p. 8.

Kultura e AFA varet shumë nga kurset e studentëve dhe viti i tyre i arsimimit. Nëse vlerat kulturore të AFA-së theksojnë autonominë, mësimdhënësit ndryshojnë programet kurrikulat mësimore dhe aftësohen me këto programe të reja mësimore. Për të kuptuar pse një kulturë arsimore e fortë përmirëson të mësuarit duhet të kuptojmë dy arsye, të cilat janë: e brendshme dhe e jashtme. E para është e brendshme, ku mësimdhënësi dhe kadetët/studentët nuk dinë apo kuptojnë se çfarë pritët prej tyre dhe si lidhen veprimet e tyre me zhvillimin e AFA-së. Pikërisht për këtë arsye, kultura institucionale arsimore siguron kohezion dhe kuptimin e brendshëm, gjë që e bën më të lehtë për mësimdhënësin të japë mësimin dhe kadetët/studentët të mësojnë. Arsyeja e dytë është e jashtme, shoqëria e gjykon institucionin e AFA-së nga perceptimi dhe rezultatet e saj. Ngarkesa fizike, largimet pa bërë një muaj mësim e bëjnë të vështirë sigurimin e mbështetjes së grupeve të jashtme. AFA mund të komunikojë identitetin e tij me grupet e jashtme përmes vlerave të përbashkëta, ritualeve dhe ceremonive dhe një rrjeti informal mbështetës. Bindjet, mesazhet, vlerat, sjellja, traditat dhe rutinat janë pjesët themelore të kulturës. AFA bëhet vendi ku përvetësohen dhe rafinohen gjuhë, kultura, feja dhe pikëpamje të ndryshme për botën. Edhe pse nuk ka organizata identike, secila strukturë brenda AFA-së është unike. AFA është organizatë komplekse që grupon së bashku një sistem më të madh e më të fortë. Organizimi i AFA-së është një kompozim i kulturës së organizatës ushtarake me marrëdhëniet që mbizotërojnë brenda saj. Kur kadetët/ studentët/ oficerët/ nënoficerët/ ushtarët vijnë në AFA, ata sjellin me vete veshjet, zakonet dhe mënyrat e ndryshme të të menduarit me ta. Të gjithë ata mbajnë me vete edukimin e tyre familjar, stilet e komunikimit dhe karakteristikat kulturore dhe edukative të mjedisit të tyre të fëmijërisë dhe adoleshencës. Kështu që kultura e AFA përbëhet nga disa nënkultura në secilin grup mësimor dhe nënkultura e grupit përbëhet nga identitete të ndryshme të individit. Aspektet më domethënëse të kulturës së AFA përfshijnë:

- klimën shoqërore duke përfshirë sigurinë, pranimin dhe kujdesin, të cilin të gjithë kadetët/studentët e ndiejnë dhe që duhet të jetë mikpritës;
- klimën intelektuale që çdo grup mësimor dhe atmosfera e AFA-së mbështesin dhe inkurajojnë kadetët/studentët të bëjnë përpjekje shtesë;
- ligje, rregulla dhe udhëzime ku të gjithë pjesëmarrësit janë përgjegjës për arritjen e standardeve të larta të studimit dhe sjelljes;
- zakonet dhe rutinën që duhet të pranohen nga të gjithë pjesëmarrësit;
- strukturën organizative që mundëson përgjegjësi të përbashkët për vendimmarrjen dhe zgjidhjen e problemeve, e cila ndikon në mjedisin e AFA dhe zbatimin aktual të jetës dhe punës;
- partneritetet dhe bashkëpunim me institucione të tjera të larta arsimore¹⁹, subjektet e biznesit dhe organizatat shoqërore që mbështesin punën e AFA.
- standardet e përcaktuara qartë në marrëdhëniet dhe sjelljet që ndihmojnë në krijimin e një kulture profesionale, përsosmërie dhe etike të njohur;

¹⁹ Universiteti “Aleksandër Moisiu”, në Durrës dhe Universiteti “Marin Barleti” në Tiranë.

- veshjen e uniformave, gradave dhe simboleve që lehtëson komunikimin dhe forcon zinxhirin e komandimit;
- ndarjen e kadetëve/studentëve në trupa (grup, skuadër, togë) që forcon ndjenjën e përkatësisë në një grup;
- vlerësimin zyrtar vjetor të personelit²⁰, që rrit cilësinë e zbatimit të detyrave të dhëna, sepse të gjithë janë të vetëdijshëm se puna e tyre po monitorohet dhe vlerësohet;
- ceremonitë, që shënojnë ditë të rëndësishme në historinë e institucionit dhe zhvillojnë ndërgjegjësimin e kadetëve/studentëve për respektimin e traditës;
- shpalljen publike të çmimeve dhe mirënjohjes, duke theksuar anëtarët që meritojnë dhe që janë të lavdërueshëm për organizatën;
- theksimin e detyrës dhe shërbimit, mësimi për të udhëhequr një grup/ skuadër/ togë/ kompani, drejtimin e aktiviteteve dhe procedurave të stërvitjes, paraqitjen e raporteve, etj.

Kultura e institucionit të AFA-së ndryshon nga mjedisi kulturor i përvojës së mëparshme arsimore të kadetëve/studentëve (kultura e tyre familjare, shoqërore, institucioni fetar, etj.). Ata vijnë në AFA me kulturën e tyre civile dhe një pjesë e asaj kulture bashkohet me kulturën e këtij institucioni. Kjo e bën më të lehtë identifikimin e kulturës të institucionit të AFA-së, nëse ajo ka ngjashmëri me kulturën e tyre shtëpiake. Mësimdhënësi duhet të mendojë gjithmonë për faktin se: kulturat e kadetëve/ studentëve në shtëpi janë të ndryshme nga kultura e institucionit të AFA-së dhe familjet e tyre kanë ide të ndryshme, sesi duhet të mësohen fëmijët e tyre.

6. Përfundime

Një popullsi e arsimuar është pasuria e një kombi. Kjo, jo vetëm për shkak të vlerës ekonomike që i kushtohet kontributeve të njerëzve të arsimuar, por edhe për shkak të aftësisë së tyre për të gjeneruar dhe ofruar punësim. Investimet në arsim, në dobi të popullatës janë të vlefshme, sepse ndihmojnë shumë në stabilizimin e kombit duke promovuar kështu sigurinë kombëtare.

Institucioni i AFA-së nuk është thjesht ndërtesa, klasa dhe njerëzit brenda në to; ai është sistem kompleks. Secila pjesë lidhet dhe varet nga njëra-tjetra edhe ndryshimet në një pjesë të saj shkaktojnë ndryshime tek të tjerat. Ky koncept kompleks nuk mund të vendoset brenda një strukture të fortë, por është e nevojshme të përcaktojmë atë sa më saktë që të jetë e mundur. Një institucion i lartë arsimor ushtarak si AFA nuk ekziston i izoluar; jeton brenda mjedisit dhe rendit shoqëror të vendndodhjes së tij.

Kultura e institucionit të AFA është unike dhe për këtë arsye është një sfidë e veçantë për kadetët/studentët. Ushtria dhe AFA përfshihen në të gjitha sferat e jetës së kadetëve/ studentëve dhe ndikojnë në stilin e jetës së përditshme të familjeve të tyre. Në AFA, sjellja specifike e kadetëve / studentëve, e sjellë nga familjet e tyre dhe jeta civile, modifikohet,

²⁰ Personel akademik, ndihmës-akademik administrativ dhe mbështetës.

mbështetet dhe ndryshohet në një formë të re, e cila është e pranueshme për kulturën e këtij institucioni dhe influencon vazhdimisht në marrëdhëniet, pritjet dhe sjelljen mes stafit mësimdhënës, stafit administrativ, kadetëve/ studentëve dhe mjedisit. Akademia e FA si institucion i vetëm i arsimit të lartë ushtarak që do të zhvillojë veprimtari mësimore e shkencore në të tre ciklet e studimit në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, do të kryejë arsimimin, kualifikimin, kërkimin shkencor dhe trajnimin në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil, për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, si dhe të institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare, do të japë ekspertizë (lidhur me fushat) lidhshimit civil dhe ushtarak të Republikës së Shqipërisë, për hartimin e politikës së mbrojtjes dhe formulimin e dokumenteve kryesore strategjike, hartimin e publikimeve doktrinare të FARSH, si dhe do të mbështesë FARSH dhe institucionet e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, të vendit dhe atyre partnere, duke përdorur programet simulative. Besimi i ndërsjellë zhvillohet midis kadetëve, fakultetit, institutit, qendrave dhe stafit. Në çdo situatë, individët kurrë nuk e marrin përsipër detyrën e caktuar, por ajo kryhet së bashku, si pjesë e një grupi, njësie bazë, njësie kryesore dhe institucioni. I gjithë zhvillimi i një kulture lidhet dhe varet nga të tjerët dhe ndryshimet në një pjesë mund të shkaktojnë ndryshime në të tjerat.

AFA ofron arsimim ushtarak për kadetët në formën e përvetësimit të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe përgjegjësisë të nevojshme për plotësimin e nevojave të FA, për përballimin e sfidave të botës moderne dhe operacioneve komplekse. Besimi i ndërsjellë zhvillohet midis kadetëve/ studentëve, fakultetit dhe stafit. Në një situatë të vërtetë lufte, individët kurrë nuk e marrin përsipër detyrën e caktuar, por ajo kryhet së bashku, si pjesë e një grupi, skuadre, toge, kompanie etj. I gjithë zhvillimi i një kulture lidhet dhe varet nga të tjerët dhe ndryshimet në një pjesë mund të shkaktojnë ndryshime tek të tjerët.

Si rezultat, kultura e AFA duhet të zhvillojë dhe të ruajë pozitivitetin dhe zhvillimin profesional të të gjithë pjesëmarrësve. Nënkultura e grupit ka një ndikim të madh nga kultura e strukturave të institucionit ushtarak, që konsiderohet si ndikim i brendshëm dhe gjithashtu ndikohet nga kultura e shoqërisë e më gjerë, që konsiderohet si një ndikim të jashtëm. Krahas një kulture të fortë pozitive, e cila mbështet zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe mësimin e pavarur të kadetëve/ studentëve, AFA, së bashku me qendrat e saj mësimore (QAPN, QAPU, QGJH, si edhe QS nëpër forca) duhet të bëhen vende ku mësimdhënësit zhvillohen profesionalisht dhe çdo kadet/student/oficer/nënoficer/ushtar fiton dhe forcon kompetencat që u nevojiten në jetë dhe në profesionin e tyre ushtarak.

Kultura e institucionit të lartë arsimor ushtarak ndryshon në aspektin e jetës dhe punës së kadetëve në aspektin e klimës sociale, klimës intelektuale në këtë institucion arsimor, rregullave dhe udhëzimeve që rregullojnë punën në to, strukturave të ndryshme organizative të komandave dhe aspekte të tjera, të tilla si: mënyra se si kryhen ceremonitë, vlerësimi zyrtar dhe shërbimi, në fakt, në gjithçka që e bën një institucion të lartë arsimor ushtarak të dallueshëm dhe të veçantë.

Bibliografia

- Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”
- VKM 156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit të saj”
- VKM nr. 628, datë 25.9.2019 “për miratimin e dokumentit të Rishikimit Strategjik të mbrojtjes, viti i botimit 2019.
- The United States Military Academy Strategic Plan, 2015-2021
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare, 2014.
- Strategjia për mbrojtjen kibernetike 2021-2023, Ministria e Mbrojtjes, viti i botimit 2020
- Edward Burnett Tylor, Primitive Culture Researches into the development of Mythology, Philosophy, Religion, Art, and Custom, 4th ed., vol. I (London: John Murray, 1920)
- Edward Burnett Tylor, Primitive Culture, Vol. 1 of 2: Researches into the Development of Mythology, Philosophy, Religion, Art, and Custom (Classic Reprint) Paperback – May 18, 2017
- ATP 3-24.3, Cultural and Situational Understanding, 2015.
- <http://forum.mit.edu/articles/higher-education-and-national-security/>
- Geert Hofstede, " Identifying Organizational Subcultures: An Empirical Approach, 16 December 2002.
- Geert Hofstede, Gert Jan Hofstede; Michael Minkov Cultures and Organizations, Software of the Mind, Intercultural Cooperation and its Importance for Survival (Johanneshov: MTM, 2017).
- Mai Moua, Culturally Intelligent Leadership: Released January 2011, Publisher(s): Business Expert Press, ISBN: 9781606491522

DOKTRINA, PJESË THEMELORE DHE E PANDASHME E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS ARSIMORE USHTARAKE

Kolonel Msc. Mehmet Metko
Nënkolonel (R) Alqi Nikolla
IKSHU, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Koncepti “doktrinë” përdoret në të gjitha fushat e jetës politike, fetare, sociale, kulturore ... por, një zbatim thelbësor ka gjetur dhe në fushën ushtarake. Mendimet doktrinare të bazuara në teoritë, parimet, konceptet përkatëse kanë udhëhequr prijësit ushtarakë në përdorimin e strategjive për arritjen e qëllimeve të ndryshme. Në këtë proces ciklik të vazhdueshëm, doktrinat janë ndryshuar e përmirësuar duke u zhvilluar dhe përshtatur në format e organizimit ushtarak, të llojeve të operacioneve, përdorimit të forcave, format dhe mënyrat për realizimin e objektivave strategjikë, nxitjes së zhvillimit teknologjik e deri në përballje me natyrën e sfidave të reja të shekullit XXI.

Në fushën e arsimimit ushtarak, trajtimi doktrinar si pjesë e programeve mësimore zë një vend kryesor në edukimin e ushtarakut, duke ndikuar në formimin e personelit nga qytetar, në një ushtarak me aftësi profesionale të gjera në këtë fushë. Si çdo vend edhe Shqipëria, në edukimin ushtarak bazohet tek elementet historike, traditës dhe betejave të zhvilluara, roli dhe kontributi të udhëheqësve, mënyrave si dhe përvojës së organizimeve ushtarake në vazhdimësi. Si pjesë e aleancës së NATO-s, trajtimi doktrinar i ushtarakut bazohet në njohjen dhe zbatimin e sistemit doktrinar për t'iu përgjigjur sfidave të këtij shekulli në mjedisin strategjik të sigurisë.

Transformimet e arsimimit ushtarak, të realizuara nga Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), kanë qenë në koherencë me zhvillimet më të fundit të koncepteve dhe publikimeve doktrinare, të ushtrive perëndimore të pasqyruara në mënyrë të vazhdueshme në programet mësimore. Këto programe janë të lidhura ngushtë me prirjet, ambiciet, nevojat kombëtare, kontributet ndërkombëtare me Aleancën dhe zhvillimin e kapaciteteve operacionale. Pjesë e këtij ndryshimi është dhe fusha e zhvillimit doktrinar, si një sistem që i paraprin sfidave të kohës në fushën ushtarake.

Fjalë kyçe: Koncept, doktrinë, mjedis strategjik, siguri, arsimim ushtarak, program mësimor, AFA, NATO.

Hyrje

Elementet doktrinare janë të hershme dhe pjesë e pandarë e zhvillimit shoqëror. Në veprën e tij klasike “Arti i Luftës”, i shkruar ndoshta në shekullin e katërt para Krishtit, Sun Tzu e identifikon doktrinën si një nga pesë faktorët themelorë të luftës, së bashku me ndikimin moral, motin, terrenin dhe komandimin. Në Evropë rrënjët e doktrinës ushtarake mund të gjenden në dy zhvillime të rëndësishme të shekullit XVIII: në identifikimin dhe studimin e taktikave si një degë e luftës dhe themelimin e akademive ushtarake për t’i dhënë kandidatëve oficerë një arsim zyrtar. Në fund të shekullit XIX, ushtritë e fuqive të mëdha po i kushtonin shumë kohë dhe vëmendje zhvillimit të arsimit ushtarak dhe zhvillimit të mendimit ushtarak e doktrinar.

Elemente të doktrinës në historinë e popullit shqiptar janë mbështetur mbi traditën: etapat e zhvillimit shoqëror, vlerat, parimet, format e trajnimit, strukturat, organizimin strukturor të formacioneve ushtarake për mbrojtjen e territoreve shqiptare. Në gjithë këtë histori del në pah karakteri mbrojtës në betejat e zhvilluara me pushtuesit. Përdorimi i formave, mënyrave dhe taktikave të ndryshme kanë çuar në suksese të arritjes së objektivave edhe ndaj kundërshtarëve më të fuqishëm në forca, mjete dhe pajisje. Një shembull i tillë është periudha e Skënderbeut, kundër pushtimit otoman, ku strategjitë e përdorura me mjeshtëri nga Skënderbeu i sollën lirinë territoreve shqiptare. Gjatë kësaj periudhe, vend të veçantë ka zënë zbatimi me mjeshtëri i elementeve doktrinare dhe taktikave të përdorura. Disa prej tyre ishin uniteti për bashkimin e burimeve njerëzore, përgatitjen e ushtarëve, organizimin e elementeve të zbulimit, shfrytëzimin e befasisë apo për shfrytëzimin e terrenit për realizimin e maskimit dhe fshehtësisë.

Në vijim të këtij vështrimi historik, përpyqjet institucionale për zhvillimin e fushës doktrinare kanë filluar pas shpalljes së pavarësisë dhe krijimit të shtetit shqiptar. Në këtë kohë u morën masa organizative për krijimin e institucioneve arsimore duke hedhur hapat e para në këtë fushë. Krijimi i këtyre institucioneve hasi vështirësi në lidhje me mungesën e buxhetit, infrastrukturës së nevojshme, mungesën e personelit dhe përvojës së tyre, si dhe prapambetjen në zhvillimin shoqëror të vendit.

Gjatë viteve 1958-1992, në akademitë ushtarake të vendit tonë u zhvilluan veprimtari mësimore pedagogjike dhe studimore shkencore, që lidheshin me përgatitjen e programeve të reja mësimore, metodikave, rregulloreve të luftimit, teksteve mësimore, bazës materiale didaktike dhe poligoneve. U organizuan sesione, konferenca e simpoziume shkencore dhe

janë realizuar një numër botimesh cilësore dokumentare për historinë ushtarake dhe artin ushtarak të periudhave të ndryshme. Vend të rëndësishëm zë një numër i konsiderueshëm artikujsh shkencorë dhe studime në fusha të ndryshme.

Në vitet '90, sistemi arsimor ka pësuar një kapërcim historik. Ndryshimet politike dhe era e re demokratike u pasqyruan edhe në Forcat e Armatosura. Në këtë proces u përfshinë sistemi arsimor ushtarak dhe institucionet e tij për t'u njësuar me sistemet perëndimore në fushën e edukimit ushtarak e të kualifikimit të oficerëve, me një imazhi të ri për sfidat e shekullit XXI. Ky proces është shoqëruar me reformat e ndërmarra në fushën ligjore për institucionin e mësimdhënies së FA-ve, organizimin strukturor, zgjerimin e spektrit të bashkëpunimit të institucionit brenda dhe jashtë vendit, rritjen e numrit të ushtarakëve në akademitë e vendeve të NATO-s dhe SHBA, rritjen efektivitetit dhe përshtatjen me sistemin doktrinar të NATO-s, si modeli më i mirë në drejtim të fushës doktrinare dhe mendimit ushtarak.

2. Doktrina dhe disa veçori të saj

Përkufizimet e doktrinë në përgjithësi, por dhe në vendet me një traditë të pasur doktrinare në thelb janë të njëjta por forma e të shprehurit ndryshon. Ndryshimi është i lidhur me modelin kombëtar të vlerësimit të faktorëve shoqërorë, strategjikë, operacionalë, taktikë, modeleve dhe parimeve të suksesshme, mjedisit dhe zhvillimit të mendimit ushtarak sipas periudhave të zhvillimit shoqëror.

Termi “doktrinë” vjen nga latinishtja “*doctrina*”, që do të thotë “ajo që mësohet”. Doktrina është një grup njohurish, që rrjedh kryesisht nga studimi dhe analiza e përvojës praktike, diçka që mësohet në interes të një qëllimi. Doktrina nuk është dogmatike, por ka për qëllim të udhëzojë, të këshillojë dhe të ndryshojë në të ardhmen. Ajo përbëhet nga një grup besimesh rreth natyrës së luftës dhe çelësit të suksesit në fushën e betejës. Ajo nxjerr parimet e luftës nga përvoja ushtarake të suksesshme dhe komandantëve të tyre. Në vijim të këtij koncepti doktrina është ura midis mendimit dhe veprimit.

Clausewitz, në librin e tij “Për Luftën”, ka thënë: “Doktrina është një udhëzues për këdo që dëshiron të mësojë për luftën nga librat: ajo të ndriçon rrugën, të lehtëson përparimin, të trajnon gjykimin dhe të ndihmon për të shmangur kurthet. Doktrina ka për qëllim të edukojë mendjet e komandantëve të ardhshëm ... por ajo nuk shoqëron ata në fushat e betejës”.

Në jetën e përditshme, doktrina mund të përshkruhet më së miri si një përvojë e distiluar, rregulla të përgjithësuara të angazhimit, “mënyra më e mirë” për të cilën bie dakord për të bërë diçka, prej eksperiencës së përsëritur. Në formën më të thjeshtë, doktrina është ajo që aprovohet zyrtarisht për t'u mësuar në shkolla e akademi apo repartet ushtarake në operacione e stërvitje, në lidhje me metodat që duhen përdorur për të arritur realizimin e objektivave ushtarakë. Kontradikta në përmbajtjen e doktrinave qëndron në faktin se si ajo që mësohet, përballlet me situatën konkrete të një operacioni në zhvillim. Kjo, pasi e ardhmja është thjesht e panjohur, kërkon shumë përvojë, imagjinatë krijuese dhe se ndikimi

i faktorëve në mjedisin e operacionit ndryshon.

Prandaj Doktrina Ushtarake përkufizohet si “Tërësia e parimeve themelore nëpërmjet të cilave forcat ushtarake drejtojnë veprimet e tyre për arritjen e objektivave të përcaktuara. Ajo është autoritare, por kërkon gjykim në zbatimin e saj”¹.

Doktrina ushtarake i referohet tërësisë së teknikave, strategjive dhe praktikave të destinuara për konfrontimet e luftës, në mënyrë që të arrihet fitorja. Përmbajtja e saj përshtet nga nocione teorike, praktike. Nëse do të duhej ta përcaktonim doktrinën në një fjali të vetme, përkufizimi i saj do të ishte: Doktrina është një përfaqësim i prekshëm i sistemit të besimit institucional të një ushtrie në lidhje me mënyrën se si ushtaraku e kupton atë, përgatitet dhe zhvillon aktivitete ushtarake. “Doktrina i siguron një organizimi ushtarak filozofi të përbashkët, gjuhë të përbashkët, qëllim të përbashkët dhe bashkim përpjekjesh”².

Nga ky përkufizim mund të nxjerrim disa veçori:

Së pari, doktrina ndryshon nga teoria sepse është institucionale. Edhe nëse një pakicë e konsiderueshme e anëtarëve të institucionit nuk pajtohet me doktrinën, ajo megjithatë mbetet një përfaqësim i besimeve institucionale të një ushtrie. Miratimi zyrtar dhe atributi institucional i doktrinës dhe manualeve e simbolizojnë atë duke i dhënë dhe atributin autoritar.

Së dyti, doktrina bashkëkohore merr formën e dokumenteve të shkruara, sipas organizimit strukturor ushtarak, niveleve të saj dhe llojit të operacionit. Ajo shpreh metodologjinë për zbatimin e procedurave të njëjta, të nxjerra nga provat dhe sukseset e provuara më parë. Përmbajtja e saj shërben si shtyllë kurrizore për të integruar mjeshtërinë e të luftuarit, lidhjen organike dhe funksionale të strukturave në një operacion të mundshëm. Ky standard është bërë i zakonshëm në ushtritë perëndimore dhe aleancën e NATO-s, tashmë pjesë e së cilës jemi dhe ne. Doktrina e shkruar nuk ka ekzistuar përherë brenda forcave të armatosura, megjithatë, sistemi i besimit që qëndron në themel të tij ka qenë gjithmonë një pjesë e kulturës ushtarake. Historia e doktrinës së shkruar është pasqyrim i marrëdhënieve në zhvillim midis ushtarakëve, shteteve dhe popujve të tyre. Megjithatë sot, doktrina e shkruar është forma më e pranuar e mendimit ushtarak brenda ushtrive perëndimore. Kjo lloj doktrine ka një histori rreth katërqind vjeçare në vendet e zhvilluara.

Së treti, doktrina është natyrë e të mësuarit dhe njohëse, që realizohet si pjesë e rezultatit të një procesi të analizës dhe vlerësimit të shpërndarjes së njohurive. Rëndësia e saj shprehet dhe në raportin e duhur të programeve mësimore të akademive ushtarake. Për strukturat ushtarake ato mbeten si busull orientimi në edukimin e ushtarakut dhe përmbushjen e misionit. Ajo mund të ketë karakter subjektiv, kur paraqet një përfaqësim jo të plotë të realiteteve të mjedisit. Ajo është e lidhur ngushtë me dinamikën në fushën e interpretimit të parimeve të luftës në dritën e rrethanave aktuale.

¹ AJP-01 “Allied Joint Doctrine”, Edition E, Version 1, February 2017, chapter I, page 1.

² General George H. Decker, US Army Chief of Staff, 1960-1962, Doctrine for the Armed Forces of the United States, 12 July 2017.

Së katërti, raporti doktrinë-koncept-parim. Shpesh përfytyrohet se doktrina dhe koncepti janë e njëjta gjë. Në fakt, në kontrast me doktrinën, termi “koncept” paralajmëron një risi, shpreh origjinalitet dhe sprovë për të hyrë në të panjohurën e luftës së ardhshme. *Koncepti* është një hipotezë, e sapokrijuar nga një individ apo grup i caktuar në përfytyrimin e një operacioni në përdorimin e forcave, që shërben si paradhoma e doktrinës së ardhshme.

Parimet, si pjesë e doktrinës, e bëjnë më të lehtë zbatimin e kërkesave doktrinare. Ndryshe nga doktrina e cila prezanton se “si bëhet diçka”, parimi ka qëllim të theksojë një ide kryesore, duke e pranuar si një aksiomë të provuar më parë nga përvojat e mëparshme. Roli i tyre është të thjeshtësojë operacionet njohëse dhe analitike të stafëve dhe komandave, me qëllim kursimin e kohës në gjetjen e zgjidhjeve të situatave të paqarta, që shpesh krijohen rëndom gjatë operacioneve dhe luftës. Parimet e luftës, sipas Napoleonit, janë ato që kanë rregulluar kapitenët e mëdhenj, veprat e të cilëve na janë dorëzuar nga historia: Aleksandri, Hanibali, Cezari, Gustavus Adolphus, Turenne, Princi Eugene dhe Frederiku i Madh. Historia e fushatave të tyre, e shkruar me kujdes, do të ishte një traktat i plotë mbi artin e luftës, parimet që duhet të ndiqen në luftën sulmuese dhe mbrojtëse. Jo çdo parim është i përshtatshëm për çdo rast, sidoqoftë, parimet e luftës mund të përdoren si një listë-kontrolli praktike për të ndihmuar gjykime të shëndosha nga arkitektët dhe vlerësuesit e teorive, koncepteve dhe planeve strategjike, me kusht që ato të administrohen në mënyrë të arsyeshme. “Parimet themelore të doktrinës përshkruajnë se si Forcat e Armatosura duhet të planifikohen, përgatiten, mbështeten, drejtohen, komandohen, angazhohen, bashkërendohen, të përfundojnë operacionet dhe të bëjnë vlerësimin e tyre.”³

Së pesti, doktrina dhe strategjia. Strategjia ka të bëjë me një nivel të lartë, e cila përfshin politikat prioritare të një shteti për mbrojtjen. Për zbatimin e saj marrin pjesë të gjitha burimet e fuqisë kombëtare të vendit. Strategjia ushtarake është arti dhe shkenca e përdorimit të forcave të Armatosura për zgjidhjen e detyrave të politikës së mbrojtjes, nëpërmjet përdorimit të forcës ushtarake ose kërcënimit për përdorimin e saj në realizimin e objektivave kombëtarë. Strategjia ushtarake është mbështetja e të gjitha doktrinave ushtarake dhe krijon kornizën për përdorimin efektiv të forcës. Raporti i doktrinës me strategjinë në këtë rast është pjesë përbërëse e instrumentit ushtarak. Strategjia merret me “çfarë” duhet bërë, doktrina merret me “si” duhet bërë.

3. Roli i doktrinave në fushën operacionale

Historia e zhvillimit të mendimit ushtarak është e mbushur me shembuj të shumtë në zbatimin e doktrinave, shembuj të suksesit dhe të dështimit në fushën e operacioneve. Kjo ndodh për arsye si më poshtë:

Së pari, doktrina ka dhënë një udhëzim të gabuar, ndoshta për faktin se sistemi i besimit që qëndron në themel të tij nuk ka marrë parasysh disa faktorë të rëndësishëm të mjedisit të operacionit si (faktorin politik, gjeografik, religjioz, ekonomik, social, teknologjik etj.) Këtu, doktrina është si një foto e një cope të vogël makine, e cila nuk i jep praktikuesit asnjë

³ DP-01, edicioni dytë; parathënia.

ide se çfarë mund të jetë vetë makineria. Një shembull në botën reale të situatës së parë është zbatimi i doktrinës gjatë luftës së Vietnamit.

Së dyti, doktrina ka dhënë udhëzimin e duhur, por në një kohë të gabuar, mbase sepse sistemi i besimit institucional ishte i papërshtatshëm për rrethanat në të cilat institucioni po kryente aktivitetet e tij. Këtu, fotografia është një portret i vjetër familjar bardh e zi, që nuk mund të rikrijohet në kushtet e një situatë reale. Një shembull është përpjekja për të aplikuar të njëjtën doktrinë të suksesshme të aplikuar në Irak edhe në Afganistan. Por Afganistani kishte tjetër natyrë faktorësh që duhet të mbaheshin në konsideratë gjatë operacionit. Për sa thamë më lart, vlen të përmendim fjalën e urtë popullore se “nuk mund të kalosh dy herë në të njëjtën rrugë”.

Rasti i Afganistanit mbetet një shembull studimi për fushën politike - ushtarake dhe doktrinare. Mbase jemi në kohën e duhur për të bërë një analizë fillestare për Afganistanin, pasi edhe operacionet ushtarake kanë një limit kohor dhe nuk mund të vazhdojnë pa pushim. Edhe pse operacioni vazhdoi për 20 vjet, për luftimin e terroristëve dhe asistencë për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të FA afgane, me largimin e koalicionit, institucionet e tij nuk mbijetuan. Arsyet janë të lidhura me faktorë të brendshëm të Afganistanit, si: kultura politike, zhvillimi religjioz, ekonomik, arsimor, roli dhe funksionimi i institucioneve shtetërore në kontrollin e territorit, respektimi i të drejtave të njeriut, zgjedhjet elektorale jo gjithëpërfshirëse në pikëpamje të pjesëmarrjes si dhe shtrirjes në gjithë territorin administrativ, korrupsioni i theksuar në të gjitha hallkat e institucioneve, mungesë motivi për të luftuar talebanët edhe pse ushtria dhe policia përbëheshin nga 350 mijë personel.

Në disa raste, ndërtimi i shtetit nga lart-poshtë ka dhënë rezultat si për shembull, dinastia “Qin” në Kinë ose Perandoria Osmane, por modeli është ndërtuar me kompromis dhe bashkëpunim me institucionet shtetërore të këtyre vendeve. Në këtë rast institucionet afgane u panë si imponuese të dëshirave të masës së kësaj shoqërie, ndërkohë që institucionet shtetërore nuk ndërtuan legjitimitet për të siguruar një mbështetje popullore. Strategjia e ndjekur për krijimin e shtetit afgan nga lart-poshtë duhet të merrte në konsideratë traditën shtet formuese të këtij vendi. Qysh herët, afganët e perceptuan praninë amerikane si një operacion të huaj që synonte të dobësonte shoqërinë e tyre.

Së treti, kemi raste të zbatimit të suksesshëm të doktrinës në historinë e mendimit ushtarak. Shembuj të tillë ka shumë por po përmendim zbatimin e doktrinës së Luftës “Air Land të Ushtrisë Amerikane” që padyshim kontribuoi në fitoren e Luftës së Gjirit në vitet 1990-1991.

Doktrina amerikane dhe ajo britanike janë bazë e zhvillimit të doktrinave të NATO-s. Përvoja në fushën doktrinare është e ndryshme në vende të ndryshme. Nevoja për t’u përgatitur dhe, nëse është e nevojshme, për të luftuar dhe fituar në luftë, pranohet si funksioni më i rëndësishëm që forcat e armatosura mund të kryejnë. Në doktrinën Britanike thuhet se: “Çdo anëtar i forcave të armatosura duhet të jetë i përgatitur të luftojë dhe të vdesë për çfarëdo kauze legjitime që Mbretëria e Bashkuar po ndjek përmes përpjekjeve

ushtarake. Nga kjo rrjedh gjithashtu se doktrina duhet të ketë në themel të saj një etik luftimesh. Lufta është një biznes i përgjakshëm dhe shkatërrues. Në thelb bëhet fjalë për zbatimin e qëllimshëm të dhunës vdekjeprurëse, zakonisht nga të dy palët kundër njëritjetrit, por gjithnjë e më shumë në modele më komplekse. Për shkak të natyrës shkatërruese të luftimeve, ata që përfshihen janë të detyruar të durojnë një kërcënim të vazhdueshëm për jetën dhe mirëqenien e tyre. Ata vetë do të përpiqen të krijojnë të njëjtën frikë në mendjet e armikut të tyre. Natyra dinamike dhe shkatërruese e këtij shkëmbimi prodhon pasiguri masive, konfuzion, kaos dhe një braktisje të pashmangshme të planeve fillestare për zhvillimin e luftës. Me të dy palët që përpiqen të fitojnë përparësi, befasia dhe tronditja do të jenë një kufizim i burimeve, si fizike ashtu edhe mendore. Për ata që nuk e kanë provuar atë, do të jetë e vështirë të imagjinohet se sa e kërkuar dhe e frikshme është një proces lufte. Askush nuk mund të jetë i sigurt se si ai ose ajo do të reagojë ndaj luftës. Frika është e zakonshme, madje edhe në mendjen e atyre që janë më të kushtëzuar për të përballuar sfidat, guximi dhe udhëheqja e shoqëruar me kohezionin dhe disiplinën e njësisë janë kundërvëniet më të mira për atë frikë. Burrat dhe gratë më trima janë të frikësuar, por është aftësia e tyre për të vazhduar pavarësisht nga frika e tyre, që është masa e guximit. E rëndësishmja nga natyra e saj, veprimtaria ushtarake ka të bëjë me përballimin e rrezikut dhe menaxhimin e tij. Padyshim që nuk ka të bëjë kurrë me shmangien e rrezikut, profesioni ushtarak nuk është për ata që janë larg rrezikut ”.⁴ Edhe pse ky paragraf është pak i gjatë, përmbajtja e tij tregon një panoramë të qartë të luftës dhe rolit të elementeve të doktrinës në aspekt të të vepruarit në një situatë luftarake dhe që në fund, fiton mjeshtëria e zbatuar përballë përfytyrimit të krijuar në kushtet e reja.

Në NATO doktrina përcaktohet: si parime themelore me të cilat forcat ushtarake drejtojnë veprimet e tyre në mbështetje të objektivave. Ajo është një dokument autoritar por kërkon gjykim në zbatim⁵. Gjatë viteve 1990, NATO njohu nevojën për të rishikuar doktrinën ekzistuese. Mbi bazën e qasjes amerikane, u mor një vendim për të krijuar një hierarki të botimeve të doktrinës. Në krye të kësaj hierarkie, guri i themelit të botimeve është botimi i Doktrinës së Përbashkët (AJP-01), si doktrina kryesore dhe e përgjithshme e NATO-s. Dhe poshtë kësaj doktrine u krijua një hierarki doktrinash, që startonin me AJP-2-Inteligjenca e Përbashkët, AJP-3.... dhe një seri manualesh, procedurash dokumentesh sipas fushave, nivelit operacional dhe llojit të operacioneve.

Niveli më poshtë përfshin botimet që mbështesin kryerjen e operacioneve të përbashkëta dhe shumëkombëshe. Këto botime përshkruajnë kontributin e përbërësve të ndryshëm (forcat tokësore, ajrore dhe detare) dhe gjithashtu aktivitetet themelore siç janë operacionet e përbashkëta speciale, të kryera në mbështetje të operacioneve të përbashkëta dhe shumëkombëshe. Duke ratifikuar botimet e aleancës, shtetet anëtare mund t'i përdorin ato në interes të pjesëmarrjes së strukturave në operacione me aleancën por dhe në zhvillimin e doktrinës brenda kontekstit kombëtar.

⁴ UK Defence Doctrine Joint Doctrine Publication 0-01 (JDP 0-01) (5th Edition), dated November 2014.

⁵ NATO Term – NATO Agreed. NATO Term is the official NATO terminology database.

4. Trendet e zhvillimit dhe implikimet doktrinare në operacionet ushtarake

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë gjërat filluan të ndryshojnë. Ndryshimet në situatat politike rajonale dhe globale patën implikime dhe në operacionet ushtarake. Si pasojë, doktrina pësoi një ringjallje të re, si nevojë e zhvillimeve të pritshme. Doli në pah rëndësia e shtuar e operacioneve të menaxhimit të krizave, ndryshoi spektri dhe natyra e operacioneve dhe përballimi i tyre kërkonte intensifikimin e bashkëpunimit midis forcave të vendeve të NATO-s dhe BE-së. Kjo situatë nënkuptonte që doktrina “e vjetër” kishte nevojën e rishikimit drejt një doktrine të re.

Në fushën doktrinare, shekulli i ri do të ketë ndryshime universale si rrjedhojë e ndryshimit dhe influencës së elementeve dhe faktorëve që sjellin edhe ndryshime madhore në përdorimin doktrinar. Këto ndryshime janë të lidhura me rritjen e pasigurisë globale, zhvillimin teknologjik, revolucionin në spektrin e epokës së informacionit, kërcënimet në fushën kibernetike, risitë në inteligjencën artificiale, daljen në skenë e armatimeve të reja, përdorimin e mjeteve të drejtuara në distancë etj.

Ndryshimet në ngrohjen globale do të ndikojnë në zhvillimin e operacioneve në kushte ekstreme, në konflikte të reja për sigurimin e ujit, energjisë e për rrjedhojë nxisin ndryshime demografike të popullsisë. Faktorët natyrorë do të jenë më prezentë në dëmtimet njerëzore apo situatat pandemike; është rritur nevoja e mbështetjes logjistike dhe transportit strategjik për dislokim, janë rritur përmasat e zonës së sigurisë dhe interesit, natyra e konflikteve sot kërkon më shumë masa parandaluese dhe gjithëpërfshirëse. Ka ndryshuar natyra e luftimeve, forma e organizimit, lufta frontale është kufizuar, koncepti për hapësirë tokësore po thellohet me zotërimin dhe shfrytëzimin e shtresave të hapësirës ajrore, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë mirëmbajtjes dhe sigurisë së armëve të dëmtimit në masë etj. Të gjitha këto kërkojnë një analizë dhe vlerësim për zbatimin e koncepteve të reja në përdorimin e forcave dhe mjeteve; ato kanë tashmë një ndikim thelbësor dhe në fushën doktrinare të Aleancës.

Në Doktrinën e Përbashkët të FARSH theksohet: “Ndërsa ndjekim me vëmendje zhvillimet rajonale dhe globale në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, si dhe rreziqet që mund të lindin nga këto zhvillime, kjo doktrinë mund të përshtatet me shpejtësi për të pasqyruar në kohë përgatitjen dhe reagimin e menjëhershëm të FARSH. Kjo doktrinë do t’iu mundësojë komandantëve dhe drejtuesve të lartë ushtarakë aktualë dhe atyre të së ardhshmes së FARSH, organizimin, përgatitjen, stërvitjen dhe realizimin me sukses të operacioneve ushtarake, brenda dhe jashtë vendit dhe Forcave tona të Armatosura, transformimin dhe modernizimin e tyre për të përballuar me sukses sfidat e reja të sigurisë. Edhe sistemi arsimor ushtarak në institucionin e AFA, organizon zhvillimin e programeve mësimore mbi bazën e kërkesave të kësaj doktrine. Thelbi saj është përgatitja e oficerit të ri, për përballimin e sfidave të këtij shekulli.”⁶

Në samitin e mbajtur më 14 qershor 2021, NATO shpalli axhendën e saj të zhvillimit “NATO

⁶ Marrë nga DP-01 edicioni dytë; Parathënia.

- 2030". Në fjalën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, duke folur mbi konceptin e ri të zhvillimit, theksoi se "NATO po vazhdon të përshtatet për të na mbajtur të sigurt në këtë dekadë dhe më gjerë. Nisma e NATO-s 2030 ka të bëjë me sigurimin, që Aleanca jonë të jetë gati sot për t'u përballur me sfidat e së nesërme." ⁷

Doktrinat ushtarake, programet mësimore duhet të marrin në konsideratë synimet dhe objektivat e NATO-s 2030. Përvoja e deritanishme duhet të vihet në shërbim të ndryshimeve të reja. Kjo strategji orienton dhe kërkon domosdoshmërisht zhvillimin e prioritetëve në drejtimin e duhur, zhvillimin e kapaciteteve operacionale në përgjigje të sfidave të reja, përmirësimin e komandim-kontrollit, ndryshime strukturore të nevojshme, nxitjen e debatit dhe mendimit shkencor, shfrytëzimin e zhvillimit teknologjik në interes të sigurisë. Koncepti i ri i Aleancës thekson se është më mirë të parandalosh një krizë apo konflikt se sa të zhvillosh atë. Në pikëpamje doktrinare kjo kërkon informacion në kohë reale, përgatitjen e planeve të sakta, lëvizje të shpejta dislokuese, kapacitete operacionale efektive, komandim-kontroll të sigurtë, mbështetje logjistike të qëndrueshme. ⁸

Gjenerali Tod D. Wolters në një seminar të doktrinës shpreh: "Ne jetojmë në një botë gjithnjë e më komplekse dhe të kontestuar. Pasiguria politike, konkurrenca e energjisë dhe përhapja e teknologjisë përçarëse po theksohen në rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Kërcënimet dhe sfiduesit kërkojnë të përfitojnë nga këto kushte përmes veprimit agresiv duke përdorur të gjitha instrumentet e fuqisë kombëtare të mbështetura nga forca ushtarake gjithnjë e më të afta. Kundërshtarët i amplifikojnë këto veprimtari malinje dhe nxisin paqëndrueshmëri, dezinformim dhe fushata destruktive kibernetike, duke testuar qeveritë kombëtare dhe institucionet shumëkombëshe. Nëse lihen të pakontrolluara, këto aktivitete mund të kalojnë në një sjellje më agresive. Tani kërcënimi është 360 gradë dhe kriza mund të vijë nga kudo." ⁹

Një nga karakteristikat e operacioneve në këtë shekull është Qasja Gjithëpërfshirëse, e cila kërkon pjesëmarrjen dhe angazhimin e shumë organizmave dhe institucioneve në menaxhimin e krizave të këtij shekulli. Kjo qasje është bërë e njohur nga aleanca në samitin e Rigës në nëntor 2006. Thelbi i saj është integrimi i shumë aktorëve të tjerë, kombëtarë, ndërkombëtarë dhe joqeveritarë në operacion. Përvoja e fundit ka treguar se operacionet për mbështetjen e paqes kërkojnë zbatimin e pushtetit politik, diplomatik, ekonomik, financiar, informues. Situata të tilla kërkojnë angazhimin bashkëpunues të të gjithë elementëve të nevojshëm civilë dhe ushtarakë të fuqisë ndërkombëtare për t'i dhënë fund armiqësive dhe vendosjen e rendit. Angazhimi i NATO-s në një qasje gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e krizave lehtësohet përmes ndërveprimit civil-ushtarak i cili zbatohet për të gjitha nivelet. Qëllimi i NATO-s është të rrisë parandalimin si një element thelbësor të mbrojtjes së saj

⁷ Stoltenberg, NATO SAMIT 14 6 2021.

⁸ Public Diplomacy Division (PDD) – Press & Media Section- E-mail: moc@hq.nato.int Follow us @NATO-press www.nato.int

⁹ Seminari i Doktrinës Ushtarake të Nivelit të Lartë të OSBE: Fjalët e Hapjes nga Gjenerali Tod D. Wolters 9 shkurt 2021.

kolektive dhe të kontribuojë në sigurinë edhe më gjerë.

Bazuar mbi këtë analizë të re të sigurisë, axhenda “NATO 2030” synon të thellojë konsultimin politik brenda aleancës, të forcojë aftësitë penguese dhe mbrojtëse dhe të rrisë elasticitetin në përgjigje të çdo krize, e cila do të shkojë paralel me investimet dhe zhvillimet në fushën e teknologjisë, trajnimit, masat për ndryshimet klimaterike dhe formulimin e Konceptit të Ardhshëm Strategjik të Aleancës. Nga këndvështrimi ushtarak, qasja gjithëpërfshirëse bazohet në njohjen e përbashkët të situatës dhe pranimin e faktit që, shpesh, aktorët joushtarakë mund të mbështetin aktorët ushtarakë dhe anasjelltas.¹⁰

Në mbështetje të kësaj qasje NATO, zhvilloi më tej atë që ne e quajmë koncept për parandalimin dhe mbrojtjen e zonës Euro-Atlantike ose “DDA” të reagimit të përbashkët, në të gjithë gjerësinë e fushës së përgjegjësisë 360-gradë, 24/7. Nëpërmjet kësaj strategjie Aleanca do të vazhdojë masat për rritjen e ndikimit në zonën e përgjegjësisë dhe më gjerë, zbatimin e masave parandaluese, për të pasur reagimin e duhur në kohën dhe vendin e duhur. Ndërsa NATO vazhdon të forcojë këto shtylla të luftës në shekullin 21, do të ndryshojë konceptet doktrinare, njëkohësisht do të zhvillojë aftësitë operacionale, do krijojë forca dhe formacione të reja, përmirësojë transparencën, ndërveprimin në mënyrën më të shpejtë në krahasim me kundërshtarët tanë të mundshëm.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në Konferencën e Sigurisë së Mynihut, në shkurt të vitit 2021 ka theksuar se: “ne duhet të demonstrojmë përkushtimin tonë për solidaritetin transatlantik jo vetëm me fjalë, por me vepra”. Më tej, ai do të shprehej: “NATO është platforma unike që bashkon Evropën dhe Amerikën e Veriut, çdo ditë. Aleatët duhet të angazhohen për këshillime për të gjitha çështjet që ndikojnë në sigurinë tonë”¹¹. Stërvitja “Defender Europe 21” pasqyroi pikërisht këtë frymë, ajo ishte një stërvitje e përbashkët shumëkombëshe në reagim të krizave. Kjo stërvitje synoi rritjen e nivelit të gatishmërisë dhe realizoi ndërveprimin midis ushtrisë së SHBA-së, NATO-s dhe ushtrive partnere, në mënyrë që bashkërisht të jemi të përgatitur për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi. Stërvitja i shërbeu rritjes së garancisë së sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Detit të Zi dhe në mbështetje të aktiviteteve në Evropën Veriore dhe Afrikë.

Siç dhe është shprehur ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi: “Bëhet fjalë për një ngjarje historike, e cila është stërvitja më e madhe e ndodhur ndonjëherë në Shqipëri dhe rajon. Është një stërvitje, e cila jep mesazhe të rëndësishme për rëndësinë strategjike të Shqipërisë dhe për rolin që vendi ynë ka dhe do të ketë në të ardhmen në të gjitha zhvillimet gjeopolitike duke pasur në krah aleatë shumë të fortë”.¹²

Kjo stërvitje demonstroi aftësinë e SHBA-së për të shërbyer si një partner strategjik sigurie. Stërvitja “Defender Europe 21” përfshiu një numër më të madh kombesh aleate

¹⁰ AJP-01 “Allied Joint Doctrine”, Edition E, Version 1, February 2017, chapter II, page 6.

¹¹ Konferenca e Sigurisë së Mynihut, shkurt 2021.

¹² Ministria e Mbrojtjes, Ministri Peleshi inspekton përgatitjet e FA për “Defender 21”: Presim stërvitjen më të madhe të zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri, MOD.GOV.AL, 29 prill 2021.

dhe partnere të NATO-s. Ajo zhvilloi aktivitete të njëkohshme në më shumë se 30 zona, të shtrira në 12 vende. Pjesëmarrja dhe kontributi i FA të vendit tonë si vend pritës ishte shumë i rëndësishëm dhe një shkollë për eksperiencën e krijuar, njohjen dhe zbatimin e procedurave doktrinare.

Konfliktet e reja dhe mbështetja ligjore ndërkombëtare, përdorimi i forcës në të drejtën ndërkombëtare. Ekzistojnë tre kriteret themelore në të drejtën ndërkombëtare, sipas të cilave NATO mund të veprojë si një organizatë ndërkombëtare e bashkëpunimit politik dhe ushtarak. Këto janë: mbrojtja kolektive, të përcaktuar në Nenin 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut se sulmi ndaj një vendi anëtar është sulm ndaj NATO-s, në mandatin e dhënë nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për menaxhimin e krizës (kapitulli VII) ose bazuar në një ndërhyrje me ftesë të qeverisë legjitime të shtetit pritës të kombit. E drejta e qenësishme për pavarësi politike dhe respektimi i integritetit territorial të shteteve të tjera, janë dy nga parimet themelore që rregullojnë marrëdhëniet miqësore midis shteteve në sistemin ndërkombëtar. Por shekulli ri do të ketë një spektër më të gjerë dhe konflikte të reja të cilat do kërkojnë ndryshime dhe përmirësime të misionit të institucioneve ndërkombëtare të sigurisë dhe të drejtës ndërkombëtare për ndërhyrje. Rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla, i cili mbështet sigurinë, lirinë dhe prosperitetin e aleatëve, është nën presion nga vendet autoritare, si Rusia, Kina dhe faktorëve të rinj ndikues mbi sigurinë.

Njohja e të drejtës ndërkombëtare është pjesë e doktrinës përgjithshme të FARSH, përgatitjes së lidershipit dhe personelit kontribuues të FA shqiptare në operacione me NATO-n. “Kjo kërkon si domosdoshmëri njohjen e ligjit të luftës, përdorimin e forcës, të drejtat themelore të njeriut, procedurat me robërit e luftës, të plagosurit, të sëmurët dhe civilët, të drejtat dhe detyrimet e luftëtarëve”¹³.

Shpenzimet globale të mbrojtjes. Ndryshimet relative në shpenzimet globale të mbrojtjes mund të jenë një komponent i rëndësishëm i ekuilibrit të ardhshëm të fuqisë ushtarake dhe fushës doktrinare. Buxhetet ushtarake do të ndikojnë në aftësitë mbrojtëse të cilat do të ndikojnë në qëllimet politike, ambiciet dhe ndikimin e vendeve. Vendet e Aleancës kanë rënë dakord dhe po vazhdojnë arritjen e objektivit 2% të GDP, si garanci e zhvillimit kapaciteteve operacionale, i cili mbetet objektiv dhe i vendit tonë.

Teknologjia dhe transformimi ushtarak. Teknologjia vazhdon të jetë një nxitës kryesor i ndryshimit doktrinar në fushën e operacioneve dhe do të paraqesë kërcënime të reja dhe forma dhe mundësi të reja të luftimit. Ndërsa qasja në teknologji bëhet më e përhapur, do të ketë mundësi më të mëdha për kundërshtarët për të zhvilluar mjete efektive për sulme të drejtpërdrejta dhe indirekte kundër kombeve të Aleancës. Shekulli i ri lidhet me progresin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit, bioteknologjisë, nanoteknologjisë, inteligjencës artificiale, teknologjisë hipersonike, teknologjisë kuantike etj. Kjo për shkak të globalizimit do të ketë ndikim jo vetëm në fushën ushtarake por dhe atë civile. Teknologjitë në zhvillim po ndryshojnë natyrën e paqes, krizës dhe konfliktit, por dobinë e tyre nuk

¹³ Marrë nga Parathënia DP-01- FARSH edicioni dytë, fq 36.

duhet lejuar ti përdorin shtete dhe forca destruktive. Strategjia e Aleancës do të jetë kundër synimit të Kinës, për t'u bërë fuqia kryesore në botë në inteligjencën artificiale në dekadën e ardhshme.

Terrorizmi. Koncepti Strategjik i Aleancës, deklarata në Samitin e Lisbonës 2010, Samitin e Çikagos 2012 dhe Samitin e Uellsit 2014 e bëjnë të qartë se terrorizmi vazhdon të paraqesë një kërcënim real dhe serioz për sigurinë e anëtarëve të Aleancës. Natyra shumëplanëshe e terrorizmit është e tillë që NATO është angazhuar në një numër iniciativash diplomatike, ushtarake, konceptuale, teknologjike dhe shkencore, për luftimin e tij.

Kërcënimet hibride. Kërcënimet hibride ndodhin kur kërcënimet konvencionale, të parregullta dhe asimetrike kombinohen në të njëjtën kohë dhe hapësirë. Konflikti mund të përfshijë një sërë pjesëmarrësish transnacionalë, shtetërorë, gruporë dhe individualë që veprojnë globalisht dhe lokalisht. Konfliktet e ardhshme do të karakterizohen nga një përzjerje e shumë formave të luftës përgjatë gjithë spektrit të tyre. Ato mund të përfshijnë dhunë lokale, terrorizëm, sulme kibernetike, kryengritje, kriminalitet, si dhe prishje të rendit publik. Gjithashtu, kundërshtarët mund të zgjedhin një strategji afatgjatë që të synojë lëkundjen e vullnetit dhe vendosmërisë së shtetit dhe institucioneve të sigurisë. Kundërshtimi i kërcënimeve të tilla hibride mund të kërkojë një qasje më të gjerë, duke përdorur aftësi të integruara, disa prej të cilave mund të jenë me natyrë jokonvencionale¹⁴. Kërcënimet hibride mund të mos përballohen vetëm me përdorimin e instrumentit ushtarak, ato do të kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse, të mbështetur nga operacionet e informacionit.

Fusha kibernetike dhe siguria e saj. Koncepti Strategjik i NATO-s thekson nevojën për të zhvilluar aftësinë e NATO-s për të parandaluar, zbuluar, mbrojtur sigurinë kibernetike. Kërcënime të tilla po rriten me shpejtësi në mënyrë të sofistikuar. Kërcënimet që vijnë nga hapësira kibernetike, qoftë nga kombet, fraksionet, apo aktorë joshetërorë, paraqesin një sfidë të konsiderueshme për Aleancën. Publiku, në situatën e një sulmi kibernetik, mund ta perceptojë këtë sulm më pak të rrezikshëm se një sulm terrorist që përdor armë zjarri dhe shkakton vdekje të drejtpërdrejta e shkatërrim, edhe pse dëmi i shkaktuar nga sulmi kibernetik mund të jetë më i madh. Politika e NATO-s për mbrojtjen e hapësirës kibernetike lidhet me një seri masash të cilat kanë efekte dhe në FA të vendit tonë. Fusha e kibernetikës është pjesë e procesit të planifikimit të NATO-s për zbatimin e masave parandaluese, rritjen e qëndrueshmërisë në mbrojtjen e aseteve kritike, mbrojtjen e rrjeteve të NATO-s, zhvillimin dhe mbrojtjen e rrjeteve kombëtare për detyrat thelbësore të NATO-s; ajo siguron ndihmë për aleatët për dobësitë në infrastrukturën e tyre¹⁵.

Epoka e teknologjisë së informacionit. Epoka e informacionit karakterizohet nga një komunikim intensiv në kohë reale. Zbatimi i këtij koncepti kërkon kontrollin dhe besueshmërinë e informacionit për ta përdorur në mënyrë efektive, por kjo mund të shfrytëzohet në të njëjtën mënyrë nga kundërshtari. Përdorimi i dezinformimit dhe

¹⁴ See PO (2015)0580, Political Guidance, 16 October 2015.

¹⁵ MC 0042- 2011, Politika e NATO-s mbi Mbrojtjen Kibernetike dhe Planin e Veprimit të Mbrojtjes Kibernetike, 7 qershor 2011.

mungesa e kontrollit të informacionit gjenerojnë mosbesim dhe pakënaqësi. Në këtë fushë qëllimi i aleancës dhe vendeve partnere është t'u kundërvihet sistemeve të informacionit dhe të dezinformimit të kundërshtarit, duke mbrojtur njëkohësisht sistemet e saj, nëpërmjet kontrollit, sisteme më të avancuara nga struktura të specializuara.

Armët e Shkatërrimit në Masë (ASHM). Ka tendenca për t'i krijuar vende të reja. Përhapja e armëve bërthamore, kimike, radiologjike dhe biologjike dhe e mjeteve të lëshimit të tyre jashtë Aleancës përbën një kërcënim të madh për sigurinë globale dhe stabilitetin e zonës euroatlantike, veçanërisht, kur përpjekjet për përhapje dhe zotërim të tyre bëhen nga shtete të papërgjegjshme ose organizata terroriste e kriminale. Në rast se ASHM-të dhe mjetet e shpërndarjes së tyre nuk kontrollohen me sukses, ato do të kenë një përhapje të konsiderueshme¹⁶.

Doktrinat ushtarake, programet mësimore duhet të marrin në konsideratë synimet dhe objektivat e NATO-s 2030. Përvoja e deritanishme duhet të vihet në shërbim të ndryshimeve të reja. Kjo strategji orienton dhe kërkon domosdoshmërisht zhvillimin e prioritetëve në drejtimin e duhur, zhvillimin e kapaciteteve operacionale në përgjigje të sfidave të reja, përmirësimin e komandim kontrollit, nxitjen e debatit dhe mendimit shkencor, ndryshime strukturore të nevojshme në sensin e kërkesave dhe nevojave të kohës, shfrytëzimin e zhvillimit teknologjik në interes të sigurisë. Koncepti i ri i Aleancës thekson se, është më mirë të parandalosh një krizë, konflikt se sa të zhvillosh atë, situatë që shoqërohet me humbje njerëzore, e kosto të lartë. Në pikëpamje doktrinare, kjo situatë kërkon informacion në kohë reale, përgatitjen e planeve të sakta, veprime të shpejta dislokuese, kapacitete operacionale efektive, komandim-kontroll të sigurtë, mbështetje logjistike të qëndrueshme.¹⁷

5. Ndikimi i mjedisit në zhvillimet doktrinare, roli tyre në edukimin arsimor ushtarak

Zhvillimi i arsimit ushtarak në këtë moment duhet të mbajë në konsideratë zhvillimin e mjedisit kombëtar, rajonal dhe më gjerë. *Grupimi i parë i faktorëve lidhet me ndryshimet dhe sfidat e reja në këtë shekull të ri, të cilët mund të përkufizohen si faktorë me ndikim nga jashtë.* Në këtë grup përfshihen faktorë të cilat sjellin ndryshime politike ndërkombëtare, dalja në pah e formave të reja të luftimit, ringjallja e synimeve për zgjerimin e territoreve, terrorizmi, ndryshimet klimaterike, pandemitë, domosdoshmëri e ndërhyrjeve humanitare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndikimi i zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit, interpretim dhe përmirësim të akteve ligjore ndërkombëtare dhe nevojës për përshtatje të organizmave dhe strukturave të sigurisë, etj.


Grupi i dytë të quajtura si faktorë të brendshëm. Në këtë grup futen marrja në konsideratë

¹⁶ NATO's Comprehensive, Strategic-Level Policy for Preventing the Proliferation of Weapons of Mass Destruction (WMD) and Defending against Chemical, Biological, Radiological and Nuclear (CBRN) Threats, September 2009.

¹⁷ Public Diplomacy Division (PDD) – Press & Media Section, E-mail: moc@hq.nato.int Follow us @NATO press www.nato.int.

e ndryshimeve dhe tranzicionit të vendeve në aspektin politik, ekonomik, social, ushtarak, forcimit të demokracisë, krimin e organizuar, probleme në funksionimin e shtetit ligjor, institucione të dobëta dhe korrupsion etj..., të cilat janë elemente që duhen mbajtur në konsideratë për ndikimin në edukimin ushtarak për brezat në vijim. Faktorët aktualë janë një shembull real i nxitjes të përfytyrimeve dhe imagjinatës të ushtarakut të ardhshëm.

Në skemën e mëposhtme janë treguar një seri faktorësh që merren në konsideratë në zhvillimin doktrinar. Doktrina ushtarake jo vetëm ndikohet nga faktorë të ndryshëm, por edhe vetë ajo ndikon mbi faktorë të tjerë. Ky zhvillim dhe ndikim ndodh brenda kontekstit kulturor, politik, shoqëror të mjedisit.



Si pjesë e Aleancës, sistemi arsimor në vendin tonë po përshtatet me ndryshimet e saj. Modelin e Aleancës e konsiderojmë si shembullin më të mirë për plotësimin e kërkesave kombëtare dhe nevojave për pjesëmarrje në operacionet ndërkombëtare. Procedurat dhe sistemi doktrinar i Aleancës janë pjesë e integritimit në hartimin e dokumenteve kryesore kombëtare dhe fushës doktri-nare të FA.

Ndërveprueshmëria ka tri dimensione kryesore: teknik (pajisjet, sistemet), procedural (doktrinat, procedurat) dhe njerëzor (gjuha, terminologjia, trajnimi), të cilat plotësojnë njëra-tjetrën dhe kushtëzohen nga ato kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në Direktivën e Mbrojtjes 2021 përcaktohet qarte se "... vazhdimi i punës për konsolidimin e këtij sistemi, zgjerimi i mëtejshëm i ratifikimit dhe përdorimit të standardeve në FA ...

si dhe harmonizimi me parimet doktrinare të NATO-s” është një nga objektivat kryesore të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura.¹⁸ Përmirësimi në fushën e doktrinave është i lidhur ngushtë me procesin e ratifikimit të STANAG-ëve. FARSH kanë ratifikuar dhe kanë në proces zbatim mbi 560 STANAG/AP të Aleancës. Sipas fushave, 64% e STANAG/AP-ve të ratifikuar janë operacionale, 25% materiale dhe 10% e tyre administrative, ku janë të përfshira FT, FD, FAj, AFA, KM dhe shumë specialitete. Efektet e këtij procesi ndikojnë në sistemin arsimor ushtarak, ndryshimin e programeve mësimore, trajnimin dhe stërvitjen e trupave, njohjen dhe integrimin lehtësisht në operacionet me Aleancën, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të doktrinave në FA. Angazhimi i vendit tonë reflektohet si kontribuues në Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes NATO-s, njohjen dhe zbatimin e sistemit doktrinar të saj, zhvillimin dhe plotësimin e kërkesave të objektivave të kapaciteteve.

“Në të gjithë Evropën dhe gjithnjë e më shumë në të gjithë botën, është përgjegjësia jonë si udhëheqës ushtarakë të mbajmë fokusin në gatishmërinë tonë gjithëpërfshirëse në të gjitha fushat, të vazhdojmë të përmirësojmë transparencën dhe rregullimin e operacioneve, aktivitetëve dhe investimeve tona dhe të jemi në gjendje të vendosim në punë aftësitë tona më shpejt sesa kërcënimet dhe sfiduesit tanë”¹⁹.

Prandaj sistemi arsimor duhet të synojë përgatitjen e lartë të brezave ushtarakë në vijim, me një vizion të qartë dhe gatishmërinë për t’u përballuar me sfidat e reja. Studenti ushtarak si oficer i ardhshëm kërkon një cilësi dhe nivel të ri në ballafaqimin e sfidave si dhe një ndërgjegjësim profesional, etnik, fetar, kulturor, ekologjik dhe të të drejtave të njeriut. Kemi nevojë për ushtarakë që kuptojnë vendin e tyre në transformimin kompleks, mendimtarë kritikë, oficerë që mund të parashikojnë ndryshimin, parashikojnë zgjidhje për pasiguritë. Reformat e ndërmarra në fushën e arsimit ushtarak kohët e fundit, kërkojnë zbatimin e tyre, mbështetje buxhetore, përmirësim të infrastrukturës së nevojshme, përzgjedhjen dhe kualifikimin e personelit mësimdhënës, përmirësimin e programeve mësimore në përshtatje me sfidat e këtij shekulli, rekrutime cilësore, krijimin e një raporti të drejtë midis teorisë dhe praktikës, orientimin e edukimit drejt nevojave dhe zhvillimeve të pritshme.

Krijimi i Kolegjit të Lartë të Mbrojtjes do të plotësojë nevojat sasiore, cilësore për përgatitjen e oficerit të ri. E rëndësishme është vazhdimësia e qëndrueshmërisë në rrugën e nisur, për të mos ndryshuar kursin dhe vizionin për edukimin ushtarak. Zgjerimi i tij për ta bërë edhe rajonal do të jetë një ambicie e madhe për institucionin e mbrojtjes dhe FA. Hapja e studimeve në fusha të reja si “IT”, “navigim” si dhe marrëveshjet me institucionet e tjera arsimore brenda dhe jashtë vendit është një ogur i mirë për plotësimin e kërkesave të reja për FA. Përvoja e krijuar ndër vite në fushën e mësimdhënies, trajnimi dhe arsimimi në vendet perëndimore dhe Aleancës, pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare dhe strukturat e NATOS, janë një garanci e madhe, për të ndryshuar metodologjinë për

¹⁸ Direktiva e Mbrojtjes 2021.

¹⁹ Seminari i Doktrinës Ushtarake të Nivelit të Lartë të OSBE: Fjalët e Hapjes nga Gjenerali Tod D. Wolters 9 shkurt 2021).

përgatitjen e ushtarakut shqiptar. Aplikimi në gjuhën angleze deri tani në KLSM dhe modulën e Zhvillimit të Forcës në Kursin e Lartë të Oficerit, janë bazë për zhvillimin në këtë model edhe të kurseve të tjera në vijim në AFA. Krijimi i një raporti të drejtë në strukturën programore midis departamenteve do të japë mundësinë e marrjes së informacionit sipas modelit që kërkojmë.

Sistemi arsimor ushtarak duhet të udhëhiqet nga parimi: “investoni në kapital njerëzor po aq sa në pajisje” dhe “arsimoni njerëzit në nivelin bazë të sistemit dhe më pas rikualifikojini ata sipas nevojës”. Karriera e ushtarakut është një proces midis edukimit, kualifikimit dhe punës. Ushtaraku provohet në situata pune, paqe, krize, ku çdo individ merr vlerësimin që i takon, gëzon suksesin ose dështimin. Por në karrierën e çdo individi dalin në pah, aftësitë teorike, profesionale, organizuese, vendimmarrëse, drejtuese, intuitave, komunikuese etj., të cilat bëjnë dallimin midis anëtarëve të grupit. Kjo pjesë e dalluar duhet të dominojë për kualifikimet e radhës në ecurinë për rritje në gradë.

Në zbatimin e reformave të ndërmarra të cilat kanë qenë domosdoshmëri për FA dhe sistemin arsimor, duhet të mbaheshin më mirë në konsideratë edhe disa elemente të tranzicionit si: zvogëlimi i strukturave dhe i numrit në FA duhej kompensuar me përzgjedhjen cilësore të personelit në kualifikimet ushtarake; disa specialitete kanë sasi minimale personeli ose mungesa, të cilët mund të përgatiteshin në vendet aleate; nuk ka ndikuar për mirë shpeshësia e ndryshimit të modeleve; duhet ishte menduar më mirë për arsimimin e pilotit, detarit pas mbylljes së akademive të tyre; niveli i rekrutimit të resurseve të FA duhet të jetë më cilësor dhe nga zona ku kemi dislokimet e strukturave ushtarake; kualifikimi profesional i shkollave të trupës kanë ndryshuar vartësinë e komandimit herë me ish-komandën e strukturës arsimore dhe herë me në vartësi të komandave të forcave; janë larguar nga FA ushtarakë të kualifikuar në shkollat perëndimore pa dhënë përvojën dhe kontributin e tyre në FA.

Megjithatë, reformat ligjore dhe organizative të ndërmarra si LAL, VKM nr.156 datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të AFA, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimit e saj”, janë garanci për të ardhmen. Qartësimi i vizionit në këtë fushë për të ardhmen, rritja e mbështetjes nga ana e qeverisë, ngritja e Kolegjit të Lartë të Mbrojtjes me gjithë infrastrukturën e nevojshme, rritja cilësore e personelit mësimdhënës dhe rekrutimit të resurseve të studentëve do të krijojnë kushte për zbatimin e modelit të duhur të përgatitjes së oficerit të ri dhe ushtarakut të ardhshëm në FA.

Duhet theksuar se arsimimi ushtarak duhet të jetë kombëtar, për t’u integruar në çdo aspekt por pa harruar veçoritë e traditës dhe përvojës pozitive të ushtrisë shqiptare, karakterin dhe strukturën e kurrikulës, etj., pavarësisht nga kualifikimet jashtë vendit. Shkëmbimi i përvojës duhet të jetë pjesë e përmirësimeve të nevojshme në zbatimin e politikave të arsimit ushtarak. Institucioni duhet të planifikojë buxhetet përkatëse për mbështetje. Ky bashkëpunim mund të aplikohet në fushën e sigurisë, marrëdhëniet ndërkombëtare, strategjisë, doktrinës ushtarake, planifikimin, programimin dhe buxhetimin, menaxhimin e

burimeve njerëzore, marrjen e informacionit për fushat e reja të teknologjisë etj.

Epoka e informacionit karakterizohet nga një komunikim intensiv në kohë reale. Studenti, ushtaraku mund të përdorë burimet arsimore kudo në botë, por kërkon kontrollin dhe besueshmërinë e këtij informacioni për ta përdorur në mënyrë efektive dobinë e tij. Studentët ushtarakë duhet të kenë në dispozicion: - mjetet e nevojshme, - njohjen dhe aftësinë për përdorimin e tyre, - hulumtimi në burime të besueshme dhe të sigurta, siç janë burimet e strukturave të NATO-s, komunikim me bibliotekat online të kolegjeve dhe universiteteve të vendeve perëndimore, si dhe infrastrukturën për shfrytëzimin dhe ruajtjen e informacionit me sisteme dhe mjedise të certifikuar kur behet fjalë për informacione të klasifikuara.

Koncepti i sotëm i mësimin në distancë, multimedia, realiteti virtual dhe teleprezenca lejojnë zhvillimin e një filozofie të re të arsimit të oficerëve dhe nevojën e zbatimit në rrethana të caktuara. Teknologjia na mundëson të lehtësojmë të mësuarit në mënyra të reja dhe inovative dhe të sigurojmë qasje në shfrytëzimin e informacionit në dispozicion. Akademitë dhe kolegjet mund të shërbejnë si katalizator për këto ndryshime. Teknologjia nuk mund të zëvendësojë lektorët më të mirë, por mund të lejojë që një lektor të zhvillojë mësim në rrethana të caktuara, në interes të rubrikave të mësimdhënies. Periudha e pandemisë nxori në pah mundësinë e realizimit programeve online, si një mundësi të zbatimit të programeve në situatën pandemike nga Covid-19. Gjithsesi, natyra ushtarake ka disa veçori për të cilat jo të gjitha fushat mund të zhvillohen në këtë formë, prandaj kërkohet forma se si mund të realizohen fushat specifike.

6. Përfundime

Arsimi ushtarak të zhvillohet në mënyrë të tillë që t'iu përgjigjet nevojave kombëtare e më gjerë, në përputhshmëri me sistemin e arsimit në vendin tonë dhe shkollave të vendeve të NATO-s. Krijimi i Kolegjit të Lartë të Mbrojtjes, si një institucion i përqendruar në arsimimin ushtarak do të krijojë kushte për plotësimin e nevojave në pikëpamje sasiore por dhe cilësore të përgatitjes së oficerit të ri jo vetëm për FA, por dhe më gjerë. Implementimi i procesit kërkon përshtatje, ekspertizën më të mirë në personelin e angazhuar për zbatim dhe koordinim të masave, mbështetje buxhetore, afate kohore të studiuara, strukturat përgjegjëse, në interes të modelit të përcaktuar.

Doktrina Ushtarake në sistemin arsimor mbetet shtylla kurrizore e formimit ushtarak, të oficerëve të shekullit të 21-të, për përballimin e sfidave të reja dhe situatave të paparashikuara që mund të ndodhin. Edukimi me fushën doktrinare në sistemin arsimor t'i paraprijë transformimit të Forcave të Armatosura, në përputhje me dokumentet kryesore kombëtare si dhe hierarkinë e dokumenteve të NATO-s, si pjesë e rëndësishme e integritetit dhe kontributeve të FA.

Shkëmbimi i informacionit, përvojës dhe metodologjisë së edukimit arsimor ushtarak duhet të jetë pjesë e strategjisë së bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënies, me shkollat perëndimore të SHBA dhe NATO-s, si modeli më i mirë për plotësimin e misionit të FA.

Strukturat e AFA dhe veçanërisht IKSHU duhet të kontribuojë në interes të edukimit arsimor ushtarak, me punime shkencore, studime, analizë dhe rekomandime, të cilat rrisin në mënyrë cilësore fushën e mësimdhënies dhe plotësimin e nevojave të reja në këtë proces.

Edukimi doktrinar në FARSH duhet të bëhet i balancuar me trajnimin dhe edukimin profesional të pjesës së nënoficerëve, ushtarëve profesionistë dhe pjesës teknike civile, për përmbushjen e të gjithë spektrit të misionëve operacionale brenda dhe jashtë vendit. Zbatimi i sistemit të trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit (Creval, Taceval, Mareval), për t'iu përshtatur spektrit të operacioneve të skenarëve të ardhshëm, duhet të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të institucionit arsimor dhe FARSH. Reflektimi në programet mësimore i dokumenteve doktrinare, koncepteve, STANAG-ëve dhe mësimëve të nxjerra duhet të kthehen në procese të vazhdueshme institucionale.

Reformat e ndërmarra kohët e fundit, në fushën ligjore, strukturore dhe përcaktimi i një vizioni të qartë në fushën e edukimit ushtarak, do të krijojë qëndrueshmërinë e duhur, duke mos ndryshuar modelin e filluar, por duke përmirësuar dhe përshtatur atë me ndryshimet e reja.

Përmbushja e objektivave sipas këtij modeli kërkon: planifikim të saktë të burimeve mbi bazën e nevojave të FA; rekrutimin e resurseve cilësore të personelit student në AFA si i vetmi institucion në fushën e edukimit ushtarak, përmirësim të mbështetjes financiare dhe reklamimin më produktiv të përfitimeve në profesionin e ushtarakut. Roli i AFA të jetë dominues në përzgjedhjen dhe emërimin e personelit mësimdhënës si dhe kompletimit të resurseve të studentëve ushtarakë sipas kritereve të përcaktuara.

AFA duhet të ketë pavarësinë në shfrytëzimin në mënyrë të pavarur të infrastrukturës për jetesë, mësim, stërvitje, aktivitete shkencore. Mendojmë se ky vizion gjen zbatim më të mirë në infrastrukturën e garnizonit “Skënderbej”.

Bibliografia

- Doktrina e Përbashkët e FARSH (DP-01), edicioni dytë, viti 2017.
- AJP-01 “Allied Joint Doctrine”, Edition E, Version 1, February 2017, chapter I.
- General George H. Decker, US Army Chief of Staff, 1960-1962, Doctrine for the Armed Forces of the United States, 12 July 2017.
- UK Defence Doctrine Joint Doctrine Publication 0-01 (JDP 0-01) (5th Edition), November 2014.
- NATO Term – NATO Agreed. NATO Term is the official NATO terminology database.
- Stoltenberg, NATO SAMIT 14.06. 2021
- Public Diplomacy Division (PDD) – Press & Media Section- E-mail: moc@hq.nato.int Follow us @NATOpres www.nato.int

- Seminari i Doktrinës Ushtarake të Nivelit të Lartë të OSBE: Fjala e hapjes së gjeneralit Tod D. Wolters, 9 shkurt 2021.
- AJP-01 “Allied Joint Doctrine”, Edition E, Version 1, February 2017, chapter II.
- Konferenca e Sigurisë së Mynihut, shkurt 2021.
- Ministria e Mbrojtjes, ministri Peleshi inspekton përgatitjet e FA për “Defender 21”: Presim stërvitjen më të madhe të zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri, <https://www.mod.gov.al/index.php>. Datë 29 prill 2021.
- MC 0042- 2011, Politika e NATO-s mbi Mbrojtjen Kibernetike dhe Planin e Veprimit të Mbrojtjes Kibernetike, 7 qershor 2011.
- NATO’s Comprehensive, Strategic-Level Policy for Preventing the Proliferation of Weapons of Mass Destruction (WMD) and Defending against Chemical, Biological, Radiological and Nuclear (CBRN) Threats, September 2009.
- Direktiva e Mbrojtjes 2021.

ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE TË REJA PROFESIONALE NË ARSIMIN E LARTË USHTARAK SHQIPTAR

Dr. Etleva Smaçi
FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Në fushën e edukimit, arsimi ushtarak është ndër më të vjetrit dhe ndër më tradicionalët. Ai synon t'i pajisë studentët me një set kompetencash profesionale që janë të lidhura ngushtë me aktivitetet që ata performojnë gjatë ushtrimit të detyrës. Mirëpo për shkak të një mjedisi dinamik, vlerësimi i këtyre kompetencave profesionale dhe faktorëve, që ndikojnë në rezultatin e tyre, është vazhdimisht objekt debati në rrethet arsimore ushtarake dhe jo vetëm.

Vetë koncepti i të mësuarit gjatë gjithë jetës që është i pranishëm në gjithë arsimimin dhe trajnimin e FA-ve çon në nevojën konstante të shtysave për aplikime të reja pedagogjike dhe mundësi të zbatimit të tyre. Kompetencat profesionale të një oficeri të ardhshëm të kërkuara për të kryer aktivitete të ndryshme formohen gjithashtu nga të gjitha fazat e trajnimit të tij dhe janë produkt i aktiviteteve intelektuale dhe praktike të ndërlydhura mes tyre.

Qëllimi i këtij punimi është të zhvillojë një model konceptual për vlerësimin e kompetencave të shërbimi ushtarak profesional në Forcat e Armatosura të Shqipërisë që do të mundësonte zhvillimin e aftësive për krijimin e njohurive të reja si p.sh., në fushën e teknologjisë, ekonomisë apo komunikimit strategjik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo, pasi ndryshimi i kompetencave profesionale ndikohet padyshim nga progresi ekonomik, social dhe teknologjik i shoqërisë. Kështu që bëhet e domosdoshme, që hartimi i procesit mësimor të bazohet në kompetenca bashkëkohore duke synuar cilësi në edukim.

Fjalë kyçe: arsim ushtarak, kompetenca, model konceptual, aplikime pedagogjike

Hyrje

Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, detyrat e Forcave të Armatosura të Shqipërisë kanë ndryshuar ndjeshëm. Përveç misionit të ruajtjes dhe mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial, ato janë përfshirë në misione jashtë vendet, të cilat kanë qenë të fokusuara në ndihmën humanitare, si dhe në misione të vërteta luftarake. Po kështu, përparimi në karrierë është tepër sfidues në radhët e FA-ve, ndaj zotërimi i kompetencave që i përshtaten zhvillimeve të reja shihet si një çelës suksesi.

Ushtarakët që edukohen në AFA njihen me emrin kadetë, por gjatë këtij punimi, ne do t'iu referohemi shpeshherë atyre me konceptin sinonim, oficer. AFA synon të përgatitë oficerë profesionistë me aftësi për të zgjidhur detyrat dhe misionet e dhëna. Prandaj, është e natyrshme që formësimi i kompetencave profesionale në përshtatje me misionin është objektivi kryesor i edukimit dhe trajnimit të FA. Punimi synon të analizojë dhe t'i japë përgjigje pyetjes se në çfarë mase trajnimi dhe edukimi ushtarak janë sot të përshtatshme për zhvillimin e kompetencave profesionale të së sotmes dhe së ardhmes.

Forcat e Armatosura të RSH ashtu si gjithë FA në botë ndodhen sot përpara një sërë rrethanash të reja që ndikojnë në mënyrën se si konceptohen dhe ekzekutohen operacionet e tyre. Këto rrethana kushtëzojnë nevojën e një përparimi intelektual të personelit të tyre ushtarak përmes një mendësie të re arsimore dhe trajnuese. Ndryshe nga tradicionalja ku profesioni i ushtarakut shihet pak i ndryshueshëm, sot, profesioni i ushtarakut po ndryshon vazhdimisht. Ai është një profesion i mbështetur nga karakteristikat të qëndrueshme, por që ndryshon vazhdimisht ndërsa shoqëria dhe teknologjia ndryshojnë. Të kuptuarit e nxitësve të ndryshimeve brenda këtij profesioni na ndihmon në sigurimin e politikave të drejta kombëtare arsimore, në arsimimin dhe trajnimin profesional të ushtarakëve.

1. Çfarë janë kompetencat

Kompetencat i mundësojnë një individ të performojë sa më mirë në situata të ndryshme në punë dhe të përshtatet me shpejtësi me mjedisin.¹ Dinamika e shpejtë e ndryshimeve të mjedisit të sigurisë ka nxjerrë në pah rritjen e kapaciteteve që lidhen me zhvillimin e kompetencave profesionale. Kapacitetet janë të bazuara në dije dhe aftësi. Pra, kur flitet për kompetencat, nënkuptohet aftësia organizuese në një situatë të re dhe komplekse. Bazuar

¹ L.Spencer, &P. Spencer, P, Competence at work: Models for superior performance, New York: 2008, John Wiley & Sons. Shiko gjithashtu: Boyatzis, R. E. (2008). Competencies in the 21st century. Journal of Management Development, 27, 5–12

në skemën e Heyse & Eperneck, kompetencat përfshijnë dije, kualifikim, që pasurohen nga normat, vlerat dhe rregullat.² Vitet e fundit zhvillimi i kompetencave të orientuara nga misioni në fushën ushtarake u përqendruan veçanërisht në kompetencat ndërkulturore. Shumë shtete kanë tashmë modele kompetencash për fusha specifike të mbrojtjes e të sigurisë.³

Le t'i hedhim një sy modelit gjerman. Bazuar në faktin se ushtarakët gjermanë duhet të veprojnë në një numër të madh misionesh nëpër botë dhe me besim, modeli i kompetencave në FA-të gjermane bazohet në 5 elemente të rëndësishme: kompetencat vetjake, kompetencat metodologjike, kompetenca e lidhshmërisë dhe menaxhimit, kompetencat profesionale dhe kompetencat sociale. Shumëllojshmëria dhe shpesh paparashikueshmëria e kërkesave në misione kërkon trajnim dhe zhvillim të orientuar drejt kompetencave, i cili përqendrohet shprehimisht në zotërimin e sfidave të panjohura.⁴ Kompetenca për të vepruar është qendrore dhe ajo përcaktohet nga shuma e kompetencave bazike.

Formësimi i kompetencave të kërkuara për t'u zotëruar nga një ushtarak profesionistë i ditëve të sotme por edhe i të ardhmes kërkon shqyrtimin e një sërë faktorësh që kanë ndikim të dukshëm. Sigurisht, teknologjia është një nxitës kryesor për evolucionin në profesionin e ushtarakut. Lidhur me teknologjinë, gjeneralmajor Mick Ryan (Komandant i Kolegjit të Mbrojtjes, Australi), duke iu referuar disa dokumenteve të Këshillit të Inteligjencës Kombëtare dhe Ministrisë së Mbrojtjes së BM, pohon se “ecja e mëtejshme e zhvillimit teknologjik po ndryshon organizatat ushtarake dhe shoqëritë nga të cilat ato dalin”. Dhe evoluimi i formave të luftës e bën të pashmangshëm ndryshimin e arsimimit dhe trajnimit në FA. Kështu, nëse më parë pasja e disa njohurive e bënte një ushtarak specialist të një fushe, tashmë pasja e këtyre dijeve është pjesë thelbësore e profesionit të ushtarakut. P.sh.,



Kombëtare dhe Ministrisë së Mbrojtjes së BM, pohon se “ecja e mëtejshme e zhvillimit teknologjik po ndryshon organizatat ushtarake dhe shoqëritë nga të cilat ato dalin”. Dhe evoluimi i formave të luftës e bën të pashmangshëm ndryshimin e arsimimit dhe trajnimit në FA. Kështu, nëse më parë pasja e disa njohurive e bënte një ushtarak specialist të një fushe, tashmë pasja e këtyre dijeve është pjesë thelbësore e profesionit të ushtarakut. P.sh.,

² V.Heyse & J. Erpenbeck, Kompetenztraining: Informations- und Trainingsprogramme. Stuttgart: 2009, Schaeffer-Poeschel Verlag.

³ Bazuar në studimin e Tian, Miao, Xu and Yang (2009) në piramidën e kompetencave të lidhshmërisë të një kadeti kinez bëjnë pjesë: raportet ndërpersonale, komunikimi i shkruar dhe gojor, qëndrueshmëria emocionale dhe devocioni. Pikërisht ky i fundit, devocioni është elementi esencial në këtë model kompetencash pasi nënkupton jo vetëm zell apo përpjekje, por më së pari besnikëri ndaj kombit dhe ushtrisë pa pasur pritshmëri të përfitojë prej tyre.

⁴ M. Rost Kompetenzmanagement und Dynamic Capabilities: Eine empirische Fallstudie bei einem Unternehmen aus der Automobilzulieferindustrie. Lohmar: 2014, EUL-Verlag.

rëndësia që ka marrë mbrojtja kibernetike dhe komunikimi bën që kompetencat në cyber defence të kenë pjesën e luanit në profesionin e ushtarakut. Chris Elliot i referohet në librin e tij “Komanda e Lartë” këtij zhvillimi si momenti i “sensorit”.

Nxitësi tjetër i rëndësishëm për evolucion lidhet me faktin se konteksti social i ushtrimit të profesionit të ushtarakut ka ndryshuar ndjeshëm. Ushtarakët e gjejnë veten shpesh në rrethana që çojnë drejt sfidave sociale. Sot nevojiten profesionistë ushtarakë të cilët mund të punojnë në një organizatë që ka diversitet etnik, gjinor, fetar dhe intelektual dhe të shfrytëzojnë përfitimet e saj.⁵

Gjatë kryerjes së detyrave të shërbimit, oficeri kryen një sërë aktiviteteve që kërkojnë kompetenca të përshtatshme. Puna e një oficeri është e lidhur me një sërë kërkesash metodike profesionale dhe aftësi komunikuese që kërkojnë një qëndrueshmëri të lartë fizike dhe psikologjike. Ushtaraku duhet të rrokë situata komplekse nën presionin e kohës, të marrë vendime të shpejta e të duhura, të komunikojë bindshëm dhe të veprojë me efektivitet dhe përgjegjshmëri. Empatia është një tjetër aftësi e rëndësishme që lidhet me shpirtin e skuadrës. E mbi të gjitha, duhet të dinë të përballen me kritikizmin, një aftësi që del jashtë modelit të bindjes që zotëron në FA.

Aftësitë taktike ngelen edhe në kohët moderne baza e profesionit të ushtarakut. Ato kërkojnë një kuptim të doktrinës institucionale por jo zbatim të “verbër” të saj. Aftësia taktike zhvillohet përmes trajnimit formal, si dhe përmes vetë-studimit, trajnimit në vendin e punës, edukimit dhe përvojës. Për trajnimin dhe zhvillimin profesional bashkëkohor dhe të ardhshëm, aftësia taktike do të kërkojë gjithnjë e më shumë një kuptim dhe integrim më të sofistikuar të një sërë përpjekjesh jokinetike dhe jotradicionale. Të tilla mund të jenë operacionet për mbrojtjen e rrjetit në një mjedis digjital të degraduar që kërkojnë bashkëpunim me ndërinstitutional. Përdorimi i instrumenteve matëse për këto aftësi jo vetëm ndihmon në përcaktimin e suksesit apo dështimit taktik, por edhe për mënyrën sesi efektiviteti taktik mbështet arritjen e objektivit operacional dhe strategjik.

Nëse i shohim me kujdes kompetencat klasike, njëra prej tyre është ajo që ka prodhuar më shumë risi. Zotërimi i psikologjisë konjitive shihet e lidhur ngushtë në literaturën akademike me modelin e ri të luftës, luftën hibride. Zotërimi i psikologjisë konjitive formon kompetencën e aspektit njohës të luftës dhe konfliktit. Natyrshëm, shmangia e konfliktit mbetet preferenca e natyrshme e profesionistëve nën armë, por përgatitja njohëse për luftën është një kompetencë e detyruar dhe qendrore për ushtarakun profesionist. Ajo kërkon përqendrim në të kuptuarin e paragjykimëve, teorive komplekse, teorive të komunikimit etj. Psikologjia konjitive shihet tashmë si çelës i të kuptuarit të luftërave të ardhshme.

⁵ P. Caligiuri, R. Noe, R. Nolan, M.A Ryan., & F. Drasgow, (2011). Training, developing, and assessing cross-cultural competence in military personnel, United States Army Research Institute for the Behavioral and Social Sciences.

Në kuadër të luftërave të ardhshme, një ndër kompetencat që luftërat e fundit në Irak dhe Afganistan vunë në fokus si të munguar ishte kompetenca ndërkulturore.⁶ Shumë prej misionëve për t'u përmbyllur me sukses u kushtëzuan nga ndërveprimi jo vetëm me popullatën lokale por edhe mes vetë partnerëve të koalicionit që vinin nga formime të ndryshme kulturore. Tashmë kjo kompetencë shihet si prioritet në formësimin e çdo ushtaraku. Ilustrimi më i mirë i saj është mesazhi që ish-presidenti amerikan Barak Obama përcolli gjatë fjalimit të tij në gusht të vitit 2009 ku theksoi se “në shekullin e 21-të forca ushtarake nuk do të matet vetëm me armët që trupat tona janë të pajisura, por edhe përmes gjuhëve që flasin dhe kulturave që njohin”.⁷

2. Piramida e kompetencave

Ndërtimi i një sistemi të suksesshëm që zhvillon kompetencat profesionale varet nga politikat, edukimi, trajnimi dhe strukturat në vend për të mundësuar ekzekutimin e tij. Më e rëndësishmja, ai siguron një pikënisje për zhvillimin e një pikëpamjeje institucionale mbi përparësinë për zhvillimin e kompetencave profesionale. Kjo pikëpamje institucionale duhet të përfshijë gjithashtu se si mund të matim këto kompetenca dhe se si mund të vazhdojmë të zhvillojmë sistemin tonë të edukimit ushtarak. Një ndër elementet më të rëndësishme në këtë proces është konsolidimi i piramidës së kompetencave. Ajo duhet të ilustrojë sesi kompetencat profesionale kuptohen në funksion të vetë-aftësimit, aftësimit sipas subjektit dhe aftësimit social.

Arsimimi i oficerëve në AFA përfaqëson një proces të formimit tërësor që zhvillohet vazhdimisht gjatë gjithë programit trevjeçar bachelor. Procesi i formimit mund të përshkruhet si një "udhëtim edukativ" nëpër kohë dhe hapësirë në të cilin kadeti është i ekspozuar ndaj konteksteve të ndryshme mësimore që lehtësojnë zhvillimin akademik dhe personal brenda kërkesave dhe pritshmërive të profesionit të ushtarakut. AFA ka identifikuar rolin kyç të lidhur me profesionin, të cilit i është kushtuar fokus i veçantë gjatë arsimimit të oficerit: udhëheqës toge. Në mënyrë që të parashikohen se cilat do të jenë kompetencat e së ardhmes në fushën e lidershit, së pari është shumë e rëndësishme të kuptohet korniza e doktrinës së lidershit si dhe të merret në konsideratë evolucioni i kësaj doktrine.

Sigurisht është e qartë se në ditët e sotme paraqitet nevoja për më shumë se një stil udhëheqës sepse drejtuesit që kërkohen sot në fushën ushtarake janë të lidhur ngushtë me misionet të përbashkëta shumëkombëshe dhe ndëragjencish. Si praktikues të profesionit ushtarak, kadetëve u jepet përgjegjësia për të kryer një detyrë të specializuar në emër të shoqërisë. Përgatitja e tyre mbështetet në sa më sipër, pasi qëllimi i përgjithshëm është të përgatiten profesionistë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë që e identifikojnë vetveten plotësisht me profesionin ushtarak. Pra, edukimi shtetëror ushtarak synon të aftësojë secilin kadet me aftësitë përkatëse profesionale, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për të përmbushur

⁶ Cross Cultural Competency i referohet njohurive, aftësive, dhe motivimit mundëson individin të përshtatet në një mjedis ku ndërthuren kultura të ndryshme.

⁷ Barac Obama, Speech to the Veterans of Foreign Wars, Phoenix, Arizon: 2009, 17 August.

çdo skenar edhe të paparashikuar. Më konkretisht, arsimimi ushtarak duhet të synojë t'i bëjë kadetët të aftë të planifikojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë projekte brenda kuadrit të konfliktit, krizave dhe luftës.

Modeli i kompetencave të formësuara nga AFA, si një IAL bashkëkohore por me një status të veçantë, synon të shpjegojë çfarë aftësish duhet të fitojnë kadetët gjatë përvojës arsimore trevjeçare në Akademi dhe si është mbështetur dhe organizuar nga institucioni arsimor. Qëllimi final është që oficerët e diplomuar të mund t'i "përkthejnë" kompetencat e fituara arsimore në aksione praktike. Për të zgjedhur veprimin e duhur, një oficer/e duhet të kuptojë kontekstin brenda të cilit ai ose ajo vepron dhe gjithashtu, kuptojnë pasojat që do të rezultojnë nga veprimi. Prandaj, kompetenca profesionale e ushtarakut është gjithashtu më shumë se një funksion i fushave të tjera të aftësive. Ajo është aftësia për të vepruar në mënyrë korrekte në situata kur ushtaraku përballlet me të panjohurën.

AFA ka përcaktuar themelin e piramidës së kompetencave që kadetët e saj të rriten në rolin e profesionistëve me kalimin e kohës dhe përmes arsimimit. Pas marrjes së diplomës bachelor në Shkencat Ushtarake apo në programet e reja që do të hapen, duket sikur përgjegjësia zyrtare e AFA për kadetët pushon. Pikërisht kjo përbën një specifikë të AFA në raport me institucionet e tjera të arsimit të lartë. Zhvillimi si udhëheqës ushtarak është mision i saj gjatë gjithë karrierës së ushtarakut. Dimensioni që e dallon lidershipin ushtarak nga lidershipi në kontekstin civil është aftësia për të përballuar situata ekstreme ku jeta e tyre dhe e vartësve të tyre është në rrezik dhe duhet të marrë vendime në kushte të vështira që përfshijnë edhe rrezikimin e jetës. Kjo kompetencë e evidentuar që nga Klauzeviçi njihet si aftësia për të ruajtur qetësinë ose siç thotë populli "për të mos e humbur pusullën" përballë emocioneve të dhunshme apo situatave stresuese.

Në mbështetje të ideve të mësipërme dhe duke marrë si bazë një model të ri të arsimimit të orientuar drejt lidershipit jo thjesht ushtarak, por lidershipit që do t'i shërbejë shoqërisë dhe kombit, do të rekomandoja që arsimimi kombëtar i lartë ushtarak të bazohej në skemën e mëposhtme të kompetencave.

Për ta përmbyllur, do t'i referohesha veprës së Samuel Huntington "The Soldier and the State": Aftësia e oficerit nuk është as zanat as art. Përkundrazi, është një aftësi intelektuale jashtëzakonisht komplekse që kërkon studim dhe trajnim gjithëpërfshirës. Menaxhimi i dhunës nuk është një aftësi e cila mund të zotërohet thjesht duke mësuar teknikat ekzistuese. Është një proces i vazhdueshëm zhvillimi dhe është e nevojshme që ushtaraku ta kuptojë këtë zhvillim dhe të jetë i vetëdijshëm për tendencat dhe trendet kryesore të tij.

Kompetencat	Karakteristikat
Kompetencat Personale	Vetë-arsimimi Integriteti Forca e karakterit Humanizmi Ndershmëria Fleksibiliteti
Kompetencat metodike	Analiza dhe zgjidhja e problemit Aftësitë organizuese Aftësitë pedagogjike
Kompetenca të specialitetit	Kompetenca specifike profesionale
Kompetenca shoqërore	Empatia Respekti për të tjerët Aftësia për të punuar në grup Aftësitë komunikuese etj.
Kompetenca të menaxhimit dhe lidershit	Aftësia për të motivuar Të menduarit strategjik Aftësitë vendimmarrëse

Bibliografia

- Abbe, A., Gulick, L. M. V., & Herman, J. L. (2007). Cross-cultural competence in Army leaders: A conceptual and empirical foundation. (Study Report 2008-01). Arlington, VA: U.S. Army Research Institute for the Behavioral and Social Sciences.
- Bartone, P. T. (2006). Resilience under military operational stress: Can leaders influence hardiness? *Military Psychology*, 18, 131-148
- Boyatzis, R. E. (2008). Competencies in the 21st century, *Journal of Management Development*, 27, 5–12.
- Brennenman, M. W., Klafehn, J., Burrus, J., Roberts, R. D., & Kochert, J. (2016). Assessing Cross-Cultural Competence: A Working Framework and Prototype Measures for Use in Military Contexts. In J. Wildman & Griffith, Richard, Armon, Brigitte (Eds.), *Critical Issues in Cross Cultural Management* (pp. 103–131). Wiesbaden: Springer.
- Dixon, Deirdre P., Weeks, M., Boland, R., & Perelli, S. (2016). Making Sense When It

Matters Most: An Exploratory Study of Leadership In Extremis. *Journal of Leadership & Organizational Studies*, 24, 1-24.

- Heyse, V., & Erpenbeck, J. (2009). *Kompetenztraining: Informations- und Trainingsprogramme*. Stuttgart: Schaeffer-Poeschel Verlag.
- Meyer, E., & Brim, W. (2016). The importance of military cultural competence. *Current Psychiatry Reports*, 18, 26.
- Obama, B. (2009, 17 August). Speech to the Veterans of Foreign Wars. Phoenix, Arizona.
- Rost, M. (2014). *Kompetenzmanagement und Dynamic Capabilities: Eine empirische Fallstudie bei einem Unternehmen aus der Automobilzulieferindustrie*. Lohmar: EUL-Verlag.
- Rost, M. (2016). Kompetenzen von Franchisenehmern zur Förderung von Effizienz und Innovation. In W. Martius, A. Hecker, & B. Renzl (Eds.), *Wissens- und Innovationsmanagement in der Franchisepraxis* (pp. 77–97). Wiesbaden: Springer
- Rost, M., & Steiner, T. (2016). Talentmanagement im Direktvertrieb. Kompetenzen durch Verunsicherung entwickeln. *F.a.Z. Personaljournal*, 10, 13–14.
- Spencer, L., & Spencer, P. (2008). *Competence at work: Models for superior performance*. New York: John Wiley & Sons.

VIZIONI, DOMOSDOSHMERI PËR SUKSES

Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi
Dr. Valbona Zeka

FMS, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Vizioni është proces i drejtuesit dhe organizatës. Kjo dukuri i jep organizatës vetëdijen e qëllimit, drejtimin, energjinë, forcën, dhe identitetin e saj. Ky proces ekziston në çdo nivel dhe në çdo lloj organizate. Përmbajtja e tij është gjendja përfundimtare e dëshiruar e organizatës. Për këtë arsye, vizioni rrit më tej vlerat, duke siguruar mjetet e organizatës për të parashikuar dhe për të lëvizur i sigurt në drejtim të së ardhmes. Vizionet në përgjithësi bëhen më komplekse dhe zgjaten në afat kohor sipas niveleve të drejtimit. Vizioni strategjik konkurren për ndikim dhe burime në zhvillimin e strategjisë kombëtare.

Drejtuesit në çdo nivel të organizatës janë kujdestarët, zhvilluesit dhe artikuluesit e vizionit. Duke filluar nga drejtuesit e strukturave të vogla e deri te niveli strategjik, drejtuesit udhëheqin përcaktimin e gjendjes përfundimtare të dëshiruar të organizatës. Vetëm drejtuesit zotërojnë autoritetin e vendimit, perspektivën, postin e përvojën e duhur për të përfutur vizionin nga mjedisi, vlerat dhe potencialet e organizatës.

Gjithashtu, drejtuesit nxisin vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të vizionit në përgjigje të ndryshimeve në mjedisin e jashtëm e të brendshëm të organizatës. Masa e vlerës së vizionit është objektive dhe subjektive, domethënë është shkalla në të cilën organizata përmbush misionin e saj si në ditët tona dhe në të ardhmen.

Fjalë kyçe: vizioni, drejtuesi, organizata, realist, i besueshëm, tërheqës, frymëzues, nxitës, e ardhmja, proces, besim, entuziazëm, planifikim, mision.

Hyrje

“Ne kemi nevojë për udhëheqës të frymëzuar nga idealizmi, udhëheqës që kanë vizion të madh, që ëndërrojnë gjëra të mëdha dhe luftojnë për t'i realizuar ëndrrat e tyre; udhëheqës të cilët mund t'i ndriçojnë njerëzit me zjarrin që buron nga shpirti i tyre”¹

Theodor Roosevelt, Presidenti i 26-të i SHBA

Në shoqërinë tonë ndihet nevoja për të pasur një lidërsip vizionar. Nevojë për lidërsip apo udhëheqje kemi dhe në shtëpitë tona, në organizata qofshin të mëdha apo të vogla, në qendrat e punës ku punojmë, në marrëdhëniet me njerëzit, si ato private, ashtu dhe publike dhe natyrisht, edhe në institucionet vendore dhe qeveritare që dretojnë vendin. Për lidërsipin kemi nevojë më shumë se kurrë ndonjëherë. Dhe sidomos, këtë nevojë për lidërsip e kemi sepse duam që ai të na **prijë përpara drejt së ardhmes**. Ne kemi nevojë për njerëz, të cilët kanë **vizion** dhe **guxim**, njerëz me aftësi për të çarë në rrugë të reja. Siç thotë dhe Brian Tracy: *“një udhëheqës vizionar motivon, inkurajon, frymëzon dhe u jep autoritet njerëzve për ta treguar veten në nivele shumë më të larta se sa kanë bërë ndonjëherë më përpara”²*.

Në këtë kuadër, në drejtimin strategjik të vendit duhet të vijmë njerëz që të kenë një vizion të qartë se ku do t'i çojnë ata që i udhëheqin. Ky vizion duhet të jetë real dhe t'i bindë ata që udhëhiqen se ai është i arritshëm; duhet të jetë i besueshëm dhe të frymëzojë; duhet të jetë tërheqës që njerëzit ta ndiejnë veten pjesë të së ardhmes së projektuar; dhe duhet të parashikojë të ardhmen që t'u tregojë njerëzve jo ku dhe çfarë janë tani, por ku do të shkojnë dhe çfarë duhet të jenë.

Vizioni nxit angazhimin dhe energjinë e njerëzve, i jep kuptim jetës së tyre, krijon standarde të përsosmërisë dhe shërben si urë midis të sotmes dhe të ardhmes. Kolin Pauelli jep një përcaktim filozofik për vizionin: *“Një vizion i mirë është një modelim mendor i së ardhmes. Ai jep qëllimin dhe rrugët që duhen ndjekur për të shkuar drejt synimit final. Vizioni i mirë ngjall entuziazëm te njerëzit dhe duhet të jetë ambicioz”³*.

¹ John A. Barnes, “Udhëheqja e John F. Kennedy, (Mësimet dhe trashëgimia e një Presidenti)” Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë, Dhjetor 2013, ISBN: 978-9928-4193-2-3, faqe 17.

² Brian Tracy, “Lidërsipi” Shtëpia Botuese “Damo”, Prishtinë 2014, ISBN: 978-9951-642-27-9, faqe 4.

³ Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1999, faqe 9-10.

Është e mira që vizioni të ekzistojë në të gjitha nivelet e organizatave. Në organizata shumë të vogla, ai mund të jetë në formën e një mirëkuptimi informal, i shprehur me gojë ndërmjet anëtarëve dhe drejtuesit të kësaj organizate, për shembull, “skuadra më e mirë në kompani”. Në organizata disi më të mëdha, ai shpesh është në filozofinë e komandimit të drejtuesit, në politikat apo deklaratat e shkruara që shprehin synimet e drejtuesit për organizatën apo veprimtarinë e saj. Në nivelet më të larta strategjike, vizioni shpesh shprehet si një formulim e deklarim formal i tij. Vizionet në nivele të ndryshëm të një organizate mbështesin dhe ndikojnë vizionet si të niveleve më të larta ashtu dhe atyre më të ulëta të organizatës. Rreshtimi nga lart-poshtë i vizioneve për një efektivitet më të lartë të organizatës është ndër detyrat kryesore të drejtuesve.

1. Vizioni dhe domosdoshmëria e tij

“Përgjegjësia e drejtuesit është që të mendojë për të ardhmen, askush tjetër nuk e bën këtë.”⁴

Peter Drucker⁵

Koncepti i vizionit është bërë tashmë një term shumë i njohur në rrethet akademike, qeveritare, të mbrojtjes dhe organizatave apo korporatave të ndryshme. Kjo ka sjellë lindjen e shumë përcaktimeve apo përkufizimeve të ndryshëm në lidhje me të. Vizioni është një koncept specifik i asaj që organizata po përpiqet të bëhet. Ai duhet të bazohet jo vetëm në një nocion të qartë mbi mjedisin, por gjithashtu edhe në koncepte të qarta se si do të mund të pozicionohet. *Vizioni strategjik jep një ide (kuptim, vetëdije) për qëllimin përfundimtar, drejtimin dhe motivimin për të gjithë pjesëtarët e organizatës dhe veprimtaritë e saj. Ai jep një koncept të qartë, që shërben për iniciimin dhe fokusimin e qëllimeve, planeve e programeve më specifike të organizatës⁶.*

Natyrisht lind pyetja: Përse vizioni është një domosdoshmëri?

Vizioni i organizatës nënkupton se çfarë ajo dëshiron të bëhet në të ardhmen: ai ka të bëjë me atë që organizata dëshiron të jetë dhe të realizojë. Vizioni shërben për të “ndërtuar një ëndërr” për njerëzit në organizatë, dhe mund të shërbejë për t’i fokusuar dhe frymëzuar ato. Megjithatë, nuk mund të themi se vizioni është thjesht një ëndërr; ai duhet të jetë i bazuar dhe të mbështetet mbi mundësitë e domosdoshme. Në këtë kuadër, vizioni është domosdoshmëri sepse:

Së pari, një vizion i qartë orienton drejt njerëzit në të gjitha strukturat e organizatës. Vizioni duhet të jetë real dhe t’i bindë vartësit se ai është i arritshëm, duhet të jetë i besueshëm, tërheqës dhe frymëzues, që njerëzit ta ndiejnë veten pjesë e së ardhmes. Në këtë kuadër,

⁴ Brian Tracy, “Leadership” Shtëpia Botuese “Damo”, Prishtinë 2014, ISBN: 978-9951-642-27-9, faqe 21.

⁵ Peter Ferdinand Drucker (1909-2005) ishte një konsulent, edukator dhe autor i menaxhimit austriako-amerikan, shkrimet e të cilit kontribuan në bazat filozofike dhe praktike të korporatës moderne të biznesit. Gjithashtu, ai ishte një udhëheqës në zhvillimin e edukimit të menaxhimit, ai shpiku konceptin e njohur si menaxhim me objektiva dhe vetëkontroll, ai mbahet si “themeluesi i menaxhimit modern” (shënim i autorit).

⁶ “Strategic Leadership Premier”, Department of Command, Leadership and Management, US Army War College, 2nd Edition edited by Colonel Stephen A. Shambach, Director of Leader Development - 2004, p. 21.

vizioni si një proces, mundëson dhe krijon një kulturë kohezive dhe një ndjenjë përgjegjësie e cila rrit performancën individuale në veprimtaritë përkatëse. Individui ndjehet pjesë e diçka je më të madhe dhe si i tillë, ai ndjehet i përfshirë në një proces i cili i jep kuptim veprimtarisë individuale.

Së dyti, një vizion real është një ogur i mirë për nxitje dhe frymëzim. Ai paraqet dëshirë dhe vullnet të përbashkët, për të ardhmen e dëshiruar të anëtarëve të organizatës. Në librin “Udhëheqja e John F. Kennedy” thuhet: *“Krijoni një vizion frymëzues. Nëse aspironi të bëheni një udhëheqës, aftësia juaj për të frymëzuar njerëzit nuk është diçka fakultative; ajo është thelbësore. Një vizion i formuluar në mënyrën e duhur jo vetëm që do t’i motivojë njerëzit të mbështesin qëllimet tuaja, por edhe do t’i frymëzojë ata të rimëkëmbin organizatën gjatë krizave”*⁷. Pra, një vizion i formuluar qartë shërben si nxitës për angazhimin dhe energjitë e vartësve, i jep kuptim jetës së tyre, krijon standarde të përsosmërisë dhe shërben si urë lidhëse midis asaj çfarë bën (të sotmes) dhe asaj çfarë do të bëjë (të ardhmes). Një drejtues me vizion dhe intelekt krijon një përfytyrim real për situatën. Prej tij kërkohet të ketë qartësi mendimi, që nënkupton aftësinë për të identifikuar thelbin e problemit, origjinalitet të bazuar në imagjinatën, gjykimin dhe nismën e tij si dhe parapërgatitje që parakupton studimin e vazhdueshëm.⁸ Në këtë kuadër, drejtuesit e mëdhenj në dallim nga të tjerët kanë aftësinë t’i frymëzojnë njerëzit që të veprojnë. Ata që e kanë këtë aftësi, u japin njerëzve një ndjenjë të përkatësisë, e cila nuk ka lidhje fare me asnjë nxitës të jashtëm, apo përfitim të mundshëm. Ata që dretojnë me të vërtetë, kanë aftësinë të krijojnë një grup ndjekësish, të cilët nuk hidhen në veprim sepse u ndikuan por sepse u frymëzuan. Për ata që frymëzohen, nxitja për të vepruar është tërësisht vetjake. Ata nuk ndikohen lehtë nga stimujt. Ata që mund të frymëzojnë, krijojnë një grup ndjekësish mbështetës, punonjës, të cilët veprojnë në të mirë të të gjithëve, jo ngaqë duhet, por ngaqë duan.⁹

Së treti, vizioni siguron mjetin e duhur për të analizuar dhe kuptuar presionet dhe ngjarjet e paparashikuara në mjedisin e jashtëm. Gjithashtu, vizioni ndihmon organizatën për të identifikuar se çfarë është e rëndësishme në mjedisin që na rrethon, përse kërkohet veprim, dhe çfarë veprimi duhet ndërmarrë konkretisht. Martin Luther King Jr., i cili u bë zëdhënës dhe udhëheqës më në zë i lëvizjes amerikane për të drejtat civile nga 1955 deri në vrasjen e tij në 1968, është bërë shumë i cituar për shprehjen e tij vizionare “I have a dream”: *Unë kam një ëndërr se një ditë në kodrinat e kuqe në Georgia bijtë e ish-skllervëve dhe bijtë e ish-pronarëve të skllervëve do të mund të ulen së bashku në një tavolinë si vëllezër*¹⁰.

Së katërti, vizioni në vetvete është hapi i parë në zhvillimin e strategjive dhe planeve

⁷ John A. Barnes, “Udhëheqja e John F. Kennedy, (Mësimet dhe trashëgimia e një Presidenti)” Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë, Dhjetor 2013, ISBN: 978-9928-4193-2-3, faqe 29.

⁸ Kolin Pauell “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtresë, Tiranë 1999, faqe 29.

⁹ Simon Sinek, “Fillo me pse, si liderët e mëdhenj frymëzojnë këdo që të veprojë”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2019, ISBN: 978-9928-261-16-1, faqe 7.

¹⁰ “Strategic Leadership Premier”, Department of Command, Leadership and Management, US Army War College, 2nd Edition edited by Colonel Stephen A. Shambach Director of Leader Development - 2004, page 22.

të nevojshëm për të sjellë ndryshim, pa vizion nuk mund të ketë drejtim, qëllim dhe përfundim të qartë. Menjëherë pas artikullimit të vizionit të dëshiruar, identifikohen me kujdes mënyrat dhe mjetet për arritjen e tij. Në këtë kuadër, vizioni lehtëson procesin e përcaktimit të prioriteteve strategjike të organizatës dhe zhvillimin e planeve specifike, për realizimin në praktikë të vizionit. Një vizion pa një plan është një ëndërr. Vizioni krijon një udhërrëfyes për objektivat në mënyrë që, realizimi i tyre të jetë i qartë dhe i arritshëm për të gjithë organizatën. Shpesh, vizioni është pikënisja për zhvillimin e skemave sistematike të organizatës për të dhënë një pamje të saj si një e tërë dhe e bashkuar, në vend të një organizate, e cila është shuma apo totali i përbërësve apo njësive të saj, që nuk ndjehen pjesë e të njëjtës trupe¹¹.

Së pesti, vizioni është një përcaktues për objektiva të qarta që bëjnë të mundur realizimin e misionit të organizatës. Referuar një studimi, paraqitur nga revista "The Economist", ishin përfshirë 22.000 kompani të ndryshme përgjatë dhjetë viteve, për të cilën kishin punuar 150 hulumtues. Qëllimi i tyre ishte të përcaktonin shkallën e kompetencës drejtuese e menaxhuese në një organizatë dhe në një krahinë, si dhe arsyet përkatëse. Hulumtuesit u morën me tre elemente, për të përcaktuar efektshmërinë e përgjithshme menaxheriale: (1) vendosjen e objektivave të qarta; (2) vendosjen e parametrave të performancës; (3) shpërblimin e performancës së lartë. Në çdo rast, aftësia e përcaktimit të objektivave të qartë për organizatën¹², për secilin departament apo degë dhe për çdo individ përbrenda organizatës, ishte zanafilla e drejtimit dhe menaxhimit të efektshëm, që çonte në performancë dhe rezultate më të larta.

Së gjashti, vizioni formëson apo modelon kulturën e organizatës¹³. Një vizion i suksesshëm integrohet lehtësisht në kulturën e qëndrueshme të organizatës, anëtarët e saj arrijnë ta bëjnë vizionin pjesë të brendshme të tyre dhe të veprojnë në mënyra të tilla që janë në përputhje të plotë me të. Në atë shkallë që organizatat dhe drejtuesit vartës përvetësojnë vizionin nga lart-poshtë, në atë shkallë bashkohen edhe vizionet e tyre me ato të drejtuesve të lartë.

Së shtati, vizioni krijon ndryshim. Ai çon organizatën drejt një gjendjeje të ardhme më efektive. Sillni ndërmend thënien e B. Tracy, "...çfarëdo gjë që ju ka sjellë aty ku ndodheni sot, nuk është më e mjaftueshme për t'ju çuar më tutje"¹⁴.

Së teti, vizioni ndikon pozitivisht, duke përçar optimizëm. Ai modelon mjedisin e organizatës dhe shtron rrugën e logjikës dhe argumentit për të realizuar "ëndrrën e dëshiruar". "Jini optimist - këshillon John A. Barnes - vërtetoni se zbatimi i vizionit tuaj

¹¹ Dr. Urim Qinami, "Vizioni Strategjik", material mësimor, viti 2018, faqe 11.

¹² Brian Tracy, "Kreativiteti dhe zgjidhja e problemeve" Shtëpia Botuese "Damo", Prishtinë 2015, ISBN: 978-9951-642-38-5, faqe 19.

¹³ "Strategic Leadership Premier", Department of Command, Leadership and Management, US Army War College, 2nd Edition edited by Colonel Stephen A. Shambach, Director of Leader Development - 2004, p. 26.

¹⁴ Brian Tracy, "Menaxhimi i kohës", Shtëpia Botuese "Damo", Prishtinë 2014, ISBN: 978-9951-642-26-2, fq. 35.

mund të çojë drejt një të ardhme më të mirë. Për shembull, kini parasysh vizionin e Apple Computer. Steve Jobs-i dhe Steve Wozniak-u vendosën jo vetëm të bënë kompjuterë, por edhe të ndryshonin botën me kompjuterët Apple. Ky qëllim më i lartë i drejtohet vizionit tonë për të ardhmen, kur teknologjia tashmë i ka përmirësuar ndjeshëm jetët tona”¹⁵. Optimizmi është një motivues i madh për anëtarët e organizatës, kjo nënkupton që ata do të kenë një pritshmëri të fortë, se në përgjithësi, gjërat do të shpresojnë të ecin mirë pavarësisht vështirësive apo ulje ngritjeve të tanishme. Nga këndvështrimi i inteligjencës emocionale, optimizmi është ai qëndrim që nuk i lejon njerëzit të bien në gjendje amullie, apo të humbin shpresën dhe të kridhen në dëshpërim në valën e vështirësive. Po ashtu si shpresa, optimizmi na sjell përfitime të mëdha në jetë”¹⁶.

2. Përcaktimi i vizionit dhe kërkesat e tij

“Mënyra më e mirë për të parashikuar të ardhmen, është që ta krijoni atë”¹⁷.

Alek Makenzi, autor dhe ekspert menaxhimi

Vizioni është një term që përdoret gjerësisht në ditët tona, por megjithatë ende mungon një kuptim i qartë i përmbajtjes së tij. Drejtuesi i një organizate, e madhe apo e vogël qoftë ajo, si një nga përgjegjësitë kryesore ka që të ideojë, të planifikojë dhe të vendosë drejtimin e saj për të ardhmen. “E ardhmja” për planifikimin strategjik, në përgjithësi është një periudhë deri në pesë vjet, por mund të jetë shumë më e shkurtër ose shumë më e gjatë në varësi të rrethanave dhe të qëllimit, që është e kushtëzuar nga e kaluara pasi, nuk do të dimë ku do të shkojmë nëse nuk dimë se nga vijmë. Për këtë arsye, nuk është një rastësi që shumica e organizatave, që nuk janë në gjendje të mësojnë nga e kaluara, nuk janë në gjendje të përshtaten dhe të ndryshojnë kulturën organizative. Metodot me të cilat janë projektuar, mënyrat me të cilat janë drejtuar dhe administruar, kultura organizative, klima organizative dhe rëndësia që i kushtohet krijimit të vizionit afatgjatë, krijojnë vështirësi në përshtatje me situata të ndryshme veprimi. Të gjitha organizatat që i kanë mbijetuar kohës, ja kanë dalë falë drejtuesit (me stafin përkatës) të cilët kanë qenë të aftë të përshtaten me sfidat e kohës duke e bërë të tyren thënien Darwiniane: përshtatu ose vdis!¹⁸ Prandaj nuk është çudi që edhe ndërmjet drejtuesve të nivelit të lartë të ketë nga ata që nuk kanë një kuptim të qartë se çfarë përfaqëson vizioni në vetvete dhe përse ai është aq i rëndësishëm për organizatën në përgjithësi.

Sipas Burt Nanus-it, autor i librit “Lidershipi vizionar”, një ekspert i mirënjohur për çështjen në fjalë, vizioni përcaktohet si *një e ardhme realiste, e besueshme dhe tërheqëse*

¹⁵ John A. Barnes, “Udhëheqja e John F. Kennedy, (Mësimet dhe trashëgimia e një Presidenti)” Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë, Dhjetor 2013, ISBN: 978-9928-4193-2-3, faqe 30.

¹⁶ Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7, faqe 114.

¹⁷ Brian Tracy, “Lidershipi” Shtëpia Botuese “Damo”, Prishtinë 2014, ISBN: 978-9951-642-27-9, faqe 21.

¹⁸ Dr. Urim Qinami, “Vizioni Strategjik”, material mësimor, viti 2018, faqe 5.

e një organizate të caktuar¹⁹. Le të shohim në vijim një zbërthim pak më të detajuar të elementeve të këtij përcaktimi:

Realist: Për të qenë diçka domethënëse (kuptimplotë) për organizatën, vizioni duhet të mbështetet në vërtetësi, pra të jetë diçka e arritshme, që ka mundësi të realizohet.

I besueshëm: Një vizion duhet të jetë i besueshëm. Lind pyetja, ndaj kujt duhet të jetë vizioni i besueshëm? Është tepër e rëndësishme që vizioni të jetë i besueshëm për punonjësit apo pjesëtarët e organizatës ku ata punojnë. Në qoftë se vizioni nuk është i besueshëm për vetë pjesëtarët e organizatës, atëherë ai nuk do të përbëjë ndonjë kuptim për ta dhe as nuk do t'i shërbejë ndonjë qëllimi të dobishëm. Një ndër synimet e dobishëm të vizionit është të frymëzojë pjesëtarët e organizatës që të arrijnë një shkallë të caktuar përsosmërie, si dhe të përcaktojnë qëllimin dhe drejtimin e tyre të ardhshëm. Sipas S. Sinek-ut, *një vizion apo kauzë e shkruar funksionon si busull. Dhe me busullën në dorë, çdo vazhdimësi drejtuesish, me vështrimin hedhur tutje përtej horizontit, mund të manovrojë më lehtë mbi teknologjitë, politikën dhe normat kulturore të kohës, edhe pa praninë e themeluesit*²⁰. Vizioni na orienton për drejtimin. Një vizion që nuk është i besueshëm nuk ka mundësi që të plotësojë asnjë nga qëllimet e mësipërme. Pra, ata duhet të besojnë që ky vizion është i arritshëm, se realizimi i tij do të thotë një e ardhme më e mirë për organizatën dhe për këtë duhet që edhe ata të angazhohen e kontribuojnë për vënien e tij në jetë.

Tërheqës: Në qoftë se duam që vizioni të frymëzojë dhe motivojë anëtarët e organizatës, ai duhet të jetë tërheqës. Njerëzit duhet të kërkojnë që të jenë pjesë e kësaj të ardhmeje të përfytyruar për organizatën. Vizioni nuk është diçka për të tashmen, por i përket së ardhmes. Vizioni nuk perceptohet si, “ku ndodhemi aktualisht”, por “ku ne dëshirojmë të jemi në një të ardhme të caktuar”. Le të japim një shembull metaforë: Ju, ndoshta e mbani mend komentin e famshëm të yllit të hokejit Wayne Gretzky. Kur ai u pyet nga një reporter për sekretin e suksesit të tij mbi akull, ai u përgjigj duke thënë: “Shumë lojtarë janë shumë të mirë, por ata shkojnë ku është topi, unë shkoj atje ku do të jetë topi”²¹. Ky vëzhgim është i lidhur drejtpërdrejt me vizionin. Ku do të jetë “topi” (nënkupto organizata) pas 3 deri 5 vjet nga çasti i tanishëm? Po pas 10 vjetësh? Të vendosësh një perspektivë afatgjatë në jetën e veprimtarinë e organizatës, drejtuesi duhet të marrë vendime të kujdesshme dhe të studiara në kohën e duhur. Jo më kot planifikuesi strategjik Michail Kam-i thotë: “Ata që nuk mendojnë për të ardhmen nuk mund të kenë një të tillë”²².

Nanus-i thotë që vizioni i saktë, pra vizioni që shpreh një të ardhme realiste, të besueshme dhe tërheqëse për organizatën duhet që të plotësojë një sërë kërkesash për këtë organizatë,

¹⁹ R. Ramadani, A. Lala, K. Xharo, E. Braneshi, “Udhëheqja strategjike”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë 2010, ISBN: 978-9928-105-15-8, faqe 281.

²⁰ Simon Sinek, “Loja e pafundme”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-265-26-5, fq. 53.

²¹ Brian Tracy, “Ndryshoni të menduarit tuaj, ndryshoni jetën tuaj, si të zbulosh potencialin tënd për sukses e arritje”, Botimet Elta BS, Viti 2009, ISBN: 987-9951-544-08-5, faqe 244.

²² Po aty.

si më poshtë:

Tërheq angazhimin e njerëzve dhe nxit energjitë e tyre. Kjo është një ndër arsyt kryesore që na shtyn që të kemi një vizion për organizatën: pra sigurohet efekti i saj motivues, nxitës e përfshirës. Mendojeni për një çast vizionin si një ajsberg. E vetmja gjë që shohim është maja e ajsbergut, pra janë gjërat që tashmë i kemi realizuar. Në një organizatë shpesh janë themeluesit dhe kontribuuesit e parë ata që e kanë më të qartë vizionin për të ardhmen e panjohur, i cili për të gjithë të tjerët mbetet i padukshëm. Sa më i qartë të jetë formuluar vizioni, aq më shumë do të tërheqë njerëz novatorë apo edhe të tjerë, ata që janë të gatshëm të ndërmarrin të parët rreziqet për të çuar përpara diçka që ekziston pothuajse tërësisht në imagjinatën e tyre. Çdo sukses zbulon për të tjerët pak më shumë nga ajsbergu: vizioni bëhet më i dukshëm për ta. Kur të tjerët e shohin se vizioni bëhet i vërtetë, skeptikët kthehen në besimtarë dhe gjithmonë e më shumë njerëz frymëzohen nga kjo mundësi dhe me dëshirë i kushtojnë kohën dhe energjinë, idetë dhe talentet e tyre për të ndihmuar në çuarjen përpara të kauzës. Por pavarësisht se sa arrijmë të shohim nga ajsbergu, drejtuesit tanë kanë përgjegjësinë të na rikujtojnë se pjesa dërrmuese ende mbetet e pazbuluar. Pavarësisht sa sukses mund të gëzojmë, kauza e drejtë për të cilën po punojmë qëndron përpara dhe jo pas²³. Në këtë kuadrë, kur njerëzit kanë mundësi të shohin që organizata e tyre është e përfshirë në përmbushjen e një vizioni të caktuar, kjo krijon entuziazëm të ligjshëm të njerëzit për kursin që organizata synon të ndjekë, dhe njëherazi rrit angazhimin e tyre për të punuar në drejtim të arritjes së këtij vizioni.

Krijon një kuptim për jetën e punonjësve. Vizioni bën të mundur që njerëzit të ndjehen si pjesë e një të tërë më të madhe, dhe në këtë mënyrë, ai siguron një kuptim e qëllim për punën e tyre. Vizioni i saktë ka një domethënie për çdo pjesëtar të organizatës, sidomos kur ata të shohin nga afër se si puna dhe përpjekjet e tyre po kontribuojnë në përmbushjen e këtij vizioni. “*Është pikërisht fuqia e tij, - thekson Barnes, - që i motivon njerëzit. Vizioni ofron shkëndijën thelbësore, ajo bën dallimin ndërmjet njerëzve të cilët thjesht bëjnë diçka sa për sy e faqe dhe atyre që vërtet përpiqen të arrijnë diçka. Vizioni nxjerr më të mirën e tyre, diçka mbi dhe përtej të zakonshmes dhe së përditshmes. Vizioni ideal është lartësues*”²⁴. Le të japim një shembull: Kini parasysh dallimin ndërmjet një ushtari profesionist në batalionin “Komando” që mund të thotë: “*Si gjithë të tjerët, edhe unë marr pjesë në stërvitje, shërbime dhe çdo veprimtari tjetër të repartit, thjesht nga nevoja që kam për të marrë një rrogë*” dhe të një ushtari tjetër, që shprehet: “*Ne stërvitemi çdo ditë me seriozitet në të gjitha disiplinat e programit mësimor me qëllim që reparti ynë të jetë repart elitë në Forcat tona të Armatosura, dhe të shquhet për nivel të lartë të përgatitjes luftarake, disiplinë, përkushtim dhe përmbushje me sukses të të gjitha detyrave të ngarkuara*”. Siç vërejmë, megjithëse veprimtaria në këtë rast është e njëjtë për të dy ushtarët, kuadri dhe kuptimi i punës për ta është i ndryshëm, pra një domethënie tërësisht larg njëra-tjetrës.

²³ Simon Sinek, “Loja e pafundme”, Shtëpia Botuese “MINERVA”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-265-26-5, faqe 51-52.

²⁴ John A. Barnes, “Udhëheqja e John F. Kennedy, (Mësimet dhe trashëgimia e një Presidenti)” Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë, Dhjetor 2013, ISBN: 978-9928-4193-2-3, faqe 18.

Krijon standarde përsosmërie. Vizioni luan një rol të rëndësishëm në krijimin e standardeve të përsosmërisë. Tom Peters, autori i librit “Në kërkim të përsosmërisë” flet rreth vajtjes së tij në një organizatë, e cila kishte një mori problemesh për të zgjidhur. Kur ai u përpoq që lidërsihipi i organizatës të trajtonte këto probleme, ai mori përgjigjen mbrojtëse: “Por ne nuk jemi më keq se të tjerët”, që do të thotë se mirë jemi, nuk kemi përse të shqetësohemi e të bëjmë përpjekje për më tej. Një vizion i tillë, që nuk karakterizohet nga përpjekjet për arritjen e përsosmërisë nuk do të motivojë apo emocionojë asnjë në këtë organizatë. Standardi i përsosmërisë mund të shërbejë gjithashtu si një qëllim i vazhdueshëm dhe të nxisë programe të përmirësimit të cilësisë, si dhe të sigurojë njësinë matëse të vlefshmërisë dhe meritave të organizatës.

Lidh të tashmen me të ardhmen. Vizioni i drejtë e nxjerr organizatën nga e tashmja, nga gjendja aktuale dhe e fokuson atë tek e ardhmja. Është lehtë të rrëmbeheni nga krizat, shqetësimet apo problemet e ditës dhe të humbisni shikimin për ku synoni të shkoni. Një vizion i përcaktuar drejt, mund t’iu orientojë me siguri drejt së ardhmes, dhe njëherazi të garantojë një drejtim të saktë dhe efikas të organizatës. Megjithatë, vetëm vizioni, i pashoqëruar me masa të tjera, nuk mjafton që t’iu lëvizë juve nga e tashmja drejt së ardhmes. Sipas K. Pauellit, *një drejtues i mirë jo vetëm duhet të besojë dhe ta publikojë vizionin, por edhe duhet ta mbështesë atë. Ai duhet ta bëjë këtë nëpërmjet planifikimit strategjik. Ndërsa vizioni tregon se ku do të shkohet, planifikimi strategjik duhet të përcaktojë se si do të shkohet atje, duke u nisur nga gjendja konkrete*²⁵. Në këtë kuadër, hartimi i një plani strategjik është i nevojshëm, sepse vizioni është gjendja e dëshiruar e organizatës, pra përfytyrimi si do të jetë ajo në të ardhmen; ndërsa plani strategjik tregon mënyrën si të arrijmë atje ku dëshirojmë të shkojmë në të ardhmen.

3. Zhvillimi i vizionit

*“Ka nga ata që i shohin gjërat siç janë dhe pyesin përse... Unë ëndërroj gjëra që nuk kanë ndodhur kurrë dhe pyes veten; përse jo?”*²⁶

Robert Kennedy

Për të zhvilluar një vizion të qartë duhet të njihni në detaje se çfarë përfaqëson një i tillë, si dhe të dalloni një parashtrësë vizioni sa herë që ju keni rastin të shihni apo të ballafaqoheni me një të tillë. Me të drejtë mund të shtrohet pyetja se në ç’mënyrë duhet të veprojë një drejtues i nivelit strategjik për zhvillimin e vizionit për një organizatë të dhënë? Nanus-i nga ana e tij ofron disa këshilla që mund të shërbejnë për çdonjërin që merret me formulimin e vizionit të një organizate të caktuar dhe konkretisht:

Mësoni dhe njihuni me gjithçka që është e mundur rreth organizatës tuaj. Njohja e plotë dhe e gjithanshme e organizatës, ka një rol të pazëvendësueshëm, ajo përbën bazën për zhvillimin e vizionit tuaj për organizatën.

²⁵ Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1999, faqe 10.

²⁶ Dr. Urim Qinami, “Vizioni Strategjik”, material mësimor, viti 2018, faqe 24.

Angazhoni protagonistët kryesorë të organizatës në procesin e përcaktimit të vizionit. Një ndër kërkesat e domosdoshme të paraqitura nga Nanus-i gjatë përcaktimit të vizionit është: “Mos bëj përpjekje që të realizosh i vetëm zhvillimin e vizionit. Në qoftë se kërkon që anëtarët e organizatës të pranojnë vizionin tuaj dhe njëherazi që ky vizion të jetë i përbashkët dhe të ndahet ndërmjet tyre, është e nevojshme që në procesin e zhvillimit të vizionit të përfshihen autoritetet dhe protagonistët kryesorë të organizatës”²⁷.

Jini të gatshëm, merrni në konsideratë fakte të tjera, ndërkohë që shqyrtoni variantet përkatëse për një vizion të ri. Gjatë gjyqimit tuaj nuk duhet të ndikoheni nga drejtimi apo kursi aktual i organizatës, i cili mund të jetë një kurs i drejtë, sikundër edhe mund të mos jetë.

Inkurajoni dhe mirëprisni ndihmën dhe informacionin e dhënë nga kolegët dhe vartësit tuaj. Një arsye tjetër që duhet të na shtyjë për të mos përcaktuar vizionin në mënyrë të vetmuar, është se njerëzit poshtë në organizatë shpesh e njohin atë më mirë dhe kanë një bollëk idesh të pashfrytëzuara. Bisedoni me ata, pasi mund të njiheni me mjaft mendime dhe propozime që mund të jenë me shumë interes, të efektshëm dhe vlera aplikimi.

Kuptoni mirë dhe vlerësoni vizionin ekzistues. Siguroni vazhdimësinë, sa herë që kjo është e mundur, dhe mos flakni tej ide të mira, nisur vetëm nga arsyeja e thjeshtë se ato nuk janë krijuar prej jush. Në librin e tij “Leadershipi vizionar”, Nanus-i përshkruan procesin e formulimit të vizionit të përbërë nga shtatë faza:

1. Kuptoni dhe njihni mirë organizatën tuaj. Për formulimin e vizionit për një organizatë të dhënë, në fillim ju duhet të njihni dhe kuptoni mirë atë. Ndër pyetjet e rëndësishme që kërkojnë përgjigje mund të përfshihen: Cili është misioni dhe qëllimi i organizatës? Çfarë vlerash përçon ajo te shoqëria; cili është karakteri i veprimtarisë? Cili është kuadri institucional brenda të cilit vepron organizata? Cili është pozicioni i organizatës brenda këtij kuadri? Çfarë kërkohet që organizata të jetë e suksesshme? Cilët janë protagonistët kryesorë, brenda dhe jashtë organizatës? Cilat janë interesat dhe pritshmëritë e tyre?

2. Kryeni një verifikim apo kontroll të kujdesshëm të vizionit. Kjo fazë përfshin vlerësimin e kursit ose drejtimit dhe gjendjes aktuale të organizatës. Ndër pyetjet kryesore që kërkojnë përgjigje në këtë çast mund të rendisim: A ka organizata një parashtrës të qartë të vizionit? Cili është drejtimi apo kursi aktual i organizatës? A e dinë drejtuesit kryesorë të organizatës se për ku është drejtuar organizata dhe a janë ata dakord me kursin e ndjekur deri tani? A mbështesin kursin aktual të organizatës sistemet e strukturave, kultura e punës, personeli, stimulimi dhe informimi?

3. Shënoni në vizion. Kjo fazë përfshin procesin e fillimit të ngushtimit të fushës së përcaktimit të vizionit. Pyetjet kryesore janë: Cilat janë kufizimet apo detyrimet për vizionin? Çfarë duhet të plotësojë vizioni? Çfarë çështjesh të rëndësishme duhet të adresohen në vizion?

4. Vendosni kuadrin ose kushtet e vizionit. Kjo është periudha në të cilën ju vështroini tek e

²⁷ R. Ramadani, A. Lala, K. Xharo, E. Braneshi, “Udhëheqja strategjike”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë 2010, ISBN: 978-9928-105-15-8, faqe 287.

ardhmja, dhe ku procesi i formulimit të vizionit fillon e vështirësohet. Vizioni i juaj është një e ardhme e dëshiruar për organizatën. Për të krijuar këtë vizion, në fillim ju duhet të mendoni se si mund të jetë mjedisi i ardhshëm i organizatës. Për këtë, së pari, bëni kategorizimin e zhvillimeve të ardhshme të mjedisit, të cilat mund të kenë një ndikim të caktuar në vizionin tuaj; së dyti, rendisni ato çfarë parashikoni për të ardhmen në çdo kategori zhvillimi; së treti, përcaktoni se cila nga këto parashikime ka më shumë mundësi që të ndodhë; së katërti, caktoni mundësinë e ndodhjes së çdo parashikimi.

5. *Zhvilloni skenarët e ardhshëm.* Kjo fazë vijon drejtpërsëdrejti nga faza e katërt. Pas përcaktimit në mënyrën më të saktë të mundshme të parashikimeve që kanë më shumë gjasa të ndodhin, si dhe të parashikimeve që kanë ndikim më të madh në vizionin tuaj, bëni kombinimin e këtyre parashikimeve në pak skenarë të përmbledhur që përfshijnë serinë e të ardhmeve të mundshme të parashikuara nga ju. Skenarët duhet të përfaqësojnë, në tërësi, të “ardhmet” alternative të mjedisit në të cilat ka të ngjarë të operojë organizata.

6. *Krijoni vizione alternative.* Ashtu siç ka disa të ardhme alternative të mjedisit, po ashtu ka edhe disa kurse alternative që mund të ndjekë organizata në të ardhmen. Qëllimi i kësaj faze është pikërisht krijimi i vizioneve që pasqyrojnë këto drejtime (kurse) të ndryshme. Në këtë fazë nuk bëhet vlerësimi i vizioneve të mundshëm me qëllim zgjedhjen e më të përshtatshmit, pasi ajo i takon fazës në vijim.

7. *Zgjidhni vizionin përfundimtar.* Tani është pikërisht çasti kur ju duhet të zgjidhni vizionin më të mirë të mundshëm për organizatën tuaj. Për kryerjen e këtij procesi, në fillim shikoni cilësitë që duhet të ketë një vizion i saktë, dhe çfarë kërkohet që ky vizion të jetë i suksesshëm, përfshi këtu edhe përputhjen me kulturën dhe vlerat e organizatës. Në vijim, krahasoni vizionet që keni krijuar për skenarët alternativë dhe përcaktoni se cili nga këto vizione të mundshme gjen zbatim në një diapazon sa më të gjerë të skenarëve alternativ. Vizioni përfundimtar duhet të jetë ai vizion, që i plotëson më mirë kriteret që kërkohen për një vizion të mirë, që është në përputhje me kulturën dhe vlerat e organizatës dhe gjen zbatim në kufijtë më të gjerë të mundshëm të skenarëve alternativ (të ardhmes së mundshme).

4. Zbatimi i Vizionit

“Vizioni pa veprim është një ëndërr. Veprimi pa vizion është një makth”²⁸.

Proverb japonez

Tani që kemi një parashitje të vizionit, shtrohet pyetja: “Vallë a kemi mbaruar punë me vizionin?” Formulimi i vizionit është vetëm hapi i parë në këtë proces. Hapi tjetër, dhe më i rëndësishmi, është zbatimi i vizionit. Ky hap megjithëse është edhe më i vështiri, duhet të zbatohet patjetër nëse duam që vizioni të ketë efektin e kërkuar në organizatë. Duke cituar Pauellin: “*Një udhëheqës i mirë duhet t’i motivojë njerëzit dhe ta përcjellë vizionin në çdo nivel drejtimi. Formulimi i vizionit është hapi i parë. Udhëheqësi në nivelin strategjik*

²⁸ Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, Universe, Inc. New York Bloomington 2009, faqe 65.

*ka tre detyra të mëdha: ta formulojë vizionin, ta komunikojë atë, dhe ta zbatojë. Nëse një vizion i deklaruar nuk zbatohet, ai do të ketë efekte të kundërta të njerëzit pasi do të shuajë shpresat. Vizioni duhet të komunikohet për të gjithë njerëzit, duke shfrytëzuar të gjithë mënyrat dhe mjetet.*²⁹ Në këtë kuadër, tre detyrat më të rëndësishme të drejtuesit të nivelit strategjik janë, *formulimi i vizionit, komunikimi dhe zbatimi* i tij. Disa organizata mendojnë se zhvillimi i vizionit është gjithçka që kërkohet të bëjmë. Duhet pasur mirë parasysh se në qoftë se nuk kryhet planifikimi i të gjitha masave të nevojshme për zbatimin e këtij vizioni, zhvillimi i tij nuk është asgjë më shumë se një përpjekje e shkuar dëm. Madje edhe më keq, një vizion, i cili nuk arrin të vihet në jetë, mund të ketë efekte të kundërta (që ndikojnë për të keq) në organizatë, pasi në fillim vizioni krijon parashikime, të cilat mund të çojnë në cinizëm nëse këto parashikime nuk plotësohen.

Përpara se të fillojë zbatimin e vizionit, drejtuesi duhet t'ua komunikojë vizionin gjithë protagonistëve të organizatës, veçanërisht atyre brenda saj. Vizioni duhet të artikulohet mirë dhe qartë, me qëllim që kuptimi i tij të bëhet sa më i lehtë. Dhe, në qoftë se duam që vizioni të krijojë besim dhe entuziazëm si dhe të inkurajojë angazhimin e të gjithë pjesëtarëve të organizatës, është e domosdoshme që ai të komunikohet e të bëhet i njohur për ata, pa përjashtim. Aftësia për të dhënë një vizion të qartë është jetike për një drejtues të nivelit strategjik. Por krijimi i një vizioni do të ishte i pakuptimtë, nëse drejtuesi nuk e bën pjesë të një audience të gjerë, nëse nuk fiton një mbështetje të plotë dhe nëse nuk e përdor atë si një busull³⁰ apo orientues për të drejtuar këtë proces.

Sapo të jetë bërë komunikimi i vizionit, shtrohet pyetja tjetër: *Si do të veprohet për zbatimin e tij?* Tani është pikërisht çasti kur fillon kryerja e planëzimit strategjik. Lidhjet që ekzistojnë ndërmjet vizionit strategjik dhe planëzimit strategjik, me pak fjalë, mund të përshkruhen në këtë mënyrë: zhvillimi i vizionit mund të konsiderohet përcaktim i asaj ku dëshirojmë të arrijë organizata në të ardhmen, ndërsa planëzimi strategjik është përcaktimi i mënyrës se si të arrijmë atje ku duam, duke u nisur pikërisht nga gjendja ku jemi aktualisht. Planëzimi strategjik lidh të tashmen me të ardhmen dhe tregon mënyrën se si të arrijmë te vizioni. Një mënyrë e planëzimit strategjik mund të jetë: në fillim të përcaktohen objektivat që ndihmojnë në arritjen e vizionit, dhe më pas të parashikohen veprimet që krijojnë mundësinë që organizata të përmbushë këto objektiva.

5. Në vend të mbylljes

Në librin “Loja e pafundme”, autori Simon Sinek na ofron një strukturë për të udhëhequr me një “mendësi të pafundme”. Nga njëra anë, askush nga ne nuk mund t'i rezistojë emocioneve të shkurtra të një ngritjeje në detyrë apo të fitimit të një gare, e megjithatë këto triumfe zbehen shpejt. Në ndjekje të një kauze të drejtë, ne do t'i zotohemi një vizioni për një botë në të ardhmen, që është kaq tërheqëse, sa që do ta ndërtojmë javë pas jave, muaj pas muaji, vit pas viti. Pavarësisht se nuk e dimë formën e saktë që do të marrë kjo

²⁹ Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1999, faqe 10.

³⁰ “Army Leadership, Component, Confident, and Agile”, FM 6-22, October 2006, fq. 12-2.

botë, përpjekja për ta realizuar këtë i jep kuptim punës dhe jetës sonë. Sipas Sinek-ut, drejtuesit që përqafojnë një mendësi të pafundme ndërtojnë organizata më të qëndrueshme, më novatore dhe më frymëzuese. Këto ide të tij na tregojnë cilësitë e vërteta të lidershit, aftësi që do të ndihmojnë të zotërojmë një mendësi të re “të pafundme” për të drejtuar më mirë organizatën tonë. Ja sa kuptimplotë shprehet ai: *“E kemi fuqinë të ndërtojmë një botë ku shumica prej nesh të ngrihen çdo mëngjes të frymëzuar; të sigurve në punë dhe të kthehen në shtëpi të përmbushur kur dita të ketë mbaruar. Ky lloj ndryshimi që mbështes nuk është i lehtë. Por është i mundshëm. Me drejtues të mirë, të shkëlqyer, ky vizion mund të vijë në jetë. Drejtuesit e shkëlqyer janë ata që mendojnë përtej “planit afatshkurtër” dhe “planit afatgjatë”. Janë ata që e dinë se kjo nuk ka të bëjë me çerek vitin e ardhshëm dhe as me zgjedhjet e ardhshme; ka të bëjë me gjeneratën e ardhshme. Drejtuesit e shkëlqyer e çojnë organizatën drejt suksesit që shkon përtej kohëzgjatjes së jetës së tyre, e ndërkohë që e arrijnë këtë, përfitimet për ne, janë të jashtëzakonshëm”*³¹. Këta do të jenë individët plot vizion që do të na udhëheqin drejt së ardhmes.

6. Përfundime

Vizioni është busulla e organizatës e cila e orienton dhe e fokuson atë drejt së ardhmes. Përmbajtja e tij është gjendja përfundimtare e dëshiruar e saj. Vizioni përcaktohet si një e ardhme realiste, e besueshme dhe tërheqëse për organizatën. Ai ndihmon në rritjen e frymës kohezive dhe në bashkimin e anëtarëve brenda strukturave të saj, për të përmbushur objektiva ambiciozë dhe për t’u përballur me sfidat që sjell ndryshimi i mjedisit të brendshëm e të jashtëm të saj.

Vizioni nxit angazhimin dhe energjinë e njerëzve, i jep kuptim jetës dhe punës së tyre, krijon standarde të larta dhe lidh të sotmen me të ardhmen. Pa vizion nuk mund të ketë drejtim, qëllim dhe përfundim të qartë. Vizioni është një përcaktues për objektiva të qarta që të çojnë në përmbushjen e misionit të organizatës. Ai “formëson” mjedisin e saj, duke përcaktuar rrugën e logjikës dhe argumentit për të realizuar “ëndrrën e dëshiruar”.

Drejtuesit e organizatave të mëdha duhet të jenë vizionarë dhe largpamës. Ata që nuk planifikojnë mirë janë thjesht kujdestarë. Megjithatë mund ta drejtojnë organizatën, ata nuk do të mund t’u përgjigjen interesave dhe detyrave afatgjata të saj. Drejtuesit, që e ndjejnë përgjegjësinë dhe kujdesin për misionin e organizatës dhe njerëzit, do t’i lënë organizatat e tyre në një gjendje më të mirë dhe me një drejtim më të qartë strategjik se sa kur morën drejtimin e tyre. Planëzimi i mirë, përcaktimi i synimeve dhe i përparësive mund të plotësojnë drejtuesin në këtë sens dhe të krijojnë një trashëgim të vlefshëm.

Një vizion i mirë duhet të jetë gjithëpërfshirës. Nëse ekzistojnë struktura që nuk lidhen ose nuk e mbështesin vizionin, atëherë ata nuk do të frymëzohen për të arritur qëllimet e tyre. Prandaj, gjatë procesit të krijimit të vizionit, përfshini njerëz nga strukturat përkatëse të organizatës tuaj. Përdorni ekipe për të zbuluar se çfarë i frymëzon ata. Bëjeni vizionin tuaj elastik, në mënyrë të tillë që t’u përshtatet rrethanave të papritura ose një mjedisi të

³¹ Simon Sinek, “Loja e pafundme”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-265-26-5, fq. XI.

ndryshueshëm.

Vizioni ka aftësinë të shumëfishojë energjinë e nevojshme për të stimuluar krijimtarinë, të çlirojë potencialin dhe të kufizojë rreziqet për konflikt e barriera në organizatë.

Një vizion i mirë përcaktuar ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në aftësinë zhvilluese të burimeve njerëzore, të rolit të tyre si trupë shoqërore në organizatë si dhe të aftësive individuale të anëtarëve. Kjo bën që individët të jenë më të përfshirë, duke i dhënë vendin dhe rëndësinë e duhur në organizatë.

Drejtuksi duhet të sigurojë vartësit kryesorë që vendimet merren duke u bazuar në vizionin strategjik të projektuar në planin afatgjatë. Në qoftë se organizata ka një vizion strategjik që përfshin detyrat dhe objektivat kryesore të zhvilluara në një plan afatgjatë, procesi i marrjes së vendimeve të përditshme do të ecë në rrugë reale e koherente. Objektivat e mirëpërcaktuar ndërgjegjësojnë për drejtimin e duhur.

Bibliografia

- John A. Barnes, “Udhëheqja e John F. Kennedy, (Mësimet dhe trashëgimia e një Presidenti)” Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë, Dhjetor 2013, ISBN: 978-9928-4193-2-3.
- Burt Nanus, Visionary Leadership: Creating a Compelling Sense of Direction For Your Organization. San Francisco, CA: Jossey-Bass Publishers, 1992.
- Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7.
- Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, iUniverse, Inc. New York Bloomington 2009.
- Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1999.
- R. Ramadani, A. Lala, K. Xharo, E. Braneshi, “Udhëheqja strategjike”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë 2010, ISBN: 978-9928-105-15-8.
- Dr. Urim Qinami, “Vizioni Strategjik”, material mësimor, viti 2018.
- Simon Sinek, “Fillo me pse, si liderët e mëdhenj frymëzojnë këdo që të veprojë”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2019, ISBN: 978-9928-261-16-1.
- Simon Sinek, “Loja e pafundme”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-265-26-5.
- Brian Tracy, “Kreativiteti dhe zgjidhja e problemeve” Shtëpia Botuese “Damo”, Prishtinë 2015, ISBN: 978-9951-642-38-5.
- Brian Tracy, “Lidershipi” Shtëpia Botuese “Damo”, Prishtinë 2014, ISBN: 978-9951-642-27-9.
- Brian Tracy, “Menaxhimi i kohës” Shtëpia Botuese “Damo”, Prishtinë 2014, ISBN: 978-9951-642-26-2

- Brian Tracy, “Ndryshoni të menduarit tuaj, ndryshoni jetën tuaj, si të zbulosh potencialin tënd për sukses e arritje”, Botimet Elta BS, Viti 2009, ISBN; 987-9951-544-08-5.
- “Army Leadership, Component, Confident, and Agile”, FM 6-22, October 2006.
- “Strategic Leadership Premier”, Department of Command, Leadership and Management, US Army War College, 2nd Edition edited by Colonel Stephen A. Shambach, Director of Leader Development - 2004.

RUBRIKA E TRETË

Studime historike

Në kuadër të 100-vjetorit të Luftës së Dibrës ose “lufta nëntëvjeçare” (1912-1921) dhe kthimit plotësisht të sovranitetit dhe tërësisë territoriale shqiptare, *Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi* vjen në këtë rubrikë me një tjetër punim historik me temë **“Lufta e Dibrës - vendimtare për sovranitetin kombëtar shqiptar”**. Nëpërmjet fakteve dhe dokumenteve të arkivuara, ai sjell në kujtesën e lexuesve Luftën e Dibrës, e cila pati rëndësi të veçantë në planin kombëtar. Ajo ishte një dëshmi e identitetit tradicional shqiptar edhe për sfondin e politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare, duke u dhënë mësim fqinjëve dhe Fuqive të Mëdha se trualli shqiptar nuk mund të tjetërsohej.

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj me shkrimin **“Çetat kryengritëse shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore”** i bën jehonë çetave kryengritëse shqiptare, kryesisht mbi baza vullnetare. Veprimtaria e çetave luftarake të ngritura në fshatra e krahina të ndryshme të Shqipërisë dhe në Kosovë ka qenë e dukshme qysh në periudhën e parë të Rilindjes, por pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit çetat u rishfaqën më të plota.

Historiografia ushtarake shqiptare, për vendin dhe rolin e çetave kryengritëse ende është në fillesat e saj për studimin dhe pasqyrimin e të gjithë veprimtarisë së tyre në këtë periudhë historike. Në mënyrë të përmbledhur kjo ishte veprimtaria e çetave që vepruan në Luftën e Parë Botërore në Shqipëri.

LUFTA E DIBRËS – VENDIMTARE PËR SOVRANITETIN KOMBËTAR SHQIPTAR

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi
Akademia e Sigurisë

(Në kuadër të 100-vjetorit të Luftës së Dibrës ose “lufta nëntëvjeçare” (1912-1921) dhe kthimit plotësisht të sovranitetit dhe tërësisë territoriale shqiptare)

Trajtesë e shkurtuar.

Lufta e Dibrës edhe pse nga përmasat ishte krahinore pati rëndësi të madhe kombëtare. Një shekull më parë, Dibra dhe rrethinat e saj bënë që krismat shqiptare në Verilindje të vendit të dëgjoheshin në gjithë hapësirën shqiptare, por dhe në Perëndim. Mesazhi i luftës së shqiptarëve ishte i qartë: “independencë, sovranitet, shtet” në kufijtë e së drejtës juridike të shteteve.

Një rol të jashtëzakonshëm luajtën prijësit, intelektualët dhe luftëtarët, të cilët, për të rimarrë fatin e vendit në dorë, rrokën armët në veri e jug të vendit për të shpallur pavarësinë e dytë të Shqipërisë. Pa luftërat shqiptare, pa krismën e pushkëve të tyre, që të dëgjohej fuqishëm në Konferencën e Versajës dhe më tej në Lidhjen e parë të Kombeve, por dhe në të gjitha kancelaritë e Fuqive të Mëdha, nuk kishte mbijetesë të shqiptarizmit. Kundërpërgjigja në frymë të lartë atdhetarie ishte në vazhdimësinë e traditës në mbrojtje të truallit arbëror, ku përveç mbështetjes qeveritare shqiptare, rol të rëndësishëm luajti lufta e vendosur dhe pa kompromis e luftëtarëve dhe kapëdanëve shqiptarë të zonave verilindore të vendit.

Lufta e Dibrës e vitit 1920-1921 edhe pse konsiderohet luftë lokale, pati karakter thellësisht kombëtar, sepse lidhej me pavarësinë dhe sovranitetin, ndërsa për nga drejtimi organizimi dhe fuqia ishte mbarë populllore. Lufta tregoi ndërgjegjësim e pjekuri mbare populllore dhe identitet të qartë kombëtar, duke u evidentuar si luftë me rëndësi të jashtëzakonshme historike për shqiptarët.

Fjalë kyçe: luftë, organizim, udhëheqës, truall, ndërgjegje kombëtare, pavarësi, identitet.

1. Luftë dhe diplomaci për shtetin dhe sovranitetin e tij

Luftërat e shqiptarëve nuk reshtën në gjithë epokat e pushtimeve të vjetra e të reja. Shqiptarët ndër shekuj e kanë lidhur lirinë me armët, që të garantonin siguri. Etja për të qenë të lirë dhe të pavarur ka qenë plotësisht e justifikuar. Për nga natyra shqiptarët janë “racë luftëtarësh”, për “karakterin, qëndrueshmërinë si komb dhe cilësinë e kastës luftëtare ballkanike me armë në dorë”¹, të trashëguar dhe në kohët moderne. Në fillim-shekullin e kaluar, pavarësia kërkonte sakrifica dhe gjak për ta mbajtur atë nga lakmitë e fqinjëve në veri dhe në jug të vendit. Lufta e Dibrës, Vlorës dhe Koplikut u kthyen në shpëtimtare të vendit në një ndër periudhat më kritike të mbijetesës shqiptare. Lufta e Dibrës nuk është vetëm në gusht-shtator 1920 dhe në vijim deri në dhjetor 1921, por një epike çlirimtare luftarake nëntëvjeçare. Lufta kundër pushtuesve jugosllavë, për të çliruar tokat e krahinës së Dibrës ka qenë një preokupim mbarë shqiptar. Gjithë Shqipëria ishte në luftë veçanërisht në muajt qershor deri në shtator 1920, që për shqiptarët ishin muaj lufte. Në Vlorë luftohej kundër italianëve, në Koplik e Shkodër luftohej kundër malazezëve, në Dibër, Kukës e në Lumë luftohej kundër serbëve.

Kërkesat shqiptare për kufirin në Veri-Lindje, Lindje e Jug-Lindje nga Tivari deri në Prevezë, Mitrovicë, Shkup, Ohër, Prespë, Gramoz, ku popullsia shqiptare shkonte në mbi 80%², nuk u përfillën asnjëherë. Rimarrja e trojeve sipas hartës së 1913-ës bazuar në vendimet e Konferencës së Londrës ishte detyrë imediate për shqiptarët. Tradita dibrane flet për krerët e “Nandë Malet e Dibrës”, kuvendet e luftërat, unitetin krahinor zakonor, që me pushkë kanë pritur çdo pushtues. Roli i madh për mbrojtjen e trojeve amtare vjen si oshtimë e shekujve: “Nand mijë vorret kush i bani,/Dibra mbarë edhe Zerqani..(Haki Stërmilli, “Dibra në prag të historisë”, që i ndan të vrarët e osmanë në tremijë në Rekë dhe nëntëmijë në Gjoricë).

Me vendosmëri i janë përgjigjur luftëtarët dibranë çdo pushtimi.³ Dibra dhe gjithë treva

¹ Eqrem Çabej, “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”, Tiranë, viti 1994, faqe 27.

² Instituti i Historisë në Akademinë e shkencave dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Arkivave të Shtetit të RPSH, “Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920” (Përmbledhje dokumentash), Vëllimi I, II, Tiranë, 1975, dokumenti nr.65, faqe 117-121.

³ Sipas defterit osman të 1467 vilajeti i Dibrës ishte me 188 fshatra e 75 mijë banorë, në shek. 18-të kishte 220 katunde me 250 mijë banorë. Sami Frashëri më 1891 shënon 25 mijë vetëm Dibra e madhe; ndërsa në kohën e LSHP, Dibra kishte 220 mijë mysliman dhe 10 mijë të krishterë vëllezër të një gjaku. Konsulli Italian në Manastir Gaetani D’Aragona, më 1902, na jep 52 mijë banor, 35 mijë në Dibër të Siperme dhe 17mijë në Reke

përreth saj ka pasur identitetin e saj edhe në kohë pushtimesh, ndërkohë që rapsodët popullore i kënduan Maleve të Dibrës dhe përballjes me pushtuesin sikurse ishte përballja me ushtritë e Hajredin Pashës: “Hajredin Pasha, po vjen o Radikës,/Vallë o ku jan o k'to malet e Dibrës...”⁴. Në periudhën pas pavarësisë janë të njohura përballje e përgjakshme në mbrojtje të trojeve dhe identitetit shqiptar, si beteja e Shkupit, Kumanovës, Prizrenit, Gjakovës, Dibër, Caralevë, Qafa e Duhles, beteja lumjano-dibrane në Qafën e Kolesjenit, mali i Pikllimës, beteja legjendare e Lumës, që ishte si betejë e Termopileve shqiptare dhe Veterlo për serbët.

Përballja luftarake shqiptare është dokumentuar në vargëzimin poetik të Naim Frashërit: “Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve”⁵. Në periudhën që shqiptarët po bëheshin gati për të rifituar të drejtat me të gjitha mënyrat diplomacia shqiptare përmes të dërguarve të saj në Paris mori këtë përgjigje: “Kërkesat tuaja nuk duhet të kapërcejnë kufijtë e Konferencës së Londrës. Të mos harroni se serbët dhe grekët luftuan me ne. Ne mund të kuptohemi me serbët, në duan këta t’ju japin një pjesë të tokës që kërkoni, kjo është një punë që s’i intereson Konferencës”⁶. Por për shqiptarët jo rrallë kanë qenë “miqtë”, të huajt dhe mercenarët e paguar prej tyre, në të gjithë shtrirjen shqiptare dhe çmontimi i këtyre “miqësive”, ka kërkuar shumë gjak shqiptarësh. Kështu mbërritja e kolonelit Xhonson, atashe ushtarak në Romë, në një udhëtim hetimor në Vlorë, Durrës, Tiranë, Shëngjin e Shkodër, ku oficerët “shoqërues” të Piaçentinit⁷ nuk i ishin shqitur,⁸ që provon, “kujdesin” e pushtuesve për të mos mësuar të vërtetat shqiptare. Por aty ku nuk bënte punë diplomacia krisma shqiptare vijoi që u dëgjua deri në Mbledhjen e Versajës dhe në fakt vendimet e 1921-it ishin rezultat i krismave në Vlorë, Dibër e Koplik për ta rifituar Shqipërinë e kërcënuar. Kjo periudhë tepër

pa Dibrën e Poshtme dhe Gollobordën. Më 1910 rregjistri turk i vilajetit të Bitolës (Manastiri): 120.486 banor në Dibër (112.226 mysliman, 8254 ortodoks, 6 katolik) pa Lurën e Gollobordën.

⁴ Vallë ku jan o k'to male e Dibrës,/Bëjn' o kuvend o mo n' atë fushë t'Gjoricës,/Në fushë t' Gjoricës o mor te kalaja,/Hajredin Pashën e ka gjet belaja,/Se belaja pashën ç'e ka gjetë,/Malet e Dibrës more ka lidhë besë./ Kanë lidhë besë o, kanë lidhë o të tanë,/Turkut Dibrën o mos me ja lanë./Hajredin Pasha o mor' ky hutaq e./ S'lidhet Dibra more me kërbace,/Hajredin Pasha o mor kry çelik,/Nuk e është Dibra o mor Selanik,/Nuk është Selanik as more Prilep,/Qysh e lype n'Dibër e ke gjet,/Hajredin Pasha ku e ke o ushtrinë,/Malet e Dibrës o mor' mi kan' gri,/N'Malet e Dibres o kanë mbet të tanë e,/Nuk janë pak o mor po 12000 mije e,/Hiç o ma pak o se 12000,/kanë mbet o në llogore në dhe pa i shti,/Hajredin Pasha ku e ke lanë atin?./në Dibër të Madhe e kam lanë të ngratin”.

⁵ Poemë e Naim Frashërit shkruar greqisht dhe është botuar së pari në Bukuresht më 1886, me titullin “O alithis pothos ton Skipetaron”/“Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve”: “Ne nuk jemi kurrësi as turq, as grekër, as sllavë./ Jemi vetëm arbërorë, shqipëtarë zemërtrimë,/Dhe ky emër i nderuar, i lavdishëm është ngahera,/ Rroftë Besa dhe liria! Rroftë drita, dituria!”

⁶ Sipas pohimeve të Ministrisë të Punëve të Jashtme të Francës, S. Pishonit, dhënë delagacionit shqiptar në Paris mbi problemin shqiptar. Takim i bërë më 31.10.1919, me Luigj Bumçi, Mehmet Konica, dr. Mihal Turtulli. Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920 (Përmbledhje dokumentash), Vëllimi I, II, Tiranë, 1975, faqe 443.

⁷ Settimo Piaçentini ish komandant i trupave pushtuese në Shqipëri deri më 3.9.1920 (Sha).

⁸ Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920 (Përmbledhje dokumentash), Vëllimi I, II, Tiranë, 1975, faqe 515.

delikate për Shqipërinë edhe miqtë ndërkombëtare i ka pasur tepër të rrallë, sikurse ishte francezi Justin Godart⁹, kolonel Aubrey Herbertin, Marry Edith Durham¹⁰ etj. Shqiptarët u përballën me erërat dhe vorbullat evropiane, ku u “shkrinë” tre perandori¹¹ dhe fqinjët ballkanikë kërkuar të përfitonin nga shteti shqiptar, ende i pakonsoliduar me institucionet e tij. Dibra dhe treva e saj ishte një prej objektivave të mbretërisë jugosllave.

Lufta e Parë Botërore pati rrjedhoja tragjike për Shqipërinë, ndonëse kjo nuk ishte pjesëmarrëse në të. Territori i Shqipërisë u bë shesh lufte, ku secila palë përpigjej ta përdorte për të realizuar interesat e veta dhe në hapësirën shqiptare shkeli këmba e rreth 250 mijë ushtarëve të tetë ushtrive. Viti i pavarësisë, ende pa u shpallur nga Ismail Qemali, kishte zhvillime të vrullshme: më 8.10.1912, Mali i Zi i shpalli luftë zyrtarisht Turqisë, më 17.10.1912, Serbia dhe Bullgaria i shpalli luftë Turqisë, ndërsa Greqia më 18.10.1912, hyri në luftë zyrtarisht kundër Turqisë, d.m.th., kundër trojeve shqiptare, që kishin qenë pesë shekuj nën pushtimin osman. Fqinjët tanë synonin që Shqipëria të zhbëhej që në embrion të formimit të shtetit. Fuqitë e Mëdha nuk e njohën të vetmen qeveri kombëtare të krijuar në Shqipëri, qeverinë e Ismail Qemalit¹². Gjithë autoritetin ja kaloi KMK-së¹³. Fqinjët ballkanikë të shqiptarëve shfrytëzuan rastin për të zënë “hapësirën e zbrazët, që linte pushtimi osman”, në veri serbët dhe malazezët¹⁴ dhe në jug të vendit, grekët¹⁵. Ndërkohë që “Territori i Dibrës, gjatë LIB, ishte nën pushtimin bullgar, kur Bullgaria ishte përkrah fuqive qendrore dhe pushtoi disa toka shqiptare, por pushtimin bullgar e zëvendësoi ai

⁹ Justin Godart ka shkruar dy libra për Shqipërinë “L’Albanie en 1921”-Shqipëria më 1921 dhe “L’Albanie en 1922”-Shqipëria më 1922, botuar të dy në Paris në vitin 1922. Muin Çami, Fjalor enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, faqe 770.

¹⁰ Personalitetete politike, shtetërore, shoqërore e deri ushtarakë anglezë, që mbrojtjen të drejtat e shqiptarëve në arenën ndërkombëtare janë edhe anglezët: ish-ministrat dhe lordët: Harry Lamington e Dickinson, anëtarët e Dhomës së Lordëve: Irwin, Headly, Howard of Penrith, Noel Buxton, George Lansbury, Renell, Grogan, Tedwell, Eric Drummond; Edward Boyle; deputetët e Dhomës së Komuneve: sir Charles Roden Buxton, Samuel, Walter Ruci, John Massefield; politikanët dhe gazetarët: Henry W. Nevinston, Charles Wood, Henry Noel Brailsford, Ernest Benett, Harry Lamb, Henry Betterton; John Prescott Hewett; Robert MacLead Gladney; Ushtarakët: gjeneralët: George Macmunn; Ian Hamilton, kolonelët: Makenzie, Willoughy Wallace, Colville, majorin Harry Herbert etj.

¹¹ LIB shpërbëu perandoritë e njohura: Austro-Hungarinë, Prusinë, Perandorinë Osmane dhe Rusinë. Gjermania humbi zotërimet koloniale dhe shtatë shtete evropiane fituan pavarësinë si: Çekosllovakia, Estonia, Finlanda, Letonia, Lituania, Polonia, Jugosllavia, një fakt historik.

¹² Histori e Shqipërisë, Vëllimi III, Tiranë, 1984, faqe 109.

¹³ Po aty, faqe 109-110.

¹⁴ Serbët dhe malazezët u lëshuan me tërbim drejt tokave shqiptare në anën e Shkodrës e të Lezhës dhe të Lumës e të Dibrës. Më 4.10.1912 ushtria e gjeneral Martinoviçit (Malit të Zi) pushtoi portin e Shëngjinit. Më 10 nëntor 1912 serbët morën Manastirin. Gjeneral Vukoviçit hyri në Malësi të Shqipërisë dhe serbët në ndihmë të malazezëve arritën në lumin Kir; më 29 nëntor 1912, forcat serbe pushtuan Dibrën, ngritën administratën, duke riorganizuar Qarkun e Dibrës, që synonin ta vendosnin në juridiksionin e saj edhe Radomirën e Matin. Në krye të Dibrës u vu Nallçanik Spiro Popoviç.

¹⁵ Ushtria Greke në sinkron me serbwt pushtonte territore në jug të Shqipërisë e mbështetur në prapavijë me frymëzimet e rusëve, anglezëve dhe francezëve, që ishin bërë edhe furnizuesit me armatime e municione të saj.

serb”¹⁶. Me armë i pritën dibranët edhe në vijimësi pushtuesit pas osmanë, me luftën nëntëvjeçare kundër pushtuesve serbë, shkruan një epope te ndritur kombëtare duke i thënë “ndal” aneksimit të trojeve të nëntë maleve të Dibrës. Prijësit dhe luftëtarët dibranë shkruan faqe të ndritur historie të luftës për liri, pavarësi dhe sovranitet, duke i dhënë dimensionin e nderit Dibrës dhe dibranëve.

2. “Vija strategjike” e projektuar nga gjenerali francez një dredhi evropiane

Në kushtet e pas-Luftës së Parë Botërore ose pas Luftës së Madhe qarqe të shumtë antishqiptare u bashkuan për të “menduar” për “zgjidhje” në marrëdhëniet fqinjësore ballkanike, por që kishin qëllime thellësisht antishqiptare. E tillë ka qenë edhe e ashtuquajtura “vija strategjike”. Dhe këtë zgjidhje do ta jepte “vija strategjike” i ideuar nga gjenerali francez Franchet d’Esperey. Burrat e mençur të Dibrës e kuptuan menjëherë hilenë franceze për ndërmjetësi dhe zgjidhje. Elez Isufi mbeti një kundërshtar i ashpër i aneksimit të tokave shqiptare sipas “vijës strategjike” të projektuar nga gjenerali francez Franchet d’Esperey. Por çfarë ishte “vija strategjike”? “Vija strategjike” ishte projektuar nga miku i serbëve gjenerali d’Esperey, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, serbët do mbanin nën pushtim toka që gjendeshin brenda kufirit të Shqipërisë londineze¹⁷. Sipas kësaj, “vije strategjike” pas mbarimit të luftës së Parë Botërore, serbët mbanin nën okupim toka që gjendeshin brenda kufirit të 1913-ës dhe shtrihej nga Martaneshi, Qafa e Buallit, Qafa e Murrës, Lana e Lurës, Malësitë e Kelmendit dhe Gjakovës. Kjo vijë strategjike nuk u respektua prej shqiptarëve. Por ajo mbeti në duart e serbëve deri më 1921, kur u tërhoqën përfundimisht nga trualli i Shqipërisë. Fakt është se Qeveria e Sulejman Delvinës i kishte duart të lidhura me pushtuesit në prag, prandaj dhe nuk mund të përkrahte prijësit dhe luftëtarët shqiptarë që luftonin në katër fronte njëherazi në vitin 1920 në Vlorë¹⁸, Shkodër, Lumë, Dibër e Stëblevë. Fillimi i luftës u vendos në mbledhjen e krerëve dibranë, që u mbajt në katundin Arras të Peshkopisë nën drejtimin e Elez Isufit¹⁹. Veprimet e armatosura nisën nga mesi i gushtit, rreth datës 15 gusht 1920. Kryengritësit çliruan Peshkopinë dhe i detyruan pushtuesit të tërhiqeshin në kufirin e 1913-ës në dhjetor të vitit 1921. Bashkë me tërheqjen e trupave pushtuese sllave u hodh në kosh të historisë edhe “vija strategjike” e projektuar nga gjenerali francez Franchet d’Esperey, vijë e cila nuk u respektua asnjëherë praj shqiptarëve, si plan ogurzi franko-serb, e gatuar në “kuzhinën” e Beogradit dhe e miratuar në korridoret diplomatike-ushtarake të Parisit. Qëndrimet e Parisit kanë sjellë edhe

¹⁶ Gazmend Shpuza, “Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme”, Tiranë, Viti 1986, faqe 257.

¹⁷ Dalip Greca: Elez Isufi, prijësi popullor dibran që historia i dha pavdekshinë, dhe Sejfi Vllamasi, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, Tiranë, Neraida 2000.

¹⁸ Konferencë shkencore: “100 vjetori i Luftës së Vlorës”, Vlorë, Salla “Petro Marko” dhe Universiteti i Vlorës, 3.09.2020.

¹⁹ Elez Isufi, (1861-1924); udhëheqës i shquar popullor në luftën për mbrojtjen e pavarësisë kombëtare e të tërësisë tokësore të Shqipërisë. Lindi në Sllovë të Dibrës. Në krye të forcave patriotike dibrane u ndesh me pushtuesit serbë më 1912. Udhëhoqi kryengritjen e armatosur që shpërtheu në krahinën e Dibrës më 15 gusht 1920, për çlirimin e tokave të shtetit shqiptar të pushtuara nga forca të armatosura jugosllave. Në betejën në Peshkopë më 16.12.1924, u plagos rëndë dhe vdiq më 29.12.1924.

përgjatë shekullit që kaloi pehllivanllëqe që janë të krahasueshme me “vijat strategjike”, “novacione”, shashka për “çorodite të opinionit publik”, për të realizuar synimet²⁰. Në këtë rast “falangat nacionaliste” serbe kishin prapavijë franceze.

2. “Çlirimi i trojeve shqiptare me çdo çmim”, vendim i kuvendit të Arrasit

Më 2 gusht 1920²¹ ishte firmosur tërheqja e italianëve nga Vlora dhe gjithë ultësira perëndimore, në Veri të vendit, zhvillimet ishin komplekse dhe pushtuesit kishin ngulur thonjtë në trupin e drobitur të Shqipërisë. Dibra dhe dibranët ishin në luftë, prandaj edhe populli e shprehte situatën luftarake në verilindje të vendit në vargjet: “Në tan’ Evropën ka shkue fjala/Qe nandë vjet luftojmë me krajla.” Dibra tregoi edhe një herë në këtë periudhë të vështirë të kombit për rolin e saj vendimtar me trimëri dhe mençuri duke shkruar faqe historike në independencën e vendit. Sipas burimeve historike më 7.8.1920, në Arras u organizua një takim me pjesëmarrjen e tremijë dibranëve, takim ku u shpreh krenaria për Luftën kombëtare të Vlorës kundër italianëve dhe shprehën gatishmërinë për të mbrojtur me çdo çmim trojet e të parëve. Kronikat e kohës janë më se të gjalla. “3 mijë vetë, që prisnin lajmin e shumëpritur dhe rëndësinë e kësaj dite në jetën dhe në historinë kombëtare”²². Por më 10.8.1920 “Trupat serbe invaduan befaz territorin shqiptar në krahinat e Shkodrës, Dibrës dhe Elbasanit.” Serbët kishin qëllim zhdukjen e shtetit dhe shfarosjen e racës sonë²³. Qeveria shqiptare me përfaqësuesit e saj diplomatikë në Paris “kërkoj pranë Fuqive të Mëdha, ndërhyrjen e tyre që të ndalet agresioni i pashembullt dhe të shpëtojë nga katastrofa..”²⁴. Paria dibrane e këtij takimi vendosi që më 13.8.1920, në Arras të mbahej një kuvend i posaçëm, që u quajt Kuvendi i Arrasit²⁵. Edhe një herë u shpalos tradita e

²⁰ Për paralele historike: Novacione të përngjashme Franca ka pasur përgjatë gjithë shek. XX, kur Presidenti Charles de Gaulle, më 1966, ngriu statusin e pjesëmarrjes së Francës në Strukturën e Integruar Ushtarake të NATO, kur nuk fsheh lavdinë dhe ambicet e vjetra të Francës, apo qëndrimet dhe “idetë populiste” për NATO-n dhe çështje të tjera në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, “sovrانيتin ushtarak” etj

²¹ Protokollin i 2 gushtit 1920, të publikuar nga Muin Çami, Lufta e Vlorës, dokumenti me Nr. 30 (f. 261-263) duke e plotësuar piken II të Protokollit, sipas botimit tek “Dokumenta e material Historike nga Lufta e Popullit Shqiptar”, me frazen “me përjashtim të ishullit të Sazanit”. Protokollin i 2.8.1920, i hoqi Romës çdo të drejtë për t’i kërkuar Konf.Paqes Versajë njohjen e pretendimeve të saj mbi Shqipërinë.

²² Instituti i Historisë në Akademinë e shkencave dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Arkivave të Shtetit të RPSH, “Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920” (Përmbledhje dokumentash), Vëllimi I, II, Tiranë, 1975, faqe 439.

²³ Po aty faqe 439.

²⁴ Po aty, Fondi MPJ, Dosja nr. 24, përkthyer nga frëngjishtja për nr.28 të dokumentit që daton 10 gusht 1920, faqe 439.

²⁵ Në kuvend të Arrasit morën pjesë edhe prijësat: Elez Isuf Ndreu, Ramiz Bej Dibra, Dine bej Maqellara, Izet bej Maqellara, Selman Alia, Jashar Erebara, Ramiz Daci, Ismail Strazimiri, Selë Bajraktari, Shaqir Dema, Dine Dema, Riza Lusha, Dervish Lusha, Dine Hoxha, Selim Noka, Haxhi Noka, Murat Kaloshi, Abdi Kaloshi, Sali e Selim Noka, Ramadan Cami, Selman e Hakik Mena (Lurë), Llan Destani, Kurt Spata dhe Dikë Spata, Ali Tahiri (Pira-Muhurr), Lita nga Ploshatani, si dhe disa përfaqësues nga paria e Matit. Kristo Frashëri, Histori e Dibrës, Botimet M&B, Tiranë, 2010.

bashkimit sipas Nëntë maleve të Dibrës²⁶. Drejtuesit e Kuvendit të Arrasit, morën disa vendime të rëndësishme, të cilat në gojën e popullit u quajtën si vendime të “Qeverisë së Përkohshme”. Kuvendi zgjodhi një shtab, anëtarë të të cilit ishin Elez Isufi, Jashar Erebara, Ramiz Daci, Suf Xhelili, Ismail Strazimiri, Destan Puca etj. Shtabi luftarak në një kohë të shkurtër dy-tri ditore zgjidhi çështjet më esenciale të karakterit politik dhe ekonomik e ushtarak. Komunikimi me Hasan Prishtinën shumë aktiv dhe pjesëmarrës në një kongres të delegatëve fuqiplotë e diplomatëve nga Italia, Hungaria e Bullgaria, kishin përgatitur programin luftarak të një kryengritje të përgjithshme, ku ndër të tjera ishte vendosur që “dibranët të sulmonin ushtrinë serbe më 15.8.1920”. Prandaj sikurse në Vlorë edhe në Dibrë lufta do fillonte me ultimatum që ju dërgua komandës së ushtrisë serbe në Llasën “për tërheqje brenda 24 orëve”. Forcat e ushtrisë serbe ishin të konsiderueshme diku tek rreth dhjetë batalione të mbështetura edhe nga bateri artilerie. Forcat kryengritëse ishin më të vogla në numër dhe të pa armatosur plotësisht. E megjithatë sulmi i kryengritësve filloi më 13.8.1920, që nën drejtimin e prijësve malësorët vullnetarë nga Çidhna, Reçi, Dardha, Kastrioti, Muhurri, Zerqani e Golloborda sulmuan furishëm me objektiva e vija të kapjes të detajuara mirë me qëllim që Dibra të çlirohej plotësisht. Lufta u zhvillua pa kompromis, sepse shqiptarët nuk mund të bënin pazarllëk për trojet e cingura shqiptare të Shqipërisë. Kur Shqipëria festonte fitoren kombëtare të Luftës së Vlorës, Beogradi politik synonte që me ushtritë e veta të shfrytëzonte rastin dhe të vijonte të thurte plane lufte e pushtimi. Shqiptarët mbyllnin një plagë, serbët hapnin plagë të tjera në trupin e drobitur nga luftërat. Një pabesi fqinjësore e mbështetur në fshehtësi e djallëzi nga Fuqitë e Mëdha. Në këto situatë komiteti i drejtoi një ultimatum komandës serbe në Peshkopi, ku i kërkonte zbrazjen për një ditë e një natë, të tokave të Shqipërisë, por komanda e ushtrisë serbe nuk u përgjigj. Kështu që kryengritja filloi në Dibrën e Poshtme. Nga të dhënat dokumentare, sikurse është “Raport i Prefekturës së Dibrës” të datës 14.8.1920, dokumenton: “14 orë luftë të rreptë në karakollin²⁷ në Luzni”, çka dibranët i thyen keqas serbët dhe i ndoqën deri në Drin. Në këto luftime pati dy dëshmorë e 9 të plagosur²⁸. Thirrja tradicionale “A besa-besë”, me mijëra luftëtarë të udhëhequr nga Jusuf Xhelili, nipi i Elez Isufit në mëngjes të 16.8.1920, sulmuan Kodrat e Shumbatit ku ndodheshin forcat kryesore serbe. Luftimet që ishin shumë të ashpra zgjatën një orë dhe ushtria serbe u shpartallua, ku lanë 100 të vrarë dhe mbi 600 robër, si dhe mjaft armatime dhe municione.

Drejtuesit e Komitetit vepruan me shpejtësi dhe kryengritja e luftëtarëve u përhap me shpejtësi në Dibrën e Sipërme, kështu që ushtritë jugosllave u detyruan të braktisin “vijën

²⁶ Sipas burimeve të ëbesite të qarkut Dibrë: Nente Malet e Dibrës ishin: Reçi, Dardha, Çidhna, Muhurri, Luznia në Dibrë të Poshtme; Gryka e Vogel, Gryka e Madhe, Bulqiza dhe Selishta në Dibrë të Epërme. Por shpesh në “Male” futet edhe Golloborda Perendimore.

²⁷ Karakolli, dikur ka qenë stacion policie/xhandarmëria për të ruajtur rendin dhe qetësinë dhe ndëshkimin e paligjshmërisë.

²⁸ Nga pala shqiptare pati një xhandar dhe Dalip Toçi nga paria dëshmorë si dhe një oficer, tre xhandarë dhe pesë vullnetarë të plagosur. Nga serbët 10 serbë robër, 10 barrë municion pushkësh franceze, një arkë bomba dhe shumë ushtarë serbë të vrarë; po aty faqe 444.

strategjike” dhe në mbrëmje kryengritësit zunë vijën e kufirit shtetëror. Çfarë ishte “vija strategjike”? “Vija strategjike” ishte vija imagjinare por edhe ëndërrimtare e serbëve, “Brenda kufirit shqiptar, e shtrirë në Peshkopi, Kukës, Has, Malësi e Gjakovës e të asaj të Kelmendit...”²⁹. Prijësit shqiptarë dhe luftëtarët kryengritës kanë qenë plotësisht të vendosur për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë tokë shqiptare, të trungut të krasitur nga Konferenca e Londrës dhe që quhej “Shqipëria londineze”. Kryengritësit të drejtuar nga Komiteti i luftës çliruan Dibrën e Madhe dhe hynë në qytet, ndërkohë që ushtritë jugosllave braktisën qytetin dhe Grykën e Radikës. Ishte një fitore, pa nënshkrim protokollar, por një ditë më vonë më 17.8.1920 kryengritësit u tërhoqën nga qyteti. Elez Isufi, në një deklaratë, ftoi ushtrinë serbe të kthehej në Dibrën e Madhe, duke garantuar dhe respektuar kufijtë e vitit 1913, që ishte njëherazi edhe rekomandimi i qeverisë së Sulejman Delvinës. Qeveria e Beogradit pruri përforsime për të ripushtuar tokat e humbura. Për të përballuar ofensivën e armikut, Komiteti i Luftës përhap forcat në pikat kyçe të kufirit forca të komanduara nga Dan Cami në Vitisht, Destan Puca në Çerenec, Dine Dema në Homesh, Dine Hoxha në Bllatë, Dine Maqellara në Maqellarë, Myftar Kaloshi në Skërtec, Jusuf Xhelili në Kala të Dodës, për të mbrojtur shpinën nga sulmet e armikut që mund të vinin nga Luma. Ndërkohë në raportimin e Prefekturës së Dibrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme në pikën “V” të raportit thuhej se: “Një fuqi 600 vetash e popullit tonë, si pushtoi Kalanë e Dodës u nis për në Lumë” dhe se “deri në 15 km qeveria serbe, si mbas lajmeve nuk ka pasë fuqi as në Ohër, Gostivar, Prizren e as në Shkup”³⁰. Por duhet pranuar se “me largimin e Italisë nga Shqipëria, nuk qëndronte më “argumenti i serbëve” për ndonjë sulm të mundshëm të italianëve nga ana e Shqipërisë, duke mbajtur të pushtuar zonën verilindore”³¹. Në një letër të Hoxha Kadriut drejtuar gjeneralit anglez Filips (20.8.1920), bën fjalë “për popullsinë e Dibrës së Vogël të Elez Isufit, për 2000 robër vetëm nga ushtarët serbë”, ndërsa “shqiptarët shkuen deri në kufi të 1913-tës dhe u ndalën aty tuj ngulë flamurin e Shqipnisë”³².

Fakt është se kryengritja e Dibrës daton në mesin e gushtit 1920. Atë e përkrahu jo zyrtarisht edhe qeveria shqiptare edhe forcat e saj të armatosura. Lakmia serbe bëri që ushtritë e saj të drejtohen disa herë në drejtim të tokave shqiptare. Edhe në fund të gushtit 1920, ndërkohë që pushtuesi Italian kishte “dhënë shpirt” në Vlorë, “serbët sulmuan sërish mbi

²⁹ Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, me autorë Bep Jubani, Hysni Myzyri, Iliaz Gogaj, Fehmi Rexhepi, Ramiz Abdyli, Muharrem Dezhgiu, Beqir Meta, Fehmi Rexhepi, (Redaktor Prof. Dr. Hysni Myzyri); Prizren: Spirint, 2001, faqe 192.

³⁰ Instituti i Historisë në Akademinë e shkencave dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Arkivave të Shtetit të RPSH, “Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920” (Përmbledhje dokumentash), Vëllimi I, II, Tiranë, 1975, faqe 445.

³¹ Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, me autorë Bep Jubani, Hysni Myzyri, Iliaz Gogaj, Fehmi Rexhepi, Ramiz Abdyli, Muharrem Dezhgiu, Beqir Meta, Fehmi Rexhepi, (Redaktor Prof. Dr. Hysni Myzyri); Prizren: Spirint, 2001, f. 201

³² Instituti i Historisë në Akademinë e shkencave dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Arkivave të Shtetit të RPSH, “Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920” (Përmbledhje dokumentash), Vëllimi I, II, Tiranë, 1975, faqe 446.

trojet shqiptare, një marshim i shoqëruar me terror shkatërrime dhe masakra³³. Por fitorja foli gjithmonë për shqiptarët, pasi serbët janë në betejë rreth 1000 të vrarë, por edhe rreth 2000 robër e më tej, u tërhoqën drejt Gostivarit. Lufta e Dibrës e gusht shtatorit 1920 ka hyrë tashmë në fondin e luftërave të trashëgimisë së popullit shqiptar, për drejtimin e mençur dhe luftën e vendosur kundër pushtuesve jugosllavë, për të çliruar tokat e krahinës së Dibrës. Drejtimin e gjeneralit me shajak Elez Isufit dhe veprimet e armatosura të luftëtarëve dibranë i njohën miqtë dhe armiqtë. Serbët raportnin te miqtë e tyre për kundërshtimin e ashpër të shqiptarëve, me të gjitha mënyrat, mjetet, format, armatimet e municionet në dispozicion, me taktikat e tyre dhe strategjinë fitimtare, që jo rrallë herë kanë çuditur historishkruesit e huaj, për vendosmërinë shqiptare, sikurse ndodhi në veprimet luftarake në Dibër, Vlorë e Koplik veprime që zhvilloheshin drejtpërdrejtë në terren, krahas zhvillimeve të konferencës së Versajës në Paris.³⁴

Diplomacia e foli fjalën e saj e megjithatë luftimet në terren vijuan. Po të mbajmë parasysh kompleksi tetin e situatës të luftërave të shumta dhe gjakut të derdhur, por edhe sulmet sllave shumë herë të dështuara, vijmë në një pikë kur përsëri zona dibrane mbeti përsëri pjesërisht e pushtuar. Qeveria e Tiranës vazhdoi me përpjekjet diplomatike, për ta detyruar Beogradin të tërhiqte ushtritë nga tokat e pushtuara në Dibër. Në prill 1921 ajo e ngriti çështjen në Lidhjen e Kombeve dhe dy muaj më vonë në qershor 1921, delegati i Shqipërisë, Fan Noli, kërkoi me këmbëngulje largimin e ushtrisë serbe jashtë kufijve të 1913-ës, të vendosur në Konferencën e Londrës. Lidhja e Kombeve, nën ndikimin e Fuqitë e Mëdha, kërkesën e Tiranës ia kaloi për shqyrtim Konferencës së Ambasadorëve, ku rol parësor kishte Franca, si përkrahëse e Jugosllavisë. Fakt është se Serbët e Beogradit nxitën politikisht e financiarisht kapërdanin e Mirditës, Mark Gjonin, i cili organizoi një kryengritje të armatosur kundër shtetit shqiptar. Rebelimi filloi në fund të qershorit, por shumica dërmuese e mirditorëve, me gjithë pakënaqësinë që kishin ndaj qeverisë së Tiranës, nuk e pasuan krye bajraktarin e tyre, i cili më pas u detyrua të largohej në Jugosllavi. Disfatën më të rëndë Mark Gjoni e pësoi në Shkallën e Gjonit nga Batalioni i Drinit, i formuar me rezervistë dhe vullnetarë dibranë, të drejtuar nga Ali Riza Kosova. Kur serbët erdhën sërish për pushtim, Elez Isufi mobilizoi 1000 luftëtarë nga Reçi, Dardha, Çidhnë e Lurë, dhe bashkë me ushtarët e batalionit të Drinit, i thyen më 1.8.1921 mercenarët te Gropa e Gëlqeres dhe i detyruan të ktheheshin në Arras, pasi lanë rreth 100 të vrarë.

Në ndeshjen e dytë të zhvilluar më 10 gusht, forcat mercenare u tërhoqën përtej Drinit, por nuk u ndoqën në tërheqjen e tyre. Bandat e tyre të ngelura në Mirditë u asgjësuan nga forcat

³³ Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, me autorë Bep Jubani, Hysni Myzyri, Iliaz Gogaj, Fehmi Rexhepi, Ramiz Abdyli, Muharrem Dezhgiu, Beqir Meta, Fehmi Rexhepi, (Redaktor Prof. Dr. Hysni Myzyri); Prizren: Spirit, 2001, fq. 202

³⁴ Konferenca e Paqes e Parisit/Konferenca e Paqes e Versajës ishte takimi i Fuqive Aleate fituese pas fundit të LIB përfshiu diplomatë nga 34 vende. Vendimet ishin krijimi i Lidhjes së Kombeve dhe pesë traktatet e paqes me fuqitë humbëse; Konferenca e Paqes në Paris hapi zyrtarisht punimet më 18.1.1919. Traktati u nënshkrua më 28.6.1919 në 5 vjetorin e vrasjes së Franc Ferdinandit. Traktati i Versajës u rregjistrua nga Sekretariati i Lidhjes së Kombeve më 21.10.1919. Ndërkohë vlonjatët, shkodranët e dibranët luftonin ende për truallin e tyre.

qeveritare. Mark Gjoni si kapedan duke e parë veten të mposhtur kërkoi të dorëzohej në “besë” të Elez Isufit. Prijësi Elez Isufi i priste në Lurë që të dorëzoheshin kapedan Marka Gjoni me forcat e tij, por dorëzimi në “besë” ishte lojë e serbëve. Forcat e ushtrisë serbe, të shoqëruar e udhërrëfyese nga bandat shqiptare e reparte mercenarësh bjellogardiste, u përqendruan gati për sulm përgjatë Drinit të Zi. Më 17.9.1921 komanda serbe dërgon në Dibër për shqiptarët një ultimatum me afat një ditë e një natë, ku kërkohet largimi i tyre nga fshatrat Çidhnë, Dardhë e Lurë nga rrugët që shkonin në Mirditë. Menjëherë u refuzua dhe Këshilli i Luftës lëshoi kushtrimin, kështu një ditë më vonë më 18.9.1921 serbët filluan bombardimin me artileri. Forcat ushtarake qeveritare shqiptare dhe luftëtarët shqiptarë u tërhoqën në vende strategjike, në malin e Sinës dhe të Gjegjishtit. Më 19.9.1921, gjykuan se rruga ishte e hapur, ushtritë serbe marshuan nga Dardha, por në Soricë u ndeshën me dibranët e vendosur, që i thyen dhe detyruan të tërhiqen duke lënë 15 të vranë. Më 20.9.1921 tentuan të marshonin nga Sinja, por u detyruan të tërhiqen, duke lënë 30 të vranë, në pritë e zëna nga luftëtarët popullorë të Guri i Sukës e Kodra e Pëllumbit. Më 21.9.1921 sulmi u përsërit nga ana e Sinës, por kundërveprimi i dibranëve ishte tepër i rreptë dhe serbët u tërhoqën duke lënë 230 të vranë në fushëbetejë. Lufta e dibranëve në zonën e Mirditës shënon një ndër kulmet e përballjes luftarake shqiptaro-serbe, që konsiderohet dhe beteja vendimtare, sepse ushtria serbe që kishte pësuar humbje të konsiderueshme nuk i ndërpreu sulmet, duke shpresuar se kriza politike në qeverinë e Tiranës do detyronte qeverinë shqiptare të pranonte pretendimet sllave.

Më 19.10.1921, në Tiranë erdhi në fuqi qeveria e “Grupit të Shenjtë”³⁵, e vendosur për të mos bërë asnjë lëshim territorial, Beogradi përgatiti një ofensivë për të arritur në Mirditë. Jugosllavët i përqendruan gjithë forcat në një front të ngushtë. Ndërkohë dibranët betejën e fundit serbët i zhvilluan me heroizëm të pashoq, në Lanë-Lurë, në vendin e quajtur Qafa e Gëlqeres, në vitin 1921. Ushtria serbe demonstroi forcë për të zënë vijën strategjike Qafë-Buall, Lanë-Lurë e Qafë-Murrë. Për këtë dërgoi 12 regjimente me 5400 ushtarë, në mbështetje të tyre edhe 31 topa e qindra mitraloza të rëndë e të lehtë. Në Reç-Dardhë rreth dymijë mercenarë të paguar të Tafë Kaziut, Osman Memës dhe Halit Lleshit mbështesnin të ashtuquajturës Republikë të Mirditës të Gjon Marka Gjoni, që në fakt ishte totalisht në shërbim të sllavëve. Edhe pse marshuan në drejtim të Martaneshit e Çermenikës, për të dalë në Tiranë e Elbasan nuk patën sukses përballë trimërisë së dibranëve. Në formacion përballë ishin 400 forca qeveritare të drejtuara nga Ali Rizai dhe shtatëqind vullnetarë të Reçit, Dardhës e Lurës. Lufta do të drejtohej nga komandantët Elez Isufi dhe ushtaraku me përvojë Ali Rizai. Më 26.10.1921 artiljerët serbë filluan të bënin përpunimin me artileri të zonës së luftimeve me forcat qeveritare e vullnetare të Dibërës. Pas tre ditësh luftimi më 28.10.1921 përballja ishte frontale, në një ndër betejat më të përgjakshme.

Luftëtarët, ushtarë apo civilë, u përleshën me ushtritë serbe dhe, në përfundim të betejës i

³⁵ Qeveria e “Grupit të Shenjtë” kishte kryeministër Pandeli Evangjeli (6.1.1859 – 14.9.1949); veprimtar i Rilindjes Kombëtare në diasporën e Rumanisë, politikan me poste kyçe në periudhën e mes dy luftërave botërore, dy herë kryetar i legjislativit, katër herë i ekzekutivit dhe një herë kryetar i Senatit të shtetit shqiptar.

detyruan të tërhiqen në breg të Drinit. Fitorja e Lanës së Lurës pati pasoja të rëndësishme, sepse eliminoi përfundimisht gjithë planet serbe edhe ushtarakët serbë nuk i përsëriten më operacionet ushtarake. Ushtarët shqiptarë bashkë me vullnetarët dibranë rezistuan rreth 40 orë në front dhe më tej kaluan në Lurë. Dibranët luftuan me trimëri e heroizëm deri në përballje trup me trup e bajonetë me bajonetë.

Dibranët dhe trupat qeveritare e ndalën përparimin e ushtrisë serbe në vendin e quajtur Qafa e Gëlqeres. Çeta e Lurës drejtohej në këtë luftë nga Selman Mena, Ibrahim Gjoçi, Gjon Doçi e Hakik Mena³⁶. Nëse i referohemi historiografisë dibrane të shkruar nga bijtë e saj, “Lufta 9-vjeçare e Dibrës më 1912-1921...”³⁷, humbjet kanë qenë kolosale në burime njerëzore dhe materiale³⁸. Trimëria, heroizmi dhe mençuria e prijësve dibranë qëndron në rezistencën heroike dhe mbijetesën përballë mizorive serbe, duke eliminuar panikun e frikën dhe duke siguruar përfundimisht fitoren. Më 9.11.1921, Konferenca e Ambasadorëve hodhi poshtë çdo lloj pretendimi të Beogradit për gjoja “vijë strategjike”. Pranoi vetëm shkëputjen e disa viseve në krahinën e Lumes dhe të Hasit, në trevën dibrane vetëm rrugën që lidhte qytetin me Strugën, e cila kalonte anës Drinit poshtë maleve të Gollobordës. Qeveria serbe e Beogradit deklaroi se do t’i tërhiqte trupat e veta nga “vija strategjike”, por i vijoi provokacionet për të shkaktuar trazira, përpara se të vinte në kufi komisioni ndërkombëtar, i caktuar për të vëzhguar zbatimin e vendimit të Lidhjes së Kombeve (LK). Ish-Jugosllavia u imponua që t’i hiqte ushtritë nga territoret e pushtuara të Shqipërisë dhe u cilësua, agresore nga Lidhja e Kombeve. Shqipërisë iu bashkuan gjithë territoret e pushtuara dhe të synuara në vitin 1921 dhe vijoi të drejtohej nga Këshilli i shtetit.

Dibranët, prijësit dhe luftëtarët kishin mbrojtur me gjak truallin, traditën, lirinë sepse në shekuj askush nuk ka mundur të fitojë mbi ta dhe të drejtën.

³⁶ Vetëm nga Lura, në këtë betejë morën pjesë 34 veta, si: Gjon B. Doçi (i cili dhe u palos), Kolë Mark Rajta, Ibrahim Gjoçi, Ahmet Gjoçi, Hasem Haldeda, Ali Vladi, Xhemë Vladi, Dullë Vladi, Osman Vladi, Liman Buci, Mehmet Ajazi, Islam Peka, Han Hoti, Demë Leka, Sulë Buci, Dan Kaçorri, Kolë Rajta, Liman Haldeda, Xhemë Haldeda, Riza Vladi, Musë Vladi, Xhafer Haldeda, Selman Haldeda, Bajram Haldeda, Ramadan Markola, Dan Haldeda, Rexhep Haldeda, Sulë Mena, Demë Mena, Bajram Vladi. Pikërisht këtu patrioti Haki Sharofi shkroi tekstin dhe Sami Gonxhja shkroi muzikën e këngës himn të Dibrës, e cila u këndua dorazi nga luftëtarët dibranë, e cila njihet si Marshi i Djelmnisë Dibrane. <http://www.radiokosovaelire.com/fatos-daci-lufta-9-vjeçare-e-dibres-me-1912-1921/>. Sipas Fatos Daci: Lufta 9 vjeçare e Dibrës më 1912-1921”; Fatos Daci historian, publicist, anëtar i Akademisë Amerikano-Shqiptare të Shkencave dhe Arteve.

³⁷ Fatos Daci, Gazeta “Sot”, “Lufta 9-vjeçare e Dibrës më 1912-1921..”, 25.9.2013.

³⁸ Për 9 vjet luftë me serbët (1912-1921), për sa u takon masakrave dhe gjenocidit shfarosës të popullsisë dibrane nga Golloborda deri në Reç ka pasur: “407 vetë të therur me thikë, 484 të vrarë me plumb, 503 të djegur në zjarr dhe në total 1394 vetë”, 4855 burra të vdekur në luftë, 55.068 të mërguar dhe të përzënë nga vatrën e tyre nga lufta në Dibër në nëntë vite, 2657 shtëpi të djegur, 54.880 bagëti të marra forcërisht nga pushtuesit, 35 fshatra të plaçkitura si: Sopot, Shupenza, Qyteti i Dibrës së Madhe, Homeshi, Okshatina, Topojani, Golevishti, Zogaj, Çereneci, Maqellara, Bllaca, Kllobçishti, Oboku, Pesjaka, Erebara, Kovashica, Majtara, Trepça, Rabdishti, Staraveci, Tomini, Bellova, Muhurri, Cerjani, Pilafet, Pollozhani, Limjani, Luznia, Peshkopia, Trepça, Dipjaka, Dardha, Shullani, Cereni dhe Vasiet”; Fatos Daci, Gazeta “Sot”, “Lufta 9 vjeçare e Dibrës më 1912-1921..”, 25.9.2013

2. Përfundime për luftën 9-vjeçare të Dibrës

- Prijësit dibranë e njihnin dhe zbatonin zakonet burrorë të odave dibrane që ka qenë protokoli i fjalës dhe besës, si dhe veprimin burrorë, ku burrat flasin dhe me heshtje, kanë ditur të shkruajnë historinë e suksesit me një fjalë, me një lëvizje, me pozicionin e mbajtjes së cigares së duhanit, me pozicionin e mbajtjes së pushkës, të lëvizjes së qeleshes, me formën e dhënies së kutisë së duhanit njësoj si me dhënë besën, por dhe formën e mirëseardhjes, të përcjelljes, përgjigje të mençura, që shprehen edhe në këngë.³⁹
- Tradita dibrane, fjala-fjalë e besa-besë, ka sjellë mbijetesën e kombit në pjesën verilindore të tij, ka ditur të vetorganizohet në shekuj; nëntë vjet luftë e dibranëve kundër serbëve (1912-1921) është një faqe lavdie në historikun e Dibrës dhe Shqipërisë.
- Lufta e Dibrës është vijimësi e luftërave të shqiptarëve për liri, pavarësi e sovranitet kombëtar. Shqiptarët me luftën e Dibrës vërtetuan se dinë të luftojnë, të fitojnë dhe të ndërtojnë shtetin e tyre të pavarur, që për nga rëndësia historike, çlirimi i trojeve shqiptare kudo ku lakmohej Shqipëria konsiderohet si pavarësia e dytë e Shqipërisë.
- Lufta e Dibrës e vitit 1920-1921 edhe pse konsiderohet luftë lokale, pati karakter thellësisht kombëtar, sepse lidhej me pavarësinë dhe sovranitetin, ndërsa për nga drejtimi organizimi dhe fuqia ishte mbarë popullore. Lufta tregoi ndërgjegjësim e pjekuri mbare popullore dhe identitet të qartë kombëtar, duke u evidentuar si luftë me rëndësi të jashtëzakonshme historike për shqiptarët, *ku mund të themi se Kongresi i Lushnjës, Lufta e Vlorës, Lufta e Dibrës dhe Lufta e Koplikut janë ngjarje madhore në historinë e kombit që plotësojnë fuqishëm njëra-tjetrën. Ato janë aksione politiko-ushtarake që risollën pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të munguar.*
- Drejtuesit e Luftës së Dibrës ditën të shfrytëzonin me mjeshtëri Kanunin e “Nëntë malet e Dibrës”⁴⁰, për të përbashkuar në një front anti pushtues gjithë popullsinë e aftë për luftë duke eliminuar çështjet e gjakmarrjes/hakmarrjes, pasi liria dhe Atdheu ishin në rrezik.
- Lufta i Dibrës sikurse të gjithë luftërat e vitit '20-të në Shqipëri kishin objektiv strategjik rivendosjen e shtetit shqiptar në të drejtën e vet territoriale dhe integritetit të plotë, por me qëllim vendosjen e marrëveshjeve miqësore fqinjësore, “... tue i dhanë

³⁹ “Madem i gjallë është krejt mjedisi,/e shenjtë është fjala,/e artë është besa,/kur flet burri, nuk flet mexhlii./ nga e shkuara ndoshta ka pak kthesa,/ se modën ka ndërruar edhe lisi./ por kush i pa e s’i lanë mbresa..”

⁴⁰ Kanuni i 9 maleve të Dibrës është i njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me “Kanunin e Lekë Dukagjinit”, “Kanunin e Labërisë” dhe me “Kanunin e Skënderbeut”. “Kanuni i Maleve të dibrës” është dëshmia monumentale civilizimi në memorien e Dibrës dhe kombit si dhe ndjeshmëria e komunikimit me kodin e lashtë legjislativ etiko-social. Krahinat që nuk iu nënshtruan asnjëherë pushtuesit u quajtën “Male”. Dibra kishte shtatë “Male”, të cilat qenë Reç e Dardhë, Çidhën, Luzni, Muhurr, Katër-Grykët, Gryka e Madhe dhe Gryka e Vogël. Më pas u nda Mali i Reçit e Dardhës dhe u krijua Mali e Reçit dhe Mali i Dardhës, si dhe Gryka u Madhe u nda në dy Male të tjera Gryka e Madhe dhe Bulqiza. Malet u materializuan në Kanun, që formësuan “Kanunin e Dibrës”.

fund armiqësisë” me fqinjët. “Në qoftë se malësorët . do të shtyhen për kalimin e kufijve, atëherë qeveria lypset të ndalojë rreptësishtë, .të mos marrin pjesë në këtë lëvizje tradhtie e marrëzie..”⁴¹

- Prijësit e vullnetarëve dibranë kanë qenë pjesë e elitës së krahut të armatosur të lëvizjes së shtet ndërtimit dhe komb formimit në Dibër dhe më gjerë që kanë përfaqësuar veçanërisht shtresa të mesme por edhe agallarët duke prirë personalisht në luftime.⁴²
- Fitoret luftarake në fushëbetejë në Dibër, Vlorë e Koplik bënë që Shqipëria të regjistrohej në “librin e gjendjes civile ndërkombëtare” të Lidhjes së Kombeve, për arsye se deri në këtë kohë shqiptarët nuk njiheshin nga Evropa as si popull, as si komb me të drejtat juridike dhe as si njësi politiko-shtetërore të ndonjë formati të caktuar. Historia dhe politika e shtetit shqiptar hyri seriozisht në axhendën e kancelarive të mëdha të kohës.⁴³
- Lidershipi i luftës së Dibrës nuk kishte studiuar në akademitë ushtarake, por ishte rritur në shkollën tradicionale popullore të eksperiencës së luftërave të shqiptarëve nëpër shekuj. Udhëheqësja e luftës në Dibër është e njohur në historinë shqiptare që në fakt u dha shqiptarëve personalitetin e munguar dhe rivuri në vend legjitimitetin e shkelur nga rreth 250 mijë ushtarë të tetë ushtrive që shkelën tokën shqiptare përgjatë LIB. Elez Isufi dhe prijësit e tjerë dibranë kishin ecur në gjurmët e prijëseve si Mahmut Daci Kalisi⁴⁴ etj.
- Prijësit e Luftës së Dibrës eliminuan elementët përçarës, realizuan bashkimin dhe unitetin luftarak të gjithë prijësve, ku për të parën herë u mundësua krijimi i një shtabi luftarak unik, i cili drejtoi me zotësi luftarake por edhe mençuri krejt luftën.
- Prijësit e Luftës së Dibrës mundësuan një kombinim të përpiktë të luftimeve të vullnetarëve popullorë në pozicionet e para luftarake, me veprimet e çetave që

⁴¹ Instituti i Historisë në Akademinë e shkencave dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Arkivave të Shtetit të RPSH, “Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920” (Përmbledhime dokumentash), Vëllimi I, II, Tiranë, 1975, No.1409, Telegram Hoxha Kadriut, Sotir Pecit, Ndoc Çobës, Bajram Currit etj., ku Kryeministri S. Delvina, për zgjidhjen e konfliktit me Jugosllavinë në Veri), Tiranë 5 gusht 1920. Faqe 436.

⁴² Prof. Dr. Bajram Xhafa, Kumtesë me rastin e 100 vjetorit të Kongresit të Lushnjës e tij (10 shkurt 2020), ku ndër të tjera theksohet: “ Nga pjesa e krahut të armatosur të lëvizjes së shtetndërtimit dhe kombformimit në Dibër kanë qenë sidomos shtresa e mesme, agallarët si: Demet e Homeshit, Dine e Shaqir Dema, Selim Dema etj; nga dera e Selman Alisë, pasardhës të Salë Demirit, Dine Hoxha e Ali Tahiri (Pira)- Muhurr, Maliq Kërçishti (Agolli), Dan Cami (i Sepetovës) dhe Camet e Vëçishtit, Kaloshet e Sinës e të Kandrit, Ndrëtë e Elezit Isufit e Suf Xhelili në Sllovë, Riza e Dervish Lusha (Arras), Murat Kaloshi e Selim Noka (Kandër), Haxhi Noka (Grykë Nokë), Sali e Selim Kaloshi (Sinë), Selman e Hakik Mena (bajraktari i Lurës), Selë Bajraktari (Arras) e Lita i Ploshitanit, Shehu i Zerqanit e Duriçi i Bulqizës, Kazihani i Selishtës (Tafa) e Llan Destani – Ndrejgioni (Lukan), Kurt e Dik Spata (Grykë Nokë), Mehmet (Dedja) Skepi e Daci i Kalisit, etj.

⁴³ Zaho Golemi, Revista Mbrojtja, Tiranë, nr.3/2011, faqe 41.

⁴⁴ Mahmut Daci Kalisi lindi në vitin 1793 në fshatin Kalis të Kuksit, që dikur i përkiste Dibrës. Ai ishte prijës e luftëtar i shquar antiosman gjatë shekullit 19. Pas luftimesh të ashpra me forcat osmane, ata arritën ta kapnin në Sllovë në 1870 dhe ia prenë kokën dhe koka e tij u çua si trofe në Stamboll. Është shqiptari i dytë pas Ali Pashës që ka dy varre.

ndodheshin në pozicionet e dyta ndihmëse duke bindur fqinjët tanë, por krejt Evropën se kur bëhet fjala për lirinë, shqiptarët vështirë t'i dallosh nga mosha, krahina, feja e gjinia.

- Prijësit dhe atdhetarët dibranë Elez Isufi, Sufë Xhelili, Ramiz Dibra, Jashar Erebara, Ramiz Daci etj., përveçse ishin drejtues të mirënjohur të gjithë trevës dibrane krijuan lidhje të ngushtë edhe me qeverinë shqiptare të kohës Sulejman Delvina.
- Prijësit e luftës në Dibër shfrytëzuan besën si institut procedural juridik tradicional shqiptar përpara fillimit të luftimeve, që ishin betime përpara betejave sipas së drejtës zakonore të odës dibrane që materializoheshin në shprehjet: “Për këtë besë”, “pasha besën”, “besa-besë”, ndërkohë që Barleti historiani i parë ushtarak shqiptar i shekullit XV, thoshte: “Besa është gjëja më e shtrenjtë që ka shqiptari”.⁴⁵
- Lufta e Dibrës e vitit 1920-1921 ka hyrë në historinë e shqiptarëve si lufta që bëri finalizimin e qëndresës luftarake nëntëvjeçare të popullit dibran, gjakun e derdhur, dëshmorët në betejë, vërtetuar kjo nga statistika e krijuar nga Ministria e Mbrojtjes në 100-vjetorin e shtetit shqiptar⁴⁶. Thënia proverbiale: “Mendja dhe urtësia ka lerë në Dibër” mbart të vërtetat luftarake dhe kontributet legjitime të mbrojtjes së trojeve me atdhetari dhe mençuri. Nga ana tjetër, edhe personaliteti anglez Xhulian Ameri që ishte në veri të vendit në L.II.B., thotë: “në Dibër unë bëra universitetin e dytë se të parin e kisha bërë në Oksford”.
- Epopeja e Luftës së Dibrës pati rëndësi të madhe në planin kombëtar dhe njëkohësisht ishte një dëshmi e identitetit tradicional shqiptar edhe për sfondin e politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare, duke u dhënë mësim fqinjëve dhe Fuqive të Mëdha se trualli shqiptar nuk mund të tjetërsohej.

Bibliografia

- Arben Puto, Shqipëria politike 1912-1939, botimet Toena, Tiranë, 2009.
- Arti ushtarak i popullit shqiptar, Lufta e Dibrës dhe rëndësia për mbrojtjen e integritetit shqiptar, Akademia e Shtabit të Përgjithshëm, Dep. Historisë, Tiranë, 1987.
- Bajram Xhafa, Lufta e Dibrës 1920 (qëndresa dibrane ndaj pushtimit jugosllav 1918-1921), Tiranë, 2001.
- Elena Kocaqi, Shqipëria dhe fuqitë e mëdha 1878-1918, Tiranë, Dodona Press, 2020.
- Eqrem Çabej, “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”, Tiranë, viti 1994.

⁴⁵ Konferenca e dytë e studimeve Albanologjike shqiptare, Tiranë, 12 deri 18 janar 1968, Tiranë, 1969, faqe 177 dhe Marin Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1964, faqe 227.

⁴⁶ Gazeta “Zëri i Ri” Tiranë, 9 shtatorë 1920, që flet për tërheqjen e serbëve në kufijtë e 1913-ës.; Zaho Golemi, Bernard Zotaj, Dëshmorët e Atdheut, publikuar në kuadër të 100 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar, nga Ministria e Mbrojtjes, Tiranë: Real-Stamp, 2012. (Qarku Dibër, Periudha deri më 7.4.1939), faqe 25-41.

- Fatos Daci, Enciklopedia e Dibrës, Tiranë, AlbGraf, 2006.
- Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi III, Tiranë: SH.B. “Toena”, viti 2002.
- Historia e Shqipërisë, Vëllimi III, Tiranë, 1984.
- Instituti i Historisë në Akademinë e shkencave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit të RPSH, “Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920” (Përmbledhje dokumentesh), Vëllimi I, II, Tiranë, 1975.
- Ismail Strazimiri, Lufta kundër pavarësisë të Shqipërisë, Naimi, 2010.
- Kristo Frashëri, “Historia e Dibrës”, Tiranë, 2012.
- Zaho Golemi, Bernard Zotaj, Dëshmorët e Atdheut, publikuar në kuadër të 100 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar, nga Ministria e Mbrojtjes, Tiranë: Real-Stamp, 2012.
- Zaho Golemi, Dëshmorët në rrënjët e kombit shqiptar, Tiranë, Emal, 2021.
- Lufta kombëtare e Vlorës, Rilindja e Pavarësisë, Tiranë: Onufri, 2020.
- Periodiku i “Revista Ushtarake”, “Policimi dhe Siguria”, “Mbrojtja”, “Ushtria”, etj.
- Periodiku i revistës “Studime Historike” (Instituti i Historisë), nr. 3-4, Tiranë, 1994.
- Revista “Koha jonë”, nr. 1,2,3, janar-mars 1985, Paris, viti XXIV i botimit, faqe 45-50.
- Revista “Shejzat”, nr. 4 - 6, Romë; Viti 1969. “Luma dhe luftërat e saj”.

ÇETAT KRYENGRITËSE SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake

Trajtesë e shkurtuar.

Lufta e armatosur nuk ishte tipike për popullin tonë. Shumë shqiptarë u organizuan në çeta dhe u vunë nën influencën e pushtuesve evropianë, nën komandën e rreshtimit organik të njërive të tyre. Kjo ndodhi se shumë prej tyre, kryetarë e komandantë mendonin realizimin e aspiratave kombëtare nën këtë apo atë shtet. Nga literatura e shteteve fqinje është spekuluar shumë me këtë problem duke i konsideruar shqiptarët dhe inkuadrimin e tyre si “banda pa ideale” në shërbim të atij që i “paguante” më mirë. Por është e rëndësishme të theksohet se asnjë komandant i çetave nuk u lidh me ushtritë e vendeve fqinje, megjithëse monarkitë u premtuan atyre shuma të majme. I vetmi që bëri një gjë të tillë ishte Esat Pashë Toptani.

Ky punim sjell në vëmendje faktin se si një bërthamë luftëtarësh apo drejtuesish të përhershëm shumoheshin numerikisht nga popullsia vendase për kryerjen e aksioneve të ndryshme, duke nxjerrë në pah figura drejtuese të çetave atdhetare të asaj periudhe. Veprimtaria e çetave luftarake të ngritura në fshatra e krahina të ndryshme të Shqipërisë dhe në Kosovë ka qenë e dukshme qysh në periudhën e parë të Rilindjes, por pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit çetat u rishfaqën më të plota.

Historiografia ushtarake shqiptare, për vendin dhe rolin e çetave kryengritëse ende është në fillesat e saj për studimin dhe pasqyrimin e të gjithë veprimtarisë së tyre në këtë periudhë historike. Në mënyrë të përmblëdhur kjo ishte veprimtaria e çetave që vepruan në Luftën e Parë Botërore në Shqipëri.

Fjalët kyçe: Çetë, luftëtarë, çetë atdhetare, çetë patriotike, formacion, armatim, veshje karakteristike.

1. Çeta si formacion luftarak

Çeta, sipas fjalorit të gjuhës shqipe është një grup i vogël njerëzish të armatosur me një komandant në krye¹. Çeta është një formacion luftarak popullor me përbërje nga pak veta deri në disa dhjetëra luftëtarë. Ajo njihet si formacioni karakteristik luftarak fillestar në luftërat shumëshekullore të popullit tonë, në të gjitha etapat e historisë. Nga mesi i shek. XIX e deri në Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri ndeshemi me emërtime të ndryshme të çetave, si: çetë e komitëve (e kaçakëve, e “hajdutëve”), çetë atdhetare, çetë kryengritëse. Ndërsa gjatë Luftës së Dytë Botërore edhe çetë nacionaliste, partizane, balliste, çetë vullnetare territoriale, etj. Çetat ngriheshin mbi baza vullnetare². Kishin një bërthamë luftëtarësh apo drejtuesish të përhershëm dhe, sipas rastit, shumoheshin numerikisht nga popullsia vendase për kryerjen e aksioneve të ndryshme. Armatimin e siguronin vetë nëpërmjet sulmeve mbi forcat pushtuese, ndërsa për ushqim mbështeteshin kryesisht në popullsinë vendase. Veshja ishte karakteristike sipas krahinave.

Çetat ishin formacione luftarake të ngritura në fshatra të ndryshme të Shqipërisë në prag të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe pas saj (1900-1910 e kryesisht 1911-1912). Turqit e rinj duke mohuar premtimet për shqiptarët, ndërmorën një fushatë të egër kundër klubeve atdhetare dhe shkollave shqipe në Shqipëri por edhe kundër aktivistëve që i mbanin gjallë ato. Ndërkohë, më 1910, forcat e Turgut Pashës mbytën me zjarr e hekur kryengritjen e shqiptarëve në vilajetin e Kosovës.³

Në këto rrethana lindi nevoja e shtimit dhe bashkimit të forcave kryengritëse në Shqipërinë e Jugut. Këtë nisëm, në pranverën e vitit 1910, e mori “Shoqëria e Zezë për Shpëtim”, e krijuar që në vitin 1878, duke shtrirë veprimtarinë gati në të katër vilajetet shqiptare të Perandorisë. Kjo shoqëri, për pjesën e Jugut të Shqipërisë, në prag të shpalljes së Pavarësisë, u riorganizua në Korfuz me kryetar Fadil Pashë Toptani dhe Pandeli Cale. Dega shtroi detyra për formimin e komiteteve kryengritëse në krahina të ndryshme të Jugut me detyrë ngritjen e mëtejshme të çetave atdhetare por edhe bashkimit të tyre. Në Labëri në krye të komitetit u caktua Demo Emini.

¹ Fjalori i shqipes së sotme, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1984, f. 158.

² Nasip Meçaj, Xhemil Çelaj, Fatmir Toçi, Enciklopedi e Kurveleshit, BOTIMET TOENA, Tiranë, 2009, f. 65.

³ Po aty, f. 68.

2. Çeta patriotike

Qysh në nëntorin e vitit 1905, me nismën e Bajo Topullit, ishte krijuar Komiteti i Fshtëtë “Për lirinë e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij komiteti ishte puna për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare. Me idenë absolute se liria nuk mund të pritej, por të kërkohej, Bajo Topulli gjykoi se kishte ardhur momenti që perandoria osmane të detyrohej që edhe me forcën e armëve të pranonte vullnetin e popullit shqiptar. Qysh në janar 1906 krijoi të parë çetë patriotike në Jug. Në këtë çetë, Çerçiz Topulli, vëllai i tij, ishte luftëtari më i shquar dhe më aktiv. Për të përçarur këtë frymë, çeta patriotike e Bajo Topullit filloi të lëvizte në të gjithë territorin e Jugut të Shqipërisë. Rezultati i kësaj punë ishte dalja në skenë e mjaft çetave patriotike të Sali Butkës, Qamil Panariti, Spiro Ballkamenit, Themistokli Gërmenjit, Muharrem Rushitit, Demo Eminut etj.

Para një grupi të vogël burrash me ndjenja atdhetare si Ibrahim Abdullau, Alem Mehmeti, Zigur Lelo, Zaçe Xhelo, Laze Malo, Murat Tërbaçi, Selam Abazi, Azem Sulo dhe Sali Vranishti, Çerçiz Topulli shpalosi pikëpamjen për ngritjen e çetave patriotike⁴. Nga fundi i vjeshtës së vitit 1908, Sali Vranishti, një ish komit i famshëm, që ishte arratisur nga kalaja e Janinës, formoi çetë patriotike me luftëtarë nga Vranishti, Kallarati, Smokthina, Tërbaçi Brataj e Kaninë⁵. Këtu zë fill miqësia midis Çerçiz Topullit dhe Sali Vranishtit, që u farkëtua në momentet më të vështira që do të kalonte Jugu i Shqipërsisë. Kryeneçësia, guximi, trimëria dhe kurajua e tyre e pashoq imponuan që të alarmohen autoritetet, të cilat nga sfida e drejtpërdrejtë që ju bëhet, nuk reshten për t’i asgjësuar.

Për të mbajtur gjallë shpirtin e qëndresës, populli në krijimet e veta me shumë mençuri vuri në pah se kapedanët qëndrojnë stoik dhe hijerëndë përballë çdo rreziku. Çeta patriotike e Bajo dhe Çerçiz Topullit do të pagëzohej me vrasjen e Dhespot Fotit, në shenjë hakmarrje ndaj Papa Kristo Negovanit, çeta e Sali Vranishtit do shtrinte përdhe Jani Putecin, vrasësin e Kadri Gjatës, kreut të klubit patriotik të Janinës.

Platforma shoviniste greke e “Megali-Idesë”, mori përpjesëtime me fillimin e Luftës së Parë Botërore. Në fillim të vitit 1914, grekomanët shpallën në Gjirokastër “Autonominë e Vorio-Epirit”. Në kushte kur andratët grekë masakruan, dogjën e plaçkitën fshatra të tërë, shpirti patriotik shqiptar shpërtheu fuqishëm në të gjithë Jugun. Çerçiz Topulli e Sali Vranishti ishin në ballë të luftëtarëve nga Gjirokastra, Lumi i Vlorës, Kurveleshi, Delvina e Bregdeti.

Isamil Qemali, dhe pse ishte dorëhequr si kryeministër, nuk mund të rrinte indiferent, kur kërcënohej seriozisht sovraniteti dhe integriteti territorial i shtetit shqiptar. Ai krijoi “Komitetin për Shpëtimin e Shqipërisë”. Në me krerët e çetave të Jugut, u vendosën në drejtimet nga do të godisnin andratët grekë, si do mbroheshin dhe nga do të furnizoheshin. Sulmi i mirë organizuar filloi ofensivën në drejtimet Tepelenë-Gjirokastër, Labovë-Libohovë, Kuç-Himarë, Këlcyre-Përmet-Frashër-Leskovik, Qafë e Skërficës-Delvinë.⁶

⁴ Gani Iljazi, Lëvizja Kombëtare në Vlorë 1878-1912, Tiranë, 1999, f. 31.

⁵ Revista Mbrojtja, Arben Saliu, Nr. 4, Tiranë 2013, f. 48-50.

⁶ S. Vllasmi, Ballafaqime Politike, Tiranë, 20, f. 74.

Po kështu, veprimtaria e çetave në Shqipëri është e dukshme dhe në periudhën e parë të Rilindjes, pas Pashallëqeve, kurse pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit rishfaqen më të plota. Të tilla ishin çetat e Bajo e Çerçiz Topullit, Mihal Gramenos, e Themistokli Gërmenjit, Kajo Babienit e Sali Butkës etj, në pragun e fitores së Pavarësisë. Guximi, trimëria dhe hallet e përbashkëta i kishin afruar me njeri-tjetrin⁷.

Në Luftën e Parë Botërore shteti shqiptar mbajti asnjësinë. Territori i Shqipërisë u pushtua nga Forcat e Armatosura të shteteve ndërluftuese duke e shndërrua këtë në shesh lufte. Në tetor 1914 Greqia pushtoi Shqipërinë e Jugut (Korçën e Gjirokastrën), po në tetor Italia u vendos në ishullin e Sazanit dhe në dhjetor 1914 pushtoi Vlorën, në qershor 1915 Serbia pushtoi Shqipërinë e Mesme, ndërsa Mali i Zi u shtri në Shqipërinë e Veriut. Në prill 1915 midis Italisë dhe Fuqive të Antantës u nënshkrua Traktati i Fshehtë i Londrës, sipas të cilit shteti shqiptar ndahej midis katër vendeve fqinje. Në fillim të vitit 1916, Shqipëria u shndërrua një shesh i Luftës së Parë Botërore, këtu u vendosën forcat austro-hungareze e bullgare, që përparonin në luftë kundër atyre serbo-malazeze e italiane në tërheqje⁸.

Nga viti 1916 deri më 1918, në Shqipëri, vija e frontit midis forcave ndërluftuese austro-hungareze e bullgare dhe forcave serbo-malazeze e italiane fillonte nga derdhja e Vjosës në Adriatik, ndiqte vijën e këtij lumi, kalonte në jug të Beratit, në Skrapar, për të dalë në Pogradec. Në njërën anë të frontit ishin forcat austriake e bullgare, në anën tjetër forcat italiane e franceze. Këto të fundit hynë në krahinën e Korçës në tetor 1916, ndërsa forcat italiane kaluan në Shqipërinë e Jugut duke dëbuar prej andej trupat greke dhe u lidhën me aleatet e tyre francezë në Kolonjë. Në krahina verilindore të vendit u vendosën forcat serbe që shtriheshin përafërsisht në rrethin e Peshkopisë e në krahinën e Lumes, në qytetin e Shkodrës u vendos një garnizon ushtarak ndër aleat, kurse në pjesën më të madhe të vendit ishin shtrirë forcat italiane⁹.

3. Patriotë të njohur në krye të çetave

Me nismën e Bajo Topulli, në qytetin e Manastirit u themelua Komiteti “Për lirinë e Shqipërisë”, i cili organizoi çetat e para patriotike. Sali Butka ishte një nga bashkëthemeluesit e atij komiteti dhe anëtar i tij. Ai bëri një punë të madhe për krijimin e degëve të këtij komiteti për përgatitjen e kryengritjes së armatosur kundër pushtimit otoman. Në dhjetor të vitit 1905 Bajo Topulli shkoi vetë në fshatin Butkë, në shtëpinë e Sali Butkës, ku u formua çeta e parë kombëtare dhe u shpall fillimi i kryengritjes së armatosur. Në këtë çetë, me komandant Sali Butkën, bënë pjesë edhe patriotë të tjerë si: Qani Starja, Qamil Panariti, Riza Veleishti, Selim Pojani, Sefer Panariti, Dilaver Lubonja, Hasan Qinami, Myftar Butka, Thoma Pituli etj.

Në vitin 1910, Sali Butka së bashku me 2500 kolonjarë, mori pjesë në mitingun e madh të

⁷ Bajo Jonuz Topulli, Topullarët e Gjirokastrës, Tiranë, 2008, f.

⁸ Fjalor Enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1985, f. 639.

⁹ Fjalor Enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botim i Ri, Vëll. i dytë, Tiranë, 2008, f. 1551.

shkronjave shqipe që u organizua në qytetin e Korçës. Lidhur me këtë ngjarje të shënuar, Mihal Grameno, në shkurtin e vitit 1910, në gazetën “Lidhja Ortodokse”, midis të tjerash shkruante: *“Gjithë qyteti, burra e gra, kishin dalë për të pritur kolonjarët, që çuditën botën me taktikën e tyre”*. Në atë kohë Sali Butka, ishte një nga patriotët shqiptarë që nënshkruan protestën kundër Portës së Lartë, duke kundërshtuar përdorimin e germave arabe. Në fillim të vitit 1911, në Kolonjë u krijua Komiteti Kryengritës me në krye Sali Butkën, si dhe vëllanë e tij, Myftar Butkën dhe Ganiun, të birin e tij.

Në mars të vitit 1911 patrioti i njohur, Spiro Bellkameni, u kthye nga mërgimi dhe shkoi në fshatin Butkë duke qëndruar disa ditë në çetën e Kolonjës e cila udhëhiqej nga Sali Butka. Me qëllim që të zgjerohej lëvizja kryengritëse, Sali Butka i dha Bellkamenit, vëllanë e tij, Myftarin, Ganiun dhe Thoma Pitulin, për të formuar një çetë më vete në Fushë të Korçës, e cila u bë e njohur në luftën e Orman-Çifligut, ku mbetën të vrarë gjashtë pjesëtarë të saj të cilët më pas u shpallën dëshmorë të atdheut.

Në maj të vitit 1912 Sali Butka mori pjesë në Kuvendin e Pejës, i cili mori vendime për fillimin e kryengritjes kundër Turqisë. Pasi u kthye nga Kosova, ai, bashkë me Tajar Tetovën, organizuan në fshatin Frashër një mbledhje të madhe, ku morën pjesë krerët kryesorë të çetave e kryengritëse të Shqipërisë së Jugut. Gjatë rrugës për të shkuar në atë mbledhje, çetës së Sali Butkës, i zunë pritë forcat turke dhe në grykën e Rrungajës, mbeti i vrarë, djali i dytë Sali Butkës, Iljazi, i cili më pas u shpall dëshmor i atdheut. Në krye të forcave të bashkuara kryengritëse, Sali Butka çliroi Ersekën dhe më pas, bashkë me çetat e Spiro Ballkamenit e të Kajo Babjenit në gushtin e vitit 1912, ato çlijuan Korçën. Lidhur me këtë ngjarje, gazeta “Koha” e datës 19 gusht të vitit 1912, midis të tjerash, shkruante: *“Në ballë të çetës së dytë ishte kapedani dhe trimi i Shqipërisë, i dëgjuari patriot Sali Butka, burrë i thjeshtë shqiptar dhe me gjithë zemër mëmëdhetar”*. Në atë kohë ai organizoi mbrojtjen e shtetit të ri shqiptar nga sulmet e ushtrisë greke dhe lëvizja e andartëve grekë që vepronin në jug të vendit. Lidhur me këtë, në atë kohë gazeta “Liri e Shqipërisë”, midis të tjerash shkruante: *“Sali Butka ka zhveshur pallën dhe po bën luftëra të rrepta. Ai po lufton me grekët nga ana e Naselishtës dhe nga an' e Korçës dhe po tregon trimërinë e tij si në kohë të Skënderbeut”*.

Duke parë kontributin e madh në mbrojtjen e krahinave të Jugut dhe Qeverisë së Vlorës, Kryeministri Ismail Qemali e thërriti Sali Butkën në Vlorë dhe e priti atë për zemërsisht. Qeveria e Vlorës e ngarkoi atë që të mbronte Vlorën nga forcat turke të Xhavit Pashës. Kur ushtritë franceze që kishin okupuar Korçën dhe qarkun e saj, mbështesnin kërkesat e Venizellosit për Shqipërinë e Jugut, Sali Butka, në krye të forcave të tij, që arrinin në 1500 veta u nis drejt Korçës dhe e rrethoi atë. Në krah të tij ishte edhe çeta e Themistokli Gërmenjit me 22 vetë. Të rrethuar, francezët kërkuan bisedime. Themistokli Gërmenji shkoi në Korçë, ndërsa Sali Butka qëndroi me ushtritë e tij në rrethinat e qytetit. Ndërsa bisedimet e Themistokli Gërmenjit me autoritetet franceze po zvarriteshin, Sali Butka u dërgoi atyre kërkesat shqiptare prej 14 pikash për vetëqeverisjen e Kazasë së Korçës nga ana e autoriteteve shqiptare. Nën presionin e brendshëm dhe sidomos atë ushtarak

të forcave të Sali Butkës, autoritetet franceze e shpallën “Vetqeverisjen e Kazasë së Korçës me gjithë rrethet nga autoritetet shqiptare”. Po kjo punë nuk vazhdoi gjatë. Në fund të luftës, autoritetet franceze e kthyen fletën, arrestuan Themistokli Gërmenjin dhe e pushkatuan në Selanik si dhe u përgatitën t’ia dorëzojnë Korçën Greqisë. Atëherë Sali Butka mbledhi forcat që arritën në 20.000 dhe mbasi e rrethoi Korçën, përsëri, i dërgoi komandantit të forcave franceze një ultimatum. Sali Butka mbrojti jo vetëm Korçën, por të gjithë Shqipërinë Juglindore nga sulmet e forcave greke.

Çeta në male. Në Qishbardhë u mbledh komisioni i Kazasë së Vlorës. Gjatë mbledhjes komisioni mbrohej nga çetat. Një çetë komandohej nga Namik Selimi dhe çeta tjetër nga Zaçe Xhelo nga Smokthina. Gjithsej ishim 25 veta. Bukën dhe ushqimet jua çonin fshatarë në male dhe në stane. Kur shkonim nëpër fshatra ju këndonim fshatarëve libra shqip, sidomos “Bagëtia e Bujqësia” e Naim Frashërit¹⁰.

Çeta atdhetare e Dervish Himës në Kurvelesh. Ibrahim Naxhi, i njohur me pseudonimin Dervish Hima, nga Ohri, ishte veprimtar i shquar i Rilindjes Kombëtare dhe luftëtar për pavarësinë e Shqipërisë. D. Hima, sipas porosive të Ismail Qemalit për të mbajtur të gjallë ndjenjën e kryengritjes anti osmane dhe të 12 kërkesave të memorandumit të Greçës (1911), por jo të ngrinin popullsinë në kryengritje, erdhi në Kurvelesh, në krye të një çete studentësh të arratisur nga shkollat e Selanikut dhe të Stambollit në mesin e vitit 1912.

Sikurse njofton atdhetari kurveleshas Sali Nivica, Dervish Hima vjen në Kurvelesh si “përfaqësues i Bajram Currit dhe Hasan Prishtinës”. Ai mori takim me përfaqësuesit e komiteteve të fshatrave të Kurveleshit dhe për 14 ditë përshkoi gjithë fshatrat e Kurveleshit të Sipërm dhe Kuçin. Mbi 200 kurveleshas shprehën dëshirën të rreshtoheshin vullnetarë në çetën e tij. Një nga anëtarët e çetës, Lek Zeza, në kujtimet e veta shkruan se çeta zgjodhi Kurveleshin si “*fushën më të përshtatshme për të zhvilluar veprimtarinë e saj kombëtare sepse i ishte dëgjuar emri si kështjellë e shqiptarizëm. Në Kurvelesh nuk kishte rehatllinj që të kishin frikë se mos i prishte turku. Dhe popullsia e këtyre maleve kreshnike ishte gati për çdo sakrificë për Shqipëri e shqiptarizëm*”. Duke shprehur përshtypjet e tij për fshatrat e Kurveleshit thekson: “Po të donte çeta mund ta ngrinte më këmbë të gjithë Kurveleshin, me gra e fëmijë”. Çeta e shoqëruar nga kurveleshas, në gjithë rrugën e saj, u largua për në Dumre.

Çeta e Golemit në mbrojtje të Janinës (1912-1913). Me porosi të kryeministrit të ri të Shqipërisë së posa shpallur shtet më vete, të Ismail Qemalit, për mbrojtjen e qytetit të Janinës nga mësymja e forcave greke në kuadrin e Luftës së Parë Ballkanike dhe për të fituar kohë qeveria e re për të shtrirë juridiksionin e vet në viset shqiptare, për mbrojtjen e Janinës dhe të Çamërisë shkuan shumë luftëtarë kurveleshas e labë nën komandën e Selam Musa Salarisë. Golemi dërgoi çetën e vet me 20 luftëtarë e me komandant Godo Vasili. Vullnetarët shqiptarë luftuan përkrah forcave osmane në radhët e të cilave kishte shumë ushtarë me kombësi shqiptare e që luftonin për mbrojtjen e trojeve të të parëve të tyre. Forcat vullnetare kurveleshase kryen veprime luftarake në rajonin e malit Drinsko pranë Bezhanit e Pesë Puseve që mbyll grykën

¹⁰ Tol S. Arapi, Që të bëhej Shqipëria, Tiranë, 1996, f. 20.

e Janinës dhe pjesërisht edhe në Çamëri. Ato penguan përparimin e forcave greke për mbi tre muaj. Kënga popullore përjeton: “*O Bezhan përmbi Janinë, / Vinin gjylet si zinxhirë, / Treqind gjyle një e shtirë....*”. Në muajin shkurt dhe në ditët e para të marsit 1913 u vranë 6 luftëtarë golëmas dhe u plagosën dy të tjerë. Të vrarët u varrosën aty. Ruhet edhe sot në kujtesën e vendasve toponimia “Varret e Goleme”.

Çeta e Kolonjës në mbrojtje të Janinës. U krijua në fund të vitit 1912 me rreth 50 luftëtarë vullnetarë. Sipas porosive të qeverisë së Ismail Qemalit, u dërgua për të luftuar për mbrojtjen e Janinës nga forcat ushtarake greke në kuadrin e Luftës së Parë Ballkanike dhe për të vonuar sa më shumë në kohë mësymjen e forcave ushtarake greke kundër viseve jugore shqiptare. Në këto luftime u vra Qerim Hoxha.

Çeta të shkëputura. Ishte ajo e Shaqo Llapit që luftoi edhe kundër forcave pushtuese italiane gjatë Luftës së Parë Botërore (që nga viti 1916) e për të ardhur te çetat e ngritura në çdo fshat të krahinës pjesëmarrëse në Luftën e Vlorës 1920. 24 korrik 1914 hynë edhe një numër oficerësh gjoja dezertorë si majori Vardha, Kondul, i Ngavanis, Papa Kostas etj. Dhe filluan plaçkitjen e dyqaneve dhe të banesave të myslimaneve, vrasjet dhe përdhunimet (Shih veprën e Petro Harizit faqe ‘84-‘87) Menjëherë pas kësaj gjendjeje u vunë në lëvizje çetat patriotike të Themistokli Gërmenjit, Sali Butkës, Gani Butkës, Mendu Zavalanit, Vangjel Gjikës, Kajo Babienit, etj. Menjëherë u vunë në lëvizje çetat patriotike të Themistokli Gërmenjit, Sali Butkës, Gani Butkës, Mendu Zavalanit, Vangjel Gjikës, Kajo Babienit, etj., lufta e të cilëve i detyroj ushtritë greke të tërhiqeshin nga qyteti. Me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, në jugë-perëndim të vendit hynë forcat italiane, ndërsa në Korçë me 18 tetor 1916, hynë trupat franceze, pjesë e Armatës së Lindjes. Në këtë kohë Themistokli Gërmenji me Sali Butkën, Kajo Babienin dhe patriotë të tjerë koordinojnë veprimet e marrin masa për t’u dalë përpara rreziqeve të copëtimit të Shqipërisë, krijojnë Komitetin e Mbrojtjes, rrethojnë qytetin me forca të armatosura e hynë në bisedime me francezët. Komanda franceze emëroi në funksione shtetërore për mbajtjen e rendit Kolonelin De Kuen, i cili ishte përkrahës i shqiptarëve dhe largoi prefektin grek të Venizellosit.

Me 10 dhjetor 1916 Korça shpallet si “Republika Autonome e Korçës”, në krye të së cilës vihet patrioti Themistokli Gërmenji. Sa qëndroi koloneli De Kuen punët në Korçë shkuan normalisht. Por më pas vendin e tij e zuri një kolonel pro-grek dhe antishqiptar i cili me 1917 e arrestoi Themistokliun e dërgoi në Selanik ku ju bë gjyqi dhe u dënua me vdekje, me pushkatim, me 7 dhjetor 1917. Por edhe pas kësaj shovinistët grekë nuk hoqën dorë nga synimet e tyre për aneksimin e Korçës dhe të Gjirokastrës.

Çetat e kaçakëve. Në krahina të Shqipërisë së Jugut, si në Skrapar u formuan në fillim si çeta kaçakësh, të komitëve dhe në fund patriotike. Të tilla ishin: çeta e Laçe Backës me 22 luftëtarë, çeta e Riza Kodhelit me 31 luftëtarë, çeta e Sulo Qorrajt me 15 luftëtarë, çeta e Servet Zaloshnjës me 22 luftëtarë, çeta e Ali Farmaqit (Çepanit) me 23 luftëtarë, çeta e Sulejman Spatharës me 8 luftëtarë dhe çeta e Tajar Vëndrezhës me 20 luftëtarë¹¹.

¹¹ Engjëllushë Braçellari, “Skrapari, gjurmë nën harresë”, Sh. Botuese “Geer”, Tiranë, 2002, f. 112.

4. Bashkëveprimi midis çetave

Skrapari gjatë Luftës së Parë Botërore, u bë arenë e saj. Në territorin e tij, në periudhën 1915-1918 u vendosën ushtritë e fuqive të Italisë, Austro-Hungarisë dhe Francës¹². Çetat e Skraparit, të cilat kishin mbajtur peshën në luftën kundër forcave greke, u ingranuan në ushtritë e huaja sipas zonave respektive. Patriotët Ali Koprencka, Mustafa Spathara, Avni Kapainova, Riza Kodheli, Ali Farmaqi, Servet Zaloshnja etj pavarësisht nga synimet apo kontraktat që kishin mes tyre fuqitë e huaja, bashkëpunimin me to, e shikonin si një mundësi në të ardhmen, për zgjidhjen e çështjes kombëtare: ruajtjen e tërësisë tokësore¹³.

Gjatë Luftës së Parë Botërore patriotët e Skraparit kishin më shumë besim tek Italia, e cila vlerësohej prej tyre si aleati më i mundshëm. Këtë e tregon fakti. Në Nishicë në gusht të vitit 1916 bëhet një mbledhje, ku morën pjesë përfaqësues të shumtë, që bënë pjesë në ushtrinë italiane si Kasem Radovicka, Mehmet Pavari, Mustafa Spathara, Ali Farmaqi, Ali e Riza Cerova, Riza Vërzhezha, Ali Koprencka. Në këtë mbledhje u vendos që të goditeshin austriakët, e të ruhej autonomia e çetave shqiptare¹⁴.

Në shtabin italian kishte një përfaqësues të forcave shqiptare. Patriotët skraparas të zonave nën pushtimin austriak, ashtu si në Nishicë, patriotët Ali Bej Koprencka, Hysen Zaloshnja, Riza Kodheli, Avni e Muco Kapinova, Sinan Leshnja, Belul Trebla, u mblodhën në Konak të Tomorricës, organizuan një mbledhje ku mori pjesë edhe Sali Butka. Më tej u zhvillua një mbledhje me përfaqësues nga dy zonat e pushtimit në Bigaz të Gërmenjit. Qëllimi i takimit ishte që çetat patriotike të informonin njëra-tjetrën për planet e komandave përkatëse ushtarake¹⁵. “Komiteti për mbrojtjen e Korçës” caktoi komandant të forcave vullnetare patriotin Sali Butka. Komiteti njofton në Skrapar Ali Koprenckën i cili ishte komandant rrethi, i xhandarmërisë së nënprefekturës së Skraparit, duke i kërkuar që të grumbullonin forcat në vijën Gjergjevicë-Gjonbabas. Ky i fundit njofton që, më 28 gusht 1919, prefekturën e Beratit për situatën në Korçë dhe i kërkon që të mobilizojë forca e t’i nisi në drejtim të Gjergjevicës.

Sali Butka që kishte vite që luftonte me trimat e Skraparit, njofton të gjithë për t’u ngritur në këmbë për mbrojtjen e Korçës. Thirrjes së tij iu përgjigjen që nga Xhelal Koprencka, Riza Cerova, Muço Potomi, Ali Farmaqi, etj. duke mbledhur forcat dhe u nisën për në Gjergjevicë. Pikërisht në këto momente dora e hakmarrjes gjen rastin dhe vret burrin e shquar të pavarësisë Xhelal Koprencka, duke krijuar një situatë tepër delikate¹⁶. Shumë aktiv u tregua “Komiteti për Shpëtimin Kombëtar” dhe në përgjithësi popullsia e Skraparit dhe e Tomorricës, në ngjarjet e Korçës.

¹² Po aty, f. 115.

¹³ Apostol Kotani, Kapedan At Stath Melani me shokë, Tiranë, 1997, f. 55-57.

¹⁴ Engjëllushe Braçellari, “Skrapari, gjurmë nën harresë”, Sh. Botuese “Geer”, Tiranë, 2002, f. 117.

¹⁵ Po aty, f. 117.

¹⁶ Po aty, f. 121.

Lufta e Parë Botërore kishte mbaruar, por në Shqipëri forcat italiane e franceze, vazhduan të qëndronin. Në Korçë, që më 28 mars 1919, komanda franceze kishte bërë veprimin e parë provokues antishqiptar. Ata hoqën flamurin kombëtar shqiptar, simbolin e shenjtë të shqiptarëve, nga godina zyrtare. Një veprim i tillë ngjalli zemërim të madh në Korçë dhe rrethinat e saj në të gjithë popullsinë e të dy komuniteteve fetare.

Në Tetor 1914: çeta e Sakoll Radëshit priti me luftë në Grykën e Devries mbi 300 forca esadiste që vinin nga Tomorrica.

Janar 1916, territori i Skraparit pushtohet nga trupat italiane, franceze e austro hungareze. Në Gusht 1916 organizohet mbledhja e Nishicës ku morën pjesë patriotë që ishin inkuadruar në radhët e ushtrisë italiane nën drejtimin e Mustafa Spatharës, Riza Cerovës, Ali Farmaqit, Riza Vërzhezhës. Në gusht 1916 organizohet edhe në Konak të Tomoricës mbledhja me pjesëtarë të ushtrisë austriake nën drejtimin e Sali Butkës, Riza Kodhelit, Avni e Muço Kapinova, Sinan Leshnja, Belul Trebla, Hysen Zaloshnja. Në tetor të 1916 krerët e Nishicës e të Konakut u takuan në Bigaz për të koordinuar veprimet.

Gjatë kësaj kohe ushtria greke sulmoi jugun e Shqipërisë, ishte fillim i marsit 1914. Patriotët shqiptarë u mbledhën në një tubim madhështor për mbrojtjen e mëmëdheut. Morën udhëzimet-vendimet për luftë kundër pushtuesit. Ky luftëtar i lirisë nuk i lëshoi armët nga dora, jo vetëm si luftëtar por edhe si komandant. Nga Poradeci, mbasi mori detyrat nga mbledhja, erdhi në Ladorisht. Aty i mbledhi 40 luftëtarë Ladorisht me rrethinë. Bashkë me këto trima ai u kthye në Bërzeshtë të Librazhdit, te Shaban Blloshmi, mik i Demir Lenës. Prej aty shkuan në Poradec ku ishte qendra e përgatitjes.

Luftëtarët vullnetarë, në krye me komandantin Demir Lena u emëruan “Tabori i Strugës”. Me 40 luftëtarët nga vendlindja dhe 50 vullnetarët nga Shqipëria, në Poradec u takuan me çetën e Jashar beut. Me çetën e Gani Butkës, Hysen Nikolicës, Shaban Blloshmit, Zalo Prodanit, Kajo Babienit e të tjerë dhe u nisën në luftë kundër pushtuesit grek. Demir Lena u emërua nga Komisioni ndërkombëtar i kontrollit, emërohet – Oficer i xhandarmërisë shqiptare.

Gjatë vitit 1914 At Stathin së bashku me djalin e tij Manthon i gjejmë në krye të një çete dhe së bashku me forca të tjera shqiptare luftoi kundër pushtuesve grekë¹⁷. Në vitin 1916 pushtuesi grek në Shqipërinë e Jugut u zëvendësua me atë Italian. Në këtë kohë at Stathi e la Amerikën dhe u kthye përsëri në atdhe, duke hu thenë miqve “sot është koha për punë në Shqipëri. Duhet te zgjojmë ata që duhet të bëjmë diçka për Shqipërinë e nesërme”¹⁸. Në krahinën e Korçës (viti 1917) formacionet vullnetare (ndër to u dallue në shenjë sidomos grupi i Sali Butkës) që e mbajtën për një kohë vetëm ballin e Jugë-Lindjes.¹⁹

Gjatë vitit 1914 dhe deri në fund të Luftës së Parë Botërore, Islam Spahia, i njohur dhe me

¹⁷ Mexhit Kokalari, Trima të kryengritjeve popullore, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1983, f. 169.

¹⁸ Gazeta Luftëtari”, 7 mars 1976.

¹⁹ Shqipëria në vitin 1937, Vëll. II, Tiranë, Shtypshkronja “Kristo Luarasi”, 1938, f. 88.

emrin Baba Lam, siç i thoshin lumjanët, e gjejmë në krye të lëvizjes patriotike të malësisë së Lumës. E veçanta është se ka vazhduar shkolla e Kolosjanit, e mbajtur dhe e mbrojtur nga patriot e arsimdashës, me Babë Lamin në krye²⁰. Princ Vidi u habit nga kërkesat e këtij malësori analfabet dhe të largët, por që çështje kryesore kishte shkollat dhe mësuesinë. Në një konflikt me pushtuesit bullagaë, Luma që i kishin marrë me forcë bagëtinë, e zgjidhi po me forcë marrjen e tyre, ku në krye printe Islam Spahia me 200 luftëtarë të armatosur në Bjeshkët e Rekës dhe Radikës.

Në periudhën 1912-1921 në krahinën e Lumës qëndruan ushtria serbe (1912-1913, 1915-1921), ushtria bullgare (1915-1916) dhe ushtria austro-hungarezë (1916-1918). Islam Spahia dhe patriotët lumjanë qëndruan luftëtarë e stoikë ndaj pushtuesit dhe nuk u përzien në administratën e tyre, por në luftë për mbrojtjen e krahinës dhe të popullsisë së saj.

Tri regjimente nga divizioni i Nishit që kishin mbetur të fundit dhe kaluan në Dibër, ndeshën me një fuqi civile që Elez Jusufi mbledhi nga krahinat e veta e pak nga Luma. Në një luftim të rreptë që u ba, vetëm njëmijë ushtarë mundën me e shpëtue jetën tue ra rob në dorë të shqiptarëve. Të tjerët u vranë të gjithë, shumë kafshë, topa, mitraloza, arnë e municion ranë në duart e shqiptarëve, të cilët gjetën rastin e volitshëm për të shfryrë mbi armikun që i kishte shkaktuar Atdheut e sidomos Dibrës aq mjerime. Kjo luftë që ndodhi më 2 dhjetor 1915 i shtoj një kunor mburrjeje, burnisë së Elez Jusufit dhe një faqe të shkëlqyer historisë sonë kombëtare.²¹

“Në qoftë se Flamuri i Shqipnisë do të rrëzohet në Peshkopi, me pëlqimin e të gjithëve, ju lutem ma ktheni prap’, se jam i sigurt se edhe atij kam me i gjet një vend që të valvisi. Pres letrën tuaj të përbashkët me z. Eles Jusufin.” (Letër e Hasan Basriu dërguar Ismail Strazimirit)²².

Heroike ishin luftimet e zhvilluara në Malësinë e Gjakovës²³ kur atje depërtuan trupat austro-hungareze. Në Gash vepronin çetat e Mal Bajramit dhe Hazis Colit, në Shishpan e Sharr Ahmetit, etj. Gjithashtu kishte grupe të vogla që vepronin në krahinat përreth. Më pas fillon zgjerimi i lëvizjes në fshatrat si në Lekbibaj, Valbonë, Krasniqe, Pac, Berishë ku vepronin çetat e Gjelosh Ramës, Syl Brukut, Zog Binakut, Binak Gashit, etj. Këto çeta organizuan sulme kundër garnizoneve të pushtuesit. Organizimi u rrit ndjeshëm në vitin e fundit të luftës. Në pranverën e viti 1918 në luftë me pushtuesit u vranë me dhjetëra malësorë trima. Më të kombinuara veprimet luftarake të çetave u kryen gjatë vjeshtës të vitit 1918. Duke bashkëpunuar me çetat e Kosovës, si me Azem Galicës në Drenicë, Bajram Baklanit në rrethet e Gjakovës, me çetat e Kaçanikut e Cërnavilës, me të rretheve të Pejës, Hasit e të Pukës etj., që vepronin në Rrafshin e Dukagjinit, në Kosovë e në krahina të tjera përreth.

²⁰ Dr. Azis Bulica, Islam Spahia i Lumës, Shtëpia Botuese “FLLAD”, Tiranë, 2004, f. 226.

²¹ Ismail Strazimiri, Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë, Shtëpia Botuese ‘Naimi’, Tiranë, 2010, f. 76-77.

²² Po aty, f. 81.

²³ M. Çami, “Pushtimi malazez i Shkodrës dhe qëndresa kundër tij, në “Buletin shënkencor ILP Shkodër”, nr. 1, 2, 1985.

Në këto moment qëndresa e patritotëve shqiptarë mori karakterin e një lufte të organizuar. Tipik ishte sulmi i përgjithshëm kundër forcave austro-hungareze në Malësinë e Gjakovës në fillimin e tetorit 1918. Batalioni i 145-të austro-hungarez që ndodhej në Bujan u rrethua nga çetat e malësorëve. Ky garnizon u asgjësua në pjesën më të madhe të tij. Ndihmat që u nisën nga Tropoja nuk mundën të arrinin, malësorët me veprime të shkathhta prenë rrugët e furnizimit. Forcat kryesore të garnizonit u dorëzuan.

Është për t'u përmendur fakti se në çetat dhe grupet e armatosura shqiptare të Kosovës u vu re gatishmëria për të bashkëvepruar e për të lidhur luftën e tyre me atë të çetave boshnjake dhe serbo-malazeze kundër pushtuesve austro-hungareze, e bullgarë. Dihet se në verën e vitit 1916 u formuan çetat në rajonet Koloshin të Ibrit, në Rogozne dhe në Kopanik në veri të Mitrovicës. Këto çeta, që vareshin nga organizata serbe me qendër në Rashkë e Krallëvë, bënë luftë të drejtë kundër pushtuesve austro-hungarezë, por duke pasur prirje shoviniste, herë mbas here u përpoqën të dëmtonin administratën lokale shqiptare²⁴.

Në vitin 1917, kur kaloi në malësinë e Koloshinit të Ibrit, Azem Galica u takua me të në katundin Pridvoricë; aty u arrit një marrëveshje për luftë kundër pushtuesve të përbashkët austro-hungareze e bullgarë. Në bisedimet me Azem Galicën, Kostë Vojvoda tha se komanda dhe qeveria e emigruar serbe njihte të drejtat e Kosovës dhe kërkonte që lufta kundër pushtuesve të përbashkët austro-hungarezë të bëhej në aleancë me njeri-tjetrin. Në këto bisedime Azemi e shokët e tij u nisën nga qëllimi i drejtë për të dëbuar pushtuesin e përbashkët.

Në këtë kohë çeta luftarake e Drenicës, nën drejtimin e Azemit e të Shotës, mbas disa ditë luftimesh të rrepta, asgjësoi postëkomandat austro-hungareze në katundet Vojnik, Kopiliç dhe Mikushnicë të Drenicës. Aftësia luftarake dhe popullarizimi i çetës trime u shtua shumë. Midis luftërave më të mëdha kundër pushtuesve austro-hungareze është edhe lufta në rajonin Radishevë-Rudnik-Rakosh. Megjithëse armiku këtu kishte më shumë njerëz dhe armë, u mund keq dhe një pjesë e madhe e ushtrisë së tij u dorëzua.

Buzë xhadesë Pejë-Mitrovicë, njësitë luftarak i Azemit shpartalloi një garnizon prej gati dy mijë ushtarësh. Qindra ushtarakë austro-hungarezë dhe krejt shtabi e komandanti i një regjimenti ranë në duar të njësitit të Drenicës. Krejt bagëtia dhe pasuria që pushtuesit austro-hungarezë i kishin grabitur popullit dhe i mbanin në kampin e Rudnikut, iu ndanë prapë popullit. Shumë mjete të transportit ushtarak, municione dhe armë ranë në dorën e njësitit. Numri i luftëtarëve të njësitit të Azemit e të Shotës mbërriti në atë kohë në 350-400 veta.

Viti 1918. Lufta e armatosur kundër pushtuesve zgjerohej nëpër krahinat e ndryshme të Kosovës. Në Gilan, kundër ushtrisë bullgare, vepronte aktivisht e në kushte të rënda çeta e plakut të vjetër Idriz Seferi. Në Vuçitemë e Llap luftonte kundër austro-bullgarëve çeta e Bel Baçinocit dhe e Mehmet Kojuhit. Në Plavë-Guci vepronin çetat e udhëhequra nga trimi i shquar Mulla Agan Kojë, i cili, në bashkëpunim me çetat e Hysen Boshkoviqit, Isuf Mehaniqit dhe te Rek Bishevës, nga krahinat e Tutinit, Rozhajës, Bihorit e Senicës, kryenin

²⁴ Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1982, f. 54-59.

aksione të guximshme. Në afërsi të Plavës Mulla Agan Koja me çetën e tij vrau kapitenin austriak Haufman Gustav Haslor dhe në vjeshtën e 1918-es, pas një lufte të rreptë, mundi të çarmatoste 3 batalione të ushtrisë austriake. Me armët e kapura ai armatosi popullin e Plavës e të Gucisë.

Në zonën franceze të pushtimit pati organizime të luftës së armatosur të popullit. Më të organizuara u shfaqën çetat e Sali Butkës dhe të Themistokli Gërmenjit. Pas përpjekjeve të armatosura të zhvilluara në fund të tetorit e sidomos në fillim të nëntorit 1916, Komanda Ushtarake Franceze konstatoi se: në zonë ata, nuk kishin të bënin me forca të pakta, të paorganizuara, por forca të shumta shqiptare dhe të armatosura²⁵. Rrjedhime të rëndësishme të kësaj lufte ishin edhe nënshkrimi i Protokollit të 10 dhjetorit 1916 dhe ngritja e Krahinës “autonome” të Korçës²⁶.

Kur ushtritë franceze që kishin okupuar Korçën dhe qarkun e saj, mbështesnin kërkesat e Venizellosit për Shqipërinë e Jugut, Sali Butka, në krye të forcave të tij, që arrinin në 1500 veta u nis drejt Korçës dhe e rrethoi atë. Në krah të tij ishte edhe çeta e Themistokli Gërmenjit me 22 vetë. Të rrethuar, francezët kërkuan bisedime. Themistokli Gërmenji shkoi në Korçë, ndërsa Sali Butka qëndroi me ushtritë e tij në rrethinat e qytetit. Ndërsa bisedimet e Themistokli Gërmenjit me autoritetet franceze po zvarriteshin, Sali Butka u dërgoi atyre kërkesat shqiptare prej 14 pikash për vetëqeverisjen e Kazasë së Korçës nga ana e autoriteteve shqiptare. Nën presionin e brendshëm dhe sidomos atë ushtarak të forcave të Sali Butkës, autoritetet franceze e shpallën “Vetëqeverisjen e Kazasë së Korçës me gjithë rrethet nga autoritetet shqiptare”. Po kjo punë nuk vazhdoi gjatë. Në fund të luftës, autoritetet franceze e kthyen fletën, arrestuan Themistokli Gërmenjin dhe e pushkatuan në Selanik si dhe u përgatitën t’ja dorëzojnë Korçën Greqisë. Atëhere Sali Butka mblodhi forcat që arritën në 20.000 dhe mbasi e rrethoi Korçën, përsëri, i dërgoi komandantit të forcave franceze një ultimatum. Sali Butka mbrojti jo vetëm Korçën, por të gjithë Shqipërinë Juglindore nga sulmet e forcave greke.

Duhet të theksojmë se lufta e armatosur nuk ishte tipike për popullin tonë. Shumë shqiptarë gjatë kësaj lufte u organizuan në çeta dhe u vunë nën influencën e pushtuesve evropianë, nën komandën e reshtimit organik të njërive të tyre. Kjo ndodhi për arsye se shumë prej tyre, kryetarë e komandantë mendonin realizmin e aspiratave kombëtare nën këtë apo atë shtet. Nga literatura e shteteve fqinje është spekuluar shumë me këtë problem duke i konsideruar shqiptarët dhe inkuadrimin e tyre si “banda pa ideale” në shërbim të atij që i “paguante” më mirë. Është e rëndësishme të theksohet se asnjë komandant i çetave nuk u lidh me ushtritë e vendeve fqinje, megjithëse monarkitë u premtuan atyre shuma të majme. I vetmi që bëri një gjë të tillë ishte Esat Pashë Toptani.

²⁵ Gen. Descoins: “Six mois d’histoire de l’Albanie (novembre 1916-mai 1917)”, Paris, 1930, f. 18-19; M. Sarraïl, “Mon commandement en Orient (1916-1918)”, Paris, 1920, f. 221-222.

²⁶ M. Çomi, “Shqipëria në marrëdhëniet midis vendeve të Antantës në 1915-1916. Në kohën e disfatës dhe të tërheqjes të ushtrisë serbe”, në “Studime historike”, nr. 3, 1986, f. 229-236.

Historiografia ushtarake shqiptare, për vendin dhe rolin e çetave kryengritëse ende është në fillesat e saj për studimin dhe pasqyrimin e të gjithë veprimtarisë së tyre në këtë periudhë historike. Në mënyrë të përmbledhur kjo ishte veprimtaria e çetave që vepruan në Luftën e Parë Botërore në Shqipëri.

Bibliografia:

- Shqipëria në vitin 1937, Vëll. II, Tiranë, Shtypshkronja “Kristo Luarasi”, 1938.
- Fjalori i Shqipes së sotme, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1984.
- Fjalor Enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1985.
- Fjalor Enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botim i Ri, Vëll. i Dytë, Tiranë, 2008.
- Kristo Frashëri, Dëshmorëve dhe luftëtarëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve “Naim Frashëri”, Tiranë, 1962.
- Toli Arapi, Që të bëhej Shqipëria, Tiranë, 1996.
- Dr. Azis Bulica, Islam Spahia i Lumës, Shtëpia Botuese “FLLAD”, Tiranë, 2004.
- Bajo Jonuz Topulli, Topullarët e Gjirokastrës, Tiranë, 2008.
- Gani Iljazi, Lëvizja Kombëtare në Vlorë 1878-1912, Tiranë, 1999.
- S. Vllasmi, Ballafaqime Politike, Tiranë.
- Mexhit Kokalari, Trima të kryengritjeve popullore, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1983.
- Nasip Meçaj, Xhemil Çelaj, Fatmir Toçi, Enciklopedi e Kurveleshit, BOTIMET TOENA, Tiranë, 2009.
- Ismail Strazimiri, Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë, Shtëpia Botuese ‘Naimi’, Tiranë, 2010.
- Apostol Kotani, Kapedan At Stath Melani me shokë, Tiranë, 1997.
- Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1982.
- Shaban Braha, Idiz Seferi, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1981.
- Revista Mbrojtja, Arben Salihu, Nr. 4, Tiranë 2013.
- Gazeta “Luftëtari”, 7 mars 1976.

ABSTRACTS IN ENGLISH

“REVISTA USHTARAKE”, NR.2, NOVEMBER, 2021

Hybrid threats, accelerating factor of civil-military cooperation in academic field

Dr. Shpetim Cami
“Barleti” University

ABSTRACT

Hybrid threats have become the subject not only of security studies but also of strategies and action plans of countries and international organizations due to their presence and sophisticated, complex nature.

Their definition was first defined by the European Center of Excellence in Combating Hybrid Threats: The term "hybrid threat" refers to an action taken by state or non-state actors whose purpose is to undermine or damage a target by combining open and disguised military and non-military means".

Through their actions, which are public and non-public activities, they aim at an objective by influencing its decision-making at local, regional, state or international level.

Based on the discussion of new policies in the field of curricula in military education with access to civil education, this paper aims to contribute in this area.

Based on the analysis of the curriculum of the bachelor program "Studies in Military Sciences", which I consider a very good finding, in this paper it will be given recommendations for the inclusion of some elements of civil education aimed at full knowledge of hybrid threats, as "smart defense" also requires "smart armed forces."

Keywords: Hybrid threats, European Center of Excellence, military science, curriculum.

Inclusion and integration of civil-military capabilities - part of the security strategy in conditions of hybrid threats

Lieutenant Colonel (R) Mcs. Kanan Himaj
MSRI, AFA

ABSTRACT

The security environment brings surprising challenges, which require a smart understanding and estimation in responding to the situation. The object of the study is the reflection on the most sensitive issues related to the way of evaluating the comprehensive actions in the integration of the activity of state and non-state institutions. Their treatment is also important, as they help to review the major security documents of the country in focusing on the coherence of the issues we need for the country.

In this context, it is valuable to address the issue of promoting comprehensive approaches to the capabilities and effects of all instruments of power, military and civilian, governmental and non-governmental, national and international, in dealing with the consequences of hybrid threats.

The strategy for the fight against hybrid threats and risks will define the objectives and the essential instruments for the protection of the vital interests of the Republic of Albania. It is based on the Security Strategy and is in line with the security and defense policies of the Republic of Albania. This paper highlights the idea that the coherent review of NSS and MS, today, needs to evaluate comprehensive policies to counter hybrid interference.

Keywords: hybrid threats, comprehensive approach, energy instruments, civil-military capabilities, hybrid warfare, strategy review, defense and security planning.

Cyber security and Albanian legal framework

Dr. Elona Bano
“Barleti” University

ABSTRACT

In recent years, with the development of technology, humanity has not only managed to significantly improve their lifestyle, but also has been significantly exposed to new forms of crime, which seems to have already, in addition to ordinary street crime, been transferred to cybercrime. Cybercrime, as the new form of using technology to undermine social and personal security, seems to have found all of humanity unprepared and made it more vulnerable than ever.

In this line of ideas, the lack of legal framework in the field of cybercrime, with a National Cyber Security Strategy adopted only in December 2020 and with partial secondary legislation in this field, exposes even more citizens to insecurity by making difficult or even impossible the reaction of state authorities due to lack of legal instruments.

The purpose of this study is to identify the legal shortcomings and problems that institutions and human capacities of law enforcement agencies encounter in screening, investigation, detection and subsequent trial of criminal offenses that violate the security of individuals in virtual space.

Keywords: strategy, cybercrime, virtual space, legal framework

Critical infrastructure and national security

Lieutenant Colonel Bajazit Muceku
MSRI, AFA

ABSTRACT

Critical infrastructure is an asset or system, which is essential for the maintenance of vital social functions. Damage to a critical infrastructure, its damage or destruction by natural disasters, terrorism, criminal activity or malicious behavior can have a significant negative impact on the safety, economy and well-being of citizens. Interruption or complete termination of services provided by critical infrastructure, whether related to water distribution, electricity grid, energy sector or other areas, can have catastrophic effects locally, nationally and even internationally. Today, cyber threats are growing in number, type and sophistication. Various reports highlight this vital point, focusing on the many cyber threats that may arise from users of technology-based systems. In light of the numerous techniques and threat vectors available to hackers aiming to carry out an attack, entities responsible for critical infrastructure and their supply chains need to have adequate security protocols to protect themselves against cyber infiltration and hacking attacks and be able to show resilience after a real attack.

Critical infrastructure protection is the proactive system of activities used to protect essential people, physical assets, and the cyber systems on which we rely. Protecting the country's most critical assets is no easy task. It requires ongoing collaboration between key agencies and structures at all levels, as well as the ongoing implementation of improved critical infrastructure protection technologies and processes.

Keywords: Critical infrastructure, interdependence, asset, system, critical infrastructure protection, resilience

Russian naval strategy¹

Roland Tashi
AISM

ABSTRACT

The crises of recent years have highlighted all the factors that have contributed to the deterioration of relations between Russia and the West. Moscow's distrust of the West is understood as a threat that includes not only the military area, but also the cultural aspect. Another factor is European distrust of Putin, who is working to restore Russia's lost influence with the dissolution of the Soviet Union in a bid to rebuild a relationship equal to that of American power. These relations reawaken the half-asleep rivalry of the Cold War, which does not affect the calming of the political climate.

Today's Russia is significantly less powerful than the former Soviet Union, yet its armed forces have sufficient military potential to be considered dangerous to the security of the region and beyond. The Mediterranean and Black Sea region is of more interest to Moscow, the presence of naval forces has increased significantly in recent years, due to the new Russian naval policy and strategy, but also the reduction of the presence of the US Navy in this region, which has increased attention in the Indo-Pacific region.

¹ For the preparation of this article, the article “Russian Maritime Strategy”, published in March 2021 by “Difesa on Line”, a portal that deals with geopolitical issues was used and elaborated. The article was written by Renato Scafi, political and military analyst. Comments and opinions express only the opinion and judgment of the author.

Hybrid warfare, case study Russia

Lieutenant Colonel Dr. Fitim Karasani

Major Msc. Enkelejda Tyrku

FDS, AFA

ABSTRACT

The tendency to describe phenomena or events has always encountered the need to introduce new concepts into it, especially when their impact is significant. Such terms and concepts, above all when they belong to the military field, have been the subject of ongoing academic debate. Academic intertwining with the meaning or "diplomatic / political" coverage of the concept, the intellectual formation of the individual or certain situations in the security environment, are elements that directly affect the respective perspective.

For centuries it has been written what we mean by attack or defense, by marching or pursuit, by siege or counterattack, and so on. In addition, viewed in a more general context, we it has been discussed about what we mean by war; total or limited war, conventional or asymmetric war, atomic or terrorist war, etc. What is being found is that the dividing lines of the war are becoming more and more blurred or in other words we are facing a "hybrid war".

In the context of contemporary warfare, the biggest challenge is to understand how war tactics are mixed and adapted in a high-tech industrialized world. The methods of economic, political, diplomatic warfare combined, intertwined with other methods of warfare, such as cyber, information, psychological means, are already the new characteristics of war. In this article we will focus on hybrid warfare methods, which we find materialized in Russian warfare methods.

Keywords: concept, hybrid warfare, Russia, cyber, information.

Weapons of Mass Destruction - a threat to peoples' peace and security

Lieutenant Colonel Msc. Esat Neziri
Lieutenant Colonel Msc. Shpresim Shllaku
FDS, AFA

ABSTRACT

This paper aims to give a realistic overview of the impact of Weapons of Mass Destruction (WMD) on peoples' security and peace in the circumstances new phenomena in today's reality of global developments. Today's world system is in the space of opportunity to unite the efforts of all states in coping with the consequences that may be caused by the use of Weapons of Mass Destruction.

The strategies adopted by the influential organizations in today's international system have facilitated the chance to take measures to deal with situations that no single state will be able to resolve alone. Also, in today's conditions of technology and information development, new opportunities and skills have been created for certain organizations, groups and individuals, related to criminal activities, to achieve their goals, objectives and aims by using the Weapons of Mass Destruction.

In these trends of the present situation, it is difficult to recommend solutions with immediate effects affecting peoples' security and peace, but it would be impermissible not to recommend the orientation of activities leading to the taking of measures to make difficult and prevent the use of Weapons of Mass Destruction (WMD) by those who intend to use them if they could possess them. It has become a necessity creating and strengthening the conviction of political elites at national, regional, global level and the general public for the elimination of WMD, through the presentation of opportunities and capabilities that exist today in the world for their use.

Keywords: Weapons of Mass Destruction (WMD), security environment, strategy, assessment, risks and threats, challenge, coherence, cooperation

"NATO 2030" challenges – future doctrinal approach

Major Mirela Lahi
MSRI, AFA

ABSTRACT

The first two decades of this century have brought about a series of special and important events, which have significantly affected the security environment. The diversity of their action spectrum and the surprise with which these events occurred have created unpredictable and unplanned situations not only by analysts and military strategists, but also by policymakers and government structures, which in some cases put in difficult situations even states with developed economies and armed forces with an advanced technology.

Extraordinary emergence and activation of terrorist groups, kneeling of states and economic paralysis before a virus, development and destructive use of cyber-attacks on important and vital institutions to the economy and health of the population, extraordinary catastrophes and great damage caused by unstable weather due to global warming, as well as the recent situation in Afghanistan has highlighted the need to improve concepts on security, civil-military relations, on how to deal with and resolve crises regardless of their nature, analysis of the events that took place, as well as of the lessons learned from them.

The Armed Forces have been directly or indirectly involved in dealing with or resolving these crises regardless of their nature. This makes even more urgent the need for continuous adaptation of procedures, manuals, regulations and doctrinal materials, closely linking them to the preparation of structures and forces, in line with the lessons learned and the changes required.

As a NATO member country, Albania and its Armed Forces have the responsibility to be involved in the planning, preparation and development of strategy and doctrinal concepts in accordance with the initiated agenda "NATO-2030", undergoing a total review not only of the main documents that guide the development and training of forces, but a special place should be given to the inclusion of these changes in the curricula and syllabus in our military schools and training centers of every level, in order to prepare officers, non-commissioned officers and soldiers to be at the forefront of these changes.

Keywords: Concept, doctrine, strategic environment, security, military education, curriculum, AFA, NATO.

Scientific research in the field of security and defense

Colonel Dr. Ahmet Leka

MSRI, AFA

Brigadier General (R) Dr. Bardhyl Hoxha

ABSTRACT

Scientific research is a very important tool to successfully navigate in our complex world, without which we will be forced to rely only on intuition, some limited references and the blindness of fate. While many of us feel confident in our capacity to understand and interact with the world around us, history is replete with examples of how bad we can feel when we do not recognize the need for findings and evidence to support hypotheses and research questions, while researching in any kind of field, especially in that of security and defense.

The field of security and defense is very broad and specific, where security in particular appears multidimensional, including military, economic, human, health, energy, environmental, food, and border and cyber security. The security environment continues to be unpredictable and today's risks and threats continue to evolve more and more towards asymmetric, hybrid and cybernetic nature. The next ten years will be very different from previous decades, where the great competing powers have on the agenda the expansion of power and their influence in the Western Balkans, including our country. Meanwhile, in addition to known dangers and threats, new dangers from pandemics and climate change are emerging. This complexity and unpredictability of the security environment raises the need for scientific research, with the aim of identifying, analyzing, evaluating and defining approaches to address them.

Nowadays, more than ever before, a very large amount of information is in circulation and with a simple internet search for any given research topic, a considerable number of contradictory studies can come up. Therefore, in order to have reliable predictions, scientific and logical methods must be applied. Researchers can use several scientific methods to predict the future, where the application of the most appropriate method will depend on many factors, such as: specific area of interest, perspective and purpose of forecasting, time span, available data, knowledge and experience, etc. Since there is no universal scientific method for predicting in the field of security, in this article we will mainly deal with qualitative and quantitative predicting methods, and we will argue that the best approach is the combination of several scientific methods, in order to support the best research and proper understanding of security complexity in the 21st century.

Uncertainties of the future require us to adapt, which should also apply to our Academy. Military university education, especially master's and doctoral programs, cannot be imagined without active scientific research. The introduction of new scientific disciplines and the increase of research capacities to prepare young scientists should also be encouraged. We must make significant efforts to change the approach to the security and defense system, increasing the interest for scientific research in our institutions, in order to create the conditions for the modern generation, of modern knowledge. Meanwhile, a comprehensive approach would enable the establishment of stable relationships between researchers and analysts, various security institutions and bodies in our country, including academy, in order to join efforts to address the broad spectrum of today's risks and design of effective strategies to cope with them in the future.

Keywords: research, security environment, military science, strategy, methodology, academy, Western Balkans

Education and culture - their impact on national security

Colonel Msc. David Rroku,

Colonel Msc. Irela Nebiaj

MSRI, AFA

ABSTRACT

An important and prominent aspect of security issues is the military education and its culture, as a phenomenon deeply rooted in society. There is a positive correlation between education and national security. The relationship between the level of culture, education and security in any society has a great impact to anticipate and meet the contemporary challenges. Culture is defined in different ways. It often depends on an individual's experiences, the era to which he relates social norms and values. Different definitions show that culture is a concept that depends on the context or point of view we study. Culture is something with which the identity of a person, group, community, minority, organization or nation can be known.

The Armed Forces Academy (AFA), as the highest military educational institution, the only one in the field of defense and security, has its specific culture. The culture of the military higher education institution can be defined as the way of life and work, the influence of tradition and the behavior of those who attend it, which includes the teachers and all the staff. Military organizations, which are some of the oldest and most prominent institutions, are specific work environments with a unique culture. Joining the armed forces involves giving up a part of one's private life to become an officer, non-commissioned officer and soldier. When a person enters a military education system, significant life changes occur, where different forms of personal, social and professional activities are accepted. This paper analyzes the impact of education on national security, the education system in AFA, identifying the distinctive features of culture in a higher military educational institution.

Keywords: education, national security, culture, military higher education institution, cadet, student, hierarchy, military organization, subculture, study programs.

Doctrine as a fundamental and integral part of the development of the military education curriculum

Colonel Msc. Mehmet Metko

Lieutenant Colonel (R) Alqi Nikolla

MSRI, AFA

ABSTRACT

The "doctrine" concept is used in all areas of political, religious, social, cultural life... but, it has found a substantial application in the military field. Doctrinal thoughts based on relevant theories, principles, concepts have led military leaders to use strategies to achieve various goals. In this continuous cyclical process, doctrines have been changed and improved by developing and adapting to the forms of military organization, types of operations, use of forces, forms and ways to achieve strategic objectives, promote technological development and even confront the nature of the new challenges of the 21st century.

In the field of military education, doctrinal treatment as part of the curriculum takes a prominent place in military education, influencing the formation of personnel from citizens, in a military with extensive professional skills in this field. Like any other country, Albania, in military education is based on historical elements, tradition and fought battles, the role and contribution of leaders, ways and experience of military organizations on an ongoing basis. As part of the NATO alliance, the doctrinal handling of the military is based on recognizing and implementing the doctrinal system to meet the challenges of this century in the strategic security environment.

The transformations of military education, carried out by the Armed Forces Academy (AFA), have been in coherence with the latest developments in the doctrinal concepts and publications of the Western armies, which are constantly reflected in the curricula. These programs are closely linked to trends, ambitions, national needs, international contributions to the Alliance, and operational capacity development. Part of this change is the field of doctrinal development, as a system that precedes the challenges of the time in the military field.

Keywords: Concept, doctrine, strategic environment, security, military education, curriculum, AFA, NATO.

Development of new professional competencies in the Albanian higher military education

Dr. Etleva Smaçi

FDS, AFA

ABSTRACT

In the field of education, military education is among the oldest and most traditional. It aims to equip students with a set of professional competencies that are closely related to the activities they perform while on duty. However, due to a dynamic environment, the evaluation of these professional competencies and the factors that affect their result is constantly the subject of debate in military education cycles and beyond.

The very concept of lifelong learning that is present throughout the education and training of the Armed Forces leads to the constant need for incentives for new pedagogical applications and opportunities for their implementation. The professional competencies of a future officer required to perform various activities are also formed through all stages of his training and are the product of interrelated intellectual and practical activities.

The purpose of this paper is to develop a conceptual model for assessing the competencies of professional military service in the Albanian Armed Forces that would enable the development of skills to create new knowledge, such as in the field of technology, economics or strategic communication and international relations. This is because the change of professional competencies is undoubtedly influenced by the economic, social and technological progress of the society. Thus, it becomes necessary for the design of the teaching process to be based on contemporary competencies aiming at quality in education.

Keywords: military education, competencies, conceptual model, pedagogical applications

Vision, necessity for success

Prof. Assoc. Dr. Edmond Braneshi

Dr. Valbona Zeka

FDS, AFA

ABSTRACT

Vision is the process of the leader and the organization. This phenomenon gives the organization awareness of its purpose, direction, energy, strength, and identity. This process exists at every level and in every type of organization. Its content is the ultimate desired state of the organization. For this reason, vision further enhances values, providing the organization with the tools to anticipate and move confidently toward the future. Visions generally become more complex and extend over time according to management levels. The strategic vision competes for influence and resources in the development of the national strategy.

Leaders at every level of the organization are the custodians, developers, and vision articulators. Starting from leaders of small organizations to the strategic level, the leaders lead the determination of the desired final state of the organization. Only executives possess the decision-making authority, perspective, position and experience necessary to derive the vision from the environment, values and potentials of the organization.

Managers also promote the evaluation and continuous improvement of vision in response to changes in external and internal environment of the organization. The measure of vision value is objective and subjective, that is, it is the degree to which the organization fulfills its mission both currently and in the future.

Keywords: vision, leader, organization, realistic, credible, engaging, inspiring, motivating, future, process, belief, enthusiasm, planning, mission.

Dibra war - crucial for the Albanian national sovereignty

(In the context of the 100-th anniversary of Dibra War or the "nine-year war" (1912-1921) and the full return of Albanian sovereignty and territorial integrity)

Prof. Assoc. Dr. Zaho Golemi
Security Academy

ABSTRACT

*D*ibra war, although regional in size, was of great national importance. A century ago, Dibra and its surroundings made the Albanian battles in the Northeast of the country to be heard throughout the Albanian territory and also in the West. The message of the Albanian war was clear: "independence, sovereignty, state" in the limits of the legal rights of states.

An extraordinary role was played by the leaders, intellectuals and fighters, who, in order to regain the fate of the country in their hands, took up arms in the north and south of the country to declare the second independence of Albania. Without the Albanian wars, without the sound of their rifles, to be heard loudly at the Versailles Conference and further at the First League of Nations, but also at all the chancelleries of the Great Powers, there was no survival of Albania. The response in a high spirit of patriotism was in the continuation of the tradition in defense of the Arber land, where in addition to the Albanian government support, the determined and uncompromising war of the Albanian fighters and leaders of the northeastern areas of the country played an important role.

Dibra war 1920-1921, although considered a local war, had a deeply national character, because it was related to independence and sovereignty, while in terms of organization and power was very popular. The war showed awareness and maturity of the people and a clear national identity, being identified as a war of extraordinary historical importance for Albanians.

Keywords: war, organization, leader, land, national consciousness, independence, identity.

Albanian insurgent groups during the First World War

Prof. Assoc. Dr. Bernard Zotaj

Institute for the Study of Military History

ABSTRACT

Armed warfare was not typical of our people. Many Albanians organized into small groups and came under the influence of European invaders, under the command of the organic alignment of their units. This happened because many of them, presidents and commanders thought of the realization of national aspirations under this or that country. The literature of neighboring countries has speculated a lot about this issue, considering Albanians and their inclusion as "gangs without ideals" in the service of the one who "paid" them better. But it is important to note that no group commander was linked to the armies of neighboring countries, even though the monarchies promised them large sums of money. The only one who did such a thing was Esat Pashe Toptani.

This paper draws attention to the fact that a small number of warriors or permanent leaders were numerically multiplied by the local population to carry out various actions, highlighting the leading figures of the patriotic insurgent groups of this period.

The activity of the combat groups set up in different villages and provinces of Albania and Kosovo have been visible since the first period of the Renaissance, but after the Albanian League of Prizren the insurgent groups reappear more fully.

Albanian military historiography is still in its infancy for the study and reflection of the place and role of the insurgent groups and all their activity in this historical period. In summary, this was the activity of the insurgent groups that operated in the First World War in Albania.

Keywords: insurgent groups, warriors, patriotic groups, formation, armament.

KUJTESË PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” është organ teoriko-shkencor i Akademisë së Forcave të Armatosura, në interes të FARSH. Misioni i saj është promovimi i vlerave kërkimore, i zhvillimeve të reja dhe i debatit shkencor në FA. Tematika e saj trajton çështje me karakter teoriko-shkencor e analitik, në ndihmë të veprimtarisë së FA-ve, duke ofruar zgjidhje për çështjet më të rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në nivel strategjik, operacional dhe taktik, në vend, rajon e më gjerë.

Ftojmë studentët/kursantët, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AFA, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësive të FARSH të bëhen pjesë e shkrimeve në RU.

Në vijim, po japim disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen nga autorët e shkrimeve.

Struktura e artikullit

Titulli. Të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere dhe të jetë fjali emërore.

Autori, bashkautori. Poshtë titullit vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe funksionin aktual i tij/saj.

Trajtesa e shkurtuar (Abstrakti). është një përmbledhje e shkurtër e artikullit. Ai tregon

se për çfarë bëhet fjalë në një artikull, metodat që janë përdorur, rezultatet që janë fituar dhe çfarë impakti ka ky artikull. Mund të themi se abstrakti shërben si reklamë e artikullit. Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht. Poshtë tij, gjenden fjalët kyçe, pra, fjalët më me rëndësi në artikull. Trajtesa nuk zëvendëson hyrjen e vetë artikullit. Ajo zë rreth 1/2 e faqes me rreth 3-4 paragrafë të shkurtër.

Përmbajtja ose pjesa kryesore e artikullit. Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa nënçështje, në varësi të tematikës që shtrun. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë **“Hyrja”**, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij, parë në këndvështrimin e interesave të FA. Shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 8-10 faqe kompjuterike.

Formati. Faqja duhet të jetë e formatit A4; lloji i shkrimit: “Times New Roman”; madhësia e shkrimit 12. Kryeradha (paragrafi i ri) përcaktohet me pt 6 (hapësira midis paragrafëve). Teksti duhet të ketë një strukturë me maksimumin 3 nivele çështjesh kryesore. Duhet të shmangen tekstet e theksuara (*bold*) apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët (*italic*) dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura.

Grafikët, tabelat dhe fotot duhet të jenë të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Nëse një foto ose grafik është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Referencat dhe bibliografia. Çdo shkrim duhet të paraqitet me referenca (*footnote*), si dhe me bibliografinë përkatëse, e cila paraqet literaturën e shfrytëzuar. *Referencat* duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare. Në to duhet të përfshihen: mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN/ISSN, *website-in* ku ndodhet artikulli. (*p.sh. Smith, James, Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209, <http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=>*).

Shënim!

1. Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatojë rregullat e klasifikimit të informacionit.
2. Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrimë e as qëndrime politike apo partiake.
3. Artikulli duhet të dërgohet i printuar, në adresën elektronike dhe/ose me CD.
4. Vlerësimi dhe miratimi i shkrimeve për botim në Revistën Ushtarake bëhet vetëm nga Këshilli Botues i RU.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në:

Adresa: Akademia e Forcave të Armatosura, (AFA)
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)
Departamenti i Publikimeve Doktrinare
Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit
Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri
Nr. Tel: 516 /1975, 516/ 1977

